

Autor:

Dr. Musli VËRBANI

Titulli:

TEMA TË ZGJEDHURA DHE TË NEVOJSHME

Botues: **Autori**

Të drejtën e ribotimit e rezervon autori

Dr. Musli Vërbani

TEMA TË ZGJEDHURA DHE TË NEVOJSHME

Kaçanik, 2018

KAPITULLI I PARË

QËNDRIMI I ISLAMIT NDAJ DITURISË, ARSIMIT DHE SHKENCËS

Vlera e diturisë fillon me njeriun e parë

Zoti i Lartmadhëruar, Ademit a.s., njeriut të parë të njerëzimit, pasi ia mësoi emrat e të gjitha çështjeve dhe sendeve, i urdhëroi melaqet që t'i bien në sexhde, përderisa kur ishte krijesë vetëm me trup (krijesë prej balte), nuk kërkoi prej melaqeve t'i bien në sexhde Ademit:

“Dhe ia mësoi Ademit të gjitha emrat (shkencën).”(El Bekare : 31).

Nga kjo kuptohet se Melaqet e kanë nderuar, e kanë respektuar dhe i kanë rënë në sexhde Ademit a.s. vetëm pas arritjes në nivelin e diturisë dhe shkencës. Zoti i Lartmadhëruar nuk i ka urdhëruar melaqet t'i bëjnë sexhde Ademit a.s. para se t'ia mësoj emrat, andaj themi se Zoti i Lartmadhëruar i ka urdhëruar melaqet vetëm për shkak se ato nuk i kanë ditur emrat:

“Tha: më tregoni për emrat (diturinë, shkencën), nëse flisni të vërtetën. (Melaqet) I thanë: Qofsh i Lartësuar! Ne nuk dimë, përpos asaj që na ke mësuar.”

E, Ademi a.s. i ka ditur emrat. Pasi ka mësuar shkencë, Zoti i Lartmadhëruar i ka thënë (Ademit):

“Tregoju atyre (melaqeve) emrat (shkencën)”.

E pasi që Ademi a.s. ka treguar për emrat (shkencën), Zoti i ka urdhëruar Melaqet që t'i bien në sexhde, e kjo për shkak të diturisë dhe shkencës që përfaqësonte:

“Dhe Ne u thamë melaqeve bini në sexhde Ademit.”

Nga e gjithë kjo kuptojmë se njeriu e ka vlerën dhe respektin kur arrin nivel të lartë arsimor dhe shkencor.

Vlera e diturisë fillon me zbritjen e ajeteve të para

Njeriu, nëpërmjet arsimit dhe shkencës e kupton qëllimin e krijimit të tij dhe e njeh vetveten, e kupton gjithësinë dhe e njeh Krijuesin e tij. Kjo ka qenë edhe arsyeja se pse Muhamedit a.s. ajetet e para i kanë zbritur për hulumtim, studim dhe shkencë, e jo për adhurim:

“Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili Krijoi.

E krijoi njeriun nga një droçkë gjaku.

Lexo se Zoti yt është më Fisniku.

Ai është i cili ia mësoi njeriut pendën.

Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte.” (El Alek : 1-5).

Kjo është jehona e parë e cila e çmon dhe e lartëson vlerën e diturisë dhe i shpall luftë analfabetizmit dhe e vendos vulën e arsimimit dhe shkencës.

Allahu, melekët dhe dijetarët

Allahu i Lartmadhëruar i ka lartësuar gradat e dijetarëve aq shumë, saqë i ka bashkëngjit me veten e Tij dhe melekët në dëshminë e Njeshmërisë së Tij dhe konfirmimin e drejtësisë së Tij:

“Dëshmon Allahu, se nuk ka Zot pos Tij, edhe melekët dëshmojnë një gjë të tillë, e edhe të pajisurit me dituri (dëshmojnë Njeshmërinë e Krijuesit) duke mbajtur drejtësi.”(Ali Imran : 18).

Kjo nuk është çudi, sepse si ka mundësi që mendjet e dobëta dhe njohuritë e ngushta të kuptojnë Lartësinë e të Madhërishmit, të Lartit, dhe si ka mundësi që ai që jeton në errësirë dhe injorancë ta njoh realitetin mbi Zotin e jetës, apo si mundet i padituri të kuptojë një segment prej cilësive të Tij madhore dhe fakteve të Tij të larta.

Gjithësia është shkolla e besimit

Ai i cili analizon Kur'anin, bindet se gjithësia është shkollë e besimit të së vërtetës, e dituria është mësimi në atë shkollë, dhe se hapi i parë në atë shkollë është një argument më shumë për të besuar dhe për të vërtetuar të vërtetën e Islamit. Islami rritet me dituri ashtu siç rritet trupi i njeriut me ushqim. Islami zhvillohet me dituri ashtu siç zhvillohet bima prej rrezeve të dritës dhe thithjes së ujit.

Në islam shkenca ka vlerë të madhe. Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë:

“Ata nga mesi i juaj, që besojnë dhe të cilëve u është dhënë dituria, Allahu do t'i ngritë në shkallë të larta.” (El Muxhadele : 11)

Po të mos ishte shkenca dhe arsimimi një çështje shumë e rëndësishme, Zoti i Lartmadhëruar nuk do t'i thoshte Muhamedit s.a.v.s. që të lutet:

“Dhe thuaj: O Zoti im! Më shto dituri.” (Ta Ha : 114)

Dituria është rruga për të njohur Krijuesin

Dituria, arsimi dhe shkenca janë rruga për të njohur Krijuesin, për të kuptuar gjithësinë, sepse pa logjikë dhe mendje nuk kuptohen ajetet, sepse pa analizë dhe pa meditim nuk mund të kuptohet se kush i ka zbritur ajetet e Kur'anit. Pa dituri, shkencë dhe arsim, nuk mund të kuptohen as ajetet, as nuk mund të njihet shpallësi i ajeteve të Kur'anit.

Teoritë dhe idetë pa argument nuk kanë vlerë. Ai i cili analizon ajetet e Kur'anit, sheh qartë gjurmët e logjikës, mendjes dhe shkencës. Logjika, dituria dhe shkenca, janë kusht themelorë për të njohur Krijuesin. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Thuaj (O Muhamed): Më tregoni mua çka kanë krijuar në tokë, dhe çfarë pjesëmarrje kanë ata në qiej, të cilëve në vend të Allahut u luteni? Më sillni një libër të hershëm për të vërtetuar këtë ose më sillni ndonjë gjurmë të dijes, nëse flisni të vërtetën.” (El Ahkaf : 4)

Ata të cilët injorojnë Krijuesin e tyre nuk kanë argument se kanë njohuri dhe shkencë, por përkundrazi është argument i mos arsimimit dhe mos dëdorisë së tyre. Për ta Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Disa njerëz diskutojnë për Zotin pa kurrfarë dëdurie, pa udhërrëfyes dhe pa Libër ndriqes.” (El Haxh : 8)

Në Kur’an, pandërprerë përsëritet refreni i përfundimit të ajetit si vijon:

“Pa dyshim, në këto ka shenja për njerëzit që kanë mend.” (err-Rradë : 4).

“Vërtetë, këtu ka këshillë për të dëdurit.” (en-Neml : 52);

“Vërtetë, këtu ka tregues për njerëzit që kuptojnë.” (en-Nahl : 11);

“Padyshim, në këtë ka shenja për të dëdurit.” (er-Rum : 22);

“Ai ua shpjegon shenjat e Tij njerëzve që logjikojnë dhe analizojnë.” (Junus : 10)

Ai i cili i analizon ajetet e Kur’anit, e kupton qartë se Islami e obligon muslimanin të studioj dhe ia obligon shkencën dhe arsimimin. Në personalitetin e muslimanit *shkenca* dhe *arsimi* janë dy pjesë të pandashme.

Në islam, feja është shkencë dhe dëduri, dëduria dhe shkenca janë fe, që do të thotë: Islami e bën bashkimin e shkencës me fenë. Prej qëllimeve kryesore të islamit është edukimi dhe arsimimi i njeriut, me fjalë tjera, synon kompletimin e njeriut në të gjitha aspektet, si në aspektin trupor ashtu edhe në atë shpirtëror. Pasi që, dihet se njeriu udhëhiqet prej mendjes dhe zemrës, e jo prej syrit dhe veshit.

Gjatë tërë kohës mesjetare, KISHA i është përmbajtur parullës *shkenca është armik i fesë, mendimi (logjika) është armik i besimit*. Faktori shkencë dhe dëduri ka qenë arsyeja e urrejtjes ndaj KISHËS dhe ka qenë shkak i fillimit të një epoke të re, e ajo epokë është quajtur *epoka e Renesancës (rilindjes)*.

Kështu ka qenë njerëzimi edhe para dërgimit të Muhamedit s.a.v.s.. Njerëzimi ka qenë në injorancë dhe errësirë, ndërsa ardhja e Muhamedit s.a.v.s. i ka nxjerr prej errësirës së injorancës në dritën e arsimimit dhe shkencës. Ardhja e Muhamedit a.s. ka qenë sikurse shiu që ngjallë tokën e vdekur, e cila një kohë të gjatë ka pasur thatësi të madhe. Shkenat islame dhe shkenca në përgjithësi kanë ngjallë zemrën e vdekur. Në Sahihajn është i regjistruar hadithi ku Muhamedi s.a.v.s. thotë:

“Shembulli i dërgimit tim prej Allahut me udhëzim dhe dituri, i ngjan shembullit të shiut i cili bie në tokë, dhe, një pjesë e tokës e cila është e mirë dhe e pëlleshme, e pranon ujin dhe nga aty mbin bimë, krijohet gjallëri dhe gjallesat ushqehen. Toka ka qenë e thatë, por e ka pranuar ujin dhe All-llahu ka sjellë dobi, sepse njerëzit kanë pirë, kanë ujitur dhe kanë gjallëruar. Ndërsa pjesa tjetër e tokës e cila është e thatë nuk e pranon ujin, dhe nga aty nuk mbin bimë dhe nuk ka gjallëri. Ky është shembulli i atyre të cilët thellohen në kuptimin e diturisë së All-llahut dhe i sjellin dobi (njerëzimit) duke u arsimuar dhe duke i arsimuar tjerët dhe shembulli i atyre të cilët nuk e ngrenë kokën dhe nuk e pranojnë udhëzimin e All-llahut me të cilin udhëzim jam i dërguar.”.

Dispozita e diturisë në Islam

Bëhet pyetja: Çfarë dispozite ka dituria në islam?

Në islam, ndonjë pjesë e diturisë është farz ajn (obligim i individit), një pjesë tjetër farz kifaje (obligim i shoqërisë), një pjesë tjetër vaxhib, një pjesë tjetër sunet, një pjesë tjetër e pëlqyer, një pjesë mekruh, dhe një pjesë haram.

Farz ajn (obligim individual) është të mësuarit dhe të arriturit e diturisë aq sa i nevojitet njeriut për fenë dhe jetën e tij.

Farz kifaje (obligim kolektiv) është dituria e cila përpos vetes i sjell dobi edhe tjerëve me diturinë e përfutur.

E pëlqyer (mendub) është të thelluarit në çfarëdo shkence si në shkencën e fikhut apo të mjekësisë, etj.

Haram është të mësuarit e sihrit (magjisë).

Mekruh është të humburit kohë në çështje që i mëson të tjerët vetëm me humb kohë, apo çka është në kundërshtim me parimet islame.

Islami dhe dituritë e dobishme

Muhamedi s.a.v.s. ka bërë lutje:

“O Zoti im, më jep dituri të dobishme.”

Muslimani duhet t'i njeh bazat që sot quhen shkenca shoqërore, siç janë: psikologjia, sociologjia, ekonomia, filozofia, etika, historia, etj., sepse njeriu është qenie shoqërore. Po ashtu, muslimani duhet të mësoj shkencën e cila bazohet në kërkim, eksperimentim dhe që i nënshtrohet masave dhe kontrollimeve siç janë: fizika, kimia, biologjia, gjeologjia, astronomia, anatomia, mjekësia, etj., ashtu sikurse i mëson edhe shkencat fetare, sepse nëse i bëjmë vështrim ajeteve kur'anore dhe haditheve të Muhamedit s.a.v.s. shohim se fjala *dituri* asnjëherë nuk është përkufizuar vetëm në *dituri fetare*, por fjala *dituri* ka për qëllim dituritë (shkencat) fetare, dituritë (shkencat) natyrore dhe dituritë (shkencat) shoqërore.

Feja nuk mund të ketë rëndësinë e saj, pa i pasur të gjitha këto shkenca në shërbim të saj. Islami është feja e cila e bën bashkimin e diturisë dhe fesë, dhe nxitë për hulumtim, zhvillim dhe shkencë.

Dituria dhe fëmijët

Pasuria dhe fëmijët janë stoli e kësaj bote dhe lumturi e jetës, për to Kur'ani thotë:

“Pasuria dhe fëmijët janë stoli e kësaj bote.” (El Kehf : 46)

Mirëpo, më e dobishme se pasuria dhe më e dobishme se fëmijët është dituria, arsimi dhe shkenca.

Mus'ab ibn Umeri e ka këshilluar birin e tij duke i thënë:

“O biri im, arsimohu dhe përfito dituri, se nëse ke pasuri dituria është stoli e asaj pasurie, e nëse nuk ke pasuri, vet arsimimi yt dhe dituria jote është pasuri.”

Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

“Kur vdes njeriu, i ndërpriten veprat e tij përpos tre çështjeve: Lëmoshës qarkulluese, diturisë frytdhënëse, dhe fëmijës i cili lutet për të.”

Shikoni pra, se si Muhamedi s.a.v.s. e ka barazuar diturinë, pasurinë dhe fëmijët. Mirëpo nga këto tri çështje dituria dhe arsimimi kanë përparësi

ndaj pasurisë dhe fëmijëve. Pas vdekjes pasuria dhe fëmijët ndalen dhe nuk të përcjellin më larg se deri te varri, ndërsa dituria vazhdon rrugën me ty edhe në varr, vazhdon dhe qëndron me ty edhe pas vdekjes, kështu pra në krahasim me dy të parat është më e vlefshme dhe më e dobishme.

Dituria dhe pasuria

Dituria, është trashëgimi e pejgamberëve. Pasuria ka nevojë për t'u ruajtur, ndërsa dituria e ruan pronarin e tij. Dituria e forcon njeriun për të kaluar urën e siratit, ndërsa pasuria mund të jetë penguese e kalimit të urës së siratit.

Sulejmani a.s. ka pasur pasuri të madhe, ka qenë mbret, mirëpo asnjëherë nuk është krenuar me pasurinë dhe mbretërinë e tij, por sa i përket diturisë ai ka thënë:

“...O ju njerëz, ne jemi në shkallë të lartë të diturisë, saqë jemi në gjendje të kuptojmë edhe shpendët...” (en Neml : 16)

Dituria dhe pushteti

Dituria të sjellë pushtet, pasuri dhe qeverisje. Sulejmani a.s. për të mbizotëruar frontin e Belkisës, ai nuk ka thënë se e lëvizi frontin e Belkisës me forcën e dorës sime por ka kërkuar këshillë dhe ndihmë prej tjerëve, në atë mes është paraqitur i dituri (i shkencës) i cili i ka thënë unë e sjelli frontin e Belkisës para se të lëvizësh vendin, para se ta përfundosh fjalën. Dhe ashtu ka ndodhur, siç e tregon Kur'ani:

“Por ai që ishte pajisur me diturinë e Librit tha: Unë do ta sjell (fronin) e saj ty sa qel e mbyll sytë.”

Kur (Sulejmani) e pa të vendosur para tij, tha:

“Kjo është nga dhuntitë e Zotit tim.” (en-Neml, 40)

Dituria është rruga e Allahut

Muslimani asnjëherë nuk ngopet me të mirat të cilat i dëgjon derisa të hyjë në xhenet. Ai i cili kërkon dituri dhe arsimohet është në rrugë të Allahut. Dituria dhe arsimimi janë shpirti i islamit dhe thelbi i tij. Islami pa dituri dhe arsimim nuk mund të jetë i sigurt e i garantuar dhe nuk mund të ekzistoj. Në këndvështrimin Islam, njerëzit i takojnë njërës prej dy grupeve: ose nxënës që arsimohet dhe kërkon udhëzim, ose dijetarë arsimues që kërkon zgjerim, hulumton dhe thellohet në shkencë. Jashtë këtyre dy grupeve, të gjithë të tjerët janë të pavlerë dhe të parëndësishëm. Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

“Arsimtari dhe nxënësi janë partnerë në mirësi, e në njerëzit tjerë nuk ka dobi.” (Transmeton ibni Maxhe).

Ai i cili studion, arsimohet dhe arsimon, ka vlerë më të madhe se të shehidit. Në ditën e Kijametit do të matet në peshojë ngjyra e dijetarit dhe gjaku i shehidit, ndërsa ngjyra e dijetarit do të peshojë mbi ngjyrën e shehidit. Lusim Allahun e Lartmadhërishëm që të na e shtojë diturinë, të na arsimon, të na ngritë në shkallë të larta me shehidët dhe pejgamberët, në xhenetet më të larta.

RRETH DITËS SË MËSUESIT

Më 14 – 22 nëntor 1908 është mbajtur Kongresi i Manastirit, apo me fjalë tjera Kongresi i Alfabetit, pra, për përcaktimin e alfabetit të gjuhës shqipe.

Dy dekada më parë, në mars të vitit 1887 në Korçë është hapur mësonjëtorja e parë shqipe. Logjikisht duhej të ishte e kundërta, sepse para se të mësohen fjalët duhet të mësohen shkronjat, por ja që ka ndodhur e kundërta, por parashtrohet pyetja, ajo shkollë e parë shqipe, a ka mësuar me shkronja të alfabetit shqip (latin) apo...? Nëse quhet shkolla e parë shqipe do të duhej që në të të mësohej me shkronja shqipe.

Përndryshe, dita e mësuesit, pra, Dita Botërore e Mësuesit është më 5 tetor, pasi që UNESCO, në vitin 1994 e ka përcaktuar 5 tetorin si Ditën Botërore të Mësuesit.

Në Paris, më 5 tetor 1966 miratohet edhe Statuti i Mësuesve. Po në këtë vit, sipas idesë dhe sugjerimit të UNESCO-së është hartuar edhe betimi solemn i mësuesit mbi bazën e betimit të Hipokratit.

Në historinë njerëzore, i pari i cili të folurit e ka shprehur dhe e ka paraqitur me shkronja është mësuesi – IDRISI. Mësuesi – IDRISI është ai i cili i ka mësuar njerëzit që me anë të shkrimit t'i paraqesin rregullat e fesë dhe të shkencës, në mënyrë që njerëzit të jetonin të lumtur, të punonin me sinqeritet, t'i ndihmonin njëri-tjetrit për të krijuar shoqëri të shëndoshë.

“Në libër (Kur'an) përkujtoje Idrisin (mësuesin). Vërtetë ai (Idrisi – mësuesi) ka qenë i sinqertë dhe peygamber. Ai (Allahu) e ka ngritur në një vend të lartë.” (Merjem : 56, 57)

Pra, Idrisi është i pari i cili ka shkruar, ka lexuar dhe i ka mësuar të tjerët për shkrim-leximin. Për këtë arsye e ka marrë emrin Idris – MËSUES.

Idrisi ka pasur dëshirë që të udhëtojë nëpër botë që të përhapë fenë dhe t'ua mësojë të tjerëve rregullat e fesë, bashkëpunimit dhe mënyrën e jetesës në baza morale të shëndosha dhe fetare, për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar për të ka thënë:

“Ai (Allahu) e ka ngritur në një vend të lartë.” (Merjem : 57)

Pejgamberët, e prej tyre edhe vula e pejgamberëve Muhamedi a.s. na kanë mësuar ta njohim Krijuesin, ndërsa shkencëtarët na i kanë zbuluar zbulimet shkencore për të vërtetuar thëniet e pejgamberëve për të njohur Krijuesin – Zotin.

Në fund...

Ai i cili e do mësuesin, e do edhe nënën edhe babën edhe vëllanë edhe motrën edhe familjen edhe shoqërinë edhe atdheun edhe njerëzimin edhe natyrën edhe kozmosin. Ai i cili i ka këto virtyte, atë e ngritë Zoti i Lartmadhëruar lartë ashtu siç ka thënë Zoti i Lartmadhëruar për Idrisin – Mësuesin:

“Ai (Allahu) e ka ngritur në një vend të lartë.”

NË BARNATOREN E LUTJEVE

Lutja është pjesë e natyrës njerëzore. Përndryshe, lutja është një veprim për kërkim falje, lavdërimi, kërkesë për largimin e vështirësive, kërkesë e ndonjë begatie ose falënderim.

Kur Aishja r.a. e ka pyetur Muhamedin a.s. se cilën lutje ta bëjë në natën e Lejletul Kadrit, Muhamedi a.s. i ka thënë:

O Zoti im, Ti je falës,

E do faljen,

Më fal mua.

Përndryshe, lutja është:

- Armë e besimtarit;
- Shtyllë e fesë;
- Thelb i adhurimit;
- Ushqim shpirtëror dhe mendor;
- Shpresë dhe kërkesë drejtuar Allahut xh.sh.; dhe
- Dritë e qiejve dhe e Tokës me të cilën qetësohen zemrat dhe shpirtrat.

Kur të lutesh:

Lute Zotin:

- Me zemër;
- Me shpresë;
- Me durim;
- Me sinqeritet;
- Me bindje të thellë; dhe
- Me vendosmëri.

Dije se lutja ka:

- Shtyllat;
- Degët;
- Kohën; dhe
- Arsyen; e saj.

- Nëse e qëllon shtyllën, forcohesh;
- Nëse i qëllon degët, lartësohesh;
- Nëse e qëllon kohën dhe arsyen, shpëton.

- Shtylla e saj është: që të bëhet me gjithë zemër dhe duke shpresuar në Allahun;

- Degët e saj janë: sinjeriteti dhe ushqimi hallall;
- Koha është: kur njeriu është i vetmuar dhe i qetë shpirtërisht;
- Arsyet e pranimit janë: salavatet mbi Muhamedin a.s.

Zoti i Lartmadhëruar gëzohet kur besimtari i lutet Atij, ndërsa hidhërohet kur besimtari e braktis lutjen. Zoti i Lartmadhëruar në Kur'anin fisnik i ka thënë Muhamedit a.s.:

“E kur robërit e Mi të pyesin për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes së atij që lutet...”.

- Njeriu ndonjëherë sëmuret dhe e humb shëndetin dhe pasurinë;
- Ndonjëherë pikëllohet;
- Ndonjëherë tradhtohet; e
- Ndonjëherë frikohet.

Përpos lutjeve të falënderimit, lavdërimit, kërkim faljes, njeriu ka nevojë të lutet edhe për tejkalimin e vështirësive, e për këtë duhet të shkojë tek barnatorja e lutjeve. Barnatorja e lutjeve i ka këndet e veta dhe duhet shikuar në barnatore llojin, formën dhe mënyrën e lutjes, për rastin e caktuar. Të shikojmë disa kënde të lutjeve që gjenden në barnatoren e lutjeve sipas Kur'anit dhe efekti i tyre shërues në ato raste.

Këndi i barnatores për fëmijë, sëmundje dhe pasuri

Nëse ndodhë dhe humb pasuri, s'ke fëmijë, mbetesh i vetmuar, mos ngurro por lutju Zotit dhe thuaj:

“Më gjeti fatkeqësia, kurse Ti je më i Mëshirshmi i të gjithë mëshiruesve.

Zoti do të përgjigjet ashtu siç iu përgjigj Ejubit a.s.:

“Tu përgjigjem nga mëshira Jonë dhe fatkeqësinë që e mundonte ia hoqëm, dhe ia dhamë familjen, dhe krahas tyre edhe aq (ia dyfishuam familjen), që të jetë mësim për adhuruesit.” (El-Enbija, 83-84)

Mos mendo se kjo ka të bëjë vetëm me peygamberët dhe posaçërisht për Ejubin a.s., përkundrazi, Kur'ani e tregon këtë rast në mënyrë që kur të ketë raste të tilla le të luten njësoj, se Ai Allahu do t'ju përgjigjet atyre ashtu siç ju ka përgjigj Ejubit a.s..

Këndi i barnatores për pikëllim dhe zemërim

Nëse je i zemëruar, i pikëlluar, lutju Zotit dhe thuaj:

“Nuk ka Zot përveç Teje, Ty të takon Lavdërimi, Unë me të vërtetë isha prej të padrejtëve.”

Mos mendo se kjo ka të bëjë vetëm me Junusin a.s. i cili ishte në momentet më të vështira, në thellësi të detit, në errësirën e barkut të peshkut, sepse kjo tregon se ashtu siç Junusit a.s. i është përgjigj, ashtu do t'ju përgjigjet edhe atyre të cilët janë në vështirësi dhe në pikëllim:

“Tu përgjigjem dhe e shpëtuam nga ajo që e shtrëngonte. Kështu Ne i shpëtojmë besimtarët.” (El-Enbija : 87, 88).

Pas lutjes me vendosmëri, largohet pikëllimi dhe zemërimi.

Këndi i barnatores për fëmijë

Fëmija është dritë e jetë dhe kopsht i kësaj bote. Nëse nuk ke fëmijë shiko në barnatoren e lutjeve dhe lutju Zotit:

“O Zoti im, mos më lër të vetmuar, e Ti je trashëgimtari më i mirë.”

Zekerijai a.s. ishte plakur, eshtrat iu kishin dobësuar, ishte thinjur i tëri, gruaja e tij ishte plakur, por kur iu lut Zotit t’i japë fëmijë, Zoti ia plotësoi dëshirën dhe ia dhuroi djalë (Jahja), i cili ishte edhe pejgamber, i ditur, i urtë, i sjellshëm për familjen dhe i devotshëm. Mos mendo se kjo lutje është vetëm për Zekerijain a.s., përkundrazi, kjo është lutje të cilën duhet thënë edhe ata të cilët nuk kanë fëmijë dhe Zoti do t’ju përgjigjet ashtu siç iu është përgjigj Zekerija a.s.:

“Ju përgjigjem dhe atij i dhuruam Jahjanë.” (El-Enbija : 89)

Lutja në fjalë është për çdo çift bashkëshortor të cilët ende nuk e kanë përjetuar gëzimin e fëmijës.

Këndi i barnatores për sigurim nga tradhtia dhe mashtrimet

Nëse e ndjen se dëshirojnë të të tradhtojnë, atëherë lutju Zotit:

“...dhe unë çështjet e mia i lë në kompetencë të Allahut. Vërtetë Zoti i sheh robërit.”

Pastaj Zoti do të shpëton nga të këqijat e lajkave të tyre siç tregon Zoti i Lartmadhëruar:

“Dhe Zoti e mbrojt nga të këqijat e të cilave e tradhtuan.”

Këndi i barnatores për largim të stresit dhe frikës

Nëse dëshiron të sigurohesh nga stresi dhe frika atëherë lutju Zotit:

**“Më mjafton Allahu, Ai është Ndihmëtari dhe Mbrojtësi më i mirë.”
(Ali Imran : 173)**

Atëherë Zoti frikën do ta zëvendësojë me *siguri* dhe *qetësi* shpirtërore dhe në mirësi, siç e tregon ajeti fisnik:

“Dhe iu shndërrua në begati prej Zotit dhe në mirësi dhe nuk i përfshiu asnjë e keqe por vetëm kënaqësia e Zotit.” (Ali Imran : 174)

Barnatorja e lutjeve është e mbushur me lutje andaj mos hezito por lutju Zotit se ai të përgjigjet për:

- Shërimin;
- Tejkalimin e rreziqeve;
- Tejkalimin e fatkeqësive; dhe
- Shtimin e të mirave; dhe kërkesave tjera.

RUKJA – PËSHTYMFRYERJA

Rukje, është fjalë e cila nënkupton **diçka që largon të keqen**, pra mbrojtje nga e keqja, e padëshiruara, ose shërim për të sëmurin.

Rukje, do të thotë të pështyhet në enën e cila ka ujë, apo mjaltë, apo ushqim, apo diçka tjetër, me fjalë të tjera, rukje konsiderohet lëshimi i ajrit të kondensuar prej fytit në ujë.

Në të kaluarën është thënë “me fry” ndërsa në esencë është frymëpështymje (pa lëng).

Arabët paraislamik besonin në këtë besëtytni, ndërsa islami rukjen e sheh si diçka që nuk ka ndikim pa dëshirën e Allahut.

Ka ardhur tekst i drejtpërdrejtë për refuzimin dhe ndalimin e Rukjes. Muhamedi a.s. për ata që hynë në xhenet ka thënë: **“janë ata të cilët: as nuk kërkojnë t’u bëjnë rukje, as nuk bëjnë rukje, dhe as nuk merren me hajmali, por i mbështeten Zotit të tyre.**

Bërja e rukjes dhe kërkesa që të të bëhet rukje janë veprime të urryera në Islam. Transmetohet nga Ibn Mesiu r.a. se ai ka hyrë te gruaja e tij dhe kur sheh diçka të varur në qafën e saj, ja heq prej qafe dhe i thotë: Ka ardhur Umeti i Muhamedit a.s. që të mos i bëhet idhujtari Allahut, në çështje për të cilat nuk ka njohuri dhe të mos bëjnë “Tilvete”.

I thonë: O Abdurrahman, sa i përket dukurisë së rukjes dhe hajmalisë e dimë, por çka është **“Tilvete”**.

Është përgjigjur: (Tilvete është) Veprimi, të cilin e bëjnë gratë, për të qenë të dashura te burrat e tyre. Hajmalitë i kanë vendosur në trupin e fëmijës për t’i larguar nga mësyshi dhe xhinët.

Muhamedi a.s. ka thënë. **“Rukja, Hajmalia dhe Tilvete janë idhujtari.”** (Transmeton Ahmed, Ebu Davudi, Bejhekiu dhe Hakimi, ndërsa e ka vërtetuar edhe Dhehebiu).

Dijetarët të cilët e kanë lejuar rukjen, e kanë lejuar me tre kushte:

- Të përmendet Allahut;
- Emrat e tij të përmenden në gjuhën arabe;
- Të dihet se rukja nuk ka ndikim por shërimi është prej Zotit.

Përderisa, dijetarët i kanë ndaluar hajmalitë, pa marrë parasysh pa ajete të Kur’anit apo me ajete të Kur’anit.

Personi i cili ballafaqohet me situata të rënda shpirtërore dhe i cili dëshiron të triumfojë kundër shejtanëve, thjesht e këndon **“Eudhubilahirin”**

(Eudhu bil-lahi mineshejtani-rraxhiimë / Kërkoj mbrojtje tek Allahu që të më mbrojë nga shejtani i mallkuar). Thotë Zoti i Lartëmadhëruar: **”Dhe kur të cyt shejtani me ndonjë cytje atëherë kërko mbrojtje nga Zoti. Pa dyshim se Ai dëgjon dhe është i Ditur”.** Për këtë arsye, kusht i rukjes është gjuha arabe, dhe nuk lejohet që të bëhet as me simbole as me shenja.

Ka dallim në mes të lutjes për shërim dhe rukjes

Askund nuk përmendet se Rukja është **“shërimin me Kur’an dhe Sunet”** ashtu siç pretendojnë rukjexhitë.

“Lutjet për shërim” janë lutje për shërim të cilat mund të lexohen në Kur’an duke e mësuar Kur’anin dhe jo duke e lënë pas dore dhe në duart e të tjerëve. Zoti i Lartëmadhëruar thotë: **“Ne shpallim nga Kur’ani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët e që mohuesve keqbërës u shton vetëm humbje.”** (El Isra : 82)

Allahu nuk ka zbritur nga qielli ndonjë shërues më të dobishëm, më gjithëpërfshirës, më madhështor dhe më efektiv për heqjen e sëmundjes se sa Kur’ani, i cili është shërim për zemrat nga sëmundja e injorancës, e dyshimit, e pasigurisë, etj. Muslimani duhet të lexojë sa më shumë Kur’an, ose të dëgjojë sa më shumë. Nëse nuk mund të lexojë atëherë duhet të përpiqet sa më shumë që të mësojë të lexojë Kur’anin arabisht, sepse kështu ai e ruan veten dhe shtëpinë e tij nga çdo e keqe dhe e lidh veten me Allahun e Madhëruar dhe kështu nuk mbetet vend për të keqen, as për stres e as për sëmundje, as për magji e as për xhin, por vetëm për melek, mirësi, e pas kësaj Allahu është Ai i cili e ka në dorë suksesin, prandaj lutjuni Allahut sa më shumë.

Nëse rukja do të kishte efekt shërues mbi një femër e cila kurrë nuk falet dhe nuk i kryen obligimet e saj, dhe është e zhytur në mëkate, dhe prapë mendon të vazhdoj jetën si e tillë, atëherë çfarë dobie ka rukja te ajo, kur edhe pas rukjes vazhdon të jetojë e tillë. E njëjta vlen edhe për meshkujt e tillë. A mund të ketë rukja efekt shërimi për këta? A mund të ketë këndimi i Kur’anit efekt shërimi te ta? Kurrësi jo!

Kur’ani është shërim i zemrave, ai largon nga mëdyshjet, injoranca, besimi i verbër, pikëllimet, vështirësitë, brengat, mërzitë, etj.. Për këtë arsye Muhamedi a.s. ka bërë këtë lutje: **“O Zot! Bëje Kur’anin qetësim të**

zemrës sime, dritë të gjoksit tim. Largim të mirësisë sime. Largues të brengave dhe vështirësive të mia.”

Rukja dhe praktikumi bashkëkohor i saj nuk ka të bëjë me atë të cilën e kanë lejuar dijetarët

Mënyra se si bëhet ‘rukje’ në këtë kohë, nuk është sipas sheriatit dhe kjo mënyrë nuk është vepruar në kohën e gjeneratave të para. Nëse dikush e përdor si argument hadithin e Ebu Seid el Hudrijut r.a. kur ai me shokët e tij kërkuan të priten si mysafir nga një fis por ata nuk i mirëpritën por i refuzuan, e që më pas kryetari i këtij fisi ishte kafshuar (nga një gjarpër ose akrep), kështu që, ata filluan që të kërkonin dikë për ta shëruar nga helmi i gjarprit, dhe Ebu Seidi dhe sehabet që ishin me të u thanë: Po, ne do t’i bëjmë lutje për te. Ai u tha atyre: Beto hem në Allahun, unë vërtet bëj rukje, por ju nuk na mikpritët si mysafir, andaj ne nuk do t’i bëjmë rukje atij përderisa ju të na jepni ndonjë shpërblim. Ata u dhanë një tufë dele, kështu që Ebu Seidi i këndoi atij suren “El Fatiha”. Muhamedi a.s. e aprovoi këtë, e madje tha: Më jepni edhe mua një pjesë (të mishit). Ky hadith është i vërtetë, por argumentimi me të është i paqëndrueshëm, sepse ata kishin arsye përse morën dhuratë dhe arsyeja ishte se ai fis ishin koprrac, kështu që ata u ndëshkuan për shkak të refuzimit të kërkesës së tyre. Asnjëri nga sahabët nuk e mori këtë rast si shkas që të hapë ‘klinika’ për të bërë rukje. Në qoftë se ky veprim do të ishte i lejuar, ata (sahabët) do të na kishin paraprirë neve sepse ata ishin më të interesuarit për të qenë më të dobishëm për njerëzit dhe për ta zbatuar sunetin.

Kështu që, të merret “rukja” si profesion dhe të hapet diçka e ngjashme me klinikat apo spitalet, nuk është vepruar nga askush tjetër përveç dashakeqësve të islamit. Ata kanë shfrytëzuar shumë gënjeshtër në mënyrë që të hanë pasuritë e njerëzve padrejtësisht, kështu që kanë filluar të hapin **“klinika të rukjes”** me pretendimin se kjo është “Rukje sheriatike”. Ata kanë trilluar gënjeshtër dhe besëtytni, dhe janë fshehur në sy të njerëzve me anë të leximit të Kur’anit, dhe kështu janë tallur me njerëzit. Për shkak të kësaj janë bërë shumë dëme të cilat nuk numërohen e as llogariten.

Veprimet që ne i shohim si f.v.: shishe në disa shitore me ambalazhe si: “kjo është rukje e filanit”, dhe rastet tjera si thëniat: “rukja e filanit shitet më shtrenjtë se rukja e alanit”, me pretekste banale se ky ‘hoxhë’ është më i fortë se ky tjetri. Këta që po praktikojnë këtë lloj rukje në esencë janë duke

u marrë me magji (mashttrim), gënjeshtër, marrëzi dhe ngrënie të pasurisë së njerëzve me pa të drejtë. Disa që bëjnë rukje i shtojnë metodat e rukjes me qëllim që të grumbullojnë sa më shumë pasuri. Ata të cilët hapin ‘qendra klinike’ apo ‘zyra ambullantë’ le të dihet se islami nuk ka të përbashkët asgjë me ta, por ky lloj veprimi është bidat të cilin e kanë shpikur njerëzit e kohës së sodit sepse ky nuk është veprim as i sahabëve, as i gjeneratave të para, ndërsa dihet se çdo bidat shpie në humbje, dhe çdo humbje shpie në zjarr, pra “rukjen” të cilën e kanë shpikur këto njerëz është bidat në islam dhe nuk buron nga sahabët ashtu siç pretendojnë këta bidatgjinj.

Nuk ka argument se sahabët e kanë hapur shtëpinë me pretendimet se: **Unë shëroj me Kur’an**, apo jam i specializuar të shëroj me Kur’an, e edhe pejgamberi s.a.v.s. nuk e ka bërë një gjë të tillë, përkundrazi Muhamedi s.a.v.s. **për shërim e ka ligjësuar mjekësinë.**

Nuk ka argumente se sahabët kanë hapur ‘ordinanca’ dhe kanë thënë se “largojnë xhinët nga trupi i njeriut”. Veprimet e tilla nuk kanë të bëjnë asgjë me islamin.

Disa njerëz e shfrytëzuan këtë bidat për të shitur “ujë” në të cilin është bërë rukje apo që është fryrë në të.

Disa të tjerë janë duke bërë tregti me ullinj, vajin e ullirit, mjalt me fara të zeza, saqë tani çmimin e tyre e kanë bërë të papërbalueshëm për njerëzit. Kështu është duke u bërë çrregullim (fitne). Ata e blejnë një shishe me vaj ulliri, kurse të njëjtën e shesin me çmim të dyfishuar (apo shumëfishuar) me pretendimin se në të është kënduar Kur’an.

Veprimet e këtilla e bëjnë të ndaluar (haram) marrjen e rukjes për profesion, ashtu siç e kanë bërë zakon disa.

Islami e ka lejuar shërimin me barna shpirtërore si p.sh.: njeriu lutet për vete dhe për të sëmurin: **O Zot, o Përkujdesës i njerëzve, largoje këtë vështirësi, shëro, Ti je shërues, nuk ka shërim nëse Ti nuk shëron, shëro me shërimin me të cilin nuk ndien dhembjet.**” (Ahmedi dhe Buhariu). Këtë lutje mund ta bëjë çdo njeri për veten e tij por edhe për tjetrin, por kurrësi ta bëjë profesion “rukjen/lutjen” dhe të përfitohet prej saj. Muhamedi a.s na ka mësuar ta bëjmë këtë lutje për veten tonë dhe jo domosdoshmërisht duhet ta bëjnë të tjerët për ne: **O Zoti im, bëje Kur’anin dritë të gjoksit tim, largues të pikëllimit tim, lehtësues të brengave të mia dhe fatkeqësive të mia.**

Kush thotë se shërimi me Kur’an është rukje, ai e ka shpikur këtë term, që do të thotë se ky term nuk është përdorur prej sahabëve por është

term i mëvonshëm, sepse shërimi me Kur'an është shërim me Kur'an, dhe shërimi me sunet është shërim me sunet dhe nuk është rukje, pra nuk dihet se ndonjëri prej dijetarëve islam e ka determinuar ashtu.

Zemra i nënshtrohet Allahut dhe e pranon Librin e Tij, dhe njeriu ka vendosmëri të fortë në shërimin me Librin e Allahut dhe me lutjet pejgamberike, atëherë njeriu shërohet me shërim të plotë nga Allahu i Madhëruar, sepse në këtë rast ka ndodhur ajo që ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.: **Për çdo sëmundje ka ilaç dhe nëse qëllohet ilaçi i sëmundjes, njeriu shërohet me lejen e Allahut.** (Muslimi)

Kur thotë Zoti i Lartmadhëruar: **“Pyete ekspertin për çështje”** me këtë nënkuptohet se ekspertët pyeten në çdo lëmi, pa marrë parasysh a bëhet fjalë për çështje të fesë apo të dunjasë, p.sh., për ndërtim pyetet arkitekti, për bujqësi agronomi, e në rastin tonë për mjekësi pyetet mjeku.

MREKULLIA LOGARITMIKE NË KUR'AN

Vërtetë, mrekullia logaritmike në Kur'anin fisnik është çështje e cila duhet të studiohet sepse është argument për zbritjen e Kur'anit dhe metodologji e gjeneratës së gjuhës bashkëkohore, sepse ne jemi gjenerata e llogaritjeve kompjuterike dhe statistikore.

Secili hulumtues dhe secili studiues i Kur'anit fisnik do të gjejë fjalë të tematikave bile edhe të shkronjave, harmoni dhe mrekulli logaritmike, simetri numerike, barazi statistikore, e kjo e bën Kur'anin paraprijës të gjithësisë dhe argument bashkëkohor dhe tregon për mrekullinë Kur'anore dhe shërben si argument i ri për vërtetimin e Muhamedit a.s. për pejgamber madhështor.

Proporcionaliteti, harmonia simetrike logaritmike dhe numerike në Kur'an në tematikat e Kur'anit fisnik nuk janë të rastësishme por kanë qëllim të caktuar dhe harmoni të pakufishme.

Barazia e përsëritjes së fjalëve të një teme me përsëritjen e fjalëve të një teme tjetër është shumë e rëndësishme sepse tregon fakte të shumta dhe të qarta. Për këtë arsye Kur'ani fisnik ka kërkuar prej neve për me i shqyrtua, me i analizua, me i meditua të gjitha mrekullitë e tij, ku Zoti i Madhërua thotë:

“Librin të cilin ta kemi zbritur ty është i bekuar, me qëllim që të i mendoni ajetet e tij dhe të merrni mend o ju të mençur!” (Suretu Sad; 29)

“A nuk po e mendojnë Kur'anin apo në zemrat e tyre kanë pranga.” (Suretu Muhamed; 24)

Mrekullia logaritmike apo simetria numerike e fjalëve të tematikave të ndryshme na mahnitë. Përsëritja e fjalëve në mes të disa tematikave me disa tematika tjera ndryshon shumë. Nuk do koment se numri i barabartë i përsëritjeve nuk është vetëm në temat të cilat do t'i tregojmë por ka edhe shumë e shumë të tjera të cilat do të dalin në shesh pas ekspertizave të vazhdueshme shkencore dhe studimeve tjera dhe duke i përcjell statistikën dhe përsëritjen.

Zoti i Lartëmadhëruar thotë:

“Dhe Ne veç të kemi dhënë ty shtatëshen e cila përsëritet dhe Kur’anin madhështor.”

Sureja e parë në Kur’an është suretull Fatiha e cila i ka shtatë ajete.

Harmonia numerike paraqitet në numrin 7. Kur’ani i ka përmend 7 qiej, ndërsa këtë fenomen e ka përsëritë 7 herë, e këtë po e tregojmë në ajetet të cilat vijojnë:

1. **“Pastaj vullnetin e vet ia drejtoi qiellit dhe i përsosi ata shtatë qiej.” (Suretull Bekare; 29)**
2. **“Lartmadhëri të merituar i shprehin Atij shtatë qiejt e toka dhe çka ka në to.” (Suretull Isra; 44)**
3. **“Thuaj kush është Zot i shtatë qiejve dhe zot i Arshit të madh.” (Suretull Muëminunë; 86)**
4. **“Dhe ata i krijoi shtatë qiej.” (Suretull Fusilet; 12)**
5. **“Allahu është Ai që krijoi shtatë palë qiej dhe prej tokës aq sa ata.” (Suretull Talakë; 12)**
6. **“Ai është që krijoi shtatë qiej, palë mbi palë.” (Suretull Mulk; 3)**
7. **“A nuk e keni parë se si Allahu krijoi shtatë palë qiej.” (Suretull Nuh; 15)**

Zoti i Lartmadhëruar pasi e zbriti njeriun në tokë, së bashku me të e zbriti edhe Iblisin. Iblisi vazhdimisht mundohet ta mashtroj njeriun. Zoti i Lartmadhëruar dëshiron që njeriu ta konsideroj armik të hapët. Kështu që në Kur’an 11 herë përmendet “Iblisi” po ashtu edhe 11 herë përmendet “kërkimi mbrojtje prej tij”. A thua a mos është kjo rastësi?.

Viti i ka 12 muaj, Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Te Allahu numri i muajve është dymbëdhjetë, ashtu si është në librin e Allahut.” (Suretull Tevbe; 36)

Fjala “muaj” (shehr) në Kur’an është përsëritë 12 herë, po kaq muaj i ka viti. Simetria logaritmike nuk paraqitet vetëm në tematika. Harmonia dhe simetria vazhdon edhe te shkronjat. P.sh.: Rojtarët e xhehenemit, pra melaqet që mbikëqyrin në të, janë nëntëmbëdhjetë. Këtë e përmend Kur’ani në ajetin fisnik:

“E ku e di ti se çka është sekar. Ai nuk lë send të mbetët pa e djegur. Ai është që ua prish dhe ua nxin lëkurat. Mbikëqyrës mbi të janë nëntëmbëdhjetë.” (Suretul Mudethir ; 30)

Ne shohim se ajeti “Bismilahirr-Rrahmanirr-Rrahim” me të cilin e fillojmë Kur’anin i ka 19 shkronja.

Mrekullia logaritmike nuk përkufizohet vetëm në përsëritjen e barabartë të fjalëve të disa tematikave të një qëllimi, apo tematikave të cilat kanë ndërlidhje të ngushtë mes vete apo tematikave të kundërta, por ajo ka të bëjë edhe me harmoninë dhe simetrinë numerike mahnitëse logaritmike dhe me befasi statistikore.

Mrekullia e Kur’anit paraqitet edhe në përqindje sikurse është rasti i përsëritjes së fjalëve “tokë” dhe “det”. Fjala “tokë” është përsëritë 13 herë, ndërsa fjala “det” është përsëritë 32 herë, e kjo ndërlidhet me proporcionin real të tokës me ujin (det), sepse 71,11% e globit është e mbuluar me ujë dhe 28,88% e globit të tokës është e mbuluar me tokë.

Lloji njeri përbëhet prej dy gjinive, prej burrit dhe gruas. Por edhe shtohet prej dy gjinive. Nëse shikojmë në Kur’an shohim se 24 herë është përmend “burri”, po ashtu edhe 24 herë është përmend “gruaja. Atëherë bëhet pyetja: Mos është kjo rastësi?!

Prej gjymtyrëve të njeriut, gjuha është mjeti me të cilën komunikohet dhe këshillohet, kështu që shohim se në Kur’an, 25 herë është përmend “gjuha” dhe po ashtu 25 herë është përmend “këshilla”. Kjo nga shkak se me gjuhë këshillohet.

Fjala “dobi” (nefea) me trajtat e saja është përsëritur 50 herë, edhe fjala “dëm” (fesad) me trajtat e saja është përsëritë 50 herë.

Fjala “shejtan” është përsëritë 68 herë, po ashtu edhe fjala “Melaqe” është përsëritë 68 herë.

Fjala “namaz” është përsëritë 99 herë po aq sa janë “emrat e bukur të Allahut”.

Fjala “kjo botë” (dunja) është përsëritur 115 herë, po ashtu edhe fjala “ahiret” (bota tjetër) është përsëritur 115 herë.

Fjala “jetë” me trajtat e saja e cila është përdorë për jetën e njeriut në veçanti është përsërit 145 herë në Kur'anin fisnik. Po me këtë numër, pra 145 herë është përsërit edhe fjala “vdekje”.

Fjala “ditë” është përsëritë 365 herë, po aq sa ditë i ka viti dhe sa i kanë 12 muaj.

Fjala “njerëz” është përsërit 368 herë saktësisht sa është përsërit fjala “të dërguar” pra 368 herë.

Fjala “besim” (iman) në Kur’anin fisnik me të gjitha infinitivët e saj është përsërit 811 herë. Fjala “dituri” (ilm) me trajtat e saja është përsërit 782 herë dhe fjala “njohuri” (mearife) që edhe ashtu ka d.m.th. dituri me të gjitha trajtat e saja është përsërit 29 herë që d.m.th. fjala “Dituri” është përsërit 811 herë, aq sa është përsërit fjala “besim” (iman).

A thua kjo harmoni, kjo simetri, ka ardhur rastësisht ??

Rastësia është në kundërshtim me besimin, sepse rastësia nuk ndodh te Allahu, por gjithçka ndodh siç e ka shkruar dhe siç e ka caktuar Allahu me diturinë e tij të përhershme.

Tema për barazi, simetri dhe harmoni, ka nevojë ende për studim, hulumtim dhe kohë për secilin studiues dhe ekspert. Ndoshta dikujt nuk i mjafton edhe e tërë jeta. Pasi që barazia, harmonia, simetria është cilësi parimore e çdo çështje në ekzistencat të cilat i ka krijuar Allahu i Lartmadhëruar duke fillua prej elementeve me të thjeshta dhe më të imta siç janë atomet, por edhe më të imta se ato të cilat janë elemente përbërëse të sendeve, deri te përsosshmëria e plotë e çdo peshe, dhe çdo lëvizjeje të atomeve dhe pjesëve tjera në diell, në tokë, në planetë, në yje, në komete, etj., të cilat nuk mund të i numërojmë. Në bazë të analizave, teleskopëve, fotografimit, shkenca ka vërtetuar se çdo gjë në gjithësi i nënshtrohet një rregulli dhe ekuilibri të përpiktë, mu ashtu siç e tregon edhe Kur’ani fisnik në ajetin:

“Në krijimin e Mëshiruesit nuk mund të shohësh ndonjë kontrast.” (Suretul Mulk; 3)

Çdo gjë që e zbulojmë i nënshtrohet një rregulli dhe baraspeshoje siç e përmend Zoti i Madhëruar në Kur’anin fisnik:

“Në të kemi vendosur kodra dhe kemi bërë që në të të mbijnë bimë të caktuara të të gjitha llojeve.” (Suretul Hixhr ; 19)

Pra, ja, ky është Kur’ani fisnik i cili i ka specifikat e tij, barazinë, peshojën, harmoninë, përputhshmërinë numerike (të cilën njeriu nuk ka aftësi, bile jo vetëm një njeri por të gjithë njerëzit dhe xhinët së bashku). A nuk është i

vërtet dhe i pamohueshëm dhe i sigurt shpallje dhe zbritje të vula e pejgamberëve Muhamedi a.s. prej Zotit të Lartëmadhëruar.

Ky barazim, kjo harmoni dhe kjo përputhshmëri është metodologji e re prej mrekullive Kur'anore të cilat zbulohen pas studimit, analizës dhe hulumtimit, mirëpo kjo metodologji është e prerë dhe nuk lejon polarizim sepse është e kështjës dhe nuk lejon mendime të lloj-llojshme, sepse nuk është as komentim as interpretim ku mund të ketë mendime të ndryshme.

“Thuaj edhe sikur të bashkoheshin njerëzit dhe xhinët për të sjellë një Kur'an të tillë, ata nuk do të mund të bënin si ky, sado që do ta ndihmonin njeri-tjetrin.” (Suretul Isra ; 88).

Ndoshta e tëra ajo çka është thënë është shpjegim i fjalës së Zotit të Lartëmadhëruar:

“Allahu është Ai që e zbriti librin e vërtetë dhe vendosi barazi, baraspeshojë dhe drejtësi.”

Çështja është ende e hapur, ajo ende vazhdon dhe meriton të studiohet. Ende ka përputhshmëri dhe harmoni.

Fuqia njerëzore është e pamundur që ta përfshijë dhe ta përmbledhë përfundimisht dhe nuk mund t'i del në fund, i tërë njerëzimi është i pa aftë të bëjë këtë.

Çështja është më e thellë, më e gjerë, madje edhe ti lexues i dashur duhet të hulumtos, të studiosh sa të kesh mundësi, për mrekullinë e Kur'anit.

Parashtrohet pyetja: Sikur të gjithë dijetarët të bashkëpunonin me të gjitha mjetet e tyre dhe me të gjitha preparatet e tyre, a do të kishin mundur të përpilonin një Kur'an të tillë ??? Natyrisht se jo.

Tematikat janë të shumta, po ashtu edhe hulumtimet duhet të jenë të shumta, ndërsa numrat shtohen dhe shumëfishohen, a thua këtë a mund ta bëjnë të gjithë njerëzit e mos të flasim një njeri, analfabet siç ka qenë Muhamedi a.s.? A mundet? Jo, kurrësi jo! Pasha Zotin e Gjithësisë!

Kur'ani veç ka kërkua prej atij i cili dyshon që të tentoj të sjellë një Kur'an të ngjashëm dhe atë në ajetin fisnik:

“E në qoftë se jeni në dyshim në atë që Ne ia sjellim gradualisht robit Tonë, atëherë silleni ju një kaptinë të ngjashme si ai (Kur'ani) dhe thirrni (për ndihmë) dëshmitarët tuaj (zotat) pos Allahut, nëse jeni të sigurtë (në thëniet tuaja se Kur'ani nuk është prej Zotit).” (Suretul Bekare ; 23)

Kur'ani fisnik në këtë ajet fisnik i ka përfshirë të gjitha llojet e mrekullive e prej tyre pa dyshim se edhe mrekullinë numerike. Edhe nëse të gjithë njerëzit tubohen që ta bëjnë një Kur'an, nuk do të mundnin, sepse rezultatin e ka sjell Kur'ani në ajetin fisnik:

“E nëse nuk e keni bërë (deri më tash), e as që do ta bëni kurrë (edhe në të ardhmen), atëherë ruajuni zjarrit, lëndë e të cilit janë njerëzit dhe gurët, që është i përgatitur për mosbesimtarët. (Suretul Bekare ; 24)

HAPAT E SHEJTANIT

Shejtani do të thotë *i larguar* dhe *i dëbuar* nga mëshira e Allahut, apo me fjalë tjera *i mallkuar*, pra, shejtani është i mallkuar.

Dy cilësi kanë ndikuar që shejtani të jetë i mallkuar dhe i dëbuar nga mëshira e Zotit:

- E para: Kryelartësia; dhe
- E dyta: xhelozia.

Kur Zoti i Lartmadhëruar i tha shejtanit: - Bjeri në sexhde Ademit. Ai i tha: - Unë jam më i mirë se ai, sepse atë e ke krijuar prej dheu ndërsa mua më ke krijuar prej Zjarri. Pra xhelozia ndaj Ademit ndikoi që ai të tregoj kryelartësi dhe të mos i bie në sexhde Ademit.

Pastaj Shejtani i ka thënë Zotit të Lartmadhëruar se: Njerëzit do t'i humb nga rruga e drejtë, përpos besimtarëve të singertë. Dhe më jep afat deri në ditën e ringjalljes.

Zoti i jep shansin që deri në momentin e ringjalljes të jetoj aty ku jeton njeriu dhe që të tentoj të i largoj njerëzit nga rruga e drejtë, por ai nuk do të mund të i largoj besimtarët e singertë nga rruga e drejtë sepse specifikë e shejtanit është që me mashtrime t'i largoj njerëzit nga rruga e drejtë, e besimtarët e singertë nuk bien pre e kurtheve të shejtanit.

- shejtani i shkon njeriut nga para,
- nëse është i pasuksesshëm i shkon nga mbrapa,
- nëse është i pasuksesshëm i shkon nga ana e djathtë,
- nëse nuk është i suksesshëm i shkon nga ana e majtë.
- shejtani nuk i shkon njeriut nga poshtë sepse në këtë anë njeriu bie në sexhde,
- po ashtu, shejtani nuk i shkon nga lart, se njeriu i ngrit duart lart dhe e lutë dhe e përkujton Zotin e Madhëruar,
- pra, sexhdeja dhe përkujtimi ndaj Zotit e largon shejtanin nga njeriu.

Shejtani ndonjëherë e sulmon njeriun, nëse nuk arrin të ketë sukses me sulm, ai i përgatit kurthe, nëse e sheh se njeriu nuk bie në kurthet e tij, fillon ta mashtroj, e nëse nuk mundet ashtu, tenton ta frikësoj e nëse nuk mundet

ashtu, fillon ta vë në dyshime, nëse nuk mundet ashtu, ai veprat jo të mira ia zbukuron kinse janë vepra të mira, e nëse nuk mundet ashtu, fillon t'i paraqitet njeriut se është një këshilltarë i mirë e i singertë dhe se ia do të mirën njeriut, por përkundrazi, shejtani qëllimin kryesor e ka që njeriun ta bëjë pabesimtar dhe të digjet në zjarr së bashku me të.

Zoti i Lartmadhëruar na ka urdhëruar që mos ta dëgjojmë dhe të mos shkojmë hapave të shejtanit, të mos biem në grackat dhe mashtrimet e shejtanit sepse ai është armik i përbetuar dhe i hapur i njeriut, ai ka larguar nga rruga e drejtë turma të mëdha të njerëzve. Ne duhet të logjikojmë të analizojmë dhe të mësojmë që të mos biem në kurthet e shejtanit, sikurse po e tregoj tregimin në vijim se në çfarë hapa dhe çfarë metoda shkon shejtani deri sa ta shpie njeriun në pabesim:

Ja, hapat të cilat i përdor shejtani:

Ka qenë një beni israil, i cili ishte ndër më të devotshmit në kohën e tij. Në atë kohë jetonin tre vëllezër, ata kishin një motër virgjëreshë dhe nuk kishin motër tjetër, pos saj.

Të tre vëllezërit ishin emëruar vullnetar në luftë në rrugën e Allahut. Nuk dinin se në përkujdesjen e kujt ta linin dhe ku ta vendosnin motrën e tyre, sepse nuk kishin besim te askush. Të gjithë së bashku u pajtuan që ta dërgojnë te një mistik beni israil që të përkujdesej për të, sepse vetëm tek ai u pushonte zemra.

Shkuan dhe e pyetën që motrën e tyre ta lënë në përkujdesje të tij derisa të kthehen, por ai thotë: - Më ruaj o Zot! Unë kurrë nuk mund ta pranoj.

Ata vazhdimisht insistonin derisa e bindën, dhe pranoi, por me një kusht: që të banojë në një shtëpi përballë faltores së tij.

Ata pajtohen dhe e dërgojnë motrën e tyre te ajo shtëpi dhe shkojnë.

Një kohë të gjatë, derisa ajo banonte aty, ai ia përgatiste ushqimin, zbriste te dera e faltores, pastaj e thërriste, ajo dilte nga shtëpia e saj dhe e merrte ushqimin që ia përgatiste.

➤ HAPI I PARË

Shejtani shkon me butësi te mistiku dhe e këshillon, se ai duhet të punojë punë të mirë, ai duhet të fitojë shpërblim më të madh, dhe se kur ajo vajza del nga shtëpia e saj ditën, e shohin të tjerët dhe mund të keqkuptojnë, por më mirë është që të shkonte me ushqim te shtëpia e saj dhe ta vendoste ushqimin te pragu i shtëpisë, kështu do të fitonte shpërblim më të madh.

Ai e pranon atë këshillë dhe vazhdon t'ia përgatis ushqimin dhe t'ia dërgonte te pragu i shtëpisë së saj, por nuk fliste me të fare.

➤ HAPI I DYTË

Kaloi një kohë, pastaj i shkon Iblisi e i thotë në vesh: Ti duhet të fitosh shpërblim edhe më të madh, dhe e nxiste vazhdimisht duke i thënë: Sikur të flisje më të, do të çmallej, sepse ajo është e permalluar për vëllezërit e saj.

Iblisi e këshillonte kështu vazhdimisht, derisa prej faltores së tij, filloi të bisedojë me të.

➤ HAPI I TRETË

Pastaj i shkon Iblisi e i thotë: Sikur të shkoje te dera, të ulesh pranë faltores, e ajo pranë shtëpisë së saj e të bisedonit, do të kishte qenë më mirë për të.

Kështu ai nuk ndalej, derisa zbret dhe ulet para faltores, e ajo vajza ulej para derës së shtëpisë ku banonte dhe bisedonin nga larg.

Një kohë kaloi kështu.

➤ HAPI I KATËRT

Pastaj i shkon Iblisi e i thotë: *Ti duhet të fitosh shpërblim më të madh, duke u sjellë më mirë me të. Pra, shko prej faltores tënde dhe ulu në prag të shtëpisë së saj e bisedo me të, sepse më mirë është për të.*

Ai vazhdimisht e këshillonte kështu, derisa edhe ashtu veproi për një kohë.

➤ HAPI I PESTË

Pastaj shkon Iblisi e i thotë: *Nëse dëshiron shpërblim më të madh, shko dhe hyr në shtëpinë e saj, bisedo më të brenda, që mos t'ia shohin të tjerët fytyrën, se kjo është më mirë për ty dhe shpërblimi është më i madh.*

Iblisi kështu vazhdimisht e këshillonte, derisa filloi të hyjë në shtëpinë e saj, bisedonte me të ditën, e kur kalonte dita shkonte në faltoren e tij.

➤ HAPI I GJASHTË

Pastaj i shkon Iblisi, ia zbukuron fytyrën e asaj vajze para tij, derisa ai e prekë në trup dhe e puthë.

➤ HAPI I SHTATË

Iblisi vazhdimisht ia zbukuronte fytyrën e saj, derisa e shtyn të kontaktojë seksualisht me të, e lë shtatzënë, e ajo pastaj lind fëmijë.

➤ HAPI I TETË

Pastaj i shkon Iblisi e i thotë: *Çka mendon nëse vijnë vëllezërit e saj e e shohin se ajo ka fëmijë me ty, si do të vepronin me ty? Nuk ka shpëtim prej tyre, andaj shko, merrja fëmijën, mbyte dhe varrose, se ajo frikësohet prej vëllezërve të saj, e do ta mbajë sekret atë se ti ke kontaktuar seksualisht me të.*

Ai ashtu veptoi dhe e mbyti foshnjën.

➤ HAPI I NËNTË

Pastaj i thotë Iblisi: *Mbyte edhe vajzën dhe varrose me të birin e saj. A mendon dhe a ke besim se ajo mund ta mbajë sekretin?*

Kështu ai e mbytë edhe vajzën, e merr vajzën dhe fëmijën dhe i dërgon në një greminë, i varrosë aty dhe mbi varr vendos një guri të madh.

Shkon te faltorja e tij dhe fillon të lutet një kohë të gjatë, deri sa kthehen vëllezërit e saj nga lufta.

Kur kthehen vëllezërit nga lufta, e pyesin për motrën e tyre. Ai i ngushëllon dhe u thotë: **“Zoti e mëshiroftë”** dhe fillon të qajë para tyre, e u thotë: - **Nuk ka pasur vajzë më të mirë, por ajo ka vdekur, ja ku e ka varrin.**

Vëllezërit shkojnë dhe e shohin varrin, aty qajnë për motrën e tyre, qëndrojnë disa ditë te varri i saj dhe kthehen në shtëpi të tyre.

➤ HAPI I DHJETË

Kur bien vëllezërit për të fjetur, u paraqitet shejtani në ëndërr në formë të një njeriu udhëtar dhe fillon prej vëllait më të madh, duke e pyetur për motrën e tyre, e ai i tregon ashtu siç ka treguar mistiku për vdekjen e motrës së tyre, se si kanë shkuar tek varri i saj... Mirëpo shejtani i thotë: *Kjo është gënjeshtër, dhe u thotë që të mos i besojnë fjalëve të tij, sepse ai e ka lënë shtatzënë motrën e tyre, pastaj ajo ka lindur djalë, kurse ai e ka mbytur motrën tuaj së bashku me fëmijën e saj, ngase është frikësuar nga ju; e ka futur në një gropë, të cilën e ka hapur vetë pas shtëpisë në anën e djathtë, në të cilën ka qenë e vendosur. Shkoni te shtëpia në të cilën ka qenë e vendosur dhe kur të hyni do ta shihni se është ashtu si po u them juve.*

Pastaj i paraqitet Iblisi në ëndërr vëllait të dytë dhe ia tregon të njëjtat gjëra.

Pastaj i shkon edhe vëllait të vogël, duke iu paraqitur në ëndërr gjithashtu.

Kur u zgjuan në mëngjes u ulën të bisedonin mes vete.

Njëri thotë: - Mbrëmë kam parë një ëndërr të çuditshme - dhe ua tregon.

Edhe tjetri thotë se kishte parë po të njëjtën ëndërr!

Vëllai i madh thotë: - Po ajo është vetëm ëndërr e asgjë tjetër, lëreni këtë punë, harrojeni.

Më i vogli thotë: - Për Zotin, nuk e lë pa shkuar te ai vend dhe të shikoj se çka ka.

Shkojnë te shtëpia ku ka banuar motra e tyre, e hapin derën dhe kërkojnë vendin, të cilin ua kishte treguar njeriu (shejtani) në ëndërr, dhe e gjejnë motrën e tyre dhe fëmijën e saj të mbytur.

E pyesin mistikun, e ai u thotë se kjo është e vërtetë.

Atëherë ata e padisin te qeveritari i asaj kohe. E marrin mistikun prej faltores së tij dhe e dërgojnë për ta dënuar me vdekje.

➤ HAPI I NJËMBËDHJETË

Kur ia lidhin duart për ta ekzekutuar, shkon Iblisi e i thotë: *Unë jam shoku yt, i cili të ka provuar me atë vajzë, të cilën e ke lënë shtatzënë, pastaj e ke mbytur atë me fëmijën e saj. Nëse sot më dëgjon dhe e mohon Allahun, i cili të ka krijuar dhe të ka dhënë formën, atëherë unë do të shpëtoj prej vdekjes.*

Ai e dëgjon dhe e mohon Allahun.

Kur e mohon Allahun, shejtani largohet prej tij dhe atë e ekzekutojnë.

Për këtë ka zbritur ajeti:

“Njësoj, sikurse shejtani kur t’i thotë njeriut: “moho”,e ai kur të mohojë thotë (shejtani): “Unë largohem prej teje, unë i frikohem Allahut – Zotit të botëve”. Dhe përfundimi i të dyve është se ata do të jenë në zjarr përgjithmonë. Ky është dënimi për kriminelët.” (Hashr : 16, 17).

“E MIRA” DHE “E KEQJA”

Ligjvënës i vetëm dhe absolut është Allahu dhe askush tjetër, për këtë Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Vërtetë, vendimi dhe ligji i takon vetëm Allahut.” (Jusuf ; 40).

Muhamedi a.s. nuk është miratues i ligjeve por është transmetues dhe sqarues i ligjeve të Allahut. Zoti i Lartmadhëruar i ka thënë Muhamedit a.s:

“Që edhe ti të gjykosh në mes tyre me atë ligj që të ka zbritur Allahu.”.

Muxhtehidët (ekspertët e Jurisprudencës islame) i zbërthejnë, i elaborojnë, i përkthejnë, i vërtetojnë dhe i arsyetojnë ligjet e ligjësuara prej Kur’anit dhe sunetit.

Në fakt, mendja mund të konceptojë ligjin e Allahut. Allahu i Lartmadhëruar e ka ndërlidhë ligjin me atë çka e kupton mendja për atë veprim. E ka ndërlidhur ashtu që vetvetiu të konceptohet *e mira* dhe *e keqja* ose vetvetiu të kuptohet dallimi në mes tyre. Ata (dijetarët) kanë thënë se: *“Ligji është zbulues i asaj çka e kupton mendja (logjika) para ardhjes së tij”.*

E mira dhe e keqja shikohen në dy koncepte:

Sipas konceptit të parë:

- *E mirë* është ajo çka është në përputhshmëri me natyrshmërinë si f.v: ëmbëlsira, zëri i bukur, etj..

- *E keqe* është ajo çka është në kundërshtim me natyrshmërinë, si f.v: thatësia, zëri i keq, etj..

Sipas konceptit të dytë:

- *E mirë* është ajo çka është e përsosur (pozitive) si f.v.: dituria, sinqeriteti.

- *E keqe* është ajo çka është e mangët (negative) si f.v: injoranca dhe rrena.

Boshti i temës nuk ka të bëjë me këtë.

Tema ka të bëjë me çështjen e të kuptuarit e *të mirës dhe të keqes*, që do të thotë: a mund të kuptohen veprat e këqija dhe veprat e mira, prej pavarësisë logjike, apo ato patjetër duhet të kuptohen nëpërmjet ligjit (ligjit të Allahut), që do të thotë: Çka ka urdhëruar Ligjvënësi të jetë e mirë, dhe çka ka ndaluar Ligjvënësi të jetë e keqe, dhe pasi që mendja ta kupton të mirën, a është e kërkuar prej neve para se të vjen ligji i jonë (sheriati ynë) ta veprojmë?!, dhe atë që mendja e kupton të keqe a është kërkuar të largohemi para se të vjen sheriati?!. E, nëse para se të vjen sheriati e kemi pasur për detyrë ta veprojmë të mirën dhe e kemi vepruar, a pason shpërblimi?, dhe nëse është kuptuar e keqja, dhe është vepruar, a pason dënimi?

Në lidhje me këto çështje dijetarët janë ndarë në tri drejtime.

Drejtimi i parë: Drejtimi i Muëtezilëve¹

E mira dhe e keqja janë çështje të mendjes e jo të ligjit. Ligjet e Allahut janë në përputhshmëri me atë çka mendja e kupton të mirë ose të keqe. Atë që mendja e koncepton të mirë edhe te Allahu është e mirë, dhe atë që mendja e koncepton të keqe edhe te Allahu është e keqe. Me fjalë tjera, për veprim të së mirës rezulton shpërblimi ose për veprim të së keqes rezulton dënimi, edhe para ardhjes së ligjit.

Drejtimi i dytë: Drejtimi Esharij²

Ligji i Ligjvënësit (Allahut) është peshoja e *të mirës dhe të keqes*. *E mira dhe e keqja* janë çështje të ligjit e jo të mendjes. Me fjalë tjera, nuk ka as ngarkesë as ndalesë, përkatësisht as shpërblim e as dënim, para dërgimit të pejgamberëve.

¹ Muëtezilët janë pasues të Vasil bin Ataun, i cili ka vdekur 144.

² Esh'sharij quhen pasuesit e Ebi Hasan el Esh'sharit, ka vdekur në vitin 324 hixhretit.

Drejtimi i tretë: Drejtimi Maturdij³

Ky drejtim mendon se: *E mira* dhe *e keqja* janë çështje të mendjes (logjikës). Pra, nuk janë çështje të ligjit, por mendja vetëm e kupton ligjin. Sipas këtij drejtimi, njeriu shpërblehet për besim dhe dënohet për pabesim. Ndërsa përpos besimit dhe mosbesimit, çka është *e mirë* apo *e keqe* nuk kërkohet prej tyre, e as nuk kanë shpërblim e as dënim.

Drejtimi i parë: Drejtimi i Muëtezilëve

Sipas këtij drejtimi, “e mira” dhe “e keqja” janë çështje të cilat patjetër duhen të konceptohen, si f.v: “E mirë” është drejtësia (e vërteta) që bën dobi, ndërsa “E keqe” është rrena e cila e dëmton. Ose të cilat kuptohen por pas një analize dhe vështirimi si f.v.: “E keqe” është e vërteta e dëmshme dhe “E mirë” është gënjeshtër e dobishme. Kjo nga shkak se mund të ndodhë që e vërteta disa persona i dëmton ndërsa në gënjeshtër është dobia e tyre. Me një analizë dhe vështirim, mendja shpie njeriun në këtë rast se në *të vërtetën* është dëmi, ndërsa në *gënjeshtër* është dobia, edhe atëherë kur gënjeshtër dëmton disa persona, ose përkundrazi është e dobishme edhe për ta, kjo sipas llogaritjes së interesit të përgjithshëm. Ose që mendja mund ta kupton por pas një përqendrimi të saj në atë çka ka sjellë ligji si f.v: “E mirë” është të agjëruarit e ditës së fundit të Ramazanit dhe “E keqe” është të agjëruarit e ditës së parë të muajit Sheval. Në këtë fushë mendja nuk ka aftësi të ndërhyjë. Obligimet janë çështje të specifikuara për ta zbuluar qëllimin e ligjit, të cilat për mendjen e njeriut janë qëllime të fshehura.

Sa i përket përkufizimit të “së mirës” dhe “së keqes”, muëtezilët janë ndarë në dy grupe:

- Muëtezilët e mëhershëm; dhe
- Muëtezilët e mëvonshëm.

³ Maturdij janë pasuesit e Ebi Mensur Muhamed el Maturdijut (Familja Maturdi e Samarkandit) i cili ka vdekur në vitin 333 h. Në këtë drejtim është medhhebi Hanefij.

Muëtezilët e mëhershëm thonë se “e mira” dhe “e keqja” janë cilësi qenësore të veprës, që do të thotë se burimin e kanë prej vet qenies së tyre e jo prej ndonjë elementi tjetër pas saj. Veprimi në vetvete dhe në gjendje normale buron ose të mirën në vetvete ose të keqen në vetvete pa shikuar se çka ndodh pastaj në të.

Muëtezilët e mëvonshëm thonë se “e mira” dhe “e keqja” është atribut i vet veprës dhe është i pandashëm dhe nuk merret parasysh a i bashkëngjitet a jo ndonjë veçori e mëvonshme.

Ligjet e sheriatit vërtetohen nëpërmjet logjikës (mendjes) në atë që mendja e sheh se është e domosdoshme, ose pas studimit e sheh se është e domosdoshme.

Ndërsa, sa i përket asaj çka mendja nuk e sheh të domosdoshme, apo pas studimit nuk e sheh të domosdoshme, ligjet janë sqarues të asaj çka është e fshehur nga ne. Ligjvënës i vërtetë është Ligjvënësi në mënyrë të përgjithshme.

Sipas këtij mendimi të muëtezilëve rezulton se: Prej robit kërkohet që të veproj të mirën në atë që e sheh se është e mirë edhe para zbritjes së sheriatit.

Ngjashëm me këtë kanë thënë dijetarët e sociologjisë: Peshoja e të mirës dhe të keqes është ajo çka kuptohet prej veprimit të së dobishmes ose të dëmshmes tek shumica e njerëzve, tek të cilët rezultojnë pasojat, apo paraqiten rezultatet e veprimit.

Argumentet e këtij drejtimi:

E para: Po të mos kishte qenë e njohur e mira dhe e keqja para sheriatit, do të kishte qenë absurde që të na mësoj kur ka ardhur sheriat, sepse do të na vinte diçka që dëgjuesi as nuk do ta paramendonte as nuk do ta logjikonte. E kjo është absurde. Për këtë arsye, ka qenë obligim që të jenë të njohura para ardhjes së tyre.

Replikohet me atë se: qëndrimi i sheriatit (ligjit) nuk është që ta paramendoj të mirën dhe të keqen. Sepse ne para ligjit paramendojmë çka është dënimi, shpërblimi, dhe mallkimi i veprës, e po ashtu paramendojmë çka nuk është shpërblimi dhe mallkimi. E paramendimi i të mirës dhe të keqes nuk është që ligji ta paramendoj, por qëndrimi i ligjit është vërtetimi i tyre, e ka dallim në mes të paramendimit dhe vërtetimit.

E dyta: Po të mos kishin qenë e mira dhe e keqja çështje logjike, atëherë prej Allahut do të kishte qenë e mirë çdo gjë, do të lejohej gënjeshtria edhe prej Allahut, sepse mendja nuk do të gjykonte as për të mirën as për të keqen. E po të lejohej gënjeshtria prej Allahut të Lartmadhëruar, atëherë nuk do të kishte pasur pengesë që të paraqiteshin mrekulli prej gënjeshtarëve. E kjo do të mbyllte derën e pejgamberisë e cila është derë e lumturisë së njerëzimit, e atëherë nuk do të mund të dallonim pejgamberin e vërtetë prej të ashtuquajturit pejgamber (gënjeshtarit). E kjo do të shpinte te zhvlerësimi i ligjeve.

Ky argumentim polemizohet në atë se: Gënjeshtria është mangësi (e metë), e Allahu është pa të meta.

Ne veç kemi thënë: *E mira* dhe *e keqja* kanë kuptime të përsosmërisë dhe *mangësisë*. E nuk ka argumentim (polemika) te dijetarët se ato janë çështje të logjikës.

Nga ky drejtim rezulton se:

Tek ai i cili nuk ka arritur shpallja (ftesa) për obligimin si f.v. i moshërrituri në ndonjë ishull të pashkelur, ku nuk ka arrit njoftimi për ngarkesë, ku nuk ka pasur besim, prej tij kërkohet veprimi i të mirave dhe largimi nga të këqijat, dhe në botën tjetër dënohet edhe për atë që mendja e tij ka qenë e pavarur të gjykojë.

Drejtimi i dytë: Drejtimi Esh'arij

Ligji i Ligjvënësit (Allahut) është peshoja e të mirës dhe të keqes. “E mira” dhe “e keqja” janë çështje të ligjit e jo të mendjes, me fjalë tjera nuk ka as ngarkesë, as shpërblim e as dënim para dërgimit pejgamberik.

Ngjashëm me këtë kanë thënë disa dijetarë të Etikës:

- çka obligon ligji, apo çka quhet e lejuar, është “e mirë” ,
- çka e ndalon ligji, apo çka quhet e ndaluar, është “e keqe”.

Argumentimi i këtij drejtimi:

E para: Po të kishin qenë e mira dhe e keqja attribute vetanake të tyre në të vepruar, do të kishte qenë në rregull gjithmonë ashtu, dhe absolutisht kurrë nuk do të kishte qenë ndryshe, por gjithmonë veprimi do të kishte

qenë përgjithmonë i mirë ose përgjithmonë i keq. Sepse ajo çka është vetanake substanciale nuk ndryshon, përderisa dihet se rrena ndonjëherë është e mirë, dhe është obligative sikurse kur ka qenë në pyetje që pejgamberi të shpëtojë nga dora e kriminelit apo të nxjerrë veten nga kthetrat e gjakpirësit, në këtë rast e vërteta (e mira) është e keqe dhe e ndaluar.

Ky argumentim replikohet me atë se:

E keqja vetanake nuk bie ndesh me të mirën aksidentale. Sikurse edhe gënjeshtria në vetvete nuk është në kundërshtim me të mirën aksidentale, por përkundrazi shpëtohet vetja nga shkatërrimi.

Po ashtu mirësia e namazit është mirësi në vete. Mirësia e namazit nuk është në kundërshtim me të keqen që e kaplon atë, në rast kur të falurit bëhet në shtëpinë e uzurpuar.

E dyta: Po të kishin qenë e mira dhe e keqja të logjikshme Allahu nuk do t'i kishte zgjedhur për të qenë ligje të Tij, por do të kishin qenë të përkufizuara në ligjësimin e ligjeve. Sepse definitivisht i ka ligjësuar dhe i ka ndërtuar në bazë të veprimit të keq ose të mirë. I logjikshmi nuk shikon në të kundërtën e asaj që është, sepse të keqen që njeriu e bën (aksidentalisht) Zoti e largon prej tij. Kështu që është vaxhib që dispozitat të jenë në përputhshmëri me logjikën. E obligueshmëria nuk e lejon të drejtën e të zgjedhurit.

Po ashtu edhe ky argument replikohet se:

Përputhshmëria e ligjit të Krijuesit me urtësinë e ligjshmërisë nuk e patjetëron domosdoshmërinë, por prapë se prapë vazhdon e drejta e të zgjedhurit. Sikurse prokurori bie vendim në përputhshmëri me ligjin, mirëpo kjo konsiderohet e drejtë për të sjellë vendim në gjykim, e jo detyrim, bile ka dallim në mes të atij që e bën obligative për veten e tij dhe atij që detyrohet të bëjë një veprim prej tjetrit. E para është e drejtë zgjedhjeje, e dyta detyrim apo imponim. Në Kur'anin fënisnik ka zbritur ajeti: **“Zoti i juaj ia ka bërë obligim vetes së Tij për ju mëshirën.”**

E treta: Po të kishin qenë “e mira” dhe “e keqja” çështje e logjikës, do të kishte qenë e lejuar që ai i cili bënë keq të dënohet ose do të lejohej të mos dënohet nëse dikush e sheh se është e mirë e vepron (edhe nëse është keq) edhe para dërgimit të pejgamberëve, e dihet se kjo është e

papranueshme, dhe në kundërshtim me argumentet e qarta të Kur'anit fisnik. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Dhe Ne nuk i kemi dënuar, përderisa kemi dërguar peygamber.”.

Po ashtu Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Dhe Ne nuk i dënojmë derisa të dërgojmë të dërguar.”.

Muëtezilët kanë kundërshtuar duke thënë:

Pjesa e ajetit “të dërguar” ka për qëllim mendjen, sepse mendja është i dërguar i brendshëm (abstrakt) e cila ia tërheq vërejtjen të kryej obligimin, pra mendja është peygamberi.

Ky interpretim po ashtu nuk mund të pranohet, sepse sipas Kur'anit “i dërguar” ka për qëllim shpalljen e cila i shpallet njeriut.

Nga ky drejtim rezulton se:

Tek ai i cili nuk ka arritur shpallja (ftesa) për obligimin si f.v. i moshërrituri në ndonjë ishull ku nuk ka arrit njoftimi për ngarkesë, ku nuk ka pasur besim, nuk kërkohet prej tij dhe nuk ka shpërblim, gjithashtu edhe nuk dënohet edhe nëse ka bindje të mosbesimit të qartë.

Drejtimi i tretë: Drejtimi Maturidij (I këtij drejtimi është medhhebi Hanefij)

Ky drejtim mendon se: “E mira” dhe “e keqja” janë çështje të mendjes (logjikës), pra nuk janë çështje të ligjit, por mendja vetëm e kupton ligjin.

Maturidijtë janë ndarë në dy grupe:

Maturidijtë e mëhershëm; dhe

Maturidijtë e mëvonshëm.

Maturidijtë e mëhershëm thonë se: njeriu shpërblehet për besim dhe dënohet për pabesim, ndërsa përpos besimit dhe mosbesimit, çka është e mirë, apo e keqe nuk kërkohet prej tyre, e as nuk kanë shpërblim për veprimin e të mirës e as nuk kanë dënim për veprimin e së keqes.

Maturidijt kanë sjellë argumente me sa vijon:

E para: Po të kishin qenë “e mira” dhe “e keqja” çështje jo të logjikës, por të ligjësimit, dhe para se të vinte ligji do të kishin qenë të barabarta në të njëjtën çështje p.sh. namazi dhe prostitucioni. Të bërit obligim njërën, e haram tjetrën nuk është prioritare prej thelbit të ligjit, ajo është të dhënit prioritet pa pasur të drejtë prioritative.

E dyta: Po të kishin qenë “e mira” dhe “e keqja” çështje të ligjit, do të kishte qenë që dërgimi i pejgamberëve dhe ardhja e feve sprovë dhe shkatërrim për botën, nxitje e konfrontimeve, shkaktar të mundimeve dhe vështirësive, kur dihet se njerëzit para feve kanë pasur liri absolute, kanë vepruar çka kanë dëshiruar, të sigurt se nuk do të dënohen e as nuk do të shpërblehen. E kur kanë ardhur Pejgamberët i kanë nda veprat në hallalle dhe haramë, e atëherë njerëzit janë nda në dy grupe: besimtarë dhe pabesimtarë, dhe po ashtu në dy grupe tjera: një grup në xhenet dhe një grup në xhehenem. E dërgimi i shpalljeve do të kishte qenë mirësi dhe dëmtim, e kjo është e papranuar se Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **“Ty Muhamed të kemi dërguar mëshirë për të gjithë botët.”**

Ky argument sikurse tregon se “e mira” dhe “e keqja” janë çështje të mendjes, gjithashtu tregon se obligueshmëria e besimit dhe ndalimi i pabesimit janë çështje të mendjes. Mendja mund të jetë e pavarur në kuptimin e disa ligjeve f.v.: Obligueshmërinë e Imanit (Besimit) dhe të ndaluarit e pabesimit (ateizmit), sa që këtë mund ta kuptojë edhe fëmija i logjikshëm. Kështu pra robi është përgjegjës në atë që e kupton mendja. P.sh. Kush nuk beson, dënohet prej Zotit të Lartmadhëruar për mosbesim, pa marrë parasysh a i ka ardhur kumtimi i shpalljes apo jo.

Ebu Hanife r.a. thotë: Për injorancë (pabesim) askush nuk ka arsyetim, pasi që ai i sheh argumentet.

Maturidijtë e mëvonshëm mendojnë se: “E mira” dhe “e keqja” në tërësi janë çështje të mendjes, ata mendojnë në atë se: “e mira” dhe “e

keqja” për njeriun nuk janë obligueshmëri ligjore, por bëhen obligueshmëri logjike kur të vendoset ligjshmëria nga Ligjvënësi, gjë që është e sigurt, sepse përderisa një çështje nuk ligjësohet është e paligjësuar. Pra, këto e kushtëzojnë kumtimin e shpalljes për ngarkueshmëri.

Këta mendojnë se para vendosjes (ardhjes) së ligjeve, rob i nuk është i obliguar të veproj, apo nuk ndalohet nga diçka, e as nuk ka dënim nga Allahu i Lartmadhëruar.

Këta janë argumentuar: se dispozita e “të mirës” dhe e “të keqes” absolutisht nuk janë të domosdoshme edhe po që se dispozita të ishte dispozitë për: obligueshmëri të besimit (Imanit) dhe ndalimit të pabesimit (kufrit). Sepse për mendjen nuk është e pranueshme që Allahu të urdhërojë për besim e në të njëjtën kohë të mos shpërblejë edhe nëse është e mirë, e që të mos ndaloj pabesimin e të mos dënoj edhe pse është e keqe. Sepse Allahu nuk ka nevojë për adhurim sado që të jetë e shumtë ajo, e nuk dëmtohet nëse nuk adhurohet sepse kur mendja nuk e ka obligueshmëri, veshëve (dëgjimit) nuk do t’i mbetej për detyrë ta përcjellë në mendje. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Dhe, Ne nuk ndëshkojmë përderisa nuk dërgojmë të dërguar”.

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Çdo herë kur hidhet ndonjë grup në të (zjarr) rojet i pyesin: - Po a nuk ju ka ardhur peygamber për t’u tërheq vërejtjen. Ata përgjigjen: - Po sigurisht po, na janë ardhur peygamber, por ne i kemi përgënjeshtuar dhe u kemi thënë: Allahu nuk ju ka shpallur asgjë.”.

Mendimi më i drejtë

Mendimi më i drejtë është mendimi i Maturidijve të mëhershëm të cilët thonë se për njeriun ligjet e besimit janë të kërkuara para ardhjes së ligjit ndërsa ligjet praktike e sekondare nuk janë të kërkuara para ligjit. Kjo është në përputhshmëri edhe me logjikën por e tregon edhe Kur’ani. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Vërtetë Allahu urdhëron për drejtësi, bamirësi dhe respektim të afërmve, dhe ndalon imoralitetin, të keqen dhe kriminalitetin.” (En-Nahl , 90).

Po ashtu ka thënë:

“Ju urdhëron për të mirën dhe ju ndalon të keqen.” (El Earaf, 158).

Domosdoshmërisht logjika i kupton të mirat dhe të këqijat por jo të gjitha. Argument për këtë janë hadithet që tregojnë për dënimin e natyralistëve në kohën e injorancës. Shembull thënia e Pejgamberit s.a.v.s. *“Poeti Kajs, prijës i poetëve digjet në zjarr”*.

Pastaj thënia e Pejgamberit s.a.v.s.:

“E kam parë (në natën e Israsë dhe Miraxhit) Amër Luhijin duke u zvarritur për mjekre në zjarr. Sepse ai ka qenë i pari i cili ka shpik idhujtarinë e arabëve. E dënim i tij është bërë sepse ai nuk është udhëzuar në besim me mendjen e tij edhe pse kjo ka qenë para dërgimit të Pejgamberit.”

Nuk ka dënim vetëm në bazë të ngarkimit. Burim i ngarkimit sipas tyre është mendja, sepse ato e kanë kuptuar dispozitën e ligjvënësit nëpërmjet mendjes, e pastaj e kanë kundërshtuar, e për këtë arsye meritojnë dënim.

Sipas këtij mendimi rezulton se: Natyralistët japin përgjegjësi për humbjen e rrugës së besimit, e nuk japin përgjegjësi për dispozitat e çështjeve sekondare, ndërsa çka është thënë te njerëzit se natyralistët do të shpëtojnë kjo nuk është ashtu sepse natyralistët janë tre llojesh:

Natyralistët e grupit të parë: të cilët me vizionin e tyre kanë kuptuar monoteizmin, si Kajs bin Saidetu el Ejadi, për të cilin i dërguari i Allahut Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: Ai do të ringjallet popull në vete. Ky grup do të jetë i shpëtuar, sepse kanë besuar duke u bazuar në mendjen e tyre të shëndoshë.

Natyralistët e grupit të dytë: të cilët besimin e drejt zëvendësojnë me idhuj pastaj për vete bëjnë hallall e haram si Amër bin Lejhi i cili ka hap rrugën për arabët që të adhurojnë idhujt, ka shpik ligje e zakone e pastaj arabët e kanë pasuar atë. Ky grup do të dënohet, sepse ka ndryshuar të vërtetën, dhe ka adhuruar puta e idhuj.

Natyralistët e grupit të tretë: të cilët as nuk bëjnë idhujtari, por as nuk kanë besuar në monoteizëm, dhe nuk ka hyrë në shëriatin e Pejgamberit,

as nuk ka shpik ligj për vete por tërë jetën ka mbetë indiferent nga të gjitha këto, dhe ka pasur qëndrim neutral, për ta ka shpresë për shpëtim.

Klasifikimi i veprave në bazë “të mirës” dhe “të keqes”

Në bazë të asaj se çka ka në të mirën dhe çka ka në të keqen, dhe çka është ndërlidhur me urdhrat e Allahut, dijetarët e medhhebit Hanefij urdhrat i kanë klasifikuar në katër lloje, ndërsa ndalesat në dy lloje.

Llojet e urdhëresave janë:

Lloji i parë: e mirë në vetvete që nuk lejon rënien, si f.v. besimi, nuk bie nga i ngarkuari asnjëherë.

Lloji i dytë: E mirë në vetvete, mirëpo në bazë të rastit lejon rënien si f.v.: Namazi është i mirë në vetvete mirëpo në disa kohë të caktuara namazi nuk lejohet të falet. Falja e namazit për lehonën dhe gruan me menstruacione nuk është e lejuar, sepse iu është paraqitur rasti jashtë namazit, e cila i vishet e keqe në shikim të Ligjvënësit. Mirëpo namazit si namaz nuk iu është zhveshur mirësia e saj.

Lloji i tretë: E mirë nga një faktorë tjetër por nuk lejon rënien. Kjo është e mira e cila paraqitet në krijesat e Allahut si f.v. zekati, agjërimi. Këto vepra janë bërë të mira (janë mirësu), pasi që i janë paraqitur shkaqe tjera e ato janë:

- Dhënia e zekatit mbulon dhe zëvendëson nevojën e të varfrit,
- Agjërimi triumfon mbi epshin i cili urdhëron në të keqe.

Nëse shikohen në vetvete këto çështje nuk shihen si të mira, sepse:

- Zekati në vetvete është pakësim (pas dhënies) i pasurisë.
- Agjërimi në vetvete është vështirësi dhe ndalim i njeriut nga të mirat dhe kënaqësitë.

Ky lloj është bartë në llojin e parë, sepse mjetet e mira janë për Allahun e Lartmadhëruar, ligjërisht ka rënë llogaria në të drejt të robit, e këto janë bë vepra posaçërisht të pastra për Allahun, e rob i nuk ka të drejtë, të hyjë e të zgjedh çka dëshiron.

Lloji i katërt: E mirë nga tjetri por që lejon rënien si f.v:

- Xhihadi dhe dënimet për vepra penale,
- E mira e xhihadi është largimi i okupesve - kur nuk ka sulmues nuk ka luftë (xhihad),
- Dënimet penale janë ndëshkim i kriminelit për kryeneçësi - nëse nuk ka krime nuk ka dënime penale.

Këto llogariten e mirë në këto nuk ka të drejtë zgjedhjeje, e nuk janë të pastra të Allahut, ndërsa janë të natyrës “të mira për tjetrin”. Janë të mira për tjetrin se p.sh.: Xhihadi është dëmtimi i robërve (njerëzve) dhe shkatërrimi i qyteteve, ndërsa e mira prej tyre është largimi i agresorit dhe shkatërrimitarit dhe ngritja e fjalës së Allahut.

Sa i përket veprimeve të cilat Ligjvënësi i ka ndaluar janë dy llojesh:

Lloji i parë: Ajo çka ka të bëjë me ndalimin në çështje të ndjeshme si f.v. pabesimi, prostitucioni, vrasja dhe uzurpimi. Pasi që këto çështje janë të ndërlukuara dhe të cilat janë të ndjeshme janë të ndaluara, Ligjvënësi nuk ka dëshiruar lejimin e tyre te asnjë popull, dhe nuk ka bërë që të realizohet asnjëfarë begatie për ata që i veprojnë, sepse nuk është mirë që kriminelit të përfitojë asnjë të mirë prej kriminit të tij.

Ky lloj është dy nënlojesh:

Nënloji i parë: Çka është e keqe në vetvete, ky lloj nuk pranon shfuqizimin asnjëherë si f.v. pabesimi.

Nënloji i dytë: Çka është e keqe nga një farë mënyre dhe nuk mund të ketë prioritet asgjë tjetër përpos keqësisë, edhe nuk pranon shfuqizimin, thuhet: Ligjvënësi është e keqe në vetvete si f.v.: prostitucioni dhe uzurpimi i pasurisë.

Lloji i dytë: Ndaletat e ndërlidhura në çështje të sheriatit (ligjit). Kjo ndalesë është bërë për shkak të vet natyrës së ndalesës, sepse Ligjvënësi ka vendos bazat të cilat janë shkaktarë që të plotësohet tërësia e çështjes. Ndaleta është bërë për shkak të shkaqeve jashtë çështjes. Shitblerja është e lejuar ndërsa shitblerja e mosplotësimit të kushteve nuk është e lejuar dhe nëse mungojnë kushtet e kontratës nuk bëhet pranim-dorëzimi dhe kontrata mbetet e pezulluar.

DEVOTSHMËRIA, ARMA MË E FORTË E BESIMTARIT

Zgjothem në mëngjes, shoh rrezet e para të diellit që shndërrisin. E di se në mesditë dielli do të përcëllon, e unë nuk kam vend ku të freskohem, e të pushoj nën hije të ndonjë lisi apo peme. Nuk kam shtëpi ku do të hyj të pushoj, të qetësohem, e të mbrohem nga nxehti i thatë dhe nga vapa e madhe. Por së shpejti do të vjen vjeshta, atëherë do të jetë edhe më vështirë, sepse do të fryjë erë, do të bie shi, do të bëhet ftohtë, e unë si do t'i shpëtoj erës së fortë kur nuk kam vendstrehim?. Si do të terem nga shiu i cili bie në trupin tim kur më nuk është dielli por është shiu dhe i ftohti i cili depërton thellë në eshtrat e mia, thellë në palcën time?. Por edhe më vështirë do të jetë kur pas shiut dhe të ftohtit, vjen acari i dimrit, kur të bie bora mbi trupin tim të lagur, borë e cila nuk e mbulon trupin tim me jorgan të bardhë ashtu siç e mbulon tokën, sepse bora tokën e nxeh ndërsa trupin tim e ftohë edhe më shumë. Bora me acar të madh trupin tim të lagur do ta shtangoj edhe më shumë. E pas dimrit edhe pse do të vjen pranvera, për mua nuk do të jetë pranverë, sepse do të jem i sëmurë në shtrat, i shtrirë pa shtrat, por jo në spital, do të jem i sëmurë i shtrirë në shtratin e tokës, ku nuk do të më vizitoj askush, nuk do të më kontrolloj askush, e unë nuk mundem as të ngrihem në këmbë për të shkuar te mjeku, sepse nuk kam të holla për mjekim, sepse më ka kapluar varfëria e skajshme e cila shkon dhe troket vazhdimisht te dera e vdekjes. E vdekja më pret. Por si të shkoj te vdekja?. A jam përgatitur që së paku kur të hyj në derën e vdekjes të kem diçka me vete, që së paku ajo të më merr në gjirin e saj me ngrohtësi, e me ledhatim, e jo me ashpërsi e kërcënim, që vdekja të mos më shpjer te zjarri i xhehenemit, sepse zjarri i xhehenemit nuk është vend për t'u ngrohur, nuk është vend për të pushuar dhimbjet por është vend i cili i shton dhimbjet, ashtu që sa herë që bie lëkura nga i nxehti aq më shumë shtohen dhimbjet kur fillon të digjet lëkura tjetër?.

E di, jam mashtruar pas kësaj bote, në të më ka mashtruar shejtani me premtime të rrejshme, shejtani më mashtroi në këtë botë ashtu që të mos e përjetoj as këtë botë, e as të përfitoj botën tjetër, fundja ai ka qenë i mallkuar, e edhe unë po e mallkoj, por para se ta mallkoj ai veç është larguar nga unë pasi që e ka realizuar qëllimin e tij. Ai është larguar por në hapësirën ku jetoj, ka jobesimtarë që nuk më duan, pasi që unë vetes i them

besimtar, por besimi im në zemrën time nuk ka gjetur vend, por vetëm është sjell rreth e përqark trupit tim, vetëm ka qarkullua në mendjen time, vetëm ka tregua formalitetin tim, për këtë edhe munafiku (dyfytirshi) herë më afrohet, e herë më largohet, ai me fjalë është i ëmbël si mjalti, e me vepër të helmon pa helm. Për t'i përballuar të gjitha këto vështirësi më duhet të mbledh tërë forcën time që kam në disponim, që të mbrohem nga nxehtësia e madhe, e nga i ftohti që shtangon, që të mbrohem nga shejtani, nga jobesimtari e hipokriti, që të mos më mashtroj kjo botë, por ta kem nën kontroll që t'i largoj mërzitë nga mendja ime, e të këndellem, pasi që mërzitë e mbysin njeriun, e për të ngadhënjye mbi mërzitë t'i kthehem besimit sepse pas një analize të thellë në vetvete, konkludova se: kodrat edhe pse janë të larta e të fuqishme, ato i shemb hekuri, por hekuri sado që është i fortë, atë e shkrinë zjarri, e zjarri sado që është i rrezikshëm, atë e fik uji, e ujin e bartin mjegullat, ndërsa mjegullat i bartë era, ndërsa njeriu është në gjendje ta mund erën kur të gjej vendstrehimin e duhur prej saj, ndërsa njeriun e mund gjumi (të fjeturit), ndërsa gjumin e mund mërzia, e mërzinë e mund **besimi**. Por pasi të bëhem besimtar i sinqertë, prapë paraqitet vështirësia tjetër, ku më rrethojnë besimtarët që ma kanë zili, e për tu mbrojtur prej tyre e kam mjetin më të fuqishëm **devotshmërinë**. E di se e ngurta i nënshtrohet bimëve, e bimët iu nënshtrohen shtazëve, ndërsa e ngurta, bimët dhe shtazët, të gjitha këto i nënshtrohen njeriut, e njeriu duhet të jetë sundimtar në fytyrën e tokës dhe rob i nënshtroar vetëm ndaj Allahut Krijues e askujt tjetër. Nënshtrimi i plotë dhe robërimi i plotë ndaj Allahut më bën që ta kryej detyrën e jetës sime në këtë botë, detyrë për të cilën jam krijuar.

ISRAJA DHE MIËRAXHI

Israja dhe Miraxhi për nga rëndësia si muëxhize bën pjesë menjëherë pas muëxhizes se Kur'anit. Kjo ngjarje ka ndodhur më 27 Rexhep të vitit të 11 para hixhretit nga Meka e bekuar. Ibn Said thotë se kjo ngjarje ka ndodhur 18 muaj para Hixhretit.

Këtë ngjarje të rëndësishme në islam e kanë transmetuar 45 shokë (sehabë) të Muhamedit a.s.

Israja dhe Miraxhi janë një fillim i një epoke të re, një faze të re, pra, parapërfundim i fazës së Mekës dhe përgatitje për fillimin e fazës së Medines.

Është e rëndësishme të përmendet se bartja e Muhamedit a.s. ka ndodhur natën (lejlen) ashtu sikurse edhe zbritja e Kur'anit ka filluar natën (në natën e vlefshme të Kadrit).

Ekzistojnë dy lloje të udhëtimeve:

1. Udhëtimi horizontal; dhe
2. Udhëtimi vertikal.

Muhamedi a.s i ka bërë që të dy udhëtimet:

1. Udhëtimi Tokësor (horizontal) – ISRA; dhe
2. Udhëtimi Qiellor (Vertikal) – Miraxh.

Ngjarja e Israsë është e përmendur në fillim të Sures 17 të Kur'anit ku Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“I Lartësuar është ai që e barti robin e tij natën prej Mesxhidul Haramit (në Meke) në Mesxhidul Aksa, rrethinën e të cilës e kemi bekuar, për t’i treguar atij disa nga mrekullitë tona. Ai, me të vërtetë Dëgjon dhe Sheh çdo gjë.”(El-Isra : 1).

Në gjuhën arabe me fjalën “Isra” nënkuptohet *udhëtimi natën*. Mirëpo fjala “**lejlen** (natën) që e barti robin e tij natën” e përmendur në ajetin e Suretul Isra nënkupton një pjesë shumë të vogël prej pjesëve të natës, e jo tërë natën.

Fjala “abd” do të thotë **rob** (i nënshtuar). Madhështia e Muhamedit a.s. qëndron te kjo fjalë sepse ai ka qenë absolutisht i nënshtuar vetëm ndaj Zotit që d.m.th se dëshirën e tij e ka lidh drejtpërdrejt me *dëshirën* e Allahut.

“Abd” (rob) nuk d.m.th. heqje lirie, por përkundrazi ky është kulmi i lirisë së njeriut dhe këtë epiteton nuk ka mundur ta arrij askush më shumë se Muhamedi a.s.

Përndryshe Muhamedi a.s. ka pasur edhe epiteton Habibullah (i dashur i Allahut) por në këtë ajet Zoti i Lartmadhëruar e ka përdorur fjalën **abd** (rob).

Pas fjalës abd vjen epiteti Halile të cilin e ka fitua Ibrahim a.s. pra fjala Halilullah - ka kuptimin shok i Allahut, dashamirës i Allahut.

Shpesh na vijnë në mendje pyetjet se në çfarë rrethanash dhe në çfarë mënyre është realizua Israja dhe Miraxhi? Cilat janë pasojat dhe cilat janë rezultatet? Cilat janë amanetet dhe urdhrat e Israsë dhe Miraxhit?

Rrethanat kur ka ndodhur israja dhe miëraxhi

Rrethanat në të cilat ka ndodhur Israja dhe Miraxhi janë:

- Muhamedi a.s. ishte duke përjetua çastet më të vështira të jetës së tij.
- Shokët e tij kishin migruar në Abisinij (Etiopi).
- Tri vjet muslimanët kishin përjetua një izolim ekonomik.
- Kishin ra dëshmorët e parë në ruajtjen e fjalës se Dëshmisë (shehadetit) (Jasiri dhe Sumeja).
- Muslimanet ishin duke përjetuar vuajtjet dhe torturimet më të mëdha deri në atë kohë dhe pothuajse nuk kishin të ndalur.
- Ishte viti i pikëllimit për Muhamedin a.s. sepse ndërron jetë bashkëshortja e tij Hatixhja, e cila kujdesej për Muhamedin a.s., e qetësonte dhe ia largonte vështirësitë të cilat i përjetonte Muhamedi a.s. Po në këtë vit vdes edhe Ebu Talibi i cili e mbronte nga idhujtarët sepse ai kishte famë dhe

respekt nga idhujtarët e Mekes dhe për shkak të tij nuk kishin mundësi ta torturonin Muhamedin a.s..

Në të gjitha këto rrethana ndodhi ngjarja e Israsë dhe Miraxhit si përgatitje për fazën e re të misionit të tij.

Mënyra e israsë dhe miëraxhit

Ekzistojnë dy çështje të cilat nevojitet të debatohen sa i përket Israsë dhe Miraxhit:

1. **Çështja e parë është:** *se a ka shkua Muhamedi a.s. vetëm me trup apo ka shkua vetëm me shpirt apo ka shkua edhe me trup edhe me shpirt?*

Një pjesë e dijetarëve mendojnë se ka shkua vetëm me shpirt.

Një pjesë e dijetarëve mendojnë se ka shkua edhe me trup edhe me shpirt.

Një pjesë e dijetarëve mendojnë se Isranë e ka bërë edhe me trup edhe me shpirt, ndërsa Miraxhin vetëm me shpirt.

E vërteta është se në Suretul Isra Zoti i Lartmadhëruar e ke përdorur shprehjen **abd** (rob) e cila shprehje ngërthen në vete edhe trupin edhe shpirtin dhe nuk e ka përdor shprehjen “bi ruuhihi” e cila do të nënkuptonte shpirtin e tij.

2. **Çështja e dytë është:** *se a ka shkua Muhamedi a.s. në Miraxh apo është bartur në Miraxh?*

Duhet ditur se nëse një aeroplan i cili fluturon me shpejtësi 600 kilometra në orë për të arritur largësinë e tokës me diellin do t'i duheshin 17 vjet e gjashtë muaj. Po të fluturonte me shpejtësi të dritës atëherë do t'i nevojiteshin 8 min. sepse për 8 min. arrin drita e diellit prej diellit në tokë. Por, e vërteta është se Muhamedi a.s. ka shkuar me anë të fjalës “**Kun**”. Në hadithet e tij pejgamberi a.s. thotë “**Usrie bi**” që do të thotë jam bartur. Kështu që, ka dallim në mes të shkuarjes së Muhamedit a.s. në hapësirë qiellore dhe bartjes së Muhamedit a.s. prej Zotit të Lartmadhëruar në qiej sepse në atë moment nuk do të ekzistonte *elementi kohë* për Muhamedin a.s.

Pasojat e israsë dhe miëraxhit

Për herë të parë në islam ka ndodhur që për shkak të Israsë dhe Miraxhit disa prej muslimanëve kanë kalua prej besimit në pabesim. Sepse për arabët me kalua distancën prej Mesxhidul Haramit në Meke deri në Mesxhidul Aksa në Jerusalem është dashur të shpenzohet koha prej një muaji me deve.

Në anën tjetër, disa prej muslimanëve vetëm se e kanë forcua besimin edhe më shumë, siç është rasti me Ebu Bekri Sidikin. Sepse menjëherë pas ndodhisë së Israsë dhe Miraxhit kur pejgamberi a.s. shkoi në Qabe dhe tregoi për Miraxhin, pabesimtarët jo vetëm që nuk besuan por filluan edhe të bënë shaka. Pastaj pabesimtarët shkojnë te Ebu Bekri dhe i thonë që shoku yt po thotë se brenda një nate ka shkuar në Kuds dhe është kthyer prej atje. Kur Ebu Bekri dëgjoi këtë ai u tha: “Nëse Muhamedi e ka thënë një gjë të tillë, unë e besoj këtë. Pasi që i besoj në zbritjen e Kur’anit e cila është muëxhize (mrekulli mbinatyrore) atëherë për të besuar këtë është edhe më e lehtë”. Për shkak të kësaj ndodhie Pejgamberi a.s. atë ditë Ebu Bekrin e quajti **Es-Sidik** që do të thotë i sinqertë (Ebu Bekri i sinqertë).

Rezultatet e israsë dhe miëraxhit

Si rezultat kryesor nga Israja dhe Miraxhi është se Muhamedi a.s. është si ylli, se Muhamedi a.s. do të triumfonte edhe pse do të përjetonte mundime dhe lodhje, edhe pse do të përjetonte lodhje dhe mundime në aspekte të ndryshme ashtu siç kanë përjetuar edhe pejgamberët e mëhershëm të cilët i ka takuar njëri pas tjetrit gjatë ngritjes duke fillua prej Ademit a.s., pastaj Jahjain a.s., Jusufin a.s., Idrisin a.s., Harunin a.s., Musain a.s. dhe Ibrahimin a.s..

Rezultati tjetër është që Muhamedi a.s. përpos pejgamberëve është takua edhe me melekët.

Rezultat tjetër është që Muhamedi a.s. është ngritur mbi të gjitha krijesat mbi të gjitha hapësirat dhe horizontet qiellore dhe ka arritur në SIDRETUL MUNTEHA.

(Sidre – është pema e lotusit e cila rrënjët dhe trungun e ka në ujë, gjethja në anën e poshtme është e prekur për uji, ana tjetër për ajri, pra mesi i dy hapësirave.) Kur ka arritur në atë vend Xhibrili i ka thënë: O Muhamed nëse prin e djeg, nëse prij ky vend më djeg.

Israja dhe Miraxhi na bën të kuptojmë se për krijesat e Allahut nuk di askush përpos Tij.

Israja dhe Miraxhi tregon se islami është fe parlamentare e të gjithë shekujve. Kjo vërtetohet me atë se Muhamedi a.s. pasi që e ka krye Isranë është bërë imam i të gjithë pejgamberëve, pastaj e ka krye Miraxhin.

Israja dhe Miraxhi tregon se islami është fe e natyrshme. Fe e pastër si qumështi. Xhibrili i ofron Muhamedit a.s. që të zgjedh gotën me qumësht ose gotën me alkool. Muhamedi a.s. e zgjedh qumështin. Xhibrili i thotë: E ke zgjedh të vërtetën dhe të natyrshmen. Forcë, shpresë dhe besim se islami do të triumfon.

Rezultati kulmor i Miraxhit është që Muhamedi a.s. t'i sheh ajetet e Allahut dhe të takohet drejtpërsëdrejti me Allahun, ndërsa sa u përket besimtarëve ata do ta përjetojnë shikimin në Allahun në botën tjetër.

Emanetet dhe urdhrat e miëraxhit

Sikurse ndodhitë tjera edhe Israja dhe Miraxhi kanë amanete e ato janë:

- Që feja Islame të jetë unike, universale.
- Israja dhe Miraxhi tregojnë se Qabja (Mesxhi Harami) dhe Mesxhhidi Aksaja ne Jerusalem janë objekte të fesë islame.
- Të gjithë pejgamberët janë vëllezër, sepse të gjithë pejgamberët Muhamedin a.s. e kanë pritur dhe e kanë përshëndetur me shprehjen –**Selam dhe Përshëndetje për ty o vëlla besnik.**
- Ndërlidhja në mes të njeriut dhe Zotit.
- Që namazi të jetë themel i fesë, sepse ka ardhur si obligim në mënyrë të drejtpërdrejt.
- Largimi nga gjërat e ndaluara (Haram) dhe veprimi i gjërave të lejuara (Halal).

- Të larguarit nga fitimi i pasurisë me kamatë.
- Të larguarit nga fitimi i pasurisë me tradhti, gënjeshtër dhe me shpifje, sepse Muhamedi a.s. ka parë një grup njerëzish që prej tyre hiqej copa e mishit edhe e hanin tjerët dhe kur e ka pyet Xhibrilin për ta, ka marrë përgjigjen se ata e kanë fituar pasurinë me shpifje, gënjeshtër dhe tradhti.
- Që të adhurohet vetëm Allahu.
- Të respektohen prindërit.
- Të mos bëhemi shkapërderdhës dhe as koprrac.
- Të larguarit nga prostitucioni.
- Të larguarit nga keqpërdorimi dhe ngrënia e pasurisë së jetimit.
- Mbajtja e fjalës dhe kryerja e premtimit.
- Të mos pasohet verbërisht, dhe
- Ndalimi i kryelartësisë.

ETTEHIJATU DHE MIRAXHI

Zoti Lartmadhëruar, Muhamedit a.s. dhe umetit të tij të gjitha obligimet ia ka kumtuar nëpërmjet Xhibrilit, siç janë agjërimi, haxhi, zekati, përderisa për shkak të vlerës dhe rëndësisë së namazit, Zoti i Lartmadhëruar këtë obligim, pra namazin, e ka urdhëruar në mënyrë të drejtpërdrejtë. Fjala namaz burimin e ka prej fjalës **SILE** që do të thotë **LIDHJE**. Pra, nënkupton të lidhurit e drejtpërdrejtë me Zotin.

Një prej pjesëve themelore të namazit është edhe ulja në fund të namazit në të cilën cilën ulje këndohet **ETTEHIJATI**, e cila ka rëndësi dhe vlerë të madhe në namaz.

Kjo lutje buron prej Miraxhit të Muhamedit a.s. në Sidretul Munteha, pra në kulminacionin e gjithësisë, aty ku përfundojnë gjithësitë dhe krijesat.

Kur Muhamedi a.s. është ngritur në Sidretul Munteha, i është drejtuar Zotit të Lartmadhëruar me fjalët:

ETTEHIJU LILAHİ VES SALAVATU VET TAJJIBATU, që do të thotë: **“Çdo përshëndetje, çdo bekim dhe çdo mirësi është për Zotin.”**

Zoti i Lartmadhëruar i thotë:

ESSELAMU ALEJKU EJUHEN NEBIJU VE RAHMETULLAHI VE BEREKATUHU, që do të thotë: **“Paqja, begatia dhe mëshira e Zotit qofshin mbi ju o i dërguar.”**

Muhamedi a.s. i përgjigjet:

ESSELAMU ALEJNA VE ALA İ BADİL-LAHI SALIHİNĖ, që do të thotë: **“Paqja qoftë mbi ne dhe mbi robërit e mirë dhe të devotshëm.”**

Ky ishte pra dialogu i zhvilluar në Sidretul Munteha, në mes Zotit të Lartmadhëruar dhe Muhamedit a.s.. Këtë dialog e ka përcjellë Xhibrili besnik i cili në atë moment e deklaroi dëshminë e shehadetit:

ESHHEDU EN LA İLAHE İL-LA-LLAH VE ESHHEDU ENNE MUHAMMEDEN ABĐUHU VE RESULUHU, i cili në gjuhën shqipe do të thotë: **Dëshmoj dhe deklaroj se vetëm Allahu është Zot dhe dëshmoj dhe deklaroj se Muhamedi është i dërguar i Zotit dhe rob i tij.**

Kjo është vula e fesë islame, ky është kushti i fesë islame dhe çelës i hyrjes në fenë islame.

Në suren Fatir Zoti i Lartmadhëruar thotë:
“Tek Ai (Allahu) ngrihen fjalët e mira dhe veprën e mirë e ngrit Vet Ai.” (El Fatir : 10)

Lusim Zotin e Lartmadhëruar që namazi, fjalët e mira dhe veprat e mira të ngrihen dhe të pranohen tek Ai.

KAPITULLI I DYTË

PËR TË QENË THIRRËSI ISLAM I SUKSESSHËM

Fjala **Daëve** është fjalë që në gjuhën arabe do të thotë thirrje apo ftesë. Vetëm fjala **daëve** ka kuptim të ftesës së përgjithshme, mirëpo nëse themi **Daëve Islamije** kemi për qëllim thirrjen apo ftesën në Islam.

Thirrja në Islam është përgjegjësi serioze dhe e rëndësishme të cilën duhet marrë me përgjegjësi të madhe sepse ka të bëjë me përhapjen e fjalës së Allahut, FJALË e cila duhet të mbizotërojë në mbarë njerëzimin.

Pasi që edhe vet fjala ka kuptim të përgjithshëm atëherë edhe thirrja në islam është shumëdimensionale, gjë që jep të kuptojë që secili në lëmin e vet mund të bëjë daëve, pra edhe zbulimi shkencor është pjesë e daëves, edhe kontributi në arsim dhe shkencë është pjesë e daëves.

Thirrja praktike në islam është më e suksesshme se thirrja teorike. Zoti i Lartmadhëruar i ka thënë Muhamedit a.s. ta veproj atë të cilën e kumton: **“O i dërguar. Kumto atë çka të është zbritur prej Zotit tënd dhe nëse nuk e vepron (atë që të është shpallur) atëherë ti nuk e ke kryer detyrën e shpalljes (ftesës).” (Et-Tevbe)**

Nuk është thirrje në islam vetëm me fjalinë “Pranoje islamin se përndryshe do të shkosh në xhehenem.”. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“E kush është më zëmbël se ai që thërret në rrugën e Allahut, bënë vepra të mira dhe thotë: Unë jam prej muslimanëve.” (El-Fussilet : 33)

Zoti i Lartmadhëruar i ka thënë Muhamedit a.s.:

**“Ti (Muhamed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me:
urtësi,**

këshillë të mirë dhe

polemizo me ata (kundërshtarët) në mënyrën më të mirë.” (Nahl : 125)

Mënyra e thirrjes duhet të jetë sipas asaj që vetë i dërguari i Allahut e ndoqi për 23 vjet, pra shëmbëlltyra e tij është bazë në daëve.

Feja islame ka zbritur për:

- Thellësi;
- gjerësi; dhe
- gjatësi.

Sa i përket gjatësisë është që feja islame ka zbritur për të gjitha kohërat, pra për të gjitha gjeneratat deri në Ditën e Kijametit.

Nuk është thirrës islam ai i cili nuk e di historinë të cilën e tregon Kur’ani, disa prej tyre janë:

- Historia e Musës a.s. me Firaunin a.s.;
- Historia e Ibrahimit a.s. me të atin;
- Historia e Musait a.s. me Hidrin, etj.

Histori të tilla përsëriten në forma tjera dhe me aktorë tjerë në perioda të ndryshme deri në Ditën e Kijametit.

Sa i përket gjerësisë është se feja islame ka zbritur për të gjithë popujt për të gjitha vendet.

- Nuk është thirrës islam ai i cili dëshiron përhapjen e islamit në perëndim duke tentua të fus zakone të cilat janë të lindjes por që nuk janë të islamit.
- Nuk është thirrës islam ai që natyrshmërinë e vet e plason si ‘natyrshmëri islame’ dhe kështu në vend se të udhëzojë bëhet pengesë për udhëzim.
- Nuk mund të jetë thirrës i suksesshëm ai që përdor fjalë fyese dhe ofenduese, fjalë përbuzëse dhe sharje (qoftë edhe ndaj zullumqarëve) me urrejtje e neveri. Zoti i Lartmadhëruar i ka thënë Musait a.s. që kur ta thërret Firaunin ta thërret me fjalë të buta:

“Atij thojini fjalë të buta, ndoshta ai mendohet a frikësohet.”

- Thirrja në islam është *art* dhe *shkencë* në vete sepse është thirrje për Allahun, i cili i ka emrat më të bukur, e si mund të thirret në islam me fjalë të këqija kur Allahu i ka emrat dhe atributet më të bukur. Thotë Zoti i Lartmadhëruar:

“Dhe Allahu i ka emrat më të bukur dhe thirreni me ato emra.”

Sa i përket thellësisë, kjo ka kuptimin që feja islame ka zbritur për çdo çështje që i nevojitet njeriut.

- Nuk është thirrës ai i cili nuk ka njohuri për të drejtat e njeriut dhe jo vetëm që i shkel të drejtat elementare të njeriut por edhe thërret në shkeljen e të drejtave elementare të njeriut.
- Nuk mund të jetë thirrësi i suksesshëm në islam kur nuk e njih fikhun islam. Thërret në islam me ‘sunet’ pa e ditur fikhun. Nuk mund të kuptohet suneti pa fikh. Fikhu me sunetin (hadithin) është sikurse farmacisti me mjekun, farmacisti i jep barnat por nuk ka njohuri për sëmundjet, mjeku e jep udhëzimin e barnave pas elaborimit (ekzaminimit) dhe detektimit të sëmundjes. Fekihu është ai i cili e ka analizua sunetin dhe është ekspert i sunetit. Nuk ka sunet pa fikh edhe nëse ai sunet (hadith) është i vërtetë.
- Nuk mund të jetë njeriu i suksesshëm në daëve kur nuk ka njohuri për historinë e politikës islame.
- Nuk mund të jetë thirrësi i suksesshëm kur nuk e njih historinë e sheriatit.
- Nuk mund të jetë thirrësi i suksesshëm kur ai nuk ka njohuri për qytetërimin bashkëkohor.
- Nuk mund të jetë thirrësi i suksesshëm kur nuk ka njohuri për filozofinë qeverisëse të vendeve të botës apo të vendit në të cilin jeton.

Dhe në fund: Thirrësi islam duhet të ketë njohuri për përmirësimin e gjendjes morale, shoqërore dhe politike, e jo për krijimin e krizës shoqërore-politike. Dihet se gjendja shpirtërore tek njerëzit ndryshon. Ka prej njerëzve të cilët janë të devotshëm dhe ka prej tyre jo të devotshëm dhe për shkak se thirrësi duhet të jetë i devotshëm nuk do të thotë se ai duhet të jetë kryelartë (arrogant) ndaj tjerëve sepse dihet se mëkatet e zemrës janë më të rrezikshme se mëkatet e pjesëve të trupit. Kryelartësia është më e keqe se pirja e alkoolit. Për alkool ekziston zbatimi i dënimit të menjëhershëm, ndërsa për kryelartësi ekziston dënimi në botën tjetër.

ISLAMI ËSHTË PAQE

Fjala Islam është paqe, këtë epitete ia ka dhënë Zoti i Lartmadhëruar dhe askush nuk mund ta zhvesh Islamin nga ky epitete qoftë prej melekëve qoftë prej njerëzve qoftë prej besimtarëve të vet fesë Islame sepse është epitete të cilin ia ka dhënë Krijuesi dhe nuk mund t'ia heq krijesa dhe krijesa nuk mund ta heq epiteten e Krijuesit. Këtë epitete e ka edhe vet Zoti i Lartmadhëruar, **Selam – Paqe**.

Këtë maksimë e gjejmë në Kur'an ku Zoti i Lartmadhëruar thotë **“Dhe jam i kënaqur që fe për juve e lashë Islamin (Fenë e Paqes)”**.

Feja Islame zanafillën **Paqe** e ka, prej Ademit a.s, bile jo prej Ademit a.s. pasi që ka zbrit në tokë por para se të zbriste në tokë, pra që nga frymëmarrjet e para të tij kur i përshëndeti melekët me përshëndetjen **“Paqja qoftë mbi ju”** dhe melekët ia kthyen **“po ashtu edhe mbi ju qoftë paqja dhe mëshira e All-llahut”**.

Cilësia **Paqe** e fesë Islame është cilësi e vet Krijuesit dhe është një prej emrave të bukur të Allahut (**es-Selam - Paqe**), dhe për këtë arsye Muhamedi a.s. është lutur:

“O Zot Ti je paqe dhe prej Teje buron paqja”.

Namazi është shtyllë e Islamit, gjatë qëndrimit në namaz përsërisim përshëndetjen e ndërsjellë të Zotit të Lartmadhëruar me Muhamedin a.s. në natën e Miraxhit, mu në atë natë në të cilën është bërë obligim namazi, për këtë arsye kjo përshëndetje ka zënë vend në namaz se Zoti i Lartmadhëruar e ka përshëndet Muhamedin a.s. me **“Paqe”** dhe po ashtu Muhamedi a.s. ia kthen përshëndetjen **“Paqe”**.

Edhe pas përfundimit të namazit kur ta vazhdojmë aktivitetin tonë e startojmë me moton **“O Zoti im! Vërtet ti je Paqe dhe prej teje buron Paqja...”**.

Paqja duhet filluar nga vet-vetja, njeriu në rend të parë duhet të arrij paqen me vet-vetën e pastaj me të tjerët, kur të hymë në shtëpi edhe nëse në shtëpi nuk është asnjë anëtar i familjes, posa ta hapim derën e shtëpisë e përshëndesim veten me përshëndetjen **“Paqe”**.

Testimin e arritjes së paqes me vet-veten e bënë agjërimi, në fund të këtij muaji është një natë e cila është më e vlefshme se sa e tërë jeta dhe gjatë tërë natës së vlerës deri në agim apelohej **“Paqe”** dhe ky apel bëhet

nga krijesat më të mira, prej melekëve dhe prej shpirtit besnik i cili kërkon që të ruhet paqja me besnikëri.

Haxhi si shtyllë e islamit është konferencë e paqes shumëdimensionale sepse moto kryesore ka **“Paqen”**, paqe me Zotin, me veten, me njerëzit, me kafshët me insektet e deri te edhe bimët qofshin ato prej bimëve më të imta.

Përshëndetja e njëri tjetrit bëhet me shprehjen **“Paqe”** në fenë tonë fillon me **“Paqe”**. Kur të takohemi në rrugë me injorantët Zoti na ka mësua që t’iu themi **“Paqe”**. Zoti i Lartmadhëruar thotë: “Robërit e të Githëmëshirëshmit janë ata të cilët ecin në tokë me qetësi dhe kur të takohen në rrugë me injorantët u thonë **“Paqe”**.”

E tërë jeta jonë është e fokusuar për të fituar shtëpinë e botës tjetër mirëpo ajo shtëpi e botës tjetër quhet **shtëpia e Paqes** për të cilën fton Zoti i Lartmadhëruar.

Përshëndetja në xhenet prej Zotit të Lartmadhëruar do të jetë me shprehjen **“Paqe”**. Në xhenet nuk do të dëgjohen shpifje e fjalë të kota por vetëm përshëndetjet **“Paqe”**.

Pra, fillimi i jetës ka filluar me paqe dhe e tërë jeta duhet të jetë për paqe dhe bota tjetër është paqe, dhe të gjitha këto janë të argumentuar me fjalët e Zotit të Lartmadhëruar në Kur’an dhe kush është ai që mund t’i mohoj këto përpos ai i cili nuk i beson fjalët e Zotit të Lartmadhëruar.

POLITIKA NË ISLAM

A është e ndaluar politika në Islam?

A është politika çështje e urreyer?

A ka bazë kur'anore politika?

Këto pyetje sillen vërdallë në mendjet tona të cilat duhet sqaruar. Ky punim nuk ka të bëjë me islamin politik dhe as për politikën Islame por për politikën në Islam se a është e lejuar apo jo?

Sa i përket atyre që thonë se është e ndaluar dhe është çështje e urreyer të marrit me politikë, ne u themi: Po si mund të jetë politika e ndaluar dhe e urreyer kur raporti mes fesë dhe politikës është sikurse raporti i mjekësisë me njeriun. Ai raport është si raporti mes terapisë medicinale me ilaçe, e jo si raport rivaliteti dhe konfliktualiteti.

Dikush mund të thotë se s'ka politikë dhe politikan të drejtë dhe për këtë arsye politika është e ndaluar dhe e urreyer, por e vërteta është se ka politikë të drejtë sikurse ka edhe politikan të drejtë ashtu sikurse ka politikë të padrejtë dhe politikan të padrejtë. Prej politikanëve të drejtë kanë qenë pejgamberët sepse edhe pejgamberët janë marrë me politikë dhe politika e tyre ka qenë politikë edukative, politikë kulturore dhe politikë sociale.

Përderisa Politika është rregullimi jetës së njeriut që mundëson realizimin e të drejtave individuale kolektive, atëherë edhe feja Islame mundëson realizimin e të drejtave individuale dhe kolektive.

Përderisa politika ka të bëjë me njeriun, ambientin dhe natyrën, atëherë edhe feja Islame ka të bëjë me njeriun ambientin dhe natyrën.

Sa i përket njeriut, Zoti Lartmadhëruar në Kur'an thotë:

“Dhe Ne i kemi nderuar dhe fisnikëruar bijtë e Ademit(njeriun).”(El Isra, 70)

Në një ajet tjetër Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Ne e kemi krijuar njeriun në formën më të bukur.” (et Tijn, 4)

Është e papranueshme që të thuhet nuk ka politikë në fe, sepse Islami nuk është fe e izoluar nga jeta e përditshme. Nëse e zhveshim Islamin nga politika e kemi bërë joislame. Islami nuk është fe vetëm e adhurimit por është fe e dhurimit dhe veprimit, fe e jetës së të dy botëve.

Islami i rregullon raportet njeri - Krijues (këtu bënë pjesë adhurimi) ; njeri - njeri (këtu bënë pjesë: Qeveria dhe qytetari) dhe njeri - njeri - Krijues (këtu bënë pjesë qeveria me qytetarin në raport me Krijuesin). Duhet cekur se të drejtat e njeriut për islamin janë nder, detyrë dhe përgjegjësi qoftë nga qeveria qoftë nga qytetari.

Feja islame rregullon domosdoshmëritë vitale të njeriut, e ato janë: Ruajtja e integritetit fetar; Ruajtja e integritetit personal; Ruajtja e integritetit familjarë; Ruajtja e integritetit të mendjes; ruajtja e integritetit të pasurisë dhe ruajtja e integritetit të nderit .

Parimet Islame janë: Barazia, liria, toleranca dhe demokracia.

Sa i përket barazisë: Sipas fesë Islame të gjithë pejgamberët kanë qenë vëllezër por nga nënat e ndryshme. Muhamedi a.s. na ka mësuar se i gjithë njerëzimi buron prej një nëne dhe prej një babe, ndërsa Ademi është i krijuar prej balte. Nga këtu buron barazia racore. Pra kemi vëllazërimin njerëzor dhe vëllazërimin e origjinës.

Muhamedi a.s. edhe pse ka qenë Pejgamber, Zoti i Lartmadhëruar i ka thënë t'i thotë njerëzimit: *“Pa kurrfarë dyshimi unë jam njeri i thjeshtë ashtu sikurse ju”*.

Liria nuk është në kundërshtim me parimin e fesë Islame, përkundrazi feja islame është promotor i lirisë, sepse Zoti i Lartmadhëruar e ka zgjedhë njeriun që të jetë krijesë me të drejtë të zgjedhjes së besimit dhe të veprimit, mirëpo është absurditet të mendohet se duhet të ketë liri absolute, por liria duhet të kuptohet në konceptin e moscenimit të lirisë së tjetrit sepse në momentin kur për shkak të lirisë tënde cenohet liria e tjetrit, fillon tejkalimi i konceptit të lirisë dhe merr kuptimin e fillimit të nënshtimit dhe të robërimit, nëse secili do të kishte liri absolute atëherë do të kishte përzierje në mes të lirive dhe ndeshje në mes tyre.

Kur’ani rekomandon njerëzit të konsultohen për të gjitha çështjet e tyre të përbashkëta. Njeriu si udhëheqës në tokë duhet të funksionojë si një trup i përbashkët për natyrën, ambientin dhe për çështjet të cilat e rrethojnë. Në ajetin Kur’anor koncepti i “shura-s” nënkupton demokracinë, sepse njerëzit duhet të konsultohen për çështjet e përbashkëta dhe për çështjet me të cilat preokupohen.

Tolerancë do të thotë vetëpërmbajtje dhe durim duke lejuar pikëpamjet e të tjerëve edhe pse me to pajtohem pjesërisht apo aspak .

Toleranca në Islam është një nga themelet e besimit fetar. Feja islame mund të bashkëjetojë dhe të bashkëpunojë jo vetëm me fetë tjera por edhe ma ata që nuk kanë aspak fe. Po të mos ishte kështu, a thua si do ta shpjegonim ajetin kur'anor: **“Nuk ka dhunë në fe.”** (el Bekare, 156) dhe ajetin tjetër **“Ju e keni fenë tuaj dhe unë e kam fenë time.”**(el Kafirunë,7).

Edhe marrëdhëniet ndërkombëtare ndërtohen në parimet demokratike si liria, barazia, njohja dhe respekti i interesave nacionale, shtetërore, ekonomike, kulturore si interesa vitale të një shteti dhe kombi.

Për çdo veprim politik duhet pasur durim. Musa a.s. nuk kishte durim me rastin e udhëtimit me shokun e tij të mirë, mirëpo, në fund, njeriu i mirë, si politikan i mirë, ia tregoi fshehtësitë e tregimit, me fjalë tjera politikën e udhëtimit të jetës dhe jo vetëm fshehtësinë e atij udhëtim. Njeriu i mirë, si politikan i mirë, e ka dëmtuar anijen e banorëve të cilët e siguronin jetesën me transport të njerëzve dhe me qarkullimin e mallrave me anije. Musa a.s. i thotë: *“Ti ke vepruar punë të keqe”*. Njeriu i mirë i përgjigjet : *“Sa i përket anijes , po pas tyre ka qenë një mbret i cili uzurponte çdo anije në gjendje të mirë dhe e dëmtova.”* Njeriu i mirë e ka dëmtuar me qëllim që mbreti ta shihte si anije të panevojshme dhe ta anashkalonte, e pastaj banorët ta ripararin dëmin e anijes dhe të vazhdonin sigurimin e jetesës po me atë anije. Pra , a nuk është ky një akt politik i drejtë!?. A nuk është politikë prej politikave sociale ku mund të dëmtohet shoqëria përkohësisht, për të siguruar jetesën më të mirë për një kohë afatgjate. Për banorët e atij vendit më mirë do të ishte që të mbetej anija me defekte e cila mund të riparohet se sa të mbeteshin pa mjet transportimi dhe pa anije.

Nuk janë politikan të mirë ata të cilët e humbin tërë anijen (vendin) dhe nuk lejojnë kompromise. Në shumë raste, politika shtetërore në fillim për banorët duket e keqe, por pas një kohe del se ka qenë në dobi të mëvonshme.

Dhulkarnejni a.s. ishte ai i cili ndërtoi pendën për të shpëtuar një popull nga një popull mizorë. A thua a nuk ishte ky një veprim politik dhe si një mësim se si duhet vepruar dhe si duhet mbrojtur prej popullit kriminel!?.

Ibrahimi a.s. i kishte thënë popullit të vet se ishte i sëmurë edhe pse nuk ishte i sëmurë vetëm e vetëm për të mos shkuar për t'i adhuruar idhujt. A nuk është ky një veprim politik i tij. A nuk është politikë, politika e Ibrahimit a.s. me babën e tij, pastaj me familjen e tij, pastaj me popullin e

tij. Jeta dhe veprimtaria e tij është mësim për tjerët sepse Kur'ani na mëson për politikën ashtu siç na ka mësuar për adhurimin.

Nëna e Musa a.s. është shembulli më i miri se si ajo me dhembjen e saj të thellë e hodhi djalin e saj (Musa a.s) me sënduk në lum, e që sënduku të lundronte deri te kështjella e Firaunit, e që më pastaj të shkoj te Firauni dhe të lajmërohet për t'i dhënë gji fëmijës të saj pa e ditur Firauni se është fëmija i saj. Ajo e qetësoi veten e saj dhe e ushqeui fëmijën e saj në mënyrën më të mirë të mundshme, e që politika duhet të gjejë rrugën më të mirë të mundshme. A thua, a nuk ishte kjo një veprim politik i saj prej së cilës duhet të marrim mësim apo ndoshta ngjarjet e Kur'anit duhet treguar vetëm si ngjarje të rëndomta pa i analizuar dhe pa i logjikuar!?

Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an ka thënë:

“Dhe Ne në këtë Kur'an kemi sjellë shembuj për çdo rast.”

Rastet e politikës në Kur'an janë të shumta, Kur'ani për çdo çështje ka parapa zgjidhje, po a ka ndokush që e merr Kur'anin si udhëzues?!.

PERSONALITETI ISLAM

Njeriu ka nevojë të komplotoj shtëpinë me dhomë gjumi, dhomë fëmijësh, me banjë, kuzhinë, e shumë elemente tjera. Shoqëria ka nevojë të komplotoj sinjalizimin e rrugëve, asfaltimin e tyre, rregullimin e hapësirave publike, etj. Për tu kompletuar të gjitha këto duhet të bashkëpunojnë mjeshtër të natyrave të ndryshme, si inxhinierë, arkitektë, elektrikistë, etj. Pra, si njeriu ashtu edhe shoqëria duhet të kompletohen. Për tu kompletuar familja duhet të bashkëpunojnë të gjitha institucionet edukative, kulturore, shoqërore, informative, etj. Nëse nuk ka bashkëpunim në mes tyre nuk mund të kompletohet familja (shoqëria). Nuk mund të bëhet kompletimi kur disa ndërtojnë e të tjerët demolojnë.

Prej qëllimeve kryesore në islam është kompletimi i njeriut në të gjitha aspektet:

- kompletimi i mendjes;
- kompletimi i shpirtit;
- kompletimi i trupit;
- kompletimi shoqëror; dhe
- kompletimi politik dhe ushtarak.

1. Kompletimi i mendjes: Mendja është bazë e besimit, sikurse trupi i cili ushqehet me ushqim ashtu edhe mendja ushqehet me lexim, për këtë arsye edhe ajeti i parë ka zbritur **“Lexo...”** . Në shumë ajete Zoti i Lartmadhëruar i përfundon me **“a nuk po analizojnë”, “a nuk po logjikojnë”, “a nuk po mendojnë”,** e të ngjashme.

Kjo dëshmon se muslimani duhet të kompletohet mendërisht (logjikisht) e cila është bazë e besimit në Zotin e Lartmadhëruar, bazë e kuptimit të obligueshmërisë dhe bazë e kryerjes së obligimeve.

2. Kompletimi i shpirtit: Ibadeti është ushqim i shpirtit. Sikurse trupi i cili ushqehet me ushqim ashtu edhe shpirti ushqehet me adhurim. Namazi, agjërimi dhe obligimet tjera në islam nuk janë caktuar për vështirësinë e jetës së njeriut por për kompletimin e shpirtit. Edhe pse adhurimet kanë

lidhje të ngushtë me shëndetin mendor dhe fizik, qëllimi i tyre është kompletimi i shpirtit.

3. Kompletimi i trupit: Obligimet në islam nuk janë adhurime vetëm të ushqimit të shpirtit por janë edhe për edukimin e trupit. Muhamedi a.s. ka thënë: ***“Muslimani i fortë është më i dashur tek Allahu se sa muslimani i dobët.”*** Mendja e shëndoshë në trupin e shëndoshë. Muhamedi a.s. na ka këshilluar që t’i mësojmë fëmijët notimin dhe kalërimin për tua forcuar trupin.

Kur’ani tregon për beni Israilët të cilët kërkuar nga pejgamberi i tyre tu dërgohet një udhëheqës, i kërkuar Samuelit t’u zgjedh edhe një mbret dhe prijës që t’i udhëheqë në luftë kundër Amalikëve. Pejgamberi atyre u tha: **“Allahu ka dërguar Talutin si mbret tuajin.”** Taluti ishte i ditur, i urtë, me trup të shëndoshë dhe i fuqishëm.

“Ata thanë: Si mund të bëhet ai (Taluti) mbreti ynë, kur ne kemi përparësi për të sunduar?! Përveç kësaj, ai nuk ka ndonjë pasuri të madhe. Ai u përgjigj: Allahu e ka zgjedhur atë për mbret tuajin dhe e ka pajisur me dijeni të gjerë dhe me fuqi trupore.” (El-Bekare : 247).

Pas këtij debati ata e pranuan Talutin si mbret dhe komandant të tyre. Kur u përballën me Xhalutin dhe ushtrinë e tij, fitoi ushtria e Talutit ndaj ushtrisë së Xhalutit.

4. Kompletimi shoqëror: Edukimi i shoqërisë bëhet nëpërmjet edukimit të individit dhe anasjelltas.

Në islam kemi obligime individuale dhe obligime kolektive. Adhurimet individuale janë për të kompletuar individin në shoqëri. Obligimet shoqërore janë për të kompletuar shoqërinë. Agjërimi nuk është çështje tjetër pos që i gjithë populli të ndjejë të njëjtën uri dhe të njëjtën dhimbje dhe të njëjtin gëzim në të njëjtën kohë. Zekati është obligim i individit i cili ka detyrë ndaj shoqërisë. Kryerja e këtij obligimi e rrit përkrahjen dhe solidaritetin social në mes komunitetit.

Adhurimet e përbashkëta janë adhurime për të krijuar stabilitetin moral, social dhe që të kompletohet shoqëria si shoqëri.

5. Kompletimi politiko-ushtarak: Muslimani nuk duhet të jetë vetëm një statujë e kësaj bote e për të arritur këtë duhet të kompletohet si në

fushën e ibadetit ashtu edhe në fushën politiko-ushtarake. Nuk ka dobi prej atij i cili angazhohet vetëm në adhurim dhe nuk përgatitet politiko-ushtarakisht.

Kur'ani na tregon për pejgamber të cilët kanë qenë vetëm pejgamber dhe jo udhëheqës. Po ashtu edhe për pejgamber që kanë qenë edhe pejgamber edhe udhëheqës. Po ashtu edhe për pejgamber që ka qenë pejgamber, udhëheqës edhe inxhinier siç është rasti i Dhulkarnejnit. Muhamedi a.s. i dërguari i fundit dhe vula e pejgamberëve gjatë periudhës së pejgamberisë së tij ka kaluar në dy etapa:

1. Në etapën e Mekës ku ka qenë vetëm pejgamber; dhe
2. Në etapën e Medinës ku ka qenë edhe pejgamber, udhëheqës dhe komandant suprem i forcave të armatosura. Biografia e Muhamedit a.s. na tregon se ai ka qenë i kompletuar politiko-ushtarakisht. Nëse e shikojmë ajetin **“Dhe ju në pejgamberin e Allahut e keni mostrën më të mirë.” (El Ahzab)** nuk ka të bëjë me pasimin e tij vetëm në çështje të adhurimit por edhe në pasimin e tij në çështjet politiko-ushtarake.

Dhe... në fund. Nëse turpi është i mangët, mendja e mangët, ibadeti i mangët, nuk mund të jetë muslimani komplet. Muslimani duhet të thellohet në dimensionet e meditimit për të zbuluar thesaret e kësaj bote. Muslimani duhet të forcohet me karaktere fisnike. Muslimani duhet të mbledh nektarin e njohjes të të gjitha fushave. Muslimani duhet pasuar rrugën e arsimimit, edukimit dhe të drejtësisë sociale. Muslimani duhet të bëjë ndriçimin e mendjes me shkencë, dituri dhe teknologji. Muslimani duhet të ndriçoj dritën e zemrës dhe të besimit dhe të mos jetoj në errësirë. Muslimani duhet të jetë komplet e jo i mangët sepse mangësia është virtyt i huaj për muslimanin.

“POLITIKA NË ISLAM”, “ISLAMI POLITIK” DHE “POLITIKA ISLAME”

Termi *politikë* na është bërë term i përditshëm, përpos kësaj, dëgjojmë për termin *politikë islame* dhe ndonjëherë dëgjojmë për *politikën në islam*, e ndonjëherë *islami politik*, kështu që do të sqarojmë këto çështje si në vijim:

1. Politika në islam;
2. Islami politik; dhe
3. Politika islame.

1. Politika në islam.

Politika është shkencë e cila ka rëndësi të posaçme, është profesion i dobishëm dhe me vlerë, sepse merret me mirëqenien e qytetarit. Është veprimtari me të cilën njerëzit mund të afrohen dhe të jetojnë në harmoni mes tyre.

Në të *drejtën islame* ekzistojnë tri lloje të raporteve:

E para: Raportet **njeri-Krijues**;

E dyta: Raportet **njeri-njeri**, pra, raportet ndërnjerëzore;

E treta: Raportet **njeri-njeri-Krijues**.

Sipas të *drejtës islame* me rregullimin e raporteve ndërnjerëzore merret politika.

Në raporte ndërnjerëzore bëjnë pjesë të drejtat e barabarta të cilat janë të patjetërsueshme të të gjithë pjesëtarëve të familjes njerëzore. Barazia ndërmjet tyre është themel i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë. Kush i shkel të drejtat e një pjesëtari të familjes njerëzore ai ka bërë mëkat të madh.

Ashtu siç fjala mund të jetë e drejtë dhe jo e drejtë, ashtu edhe politika mund të jetë politikë e drejtë dhe jo e drejtë, kështu që politika e drejtë nuk

mund të jetë në kundërshtim me ligjin e Allahut, por përkundrazi harmonizohet dhe përputhet me të.

Ashtu siç është farz të bashkëpunohet në largimin e të keqes, ashtu edhe politika e drejtë është farz.

Sa i përket çështjes së politikës në islam ekzistojnë dy mendime (drejtime):

2. Politika është haram;
3. Politika është farz.

1. Politika është haram.

Ky drejtim mendon që politika është haram dhe se demokracia është pabesim dhe mëkat i madh.

Ky mendim i përket havarixhëve, të cilët argumentonin se demokracia insiston qeverisjen e popullit me popull, ndërsa në islam populli nuk është gjykues dhe qeveritar, sepse qeveritar është vetëm Allahu, ata citojnë ajetin kur'anor: **“Vërtetë gjykimi dhe qeverisja i takojnë vetëm Allahut.” (El-Enam : 57).** Këtij deklarimi i është përgjigjur Aliu r.a. me fjalët: **“Fjali e saktë, por me të kanë qëllim të keqen.”**

Me anë të këtij mendimi synohet që demokracinë ta gjykojnë si çështje të urryer ose pabesim. Ata që janë të këtij mendimi ose nuk e njohin realitetin ose nuk dëshirojnë ta njohin realitetin, me fjalë tjera nuk dëshirojnë ta kuptojnë esencën e demokracisë. Nëse analizohet esenca e demokracisë, kuptohet se ajo e ka burimin prej islamit. Esenca e demokracisë është që njerëzit të zgjedhin qeverinë e cila e udhëheqë politikën dhe çështjet e tyre dhe njëkohësisht vetë populli ka të drejtë të kërkojë llogari nga qeveria nëse gabon.

Me anë të këtij mendimi pikësynohet që të largohen muslimanët nga Islami gjithëpërfshirës dhe të izoloohen. Me anë të këtij mendimi i ndajnë muslimanët në musliman politik dhe musliman të devotshëm e që pastaj muslimanët që merren me politikë i urrejnë duke i quajtur mëkatarë ose pabesimtarë.

Përpos mendimit se politika është haram ekzistojnë edhe thënie të cilat nuk e kanë bërë haram politikën por që e kanë urryer për shkak se janë dëshpërua nga politika pasi që kanë vuajtur shumë prej politikës dhe politikanëve të padrejtë, siç ka qenë rasti me Muhamed Abduhun i cili pasi që është torturuar dhe ka përjetuar tradhti politike thuhet të ketë thënë:

“Kërkojmë mbrojtje prej Allahut nga politika;

- edhe prej atij i cili merret me politikë;
- edhe prej çështjes së politizuar;
- edhe prej udhëheqësit politik;
- edhe prej të udhëhequrit politik.”

2. Politika është farz.

Politika në islam është farz nga shkakun se bashkëpunimi në largimin dhe parandalimin e të keqes është farz. Thotë Zoti i Lartmadhëruar: **“Ju jeni umeti më i mirë, i zgjedhur prej njerëzve, sepse urdhëroni në të mira dhe largoni nga të këqijat dhe besoni në Allahun.”** (Ali Imran – 110)

E keqja parandalohet me dorë, nëse nuk mundet me dorë atëherë me gojë. Largimi i të keqes me gojë ka të bëjë me politikën sepse me shprehje të lirë parandalohet e keqja, ndërsa largimi i të keqes me dorë është detyrë e atyre të cilët kanë marrë përgjegjësi politike, e atyre të cilët janë votuar për të marrë përgjegjësi politike, thënë me fjalë tjera e qeverisë.

Nëse e para dhe e dyta nuk funksionojnë, atëherë bëhet largimi (urrejtja) me zemër, mirëpo në këtë rast imani është më i dobët sepse ajo e mundon zemrën dhe nuk lejon pajtim me të keqën mirëpo është e paaftë të marrë masa për të larguar të keqen.

Ndoshta dikush mendon se e keqja ka të bëjë vetëm me prostitucionin, pirjen e alkoolit dhe të ngjashmet, por e vërteta është se e keqja është e shumëllojshme, si:

- keqpërdorimi dhe keqmenaxhimi i pasurisë publike;
- korrupsioni;
- keqpërdorimi i mjeteve dhe mbulesat me falsifikime;
- shpërlarja e parave;

- abuzimi me simbole kombëtare;
- monopolizimi i artikujve për të cilat ka nevojë populli;
- emërimi në poste i personave jo adekuat; etj.

Imani e obligon muslimanin që të mos qëndroj indiferent ndaj të keqes pa marrë parasysh ajo e keqe a i takon politikës, ekonomisë apo kulturës.

Përgjegjësia politike është raport specifik ndërmjet qeveritarëve të zgjedhur në një anë dhe zgjedhësve në anën tjetër. Përgjegjësit politik janë debitorët, votuesit janë kreditorët. Kjo është ajo që në të drejtën islame quhet BEJ'A (Debitori-Kreditori) që në çështje konkrete quhet shit-blerje.

Allahu i dënon ata që i përkrahin të padrejtë. Thotë Zoti i Lartmadhëruar:

“Mos anoni dhe mos u mbështetni në ata të cilët bëjnë padrejtësi.” (Hud : 113)

Zoti i ka mallkuar popujt të cilët iu kanë nënshtuar qeveritarëve të padrejtë dhe nuk janë angazhuar në rrëzimin e tyre prej qeverisjes, siç është rasti me popullin e Firaunit (Faraonit) dhe të Nuhut a.s.

Për popullin e Firaunit Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe ai (Firauni) e frikësoi popullin e vet dhe iu përulën. Ai (popull) me të vërtetë u bë popull mëkatarë.” (Zuhruf : 54)

Për popullin e Nuhut Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe e kanë pasuar atë i cili nuk i ka shtuar as pasurinë e tij (e ka shkatërruar) dhe as pasardhësit (fëmijët e tij), por vetëm i ka shpie në humbje dhe shkatërrim.” (En-Nuh : 21)

Kur'ani e ka kritikuar ashpër qeverisjen dhe qeveritarët e padrejtë, politikanët puthadorë (servil) dhe materialist, politikanët të cilët e shfrytëzojnë djersën e qytetarit për interes të tyre.

1. Qeveritarët e këqij i përfaqëson **Firauni**, i cili ka qenë kryelartë.
2. Politikanin puthadorë të sundimtarit të padrejtë e përfaqëson **Hamani** (këshilltari i Firaunit). Të tillët si Hamani i ndihmojnë qeverisjes së keqe.
3. Politikanin materialist e përfaqëson **Karuni**, i cili e ka investuar kapitalin shtetëror për të fituar kapitale të shumta personale, pra, qeverisjen e ka shfrytëzua për interes material personal.

Musa a.s. përfaqëson popullin i cili është ngritur kundër qeverisjes së keqe. Thotë Zoti i Madhëruar:

“Ne Musain e kemi dërguar me mrekullitë Tona dhe me argumente të qarta te Firauni, Hamani dhe Karuni, por ata thanë: - Është magjistar dhe gënjeshtar.” (El-Muëminunë : 23, 24)

Dhe në fund: Islami e konsideron çështje të urryer (mekruh) që imam i namazit të jetë ai, të cilin xhemati e urren dhe nuk e do. Këtë e kemi në thënien e Muhamedit a.s.:

“Tre personave nuk iu ngrihet as një pëllëmbë mbi kokë namazi...e prej tyre të parin e ka përmendur:...njeriu i cili bëhet imam (udhëheqës) i një populli kur atë e urrejnë apo nuk e duan. Nëse kjo ka të bëjë me namazin, po si qëndron puna me çështjet e jetës dhe të politikës?.

2. Islami politik

Laicizmi është i ndërtuar mbi bazën e ndarjes së fesë nga shteti. Me këtë ka për qëllim që feja të mos e marrë qeverisjen shtetërore, mirëpo që të dyja të funksionojnë të ndarë nga njëra tjetra.

E vërteta është se feja islame nuk merret vetëm me adhurim por është edhe *sistem i jetës*.

Islami është fe në bazë të asaj se i rregullon marrëdhëniet e njeriut me Zotin e tij, ku bëjnë pjesë namazi, agjërimi, zekati, haxhi e të ngjashme.

Islami është sistem i jetës në bazë të asaj se i rregullon marrëdhëniet reciproke ndërmjet njerëzve, raportet e individit me individin, raportet e individit me shoqërinë, si dhe raportet e një shoqërie me një shoqëri tjetër. Në këto ligje bëjnë pjesë:

- e drejta familjare;
- e drejta qytetare;
- e drejta penale;

Këto (tri lloje të së drejtës) quhen Muamelat.

Islami është fe absolute (gjithëpërfshirëse) dhe assesi nuk mund të quhet (islam) politik.

Të quhet islami *islam politik* do të thotë të shkëputet nga pjesa e parë e adhurimit në Zotin (ibadet), mirëpo me dashje apo pa dashje muslimanët pa e njohur të vërtetën e quajnë islamin *islam politik*, i cili si term rrjedh nga *laicistët* të cilët i frikësohen qeverisjes nga muslimanët, kështu që:

- namazin e bajrameve e konsiderojnë si namaz politik;
- namazin e xhumasë e konsiderojnë namaz politik;
- leximin e pjesëve të Kur'anit e konsiderojnë lexim politik;
- leximin e biografisë së Muhamedit a.s. e konsiderojnë lexim politik.

Është e vërtetë se islami ka shumë çështje të cilat janë thelb i politikës por assesi nuk mund të quhet *islam politik* sepse atëherë do të zhvishej nga baza e saj e cila është *Njohja dhe nënshtrimi ndaj Krijuesit*.

3. Politika islame

Politika islame bazohet në pesë të drejta vitale (DARURIJAT HAMSE):

- e drejta elementare e lirisë fetare dhe sigurimit fetarë;
- e drejta elementare e sigurimit të jetës së njeriut. Sigurimi dhe garancia i jetës;
- e drejta elementare e sigurimit të pasurisë në politikën e pasurisë;
- e drejta elementare e sigurimit familjar-kombëtar në politikën e paqes;
- e drejta elementare e sigurimit fiziko-psikik në politikën arsimore, kulturore, edukative, etj.

Islami është *sistem konsultativ dhe parlamentar*. Qeveria e ka për obligim që të konsultohet me ekspertët e të gjithë lëmenjve. Kuvendi dhe sistemi parlamentar është çështje themelore në Islam. Thotë Zoti i Lartmadhëruar: **“...dhe konsultohen në mes vete.”** Po ashtu edhe Muhamedit a.s. i cili ka qenë peygamberi i fundit Zoti i Lartmadhëruar i ka thënë: **“... dhe konsultohu për thellësinë e çështjes.”**

Muhamedi a.s. ka qenë Pejgamber, Imam dhe udhëheqës, e pas tij udhëheqjen e muslimanëve për çështjet fetare dhe politike e kanë vazhduar Ebu Bekri, Umeri, Uthmani dhe Aliu, këta janë ata të cilët e kanë vazhduar

planprogramin e tij, kanë qeverisur umetin me drejtësi dhe barazi, kanë udhëhequr me dituri dhe iman (besim) të plotë.

Muslimanët mund të jetojnë në *shtetin islam* ku në atë shtet e drejta e minoriteteve është e garantuar dhe liritë fetare të tyre janë të garantuara, por mund të jetojnë edhe në *shtet jo islam* ku muslimanët janë minoritet ku e zhvillojnë jetën fetare të tyre.

Politika islame nuk mund të jetë në kundërshtim me të drejtën, lirinë, barazinë e familjes njerëzore, por përkundrazi, siguron liri, barazi, drejtësi, për të cilën edhe është shpallur feja islame.

LAICIZMI DHE FEJA ISLAME

Njerëzimi ka kaluar nëpër etapa të ndryshme. Prej atyre etapave është edhe laicizmi. Laicizmi është prej etapave më të reja të njerëzimit. Edhe sot e kësaj dite laicizmi mendohet ndryshe nga çfarë është në të vërtetë. Shumë prej njerëzve mendojnë se laicizmi është ndarja e fesë nga shteti, mirëpo në esencë laicizmi thërret që edukimi dhe arsimimi të bëhet jo mbi bazat fetare, por mbi bazën shkencore. Laicizmin mund ta kuptojmë edhe si një lëvizje shoqërore e cila ka për synim që njerëzit të cilët angazhohen për botën tjetër t'i largoj nga kjo, dhe t'i thërras që të angazhohen vetëm për këtë botë dhe ta harrojnë botën tjetër.

Në bazë të literaturave të ndryshme, laicizmin mund ta kuptojmë edhe si ateizëm, i cili ndahet në dy lloje:

1. Laicizëm teorik; dhe
2. Laicizëm praktik.

Sa i përket laicizmit praktik, mund t'i nënvizojmë dy çështje të rëndësishme të saj:

Çështja e parë është se laicizmi nuk ka të bëjë me shkencën, siç e mendojnë dhe e deklarojnë disa dijetarë, pra duke e proklamuar se laicizmi ka të bëjë vetëm me shkencën praktike.

Çështja e dytë është se laicizmi është drejtim shoqëror, i cili ka për synim të izolojë fenë nga shoqëria, duke e orientuar shoqërinë të përqendrohet vetëm për këtë botë, në të gjitha aspektet, si në aspektin ekonomik, moral, shoqëror, ashtu edhe politik.

Nëse shikojmë në thellësi, e kuptojmë se, laicizmi nuk ka të bëjë vetëm me ndarjen e fesë nga shteti, por e kuptojmë se çka është fetare nuk është shkencore, dhe çka është shkencore nuk është fetare, që do të thotë se, laicizmi dhe feja janë të kundërta dhe në kundërshtim me tjetrën.

Ka prej njerëzve të cilët e keqinterpretojnë termin e laicizmit, duke i dhënë kuptimin se laicizmi është në shërbim të shkencës dhe logjikës, duke aluduar se feja islame është në kundërshtim me logjikën dhe shkencën, por e vërteta është se feja islame është gjithëpërfshirëse edhe për atë botë edhe për këtë botë. Feja islame ngërthen në vete të gjitha çështjet e jetës, si morale ashtu edhe materiale, si ekonomike ashtu edhe juridike, si personale ashtu edhe shoqërore.

Laicizmi si lëvizje shoqërore ia ka arritur qëllimit që të ndaj kishën nga shteti, duke proklamuar se feja është çështje shpirtërore e individëve dhe duke thënë se shteti dhe qeveria është ajo që do të duhej të rregullonte raportet në mes të individëve në shoqëri. Si rezultat i kësaj, duke i rregulluar raportet e individëve në shoqëri, kanë filluar të çrregullohen raportet në mes të individit me individ, dhe individit me familjen. Nëse bëjmë një analizë, shohim se laicizmi e ka zbratur energjinë e zemrës dhe mendjes nga feja, sepse janë liruar nga përkufizimet që i parasheh feja.

Nëse analizojmë anën morale dhe të lirisë së njeriut në bazë të logjikës së laicizmit, e shohim se morali dhe etika njerëzore janë në kundërshtim me lirinë njerëzori. Morali dhe etika njerëzore parasheh që njeriu si individ të martohet dhe nëpërmjet martesës të krijohet familja e cila është bazë themelore e shoqërisë, por liria e cila i jepet njeriut, liri të cilën e përkufizon feja, bën që shoqëria të ketë shumë më pak baza themelore sepse duke i ikur përgjegjësisë ligjore, martesat, ose bëhen me vonesë, ose nuk bëhen fare, e edhe ato që bëhen shpesh janë afatshkurta.

Edhe pse krijohet familja, në emër të lirive ndodhin tradhtitë bashkëshortore, shkaktohen shkurorëzimet dhe degradohen raportet prindër-fëmijë. Kështu krijohet një *frymë e re* në familje, ose shkurorëzim i vonshëm, ose shkurorëzim i shpejt pas kurorëzimit, ose mosmartesë. Pastaj, mosmartesa shkakton edhe devijime tjera, si bie fjala homoseksualitetin, gjë që shkakton mortalitetin në shoqëri.

Pasi që të humb esenca e bazës në familje, fillon humbja e bazës në shoqëri, sepse shoqëria përbëhet prej familjeve. Individët e familjes së çrregulluar edhe po të donin nuk mund ta japin maksimumin e kontributit në shoqëri.

Kështu që, laicizmi pasi që ka pasur pikësynimin e izolimit të fesë dhe zhdukjen e fesë nga shoqëria, ka filluar të kërkoj ndihmë dhe përkrahje nga feja dhe kështu ka filluar dalëngadalë të zhvishet nga origjina e saj. Ndoshta laicizmi si lëvizje shoqërore ia ka arritur qëllimit që të izoloj besëtytnitë fetare të cilat nuk janë në përputhshmëri me logjikën, mirëpo shkenca e cila është në përputhshmëri me fenë islame apo feja e cila është në përputhshmëri me shkencën nuk mund të izolohej dhe as të mënjanohej sepse ashtu sikurse mendja është pjesë e çdo individi. Përderisa feja islame është fe e logjikës, ashtu edhe njeriu është qenie logjike, kështu që përderisa laicizmi pretendon se logjika dhe shkenca janë bazë e saj dhe me të zhvillohet shoqëria, atëherë fenë islame e cila është fe e logjikës dhe

shkenca është e pandarë prej saj, atëherë mbështetja më e madhe duhet të jetë në fenë islame dhe shoqëria njerëzore e cila është lëkundur prej themeleve të saj për t'u vendosur në ato themele nevojitet feja e shkencës, e ajo fe e arsyes, logjikës dhe shkencës është feja islame.

POLITIKA NË BAZË TË KUR'ANIT

Kur'ani përveç që është libër leximi dhe adhurimi, në të njëjtën kohë është libër studimi dhe analizimi, është libër i cili qetëson shpirtin dhe forcon mendjen, është libër i cili ndërton shoqëri të shëndoshë.

Njeriu, duke e lexuar Kur'anin dhe duke u thelluar në të, e mpreh mendjen e tij dhe i kupton çështjet thellësisht, por në të njëjtën kohë edhe i shpreh qartë, i sqaron me lehtësi dhe është më oratorë.

Oratoria është aftësia e të shprehurit, aftësia e shpjegimit dhe sqarimit. Me këtë cilësi, Zoti i Lartmadhëruar e ka dalluar njeriun nga të gjitha krijesat tjera.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Muaji i Ramazanit është muaji në të cilin ka zbritur Kur'ani, i cili është udhëzim dhe sqarues për njerëzimin dhe dallues i të mirës nga e keqja.” (El Bekare)

Po ashtu në suren Rrahman, Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“I Gjithmëshirshmi u ka mësuar Kur'anin, ka krijuar njeriun dhe ia ka mësuar oratorinë.” (Err Rrahman : 1-4)

Njeriu politikan, kur flet është i qartë në shprehje, kur shpjegon mendimin e tij e shpjegon bindshëm.

Përderisa fekihi (juristi) e sqaron një çështje të tij të fikhut dhe dijetari e sqaron këshillën e tij dhe thirrësi islam e tregon urtësinë e çështjeve, atëherë pse politikani të mos e sqaroj librin e përgjithmonshëm, Kur'anin, apo stilin artistik të Kur'anit, apo planprogramin e qeveritarëve të popujve të mëhershëm të cilët përmenden në Kur'an. Kuptohet, Kur'ani tregon për qeveritarin me qeverisje të keqe dhe qeveritarin me qeverisje të mirë.

Në një kënd Kur'ani tregon për Firaunin ndërsa në këndin tjetër tregon për Dhulkarnejnin, i cili i ka qeverisur anët e lindjes dhe të perëndimit. Kur'ani tregon edhe për qeverisjen e Sulejmanit a.s. i cili ka qenë edhe peygamber por edhe qeveritar, por tregon edhe për Muhamedin s.a.v.s. se si e ka ndërtuar qeverinë në bazë të drejtësisë, barazisë dhe vëllazërimit.

Kur'ani na tregon për Kuvendin e parë në histori. Në atë kuvend Kryekuvendar ka qenë Zoti i Lartmadhëruar. Kuvendarët kanë qenë melekët. Tema e diskutimit ka qenë krijimi i krijesës njerëzore. Zoti i Lartmadhëruar e ka hapur debatin për çështjen e krijimit të njeriut. Melekët arsyetohen para Zotit duke thënë se nëse është në pyetje për Lartmadhërim dhe Lavdërim ndaj teje, ne të Lartmadhërojmë dhe të Lavdërojmë, ndërsa

krijesa njeri do të shkaktojë gjakderdhje dhe trazira në fytyrën e tokës. Pas kësaj Zoti i Lartmadhëruar debatin e shndërron në çështje praktike. Ademiti a.s. ia mëson shkencat shoqërore dhe natyrore, emrat e të gjitha çështjeve dhe kërkon nga kuvendi ku ishin kuvendar melekët që t'i shpalosin ato. Kuvendi i përbërë prej melekëve i thonë Zotit të Lartmadhëruar: Ti o Zot je i Ditur për gjithçka dhe je i Urtë, ndërsa ne nuk dimë asgjë tjetër pos asaj që na ke mësuar Ti. Pastaj Zoti i Lartmadhëruar i thotë Ademiti: Lajmëroj dhe sqarojua emrat (shkencën). Kur ua sqaroj Ademi a.s. emrat, atëherë Zoti i Lartmadhëruar u tha: A nuk u kam thënë juve se Unë e di të fshehtën e qiejve dhe tokës dhe e di atë që e shprehni haptazi dhe atë që e fshihni.

Zoti i Lartmadhëruar krijon çka të dojë dhe si të dojë dhe kur të dojë, por ky parlament është pasqyruar për ta mësuar njeriun se si të veproj, ashtu që të kuvendohet për çështjet madhore dhe të rëndësishme të tij.

Kuvendi nuk duhet të jetë vetëm sipërfaqësor por realitet dhe argumentim, duke u mbështetur në bazën e parimit dhe të argumentimit.

Kuvendi nuk duhet të jetë vend ku politikanët mendojnë vetëm se si të udhëheqin, qeverisin, mashtrojnë, e të tradhtojnë, por duhet të jetë vend i butësisë dhe i mëshirës, i sinqeritetit dhe devotshmërisë dhe i mbajtjes së fjalës dhe premtiveve.

Shumë politikan imponojnë mendimin nga lartë dhe pastaj kërkojnë kuvendimin formal, e ky lloj kuvendi dhe kuvendimi nuk ka vlerë por është vetëmashtrim.

Zoti i Lartmadhëruar ka dashur që të vendos një parim themelor të parimit të politikës dhe qeverisjes e ajo është: Kuvendimi dhe sistemi parlamentar. Këtë parim e tregon me rastin se si Zoti i Lartmadhëruar i drejtohet Muhamedit a.s.:

“Ti ishe i butë ndaj atyre, ngase All-llahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do shkapërderdheshin prej teje, andaj ti falju atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultohu me ta në të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në Allahun, se All-llahu i do ata që mbështeten.” (Ali Imran : 159)

Zoti i Lartmadhëruar në këtë ajet na tregon se si qeveritari duhet të jetë i mëshirshëm dhe tolerant.

Në ajetin tjetër Zoti i Lartmadhëruar na tregon se si duhet të jenë besimtarët:

“Dhe bazë e çështjes së tyre është se kuvendojnë (konsultohen) ndërmjet vete.”

Në fund, një peygamber prej peygamberëve të Allahut i cili është munduar me të gjitha mënyrat të debatit me popullin e tij, u thotë:

“Unë nuk dua asgjë tjetër nga ju, pos përmirësimin e gjendjes suaj me aq sa kam mundësi.” E ky peygamber ka qenë Shuajbi a.s..

TË DREJTAT E FËMIJËVE NË ISLAM

Në Islam, fëmijët janë qetësim i shpirtit, lumturi e jetës, lule e familjes dhe zbukurim i shoqërisë.

Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an na ka mësuar formën e lutjes për fëmijët:

“...O Zoti ynë, na bëj që të jemi të gëzuar me gratë tona dhe me pasardhësit (fëmijët) tanë dhe neve na bënë shembull për të devotshmit.”(el-Furkan,74).

Në një ajet tjetër Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Allahu krijoi për ju bashkëshorte nga vet lloji juaj, e prej bashkëshorteve tuaja fëmijë e nipa dhe ju furnizoi me të mira...”(en-Nahl,72).

Fëmijët janë pjesa më e rëndësishme e shoqërisë, ashtu si çdo qytetar tjetër i shoqërisë kanë të drejtat e tyre në shoqërinë ku ata jetojnë. Të drejtat e fëmijëve paraqesin thelbin e konceptit për të drejtat e njeriut. Kjo aspiratë e vë mirëqenien e fëmijës në qendër të interesit, vëmendjes dhe përkushtimit tonë.

Të drejtat e fëmijëve përbëjnë prioritetet kryesore që duhet të garantojë një shoqëri normale njerëzore. Këto të drejta janë parësore, jo vetëm për nga rëndësia që kanë fëmijët në jetën tonë, por mbi të gjitha, fëmijët mbajnë gjurmën e së nesërme, dhe tek ata shohim të ardhmen e shoqërisë. Pa një brez të ri, të shëndoshë e të sigurt, do të thotë të mbetemi pa të ardhme, do të thotë që shoqëria të shpallë dështimin total të përpjekjeve për në rrugën e zhvillimit të saj.

Për këtë arsye, të drejtat që u takojnë fëmijëve, duhet t'i respektojmë dhe duhet të shprehim solidaritetin për ata fëmijë të cilëve u janë mohuar të drejtat e tyre.

Në Islam të drejtat e fëmijëve mund t'i ndajmë në:

1. Të drejtat e fëmijëve para lindjes së tyre dhe
2. Të drejtat e fëmijëve pas lindjes së tyre.

Të drejtat e fëmijëve para lindjes janë:

1. Që fëmija të lind prej prindërve legjitim martesor sipas ligjit Islam.

Kjo e drejt rezulton nga shkaku se Jeta në martesë obligon që të dy prindërit duhet të sigurojnë jetën fëmijëve të tyre.

2. Që prindërit të jenë të një feje.

E drejt e fëmijës është që prindi të zgjedh nënën e mirë, prej fesë së pastër islame, siç thotë Muhamedi a.s:

“Martoju me atë që është fetare se përndryshe të rrokë varfëria”.

Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë:

“Mos u martoni me idhujtare deri sa të bëhen besimtare, nuk ka dyshim se robëresha besimtare është më e mirë se idhujtarja edhe nëse ju pëlqen ajo.”(el-Bekare,221).

3. Të mos urrehet gjinia femërore.

Arabët paraislamik e kanë pasur zakon që kur fëmija t'i lindte vajzë, ta varrosnin për së gjalli, ngase, sipas tyre femra do t'ju sillte atyre turp në familje, mirëpo Islami e ka ngritën femrën në nivelin të cilin e meriton në shoqëri dhe se një veprim të tillë e ka ndaluar rreptësisht dhe të mos përsëritet kurrë. Zoti i Lartmadhëruar na paraqet momentet e lajmërimit të lindjes së gjinisë femërore te arabët paraislamik:

“Dhe kur ndonjëri prej tyre lajmërohet me vajzë, fytyra e tij prishet dhe bëhet plot mlllef, fshihet prej njerëzve, për shkak të asaj të keqeje me të cilën u lajmërua, m andej mendon a ta mbaj atë ,ashtu i përulur apo ta mbuloj ashtu të gjallë në dhe. Sa i keq është gjykimi i tyre.”(en-Nahl, 58, 59).

Pastaj Zoti i Lartmadhëruar me ajet ndalon një veprim të tillë ku thotë:

“Ju mos i mbytni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë, se ne ua sigurojmë furnizimin atyre dhe juve, mbytja e tyre është mëkat i madh.”(el-Isra, 31).

4. E drejta e trashëgimisë.

Sipas fesë islame njeriu me të drejta të barabarta fillon që në muajin e katërt të shtatzënisë ku edhe i vjen shpirti fëmijës në barkun e nënës së saj.

Trashëgimia i takon fëmijës edhe para lindjes së tij ashtu që nëse njeriu vdes dhe e lë gruan shtatzënë atëherë fëmijës i rezervohet trashëgimia dhe kur të rritet i dorëzohet në dorën e tij. Çdo formë e trashëgimisë që i takon i rezervohet dhe kur të rritet i dorëzohet në duart e tij .Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“E kur të rriten atëherë dorëzoju atyre pasurinë e tyre. Mos e hani atë duke e shkapërderdhur dhe duke u ngutur para se të rriten ata. Kush është i pasur le të ruhet, e kush është i varfër le të hajë me maturi. E kur t’ju dorëzoni atyre pasurinë e vet ,dëshmoni atë. Mjafton që Allahu është Llogaritës.”(en-Nisa, 6).

Të drejtat e fëmijës pas lindjes

1. Thirrja e ezanit.

Para se të dëgjoj fëmija emrin e tij është drejt që t’i thirret ezani me qëllim që ta dëgjoj emrin e krijuesit të Tij, pra t’i dëgjoj fjalët “All-llahu Ekber” dhe “Laa ilahe il-lAll-llah”. E pastaj me shpresë dhe dëshirë që edhe fjala e fundit me të cilën do të ndahet nga kjo jetë të jetë po e njëjta fjalë.

2. E drejta e gjidhënies

Nëse fëmija nuk ka nënë (i vdes), prindi e ka për obligim t’i sigurojë gjidhënien nga ndonjë grua tjetër me kompensim.

Nëse nëna është gjallë, ajo i jep gji fëmijës së saj dy vite të plota. Thotë Zoti i Lartmadhëruar:

“Nënat u japin qumësht fëmijëve të tyre dy vjet të plota nëse dëshirojnë ta plotësojnë saktësisht gjidhënien.” (el-Bekare, 233).

Nëna mund ta ndërpres gjidhënien, nëse shëndeti i është në rrezik apo është shumë e dobët. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Asnjë nënë nuk bënë të dëmtohet me fëmijën e saj (el-Bekare, 233).

3. E drejta e emërtimit.

Emërtimi është shenjë e identifikimit të njeriut, çështjet e para të cilat i ka mësuar Ademi a.s. pas krijimit të tij kanë qenë emrat sepse nëpërmjet emrave bëhet edhe identifikimi i sendeve dhe çështjeve. Për këtë arsye, emri luan rol të rëndësishëm në jetën e njeriut, por edhe në botën tjetër do të thirremi në bazë të emrave në këtë botë, për këtë arsye është e drejt e fëmijës është që ai të emërohet me emër të mirë.

Muhamedi a.s. ka thënë:

“Ju, në ditën e Kijametit do të thirreni me emrat e juaj dhe të baballarëve tuaj, andaj emërtoni fëmijët me emra të bukur”.

4. E drejta e sunetisë.

Sunetinë e kanë praktikua pejgamberët e mëhershëm. Me suneti ruhet shëndeti dhe pastërtia e fëmijës për të cilën fëmija ka nevojë në jetë. Muhamedi a.s. ka thënë:

“Pesë çështje janë prej natyrshmërisë së njeriut: Sunetia, shkurtimi i mustaqeve, prerja e thonjve, të rruarit e nënsqetullave dhe të rruarit në organet e turpshme”.

5. E drejta e sigurimit të zhvillimit të jetës së fëmijës.

E drejt e fëmijës është që ai të sigurohet nga çdo gjë që e dëmton qoftë fizikisht qoftë psikikisht. Muhamedi a.s. ka thënë:

Njeriu bëhet mëkatar nëse për atë që kujdeset nuk e ushqen.

Për zhvillimin e plotë të fëmijës, fëmija duhet të rritet në një mjedis familjar, në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi.

Fëmija nëse rritet i shëndoshë i ndihmon edhe familjes e edhe shoqërisë, por është edhe i dashur tek All-llahu. Muhamedi a.s. ka thënë:

“Besimtari i shëndoshë dhe i fuqishëm është më i dashur tek Allahu se besimtari jo i shëndoshë dhe i dobët.”

6. E drejta e kujdesit familjar.

Kujdesi ndaj fëmijës është obligim ndaj Allahut dhe ndaj robit të tij. Mosha e fëmijërisë ka të drejt për një përkujdesje dhe përkrahje të veçantë.

Familja si njësi themelore e shoqërisë duhet të marrë përsipër rolin e saj në bashkësi. Prindërit e kanë për obligim që ta ushqejnë fëmijën, ta veshmbathin dhe ta pastrojnë deri sa të rritet. Prindërit duhet ta ushqejnë fëmijën me ushqim të hallallit.

7. E drejta e porosisë për mbikëqyrje para vdekjes së dy prindërve.

Kujdestar i fëmijës është baba, nëse ai mungon (vdes) e merr përsipër gjyshi. Nëse ai mungon atëherë kujdesia kalon te vëllai i babit, nëse ai mungon atëherë kujdesi kalon te axha i babait. Me një fjalë mbikëqyrja kalon në të njëjtën renditje të trashëgimisë.

8. E drejta e edukimit dhe arsimimit

Muhamedi a.s. ka thënë:

“Mësoni fëmijët tuaj, edukoni mirë dhe arsimoni mirë”.

Në një hadith tjetër Muhamedi a.s. ka thënë:

“Prindi nuk mund t’i japë fëmijës së vet gjë më të mirë se edukata e mirë!”

Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën për pushim, kohë të lirë, lojë dhe pjesëmarrje në aktivitete kulturore dhe artistike. Nuk ka dyshim se dhe rrethi ku jeton fëmija ndikon shumë në edukimin e tij.

9. E drejta e shkollimit

Fushë e rëndësishme e zbatimit të drejtave të fëmijës është arsimi dhe shkolla. Shkollimi nuk përkufizohet vetëm me shkencat fetare por shkollimi përfshinë të gjitha shkencat si ato fetare, shoqërore, ekonomike, ekzakte dhe çdo lëmi tjetër që i nevojitet atij për të fituar lumturi edhe në këtë botë edhe në botën tjetër.

10. E drejta e shëndetit dhe e shërimit

Fëmijët kanë të drejtë të gëzojnë shëndet të plotë dhe t’iu jepet kujdesi maksimal shëndetësor dhe mjekësor. Duhet të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal.

Preventiva është më e mirë se përdorimi i ilaçit. E drejtë e fëmijës është që prindi t'i siguroj ushqim të mirë, veshmbathje të mirë, vendstrehim të mirë. Për tu siguruar nga infektimet e viruseve dhe mikrobeve duhet të jetë i pastër, për këtë arsye fëmija mësohet të merr gusul, të merr abdest, t'i shkurton thonjtë dhe bëhet sunet, të gjitha këto janë preventivë e fëmijës për shëndetin e tij.

11. E drejta e trashëgimisë.

Trashëgimia i takon fëmijës edhe para lindjes së tij. Nëse njeriu vdes dhe e le gruan shtatzënë, atëherë fëmijës i rezervohet trashëgimia dhe kur të rritet i dorëzohet në dorën e tij. Çdo formë e trashëgimisë që i takon i rezervohet dhe kur të rritet i dorëzohet në duart e tij. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“E kur të rriten atëherë dorëzoju atyre pasurinë e tyre. Mos e hani atë duke e shkapërderdhur dhe duke u ngutur para se të rriten ata. Kush është i pasur le të ruhet, e kush është i varfër le të hajë me maturi .E kur t'ju dorëzoni atyre pasurinë e vet, dëshmoni atë. Mjafton që Allahu është Llogaritës.”(en-Nisa, 6).

12. E drejta e mendimit të lirë.

Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën e informimit, shprehjes së mendimit të tyre dhe të drejtën për t'u dëgjuar. Sheriati Islam respekton mendimin e fëmijës nëse ai ia qëllon dhe ka mendim të drejt. Islami i edukon fëmijët që ata të bëhen të pavarur në mendimet e tyre si në aspektin e diturisë, profesionit, etj..

13. E drejta e argëtimit.

Në jetën e fëmijës argëtimi ka përparësi nga mësimi. Argëtimi në rend të parë duhet të jetë nën përkujdesjen e familjes pastaj nën përkujdesjen e të rriturve e pastaj në rend vjen argëtimi me të vegjlit. Loja i ndihmon fëmijës në zhvillimin e trupit të tij.

13. E drejta e fëmijës në kurbet.

Muhamedi a.s. ka thënë:

“Edukoni fëmijët tuaj që ta duan Allahun dhe të dërguarin e Tij.”

Mëkatin për mosmësimin e Islamit dhe përkatësisë së fëmijës në kurbet e merr prindi i tij, e pastaj shteti i cili nuk përkujdeset që të ofroj mësim se si ta donë fenë e tyre, atdheun e tyre dhe kombin e tyre.

Fëmija në kurbet është si zog në vend të huaj. Ai zog një ditë duhet të kthehet në vendlindje, ai duhet ta dijë origjinën dhe prejardhjen e tij. Ai zog assesi nuk duhet të humbas dhe nuk duhet të shkoj në rrugë pa kthim.

14. E drejta e zgjedhjes së shokut të jetës.

Pasi që fëmija të arrijë moshën e pjekurisë, pa marrë parasysh a është mashkull apo femër, ka të drejtë në zgjedhjen e shokut të jetës dhe nuk lejohet që prindi ta detyroj djalin të martohet me vajzën të cilën nuk e pëlqen, ose në të kundërtën, ta detyroj vajzën të martohet me djalin që nuk e pëlqen. Prindërit kanë të drejtë të intervenojnë vetëm atëherë kur ka ndonjë pengesë apo ndalesë të sheriatit që e pengon apo e ndalon martesën, në të kundërtën jo.

15. E drejta e jetës në bashkësi apo shoqëri (e drejta e mosizolimit).

Me këtë të drejtë të fëmijëve kemi për qëllim që fëmijës t’i sigurohet jeta e lumtur pa presione, pa dhunë, pa keqtrajtime dhe pa cenim. Kjo e drejtë është për të gjithë muslimanët sepse Muhamedi a.s. ka thënë:

“Muslimanët janë të drejtë në mes vete dhe u ndihmojnë të dobëtëve”.

16. E drejta e përgjegjësisë.

Nëse fëmija nuk vepron punë të mira, duhet të këshillohet të veproj punë të mira. Nëse vepron punë të këqija duhet të këshillohet të largohet nga punët e këqija.

Kur të rritet prindi i thotë fëmijës: “Të rrita, të edukova, kërkoj mbrojtje të mos vuash në botën tjetër”.

Këto janë të drejtat e fëmijëve të cilave feja Islame ju ka kushtuar kujdes për më shumë se 14 shekuj ndërsa në shekullin e fundin pra në vitin 1989 Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara ka miratuar Konventën e të Drejtave të Fëmijës. Edhe pse konventa përmban 45 nene, ato të drejta të fëmijëve mund të përmbledhen në 10 pika:

1. Të gjithë fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejta të barabarta. Asnjë fëmijë apo i ri, nuk duhet të dëmtohet për shkak të gjinisë, ngjyrës, gjuhës apo besimit të tij.
2. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë të gëzojnë shëndet të plotë dhe t'iu jepet kujdesi maksimal shëndetësor dhe mjekësor.
3. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë për arsim fillestar falas. Përveç kësaj, atyre duhet t'iu mundësohet edhe arsimimi i mëtejshëm.
4. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën për pushim, kohë të lirë, lojë dhe pjesëmarrje në aktivitete kulturore dhe artistike.
5. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën e informimit, shprehjes së mendimit të tyre dhe të drejtën për t'u dëgjuar.
6. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën për një edukim të mirë. Prindërit apo edukatorët e tjerë nuk duhet të përdorin dhunë, keqtrajtimi dhe keqpërdorimi është i ndaluar.
7. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën e mbrojtjes dhe ndihmës së veçantë në luftë dhe gjatë arratisjes.
8. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën e mbrojtjes nga puna shfrytëzuese dhe keqpërdorimi seksual.
9. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë të jetojnë me prindërit e tyre dhe të mbajnë kontaktin me të dy prindërit, nëse ata jetojnë të ndarë.
10. Fëmijët dhe të rinjtë e gjymtuar kanë të drejtën e ndihmës dhe përkrahjes së veçantë, si dhe të pjesëmarrjes aktive në jetën shoqërore.

Dhe në fund, mund të themi se dobia prej fëmijëve nuk ndalet në këtë botë siç mendojnë disa, por vazhdon edhe në botën tjetër sepse Muhamedi a.s. ka thënë:

“Kur të vdes i biri i Ademit i ndërpriten veprat përpos që vazhdojnë shpërblimet prej tri çështjeve e ato janë. Lëmosha rrjedhëse. Dituria prej së cilës kanë dobi të tjerët pas tij dhe fëmijën i cili lutet për të.”

SHERIATI ISLAM DHE LIGJET NJERËZORE

Njeriu është qenie shoqërore. Natyrshmëria e tij është që të bashkëjetoj me të tjerët. Kështu që, shoqëria është çështje e patjetërsueshme. Përderisa njeriu jeton në shoqëri, rezultojnë raportet ndërmjet individit dhe shoqërisë. Këto raporte fillojnë prej raporteve familjare, shoqërore, politike, kulturore e të ngjashme.

Për të jetuar individ në harmoni me shoqërinë dhe një shoqëri me një shoqëri tjetër, nevojitet ligj dhe rregull.

Qëllimi i ligjit është që të siguroj liritë e njeriut dhe realizimin e interesave të tij në njërën anë dhe sigurimin e shoqërisë në anën tjetër.

Sheriati islam është ligj i kësaj bote dhe i botës tjetër. Sheriati islam nuk mund të përkufizohet vetëm në besim, moral dhe adhurim, por përfshinë edhe raportet shoqërore. Kështu që, sheriati islam përfshinë rregullat dhe ligjet e njeriut ndaj Zotit të tij, ndaj vetes së tij dhe ndaj shoqërisë. Nga kjo rezulton se sheriati islam ndahet në dy pjesë:

1. Ligjet të cilat kanë të bëjnë me besimin, moralin dhe adhurimet;
2. Ligjet të cilat kanë të bëjnë me veprimet praktike ndërnjerëzore, siç janë: statusi familjar dhe raportet apo të drejtat, detyrat dhe obligimet ndaj të tjerëve.

Nga kjo mund të kuptojmë se sheriati islam përputhet me ligjet dhe kushtetutat njerëzore sa i përket asaj se qëllimi i tyre është sigurimi shoqëror dhe realizimi i interesave të njerëzve, por ekziston edhe pika dalluese në atë se ligji njerëzor parasheh raportet e njeriut me njerëzit e tjerë, me qëllim që të sigurohet dhe të zhvillohet shoqëria, përderisa sheriati islam përpos kësaj parasheh obligimet e njeriut ndaj vetes së tij dhe ndaj Zotit të tij.

Sheriati islam përputhet me ligjet dhe kushtetutat njerëzore sa i përket asaj se që të dyja sigurojnë dhe garantojnë shoqërinë në realizimin e interesave individuale dhe shoqërore në bazë të lirisë dhe barazisë, por ekziston edhe një çështje tjetër ku dallohet se sheriati islam në edukimin dhe strukturimin e individit parasheh adhurimet të cilat janë mjet të edukimit shpirtëror dhe moral të tij.

Ekziston edhe një çështje dalluese të cilën sheriati islam e konsideron si çështje të domosdoshme e ajo është ruajtja, sigurimi dhe garantimi i mendjes së njeriut, sa që për të garantuar mendjen e njeriut e ndalon rreptësisht alkoolin dhe pijet dehëse të mendjes së njeriut, e që ligjet dhe

kushtetutat njerëzore nuk e parashohin një gjë të tillë përpos në disa raste dhe momente të caktuara.

Për të siguruar dhe garantuar pasardhësit që të jenë të ndërlidhur me paraardhësit, sheriatu islam e ndalon rreptësisht prostitucionin, sepse në të kundërtën shoqëria dhe pasardhësit do të çregulloheshin dhe do të shkatërrohet baza familjare e cila është themel dhe element bazë i shoqërisë, e që ligjet dhe kushtetutat njerëzore nuk përputhen me sheriatin islam në këtë çështje.

Sa i përket pasurisë, pra konsiderohet e shenjtë edhe në sheriatin islam por edhe në ligjet dhe kushtetutat njerëzore.

Duhet ditur se ligjet në sheriatin islam ose janë ligje të cilat kanë të bëjnë me besimin, moralin dhe adhurimin ose ligje që kanë të bëjnë me njeriun në raport me të tjerët.

Sa i përket ligjeve të cilat kanë të bëjnë me besimin, moralin dhe adhurimin, janë ligje të cilat nuk ndryshojnë me ndryshimin e kohëve dhe vendeve.

Sa i përket ligjeve të cilat kanë të bëjnë me detyrat e njeriut me të tjerët ndahen në dy lloje të ligjeve:

1. Llojet e ligjeve të cilat nuk ndryshojnë;
2. Llojet e ligjeve të cilat ndryshojnë.

1. Llojet e ligjeve të cilat nuk ndryshojnë me ndryshimin e kohëve dhe vendeve janë ligjet bazë dhe ligjet e prera në sheriatin islam.

2. Llojet e ligjeve të cilat ndryshojnë me ndryshimin vendeve dhe kohëve, e që në këtë lloj të ligjeve bëjnë pjesë ligjet e papërcaktuara dhe edukuese, ose llojet e ligjeve që kanë të bëjnë me traditën ose me interesin e përgjithshëm shoqëror (meslehatul mursel) të cilat nuk bien ndesh me tekstet bazë.

Sheriatu islam parasheh shpërblim në kryerjen e obligimeve, ashtu siç parasheh dënim për kryerjen e veprave të ndaluara.

Sheriatu islam parasheh dënime në botën tjetër për moszbatimin e urdhrave ose mosrespektimin e ligjeve, përderisa ligjet dhe kushtetutat njerëzore parashohin dënime vetëm në këtë botë dhe jo për në botën tjetër.

Ligjet dhe kushtetutat njerëzore i drejtohen personit si pjesë e shoqërisë, përderisa sheriatu i drejtohet personit si individ, ashtu siç i drejtohet atij edhe si pjesë e shoqërisë. Sa i përket çështjes së parë, ka të bëjë me edukimin e njeriut ndaj Zotit të tij dhe vetes së tij, përderisa sa i përket çështjes si pjesë

e shoqërisë, i drejtohet atij që të jetë i drejtë dhe t'i kryej obligimet ndaj pjesëtarëve tjerë të shoqërisë. Shihet se, sa i përket kësaj çështje sheriati islam përputhet me ligjet dhe kushtetutat njerëzore dhe ka ngjashmëri me shkencat shoqërore.

Sheriati islam kërkon përgjegjësi edhe për veprën, edhe për qëllimin, dhe nëse për qëllim nuk gjykohet nga ligjet njerëzore, në sheriatin islam gjykohet edhe për qëllimin edhe për veprën, për të cilën nuk dënohet njeriu në këtë botë, pa marrë parasysh dënimit të merituar a i ka ikur me arsyetimin e gjykatës apo duke i ikur drejtësisë dhe duke mos dalë para gjykatës. Kështu, sheriati islam avancoi ndaj ligjeve njerëzore sepse njeriu e ndien prezencën e Zotit në çdo çast dhe edukohet me prezencën e tij, ashtu që nëse në këtë botë nuk vendoset në vend drejtësi për të, atëherë drejtësia vendoset në botën tjetër sepse sheriati islam nuk është vetëm ligj por është ligj dhe besim, ligj dhe fe.

MEDHHEBI DHE MEDHHEBET

(Drejtimi dhe Drejtmet)

“Dhehebe” në gjuhën arabe do të thotë “*ka shkuar*”, ndërsa “medhhebe” do të thotë “*rruga në të cilën ka shkuar*” apo “*drejtimi i cili zgjidhet për të shkuar*”.

Feja islame është fe universale, për të gjithë popujt, për të gjitha vendet dhe për të gjitha kohërat.

Ligjet në fenë islame ndahen në ligje të besimit dhe ligje të adhurimit.

Sa i përket besimit, prej Ademit a.s. e deri te Muhamedi a.s. dhe deri në ditën e kiametit nuk ndryshon me ndryshimin e popujve, vendeve dhe kohërave. Besimi është *një* dhe i *pandryshueshëm*.

Sa i përket formës së adhurimit, kemi ligjet e adhurimit të cilat nuk ndryshojnë, por kemi edhe forma dhe ligje të adhurimit të cilat ndryshojnë.

Dijetarët nuk prodhojnë ligje por ata zbulojnë ligje nga Kur’ani dhe Suneti. Ata e zgjedhin rrugën dhe mënyrën se si të vijnë deri te zbulimi i ligjit dhe kjo ka të bëjë me çështjet sekondare nga Kur’ani dhe Suneti. Sa për ilustrim ne do të tregojmë një shembull konkret se si arrihet deri te zbulimi i ligjit nga Kur’ani, me fjalë tjera do të ilustrojmë se si derivohen ligjet nga një ajet kur’anor. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“O ju të cilët keni besuar, kur të synoni faljen e namazit atëherë:

- 1. Pastroni fytyrat tuaja;**
- 2. Dhe duart tuaja deri në bërryla;**
- 3. Dhe lëmoni në (mbi) kokat tuaja;**
- 4. Dhe (pastroni) këmbët tuaja deri në zogj.” (El Maide,6)**

Nga ky ajet të gjithë dijetarët janë munduar të zbulojnë ligjet që kanë të bëjnë me abdesin.

Të gjithë dijetarët janë pajtuar se abdesi është kusht (farz) për t’u pranuar namazi dhe këtë nuk e ka kundërshtuar askush. Kështu pra, sa i përket kësaj çështjeje nuk ka medhhebe apo drejtme.

Të gjithë dijetarët janë pajtuar se larja e fytyrës gjatë abdesit është farz, dhe në përcaktimin e fytyrës bën pjesë pjesa prej ku dalin flokët në ballë e deri nën mjekër nga drejtimi vertikal, dhe prej veshit deri në veshin tjetër nga drejtimi horizontal, sepse fjala “vexhh”(fytyr) nënkupton këtë që thamë.

Sa i përket duarve, Zoti i Lartmadhëruar e ka përcaktuar **“deri në bërryla”**, për këtë arsye edhe dijetarët janë pajtuar në këtë çështjedhe nuk ka divergjenca në lidhje me këtë çështje.

Shihet se, dijetarët kur t’i qasen ajeteve kur’anore ata i qasen me seriozitet dhe vendosmëri për të kuptuar esencën e ajetit dhe zbulimin e ligjeve (rregullave) prej saj, dhe kjo assesi nuk nënkupton se dijetarët prodhojnë ligje dhe rregulla.

Tash vazhdojmë me pjesën e ajetit kur’anor ku Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“...dhe lëmoni në (mbi) kokat tuaja.”

Kjo pjesë e ajetit tregon dy çështje:

1. Mjetin e lëmimit (mes’hit) të kokës; dhe
2. Vendin e lëmimit (mes’hit) të kokës.

Kështu pra, kjo pjesë e ajetit i ka detyruar dijetarët që të shkojnë në drejtime të ndryshme për të zbuluar ligjin (rregullin) në lidhje me këtë çështje.

Ndonjë dijetar e ka zgjedhur drejtimin e mjetit të lëmimit (mes-hit). Ndonjë tjetër e ka zgjedhur drejtimin e vendit të lëmimit (mes-hit) të kokës.

Sa i përket mjetit të lëmimit të kokës, ajo është dora, me fjalë tjera, shuplaka e dorës. Nga të kuptuarit e mjetit të lëmimit që në këtë rast është dora (shuplaka e dorës) kanë rezultuar dy drejtime (medhhebe).

Drejtimi i parë (medhhebi) e parasheh tërësinë e mjetit, pra aq sa është shuplaka e dorës aq edhe duhet të jetë lëmimi i kokës, me fjalë tjera, një e katërta e kokës sepse shuplaka zakonisht përfshinë një të katërtën e kokës.

Drejtimi i dytë (medhhebi) e parasheh jo tërësinë e mjetit, por pjesësinë e mjetit, pra, aq sa përfshinë shumica e mjetit, që do të thotë se pasi që dora përbëhet prej pesë gishtave atëherë parashihet sa tre gishta të dorës.

Sa i përket vendit të lëmimit, prapë kemi dy drejtime.

Drejtimi i parë (medhhebi) e parasheh tërësinë e vendit, në këtë rast lëmimin e tërësisë së kokës.

Drejtimi i dytë (medhhebi) e parasheh vetëm një pjesë të vendit, në këtë rast lëmimin e një pjese të kokës.

Shihet se dijetarët iu kanë qasur pjesës së ajetit **“në (mbi) kokat tuaja”** dhe nuk është pjesa e ajetit “kokat e juaja”. Po të kishte qenë pjesa e ajetit **“kokat tuaja”** dhe jo **“në kokat tuaja”** nuk do të kishte pasur nevojë që të paraqiten katër e më shumë drejtime, siç është rasti te fytyra, duart dhe këmbët, sepse te duart Zoti i Lartmadhëruar e ka përcaktuar **deri te**

bërrylat, te këmbët e ka përcaktuar **deri te zogjt e këmbës**, ndërsa nuk ka thënë **“lani në fytyrat tuaja”** por ka thënë **“lani fytyrat tuaja”**. Kështu që, sa i përket fytyrës janë pajtuar se bënë pjesë tërësia e fytyrës.

Kjo është mënyra dhe qasja e dijetarëve në kuptimin e ajeteve dhe kjo vërteton atë se ata nuk kanë ligjësuar kryekëput me mendjet e tyre, por i kanë shfrytëzuar mendjet e tyre që të kuptojnë ajetet e Allahut xh.sh. dhe hadithet e Muhamedit s.a.v.s..

KAPITULLI I TRETË

SHEKULLARIZMI, LAICIZMI DHE VEHABIZMI

Shekullarizmi, laicizmi dhe vehabizmi, janë terma të cilat janë paraqitur në të njëjtën kohë, e para dhe e dyta në perëndim ndërsa e treta në lindje.

- Kur Evropa në mesjetë u përballë me luftëra të përgjakshme fetare, lindën reformatore si Luther dhe Calvin, të cilët kërkuar marrjen e pushtetit nga dora e klerit katolik. Prandaj dhe protestantët bashkë me intelektualët iluministë në këto rrethana këmbëngulën në pavarësimin e shtetit nga kisha.

- Kur perandoria Osmane (Hilafeti Islam) ishte në shkallë të lartë të zhvillimit, lindi lëvizja e Muhamed Abdul Vehabit për ta ndarë shtetin nga xhamia.

- Kur në Evropë shteti është ndarë nga kisha, Evropa ka filluar të zhvillohej.

- Kur pas 13 shekujve, në Islam shteti është ndarë nga xhamia vendet islame kanë filluar të mos zhvillohen dhe kanë mbetur të prapambetura.

Këtyre tre termave nevojitet tu bëhet një analizë krahasuese dhe një vështrim historik.

E para: Shekullarizmi.

Fjala **sekularizëm** (lat. Saeculum) ka kuptimin e shekullit, periudhës njëqindë vjeçare. Pra me sekularizmin (shekullarizëm) kuptojmë përshtatje me kohën në të cilën jetohet.

Fillimisht fjala “**shekullarizëm**” është përdorë nga shkrimtari britanik Xhorxh Xhekob Houlliouk në vitin 1851. Houlliouk duke qenë antifetarë e shpiku termin “shekullarizëm” për të përshkruar këndvështrimin e tij për të promovuar një rregull shoqërorë të ndarë nga feja, pa i kritikuar apo larguar besimet fetare. Ai debatonte me të tjerët se: “*Shekullarizmi nuk është një argument kundër Krishterimit, është diçka e pavarur nga ai.*”

Në kuptim të rregullimit të sistemit shoqërorë shekullarizimi është: transferimi apo shitja e pronave të kishës. Kështu që prona e Kishës së Zotit i dhurohet kësaj bote, prona i dhurohet shekullit.

Në kuptim të racionalizmit të inspiruar nga iluminizmi evropian, shekullarizmi nënkuptohet si largim nga ‘magjia’ (Max Weber), ‘pjekuria e njeriut’ (Immanuel Kant) dhe ‘botëkuptimi i tokësorës’ (‘jo i qiellores’ së Friedrich Hegel). Në shekullarizëm dija shekullare haptas është ajo lloj dije, e cila gjendet në këtë jetë, e cila është e lidhur me sjelljet e kësaj jete.

Në kuptim filozofik i bazuar në racionalizëm të plotë shekullarizmi është mohues i fesë dhe i botës tjetër.

Në politikë shekullarizmi është një lëvizje drejt ndarjes së fesë nga qeverisja (shteti) në atë mënyrë që ligjet e bazuara nga librat e Shenjta (si Bibla, Tevrat dhe Kur’ani (Sheriati)) të zëvendësohen me ligjet civile (njerëzore).

Në aspekt historik apo kronologjik shekullarizmi është një proces i ndryshimit gradual dhe koordinimin e fesë (organit të kishës) shtetit dhe shoqërisë civile për realizimin e kërkesave dhe nevojave të kohës. Nga ky aspekt nuk kemi ndarje të shtetit dhe politikës nga feja, por dhënien fund të pushtetit të klerit, pra që kleri të mos ketë pushtet apo qeverisje.

Shekullarizmi asociohet me periudhën e Iluminizmit në Evropë dhe ka luajtur një rol qendrorë në shoqërinë perëndimore.

E dyta: Laicizmi.

Laicizmi: Fjala laicizëm (lat. Laikos apo Laicus) domethënë ajo që i përket popullit, që rrjedhë nga populli, gjë e përbashkët apo e përgjithshme, jashtë organeve zyrtare dhe administrative, jo qeveritare, civile (jo ushtarake), etj.

Për herë të parë fjala laicitet në konotacionin e ‘mos ndërhyrjes së shtetit në punët e fesë dhe kishës’, ‘ndarjes së shtetit nga feja dhe kisha’ dhe ‘siguria e lirive fetare të qytetarëve’ është përdorur në Francë (pas vitit 1870), në kuadër të aktiviteteve civile, politike dhe parlamentare.

Fjala laicitet është përdorur për të kuptuar lirinë e institucioneve publike dhe veçanërisht të shkollave fillore nga ndikimi i Kishës Katolike në ato vende ku ajo ka pasur ndikim në kontekstin e një procesi shekullarizues.

Premisat e laicizmit në përgjithësi mund t'i përkufizojmë si më poshtë:

- Laicizmi ndalon diskriminimin fetar, etnik dhe gjinor dhe diskriminimet mbizotëruese në marrëdhëniet midis institucioneve të shoqërisë.
- Reformimi i qasjes fetare (kishtare) ndaj çështjeve shtetërore, gjithnjë duke pasur parasysh nevojat dhe kërkesat e kësaj bote.

Shihet se laicizmi është një proces socio-politik që rregullon lidhjet mes shtetit dhe institucionit të fesë si dy organe të pavarura nga njëri-tjetri.

Në shumë raste haset në ngatërrimin e shekullarizimit me laicizmin, ku në vend të laicizmit përdoret shekullarizmi dhe anasjelltas, mirëpo në mes tyre ekziston një vijë dalluese:

- Me *shekullarizëm* kuptohet ndarja e shtetit nga feja, këtu kemi të bëjmë më shumë me shtetin, shoqërinë civile në njërën anë dhe institucionin e fesë në anën tjetër, të cilat në bashkëpunim të plotë dhe duke ndihmuar njëra-tjetrën ecin drejt reformimit, ndryshimit, modernizimit apo thënë shkurt drejt përshtatjes me shekullin (me kohën).
- Kurse *laicizmi* nënkupton ndarjen e shtetit nga organi i fesë, por jo edhe fenë nga politika dhe shoqëria. Edhe pse me Laicizëm ndalohej ndikimi i fesë në qeverisje apo pushtet prapëseprapë në Evropë kemi parti të mëdha krishtere të cilat janë nën influencën e kishave.

Ka dallim në mes të thënieve: **“të ketë shtet fetarë”** dhe **“të ketë fe shtetërore”**.

Në **“shtetin fetarë”** qeverisë feja, ndërsa në vendin ku është **“feja shtetërore”** kuptohet aty ku shteti qeverisë ndërsa feja është zyrtare në atë shtet. Nga kjo mund të thuhet se laicizmi i vërtetë arriti të instalohet i plotë vetëm në Francë, kurse vet ‘logjika e laicizmit’ depërtoi në shtetet katolike të Evropës perëndimore si Belgjikë, Spanjë, Portugali dhe në Itali (*The Rise and Decline of Western Liberalism, Anthony Arblaster*).

Laicizmin radikal francez të periudhës së kryeministrit Emile Combes e huazoi themeluesi i Turqisë moderne, Kemal Atatürk. Më pastaj, megjithëse francezët rishikuan laicizmin e tyre, në Turqi kjo është shndërrua në ideologji për të shtypur besimtarët muslimanë.

Mund të konstatojmë se kemi dy drejtime të laicizmit:

- I pari është Laicizëm, sekularizëm i orientuar kundër religjionit me detyrë për të mbrojtur shoqërinë nga religjioni dhe religjioziteti, dhe
- I dyti është Laicizëm i orientuar drejt mbrojtjes së shprehjes së religjionit dhe religjiozitetit në shoqëri.

Disa dijetarë mendojnë se laicizmi është një formë e maskuar e anti-klerikalizmit dhe shkelje e të drejtave individuale e shprehjes fetare, dhe kjo në vend që të promovojë lirinë e mendimit dhe lirinë e fesë, e ndalon besimtarin të ndjekë fenë e tij.

Perëndimi është një trend i mirënjohur shekullarizmi dhe eksportimi i tij nëpërmjet sistemit demokratik është instaluar edhe në vendet e tjera të Lindjes.

Në vitin 1839, kur ka filluar rendi i ri shoqëror botërorë, pra i ashtuquajturit TANDHIMAT (Rend dhe sistem i ri shoqërorë), në perandorinë osmane, atëherë kanë filluar edhe shenjat e para të paraqitjes së shekullarizmit edhe në lindje, që në histori quhen Xhon Turqit e rinj, mirëpo prapëseprapë nuk ka pasur shekullarizim.

Pas luftës së parë botërore dhe pas rënies së perandorisë Osmane në vitin 1923, pra me rënien e hilafetit dhe të sulltanit osman hapet rruga e ndërtimit të shteteve kombëtare në Ballkan siç është edhe Shqipëria.

Po ashtu me rënien e perandorisë Osmane në vitin 1923, shekullarizmi kaloi edhe në vendet tjera Islame si në Siri, Arabi Saudite por edhe të gjitha shtetet e reja Islame, të cilat në gjirin e tyre kanë pasur edhe minoritete fetare të krishtera të cilat iu drejtuan filozofive të qeverisjes shekullarizuese dhe laicizuese.

Edhe pse Arabia Saudite, e cila qysh në fillimet e veta vendosi në kushtetutën e vet bazat e Sheriatit dhe të gjyqimit në bazë të këtij ligji edhe Arabia Saudite është shtet Laik edhe pse këtë ata nuk e pranojnë.

Mund të konstatojmë se kemi tri lloje të botëkuptimit të Shekullarizmit dhe Laicizmit:

Botëkuptimi i parë: Shekullarizmi dhe Laicizmi i cili sulmon fenë dhe është kundër fesë.

Botëkuptimi i dytë: Shekullarizmi dhe Laicizmi i cili mbron diskriminimin fetarë pra nuk është kundër fesë por që mbron bindjet fetare mirëpo nuk lejon ndikimin në qeverisje shtetërore, dhe

Botëkuptimi i tretë: Shekullarizmi dhe Laicizmi ku feja dhe shteti në mënyrë paralele ndihmojnë njëra tjetrën, por që secila prej tyre vepron e pavarur nga njëra tjetra.

Në bazë të botëkuptimit të parë të shekullarizmit, Shqipëria në vitin 1968 ndaloi edhe kishat edhe xhamitë duke u bërë si shembull tipik në botë i shekullarizmit.

Në bazë të botëkuptimit të dytë Turqia e Mustafa Kemal Atatürkut, i cili doktrinën e vet qeverisëse e ngriti në nivel kushtetues, duke e ashpërsuar luftën për zbatimin e saj, sa që ka kërkuar të nacionalizojë edhe fenë islame, duke kërkuar që edhe Kur’ani të këndohet turqisht edhe ezani të këndohet turqisht, edhe falja e pesë kohëve të namazit të bëhet turqisht.

Botëkuptimin e tretë në përgjithësi e praktikuan vendet tjera si në përfundim ashtu edhe në lindje.

E treta: Vehabizmi.

- Në kohën kur muslimanët kishin halif legal kurse halifi kishte vali në çdo vend të botës muslimane, paraqitet lëvizja Vehabite e cila refuzon edhe institucionin e hilafetit, duke pohuar se hilafet universal nuk duhet të ketë. Ibn AbdulVehabi mendon se në territorin e caktuar duhet shpallur sundimin e të drejtës së Zotit, dhe aty të ketë imam, e jo edhe të ketë halif universal për tërë botën.

- Në kohën kur lindën reformatoret evropian të cilët këmbëngulën pavarësimin e shtetit nga kisha u paraqit lëvizja Vehabite për ta ndarë shtetin nga xhamia, pasi që familja e Abdul Vehabitë me familjen Saude bënë marrëveshje që vehabijtë të merren me çështjet fetare ndërsa Saudët të merren me çështjet politike dhe mbretërore.

- Në kohën kur Perandoria Osmane ishte e angazhuar në luftë kundër Kryengritjes serbe, dhe me Rusinë, filloi kryengritja Vehabite.

- Në kohën kur ushtria franceze filloi të zbarkohet në Egjipt dhe muslimanët mbroheshin nga ushtria e Napoleonit vehabijtë kryejnë masakra, plaçkitje dhe shkaktojnë rrëmujë të madhe, kryesisht ndaj banorëve myslimanë.

- Në kohën kur Anglia me ushtarët e saj arriti në Moskut (në vitin 1798), e shteti islam osman ishte i preokupuar nga sulmet e jashtme dhe nuk kishte mundësi të merrej me vehabijtë, ata (vehabijtë) tri herë u ngritën kundër Hilafetit edhe pse tri herë u dorëzuan ata prapëseprapë ia kanë arritur qëllimit të tyre. Në mbrojtje ndaj kryengritjeve të tyre të njëpasnjëshme kundër halifatit të perandorisë osmane, Muhammed Ali Pasha me ushtri të madhe muslimane nga Egjipti erdhi në krahinën e Hixhazit dhe aty rreptë u konfrontua me lëvizjen vehabite. Vdiqën shumë myslimanë në të dy anët.

Vehabizmi dhe kryengritjet e tyre

Kryengritja e parë:

Pushtimi i Nexhdit në vitin 1775 nga ana e Muhammed Ibn Saudit ishte shenja e parë për daljen në sipërfaqe të një force të re fetare, politike dhe ushtarake.

I biri i Muhammed ibn Saudit, Abdulazizi përkundër vështirësive më 1786 pushtoi Rijadin dhe bëri bashkimin me Nexhdin. Kjo ishte prova më e sigurt se sukseset vehabite s'kanë të ndalur.

Në viti 1803 Saud ibn Abdulazizi, pushton Medinën.

Në vitin 1804 Saudi pushton Mekën dhe jep urdhëresë me të cilën ndalohet leximi i lutjes për sultanin osmanli në xhuma të premtëve në Mekë. Kjo shfaqje ishte çështje tejet e rrezikshme. Princi Saudi pasi hyri në Meke i shkroi letër sultanit: “Nga Saudi Selimit! Në Meke kam hyrë më 4 muharrem 1218 hixhrij (1804), kam rrënuar çka kam gjetur në Meke nga shenjat pagane mushrike. E ke për detyrë t’u urdhërosh mëkëmbësve në Damask dhe Kajro që mos të vijnë në këtë qytet të shenjtë”.

Kryengritjes vehabite nuk iu nënshtrua shteti Islam, por nga njëra anë Sulltani dhe nga ana tjetër Muhammed Aliu gjatë viteve 1811-1815 bënë katër luftëra dhe ngadhënjyen ndaj vehabistëve dhe mbretit të porsaemëruar i imponuan kushte të rënda për nënshtrim. Mirëpo, sërish shpërtheu kryengritje. Kështu, në vitin 1816 nën komandën e Ibrahim pashës, u nis ushtria e fuqishme, që përfundimisht ta mund ushtrinë vehabiste, kurse

mbretin Abdullah ta dorëzojë në Stamboll, të cilin Porta e ekzekutoi më 17 janar 1818.

Në këtë mënyrë kryengritja e parë e vehabijve mori fund.

Kryengritja e dytë:

Tri vite më vonë, pra në vitin 1821, një degë e familjes Saud, me princin Turkij, sërisht e formoi mbretërinë vehabite, me selinë në Rijad, jo larg selisë së mëhershme.

Më 1884, perandoria Osmane prapë pushtoi Rijadin dhe shpartalloi shtetin e dytë vehabit, kurse familja Saud u strehua në Kuvajt.

Kryengritja e tretë:

Shtetin e tretë vehabit e formoi princi Abdulaziz. Ai, më 1901, në krye të një grupi njerëzish, depërtuan në Rijad dhe pushtuan selinë mbretërore. Pastaj pasuan sukseset e njëpasnjëshme dhe, pas marrjes së Hailes më 1921, zotëroi tërë Nexhdin.

Deri sa zhvilloheshin luftërat ndërmjet ushtrisë së Muhammed Ali Pashës dhe vehabijve në Hixhaz, britanikët e shfrytëzuan këtë konflikt dhe e pushtuan Bahrejnin. Me këtë filloi procesi i kolonizimit nga ana e Britanisë në tërë territorin e botës islame.

Vehabizmi dhe Hilafeti

Sa i përket çështjes së imamit apo halifit, jo që refuzojnë imametin shi'it, por refuzojnë edhe institucionin e hilafetit, duke pohuar se hilafet universal nuk duhet të ketë. Ibn AbdulVehabi mendon se në territorin e caktuar duhet shpallur sundimin e të drejtës së Zotit, dhe aty të ketë imam, e jo edhe të ketë halif universal për tërë botën. Me këtë ata provonin ta privojnë nga legjitimitimi fetarë Perandorinë Osmane, duke e eliminuar halifin dhe duke e promovuar imamin.

Në vitin 1787 emiri Abdulazizi e proklamoi administratën e pavarur shtetërore dhe e futi sistemin trashëgues të sundimit (hukm wirathi), duke i

siguruar vend të birit Saudit të bëhet “halif” pas tij. Muhammed ibn AbdulVehabi ishte i pranishëm në këtë promovim.

Fatkeqësisht, sistemi trashëgues, sipas shembullit politik, kaloi edhe në rrafshin fetarë. Pas vdekjes së Muhammed ibn AbdulVehabit më 1792, trashëgues u bë i biri i tij Dehlani.

Vehabizmi dhe marrëveshjet e tyre me shtetet kolonialiste

“Pushteti britanik ishte në paqe, në marrëveshje dhe në bashkëpunim të përhershëm me vehabijtë”. Në marrëveshje parashihej që Britania nuk do të përzihet në konfliktet e tyre fetare, kur derdhet gjaku musliman. Ata do t’i sulmojnë vetëm ata që do t’i atakojnë barkat dhe anijet e tyre që kanë ardhur ta robërojnë dhe plaçkitin botën islame.

Anglia u ka premtuar liderëve të fiseve arabe pavarësi dhe sovranitet të plotë, nëse ata do të luftojnë kundër osmanlinjve. Britanikët ua theksuan vehabijve se ata nuk do të përzihen rreth luftës së tyre që e zhvillojnë kundër atyre që nuk pajtohen rreth çështjeve fetare dhe kërkuan vetëm që vehabijtë mos t’i sulmojnë barkat dhe anijet e tyre të ankoruara.

Përpos me Anglezët, Saudët kanë pasur marrëveshje edhe me Francën kur Napoleoni i dërgoi misionarët e tij të vendosin bashkëpunim dhe lidhje me Ibn Saudin dhe i ofroi atij aleancë kundër shtetit osman.

Britania dhe Franca lidhën Marrëveshjen e fshehtë Sykes-Picot, në të cilën parashihet ndarja e pjesës qendrore lindore të Perandorisë Osmane. Pra, edhe pse marrëveshje ka pasur edhe më herët, por pas kësaj marrëveshje u intensifikuan edhe më shumë.

Ibn Saudi i njoftoi Britanikët me proklamatin e vitit 1810 se u ka dhënë urdhër njerëzve të vet që mos t’i prekin barkat dhe anijet angleze. Ajo që doli nga kontrolli i pushtetit islam ishte e sinkronizuar dhe e koordinuar me kolonizatorin e forcave perëndimore: Britaninë apo Francën për të copëtuar shtetin islam.

Vehabizmi thërret në parimin e ‘tevhidit’, dhe në mohimin e ‘shirkut’.

Vehabijtë duke e quajtur veten ehl’ut-tevhid, të gjithë të tjerët jashtë tyre i quajtën ehl’ul-shirk (idhujtarë). Mirëpo, “të tjerët”, i quajnë vehabistët

si kokëfortë, ekstrem dhe zemërngushtë në të perceptuarit e tevhidit, sepse ndërtimi i mauzolejeve (Teqeve) dhe vizitimi i tyre nuk është idhujtari e arabëve parakur'anor.

Me shenjtëri dhe adhurim në vehabizëm nënkuptohet çdo respektim, qoftë ai që zë fill në traditë apo miqësi. Ngritja e mauzolejeve (Teqeve), vizitimi i rregulltë i tyre dhe qëndrimi me përulësi para tyre nuk është rrugë deri në idhujtari dhe politeizëm, por është vetë idhujtaria. Këtu qëndron edhe faktori i ndarjes ndërmjet vehabistëve dhe të tjerëve, sepse, të tjerët mendojnë se vehabistët e teprojnë në kërkesat e tyre rigoroze,

Vehabizmi dhe Fikhu

Vehabijtë nuk i pranojnë medhhebet, bile medhhebet në islam i quajnë idhujtari. Tendanca e vehabistëve për eliminimin e medhhebeve dhe moszgjedhja e mjeteve për zhdukjen e tyre na detyron të konstatojmë se angazhimi i tyre ka qenë dhe është i paarsyeshëm.

Fikhun shi'it e refuzojnë sidomos për shkak të bindjes së shi'itëve se imami është i pagabueshëm në fjalë dhe vepra dhe se ixhtihadi i imamit është obligativ. Meqë këto virtyte i posedon vetëm pejgamberi.

Vehabizmi dhe parimi shkencor dhe intelektual

Vehabizmi lufton edhe kundër tendencave të ndryshme ideologjike islame, sikurse është edhe kundër filozofisë. Vehabizmi ndër synimet e tij kishte pengimin e kelamit dhe të filozofisë islame, përpos që këtë në masë të madhe e arriti në Siujdhesën Arabe, me mjete të dhunshme dhe kërcënuese, këtë nuk arriti ta bëjë në Egjipt, Turqi, Iran, Indi dhe në vendet tjera.

Ata me gënjeshtër dhe strategji djallëzore filluan t'i sulmojnë alimët e ehli-sunnetit dhe ta shkatërrojnë islamijetin përbrenda e sidomos në vendet siç është Arabia Saudite, ku alimët e ehli-sunnetit nuk guxojnë të flasin haptazi. Po ashtu, për të gjithë myslimanët që nuk mendonin si ata, ishin në pamëshirë ndaj tyre, ndaj duhet të betohen se heqin dorë nga bindjet e tyre dhe të mësojnë kredon e tyre nga mësuesit e rinj. Nuk arriti ta pengojë as

sufizmin dhe shi'izmin, e edhe më pak depërtimin e ideve dhe sistemeve perëndimore.

Qysh me paraqitjen e Vehabizmit, është paraqitur një numër i madh shkrimesh që kundërshtonin parimet e tyre, sidomos shkrimet e dijetarëve me prejardhje egjiptiane, osmane por dhe të vendeve të tjera. Në to kryesisht theksoheshin, vrazhdësinë, ngurtësinë dhe ekskluzivitetin e tyre teorik dhe praktik.

- Ed-Dahlani, mufti i Mekes, paraqitjen e vehabistëve e quajti hiq më pak se fitne. Një tjetër dijetarë arab paraqitjen e lëvizjes vehabiste e përshkruan: ***“Potez i suksesshëm që Perëndimi e tërhoqi ishte themelimi i një lëvizjeje fetare e cila në formën e saj të jashtme do të dukej islame, e në esencë detyra e kësaj lëvizjeje do të ishte që vendet perëndimore, nëpërmjet saj, ta marrin pushtetin mbi myslimanët dhe ta rrënojnë hilafetin”.***

SEKTET E FILLUARA BRENDË ISLAMIT DHE TË NXITURA NGA JASHTË APO TË NXITURA NGA JASHTË E PASTAJ TË FILLUARA NGA BRENDË

Ademi a.s. ka qenë njeriu i parë dhe njëkohësisht edhe peygamberi i parë, dy fëmijët e tij kanë prerë nga një kurban (sakrificë) dhe njërit i është pranuar dhe tjetrit nuk i është pranuar. Sepse e vërteta pranohet prej Zotit të Lartmadhëruar ndërsa e pavërteta jo. Nga kjo rrjedh se e vërteta dhe e pavërteta janë dy të kundërta të cilat dëshirojnë ta largojnë njëra tjetrën nga vet-vetja.

Zoti i Lartmadhëruar, për të vulosur të vërtetën, ka dërguar një varg peygamberësh, ndonjë prej tyre ka qenë vetëm peygamber e jo udhëheqës shteti, e ndonjë prej tyre ka qenë peygamber dhe në të njëjtën kohë udhëheqës shteti.

Zoti i Lartmadhëruar e dërgoi vulën e peygamberëve Muhamedin a.s. Muhamedi a.s. kaloi nëpër dy faza të peygamberisë, të cilat janë të njohura:

Faza e parë: epoka para hixhretit ku Muhamedi a.s. ishte peygamber por nuk ishte udhëheqës shteti, ku kaloi 13 vite dhe

Faza e dytë: Epoka pas hixhretit ku Muhamedi a.s. ishte edhe peygamber edhe udhëheqës shteti.

Në kohën kur ka zbritur Kur'ani ekzistonin dy grupe njerëzish:

1. Besimtarë (musliman); dhe
2. Pabesimtarë (idhujtarët)

Sa i përket sahabeve ato ndaheshin në:

1. Ensar (ndihmëtarë të Muhamedit a.s) të cilët ishin Medinasit; dhe
2. Muhaxhirinët (Emigrantët) Mekas të cilët ishin shpërngulur në Medinë.

Muhamedi a.s. e kishte bërë vëllazërimin e tyre kur kishte shkuar në Medinë.

Sa i përket medinasëve ata ishin të përbërë prej dy fiseve :

1. Fisi Evs; dhe

2. Fisi Hazrexh.

Para se të shkonte në Medine Muhamedi a.s. e kishte bërë pajtimin e tyre.

Sa i përket Mekasëve përpos tjerëve, ishin të njohur dy grupe:

- grup i parë ishin kurejshitët, të cilët nuk kishin marrëdhënie të mira me fisin Hashimit edhe para shfaqjes së Islamit,

- grupi i dytë ishin përkrahësit e Aliut, të cilët përbëheshin nga Hashimitët.

Mekasit i kishte pajtuar Muhamedi a.s. para se t'i shpallej Kur'ani kur ishte vendosur haxherul Esvedi në vendin e tij në Qabe pas meremetimit të saj.

Kush duhej ta zëvendësonte Muhamedin a.s. në qeverisje të shtetit?

Muhamedi a.s. ndërroi jetë dhe nuk la porosi kush do të zëvendësonte atë në udhëheqje shtetërore. Çështja e parë në mesin e muslimanëve ishte çështja e zëvendësimit të Muhamedit a.s. në çështjen shtetërore.

Në lidhje me këtë çështje u paraqitën dy mendime kryesore:

Mendimi i parë ishte se Muhamedi a.s. duhej të ndiqej për çështjet fetare e jo në çështjet shtetërore, pra me qeverisjen dhe politikën.

Mendimi i dytë ishte se duhej të ndiqej Muhamedi a.s. edhe në çështje shtetërore edhe fetare.

Sa i përket zëvendësimit si udhëheqës shtetëror:

Medinasit mendonin se prej mesit të tyre duhej të ishte udhëheqësi.

Mekasit mendonin se prej mesit të tyre duhej të ishte udhëheqësi.

Edhe Mekasit kishin dy mendime se kush duhej të ishte udhëheqës shteti.

Një pjesë mendonte se duhej të ishte çdo Mekas.

Një pjesë tjetër mendonin se duhej të ishte çdo Mekas i cili kishte migrua prej Mekës deri në Medine e jo Mekasit të cilët nuk kishin migrua prej Mekës në Medine.

Një pjesë mendonte se duhej të ishte Aliu r.a.

Një pjesë tjetër mendonte se duhej të ishte Abasi r.a.

Në fund u mor vendimi që udhëheqës të ishte Ebu Bekri Siddiku.

Në kohën kur Omeri r.a. sa e mbante pozitën e Halifit, dallimet që ekzistonin nuk kishin ndonjë ndikim të madh.

Pas Omerit r.a. pozitën e Halifit e mori Osmani r.a. i cili u vra në fund të vitit 35 sipas Hixhrit (656 Isa a.s.) ndërsa pas tij u zgjodh Aliu r.a. për Halife.

Ndarja e parë e muslimanëve për udhëheqjen e shtetit dhe jo për çështje fetare

Ndarja e parë e muslimanëve në aspekt politik dhe qeverisës, jo fetar u bë në dy grupe:

Grupi i parë: Pro Alisë për të qenë Halife, që quheshin Shiatu Alij; dhe

Grupi i dytë: Pro Osmanit kushtimisht, quheshin Shiatu Osman.

Grupi pro Osmanit (Shiatu Osman) nuk pajtoheshin me hilafetin e Aliut r.a. dhe në esencë nuk e pranuan hilafetin e tij (Udhëheqës të këtij grupi ishin Talha dhe Zubejri, këta bënë Basrën bazë të tyre).

Përpos kësaj ndarje në aspekt të rrafshit qeverisës politik nuk ekzistonte ndonjë ndarje tjetër ideologjike Islame.

Ndarja politike kalon në ndarje fetare

Me kalimin e kohës, nga ndarja politike fillon edhe ndarja fetare, kjo ndarje fetare është bërë për shkak të cilësimit të Hilafetit, dhe u ndan në dy grupe:

Grupi i parë e pranonin Aliun r.a. si Halife dhe në të njëjtën kohë e konsideronin detyrim fetar ndjekjen e tij dhe prej kushteve të imanit.

Grupi i dytë nuk e pranonin Aliun r.a. si Halif dhe e kundërshtonin atë me pretekstin e hakmarrjes për vrasjen e Osmanit r.a.

Nga grupi i parë, pra prej atyre të cilët e pranonin Aliun r.a. kishte divergjencë. Një pjesë mendonte se Aliu r.a. ka pasur të drejt të ishte Halif para Ebu Bekrit, para Omerit dhe para Osmanit r.a.

Një pjesë e pranonin Aliun r.a. si Halif legjitim, por në të njëjtën kohë i pranonin Hilafetin e Ebu Bekrit, Omerit dhe të Osmanit r.a. Mendimi i këtij grupi ishte se Aliu r.a. për të mirën e Islamit kishte heshtur në ato rrethana kështu që nuk e kanë ndier të domosdoshme me bashkëpunua me Halifët pararendës.

Kështu pra, kundërthëniet nuk u ndalën në çështje politike, por ato kaluan në kundërthënie në rrafshin fetar dhe u paraqit mendimi se para vdekjes, Muhammedi a.s. ka thënë se pas vdekjes së tij, udhëheqjen e imametit duhet ta marrë Aliu r.a. dhe në këtë pikëpamje theksuan disa thënie, të cilat ia atribuuan Muhammedit a.s.:

“Udhëheqës i kujt jam unë, edhe Aliu do të jetë udhëheqës.”

Trashëgimia e udhëheqjes të Shiitët kalon në rrafshin fetar

Shiitëve nuk ju mjaftonte që për halife të jetë vetëm Aliu r.a, por ato mendonin se hilafeti duhet të kalojë edhe te trashëgimtarët e tij.

Në lidhje me këtë çështje ata u ndanë në mes vete.

Disa mendonin se trashëguesit duhet të jenë vetëm nga bijtë e Aliut dhe të Fatimes, vajzës së Muhammedit a.s., djemve të Hasanit dhe Huseinit.

Disa mendonin se trashëgues përpos bijve të Fatimes mund të jenë edhe bijtë tjerë të Aliut r.a. të cilët ishin jo me Fatimen r.a.

Kështu shiitët u ndanë edhe në bazë të imamëve të tyre në dy grupe:

- Shiitët e dymbëdhjetë imamëve dhe
- Shiitët e shtatë Imamëve i cili quhet *seb'ij*, ata të cilët besojnë se imami i shtatë është fshehur dhe se do të paraqitet si *mehdi*.

Ka edhe ndarje tjera të shiitëve.

Shiitët kalojnë në ekstremitet të cilin nuk e pranon logjika

Shiitët shkuan edhe më larg, shkuan aq larg sa që ajo konfrontohet me logjikën dhe fenë. Ata filluan t'iu përshkruajnë atyre edhe cilësi Zoti, d.m.th. Zotin filluan ta personifikojnë fizikisht dhe shpirtërisht me këta imamë, plotësisht ashtu sikurse vepruan edhe kristianët me Isain a.s.

Pas një kohe lindi ideja mbi atë se Zoti do ta dërgojë ndonjë person, i cili popullin e humbur do ta drejtojë drejt rrugës së vërtetë. *Kjo ide ka ekzistuar edhe te kristianët, e në esencë e njëjtë.*

Me dallime të vogla ka ekzistuar edhe te hebrenjtë. Kristianët mendojnë se mehdiu i pritur, të cilin e quajnë “mesih” do të paraqitet me ringjallje të re, kurse hebrenjtë mendojnë se ai do të paraqitet, por jo me ringjallje, por do të lindet nga se më parë nuk ka vdekur e as ekzistuar.

Një prift hebrej, i cili Islamin e pranoi doli me argumentimin se Muhammed ibn Askerij, i cili hyri me xhybe në vendin nëntokësor të shtëpisë së tyre dhe aty u zhduk, kurse nga fundi i botës (para shkatërrimit), do të shfaqet dhe do ta mbush me drejtësi.

Këtë pohim e trashëgoi grupi shiit, i cili edhe tash e pret, për shkak se është quajtur “mehdiu (udhëzuesi) i pritur”

Shumica mendojnë se muslimanët janë të ndarë gjysmë-gjysmë në dy grupe Shiit dhe Sunnij. Në realitet, shiitët në botë përbëjnë prej 7.5 deri në 11% që do të thotë se ato janë pakicë ndërsa sunnitët përbëjnë 92.5 %. Kjo dëshmon se ato janë sekt i ndarë nga trungu dhe nuk kanë përgjysmuar botën Islame.

Ndjekësit e Aliut r.a. ndahen në shiit dhe Havarixh

Aliu r.a ishte caktuar Halife, mirëpo një pjesë e muslimanëve nuk e kishin pranuar si Halife e posaçërisht Muaviju dhe Jezidi të cilët ishin Valij në Damask, pas një kohe edhe ndjekësit e Aliut r.a. u ndanë në dy grupe:

- Grupi besnik i Aliut r.a. që quheshin Shiatu Alij dhe
- Grupi tradhtar i Aliut r.a. i cili nuk ishte pro Osmanit, por u shkëput nga tabori i Aliut të cilët quhen Havarixh (dezertor) apo të dalë nga radhët e grupit të Aliut r.a..

Sikurse edhe grupet tjera edhe në këtë grup u paraqitën mendimet në rrafshin politik dhe në atë fetar:

Sa i përket rrafshit politik mendonin se e drejt e udhëheqjes nuk është e drejt e Aliut r.a. por është e drejt e secilit nga radhët e muslimanëve. Halifi duhet të zgjidhet në mënyrë të lirë prej muslimanëve.

Havarixhët mendonin se Sundimi (hilafeti) i Ebu Bekrit dhe Omerit r.a. është i vlefshëm, ashtu siç e pranojnë sundimin e Osmanit r.a. në fillim, mirëpo, sipas tyre, Osmani do të duhej të izolohej.

Sa i përket rrafshit fetar ky grup kalon në ekstremizëm sa që ata të cilët bëjnë mëkat të madh i quanin pabesimtarë. Këta filluan që sehabet t'i konsiderojnë pabesimtarë, mendonin se Aliu ka bërë kufër, e me të kanë bërë kufër edhe të gjithë ata që pranuan këtë gjykim. Po ashtu i fusin në kufër edhe ata që morën pjesë në luftën e ashtuquajtur **“lufta rreth deveesë”**, pastaj dy ndërmjetësuesit e arbitrazhit dhe të gjithë ata që u pajtuan me rezultatin e tij, me një fjalë nuk e pranojnë gjykimin në betejën e Siffinit.

Havarixhët mendojnë se imani dhe vepra janë njësi e pandashme. Secili që kundërshton ligjet e Allahut, është pabesimtar dhe ai që bënë mëkat të madh dhe nuk pendohet prej tyre vdes si pabesimtarë.

Havarixhët mendojnë se është detyrim mosnjohja dhe luftimi kundër sundimtarit tiran, dhe e lejojnë vrasjen e muslimanit sepse ata muslimanët i konsiderojnë jo musliman për shkak të mëkateve të tyre.

Ebu Hanifja pengonte havarixhët edhe sektet e tjera, të cilat përpiqeshin të shtrembëronin mësimin islam, andaj ata mundoheshin ta eliminonin në çdo mënyrë.

E para është: Kur personi gjatë konsumimit të pijeve alkoolike ose gruaja duke lindur fëmijë të jashtëligjshme vdesin, para se të pendohen, a kanë vdekur si muslimanë?

Ebu Hanifja duke kuptuar se cili ishte qëllimi i tyre i pyeti: Ai njeriu dhe ajo gruaja, që i përmendet ju, a janë Jehud?

Jo, nuk janë! - u përgjigjën.

Po, a janë të krishterë? - prapë i pyeti.

Nuk janë! - u përgjigjën.

Po, a janë zjarrputist? - përsëri i pyeti.

Nuk janë - u përgjigjën.

Po ç'janë atëherë? - u tha.

Ata e pranuan: Ata janë muslimanë!

Atëherë Ebu Hanifja përfundoi: Shumë bukur! Ja, u përgjigjët ju vet, nuk keni pasur nevojë fare të më kërkonit mua që tu përgjigjem!

Ata të çuditur pyetën: Si?

Ebu Hanifja tha: Pak më parë e deklaruat se ata janë muslimanë, kurse krahas Islamit, a mund të jenë diç tjetër?

Ata, atëherë të çuditur vetëm pyetën: Ai muslimani a do të shkoj në Xhennet apo në Xhehennem?!

Ebu Hanifja iu përgjigj: Kjo varet nga vullneti i Allahut, siç thotë Ibrahim i a.s. për ata që kanë qenë edhe më të këqij se ai njeriu dhe ajo gruaja, d.m.th. ata që i adhuronin idhujt: Ai që do të më pasoj mua – është i fesë sime, kurse ai që ngrihet kundër meje, atëherë – Ti vërtet je Falës dhe Mëshirues! Ose siç ka thënë Isai a.s: Nëse i dënon, ata janë robërit e Tu, e nëse ua fal, Ti je i Fuqishëm dhe i Urtë.

Sipas havarixhëve dhe disa sekteve këta persona nëse vdesin para pendimit, vdesin jobesimtarë, ndërsa qëndrimi i ehli-sunetit dhe xhematit është se ata vdesin si mëkatarë, por megjithatë janë muslimanë!

Nga pro shiitët dhe pro Osmanët qëndrojnë neutralët

Treguam se në esencë u paraqitën dy grupe, grupi pro Osmanit dhe grupi pro Aliut.

Grupi pro Aliut u nda në grupin besnik dhe grupin tradhtarë që quheshin Havarixh, përpos këtyre dy grupeve ishte edhe një numër i caktuar i shokëve të Profetit, ndonëse tejet i vogël, nuk i shprehu besnikëri Imam Aliut si Halif. Ata ishin “neutralistët” (*Ka'idin*).

Të ashtuquajturit *Ka'idin*, pra neutralistët, përbëhej nga dy nëngrupet me prirje të ndryshme.

Nëngrupi i parë ishin ata që besonin se njeriu duhet të tërhiqet nga skena në kohët e trazirave shoqërore (*fitne*). Këta kishin mendimin se grupet luftuese ishin të devijuar dhe të destinuar për të hyrë në xhehenem, dhe shprehnin idenë se qëndrimi asnjans ishte një virtyt, ndërkohë që përfshirja në këto trazira është *fitne*.

Nëngrupi i dytë në mesin e “neutralistëve” ishin ata që quhen *mu'tezilë* dhe që besonin se njëri nga dy grupet luftuese kishte të drejtë, por se kjo gjë nuk mund të përcaktohej qartësisht. Ky grup (fillimisht) quhej *mu'tezilë*, ndërsa më vonë, Vasil ibn Ata dhe Amr bin Ubejdi patën qëndrime të ngjashme me ta, kur bëhej fjalë për Talha-në dhe Zubejrin.

Një koncept i rëndësishëm, i përdorur nga të dy nëngrupet e Kaidinëve ishte në vlerësimin e gjendjes së krijuar, pra të *fitne*-s. Ata besonin se në kohët kur ka *fitne* “*është më mirë të jesh një nga të vvarët sesa një nga vrasësit*”.

Hixhazi nuk mbajti anë në konfliktin ndërmjet grupeve pro-Aliut dhe pro-Osmanit, por u bë skenë e një lëvizjeje që mund të quhet “lëvizja e pasardhësve të sahabeve” (*ebna’ el-sahaba*).

Përhapja e Islamit dhe themelimi i shkencave Islame

Shekulli i dytë dhe i tretë hixhrij ishte shekulli i përpilimit dhe definimit të shkencave Islame. Në këto dy shekuj Islami u përhap në tërë gadishullin arabik dhe më gjerë, kështu që Islami zhvillohej edhe në aspektin politik por edhe në atë shkencor.

Në këtë kohë u bë përpilimi i shkencave islame siç janë: Shkenca e akaidit, Shkenca e Fikhut, Shkenca e hadithit, Shkenca e tefsirit, etj.

Akaid quhet shkenca e besimit, ndryshe quhet edhe shkenca e ilmul kelamit. Kemi dy lloje të fikhut:

- Fikhu i madh - që është akaidi; dhe
- Fikhu i vogël - ku bënë pjesë fikhu i të drejtës islame.

Në këtë kohë ishin përkthyer shumë libra nga romakët grekët dhe nga kulturat dhe civilizimet e huaja. Në mesin e muslimanëve filloi të zhvillohej edhe filozofia (posaçërisht ajo greke) të mbështetura në akl (mendje), pastaj filluan të paraqiten fraksionet bidatiste, pastaj u parashtrua pyetja e mëkatit të madh, e ndër mëkatet e mëdha me theks të veçantë vrasja, e në këtë rast të posaçëm vrasja e Aliut r.a. Filloi debati në lidhje me cilësitë e Allahut. Të gjitha këto ndikuan në paraqitjen e drejtimeve në ilmul kelam(akaid):

Drejtimi i parë ishte drejtimi muëtezil i cili pasi që ishte ngjyros me filozofi të huaja i jepte mendjes përparësi në çështje të bazave të fesë dhe paraqiste mendime në çështje të akaidit. Ky drejtim anonte mendimin mbi tekstet e fesë.

Drejtimi i dytë ishte drejtimi tradicional (Ehlus suneti) i cili ishte i kundërt me të parin sepse bazohej vetëm në tekste (nas) dhe nuk lejonin që mendja të merrte pjesë në gjykimin e çështjeve të bazave të fesë.

Në këtë drejtim bënin pjesë muhadithinët të cilët duke e parë se muëtezilët do të binin në humnerën e filozofive të huaja, nuk e lejonin që logjika të jetë primare në çështje të ilmul kelamit por kërkonin me ngulm se duhet t'u përmbaheshin vetëm teksteve fetare siç ishin Kur'ani, Hadithi dhe Ixhmai.

Drejtimi i tretë: ishte mesi i dy të parëve sepse kundrejt dy poleve ekstreme u paraqit drejtimi Esharit dhe Maturidij **i cili** bazohej në tekstet ashtu që duke i marrë për bazë anët pozitive të tyre (ehli sunetit) dhe duke i marrë anët pozitive të muëtezilës kështu që brenda ehli sunetit arrin në nivelin e **“ehlu suneti vel xhemaati”**.

Ky grup i dietarëve përjashtuan nga skena muëtezilët dhe i nxjerrën nga ngurtësimi ehlu sunetin dhe duke vazhduar rrugën e sehaveve dhe të Tabiinëve, vazhduan metodën e **selefu salih** sepse ky Drejtim ngërthen në vete dy drejtimet, në këtë grup bënin pjesë fukahat, muhadithët dhe shumica absolute e asaj gjenerate, ky është grupi e shpëtuar, grupi i ndihmuar dhe këta janë ithtarë të së vërtetës (ehlul-hakki).

Ky drejtim i filluar nga Eshariu dhe Maturidiu, të cilët janë themelues të shkencës së Ilmul Kelamit sunnij që nga shek. i III hixhrij vazhdon deri në ditët tona.

Ja vetëm një shembull të dallimit të drejtimeve sa i përket cilësive të Allahut:

Tradicionalistët mendonin se cilësitë e Allahu nuk mund të kuptohen me anë të arsyes dhe logjikës pos me anë të argumenteve tradicionale ashtu që mendja nuk ka mundësi që të arrij njohjen e tyre.

Muëtezilët mendonin se me anë të mendjes dhe arsyes mund të arrihen dhe të kuptohen cilësitë e Allahut.

Ehli suneti vel xhemaati mendon se duke përdorur argumentin logjik dhe pa e kundërshtuar Kur'anin dhe sunetin mund të arrihet deri te konkluzioni i kuptimit të çështjeve, sepse ai i cili e mohon rolin e logjikës

nuk mund të ketë argument tjetër përpos argumentin e logjikës dhe është obligim i shikimit të çështjeve me anë të mendjes.

Babizmi, Behaizmi, Kadizianizmi dhe Vehabizmi

Perëndimi e dinte se nuk mund të mbërrinte deri te qëllimet e veta derisa muslimanët jetonin të bashkuar shpirtërisht, për këtë arsye projektoi themelimin e disa lëvizjeve fetare të cilat në formën e saj të jashtme do të dukeshin islame, e në esencë detyra e atyre lëvizjeve do të ishte që vendet perëndimore, nëpërmjet tyre, ta marrin pushtetin mbi muslimanët dhe ta rrënojnë hilafetin. Kështu që u projektuan lëvizjet si: Babizmi, Behaizmi Kadizianizmi dhe Vehabizmi

Babizmi, Behaizmi ishte i përshtatshëm te Shiitët dhe në lindjen e largët ndërsa ,

Vehabizmi ishte i përshtatshëm në qendër të Islamit në shkretëtirën e Arabisë Saudite.

1. Babizmi

Babizmi (Babud dijnë-Dera e fesë) themelues Mirza Ali Muhammed është me prejardhje shiite, u lind në mesin e varfanjakëve dhe fshatarëve të Iranit në vitin 1844 nga Mirza Ali Muhammed i cili në moshën 25 vjeçare, shpalli se është përfaqësues i predikuesit (bab) të imamit të pritur, ai ka deklaruar: *“E kam parë kokën e Husejnit – kokën e shehidit më të zgjedhur – të varur për një dru se si prej tij rrjedh gjak me bollëk. Iu afrova drurit, e kapa me dorë gjakun e tij dhe kur u zgjova ndjeva se shpirti i Zotit është në mua dhe se plotësisht ka dominuar trupin tim. Zemra ime u gëzua me praninë e Zotit në mua...”*.

Babizmi ngërthen në vete shumë ide interne ekstreme shiite dhe sufiste, por edhe ide ekstreme krishtere, jehude dhe të feve tjera.

Perëndimi e cilësoi lëvizjen babiste si revolucionare, kurse liderët e saj heronj. Edhe Gold Ziheri e lavdëron Ali Muhammedin – *Bab*-in si hero.

Rusia cariste jo vetëm që i simpatizonte babistët, por edhe i ndihmonte me para dhe armë.

Shtrirja e tyre në Iran, Irak dhe Turqi. Aktualisht, babistë sot ka në Uzbekistan dhe numri i tyre është tejet i vogël.

Nuk është e qartë a e ka konsideruar vetveten vetëm *bab* të imamt të dymbëdhjetë, si komentues i vetëm i autorizuar i mendimit të tij apo edhe *mehdi* apo meqë cikli peygamberik ka përfunduar me Muhammedin a.s., ky do ta fillojë ciklin e ri peygamberik.

Shtëpia e babit dhe vendet në të cilat ai ishte ngujuar janë shndërruar në vende të shenjta për pelegrinazh.

Babistët në Horasan më 1848 mbajtën kongresin ku u shpall ndarja nga islami dhe shfuqizuan të drejtën e sheriatit.

2. Behaizmi

Pas vdekjes së *babit* rezultoi çështja e trashëgimitarit me paraqitjen e behaizmit, nga nxënësi i tij me emrin Mirza Husejn Ali Nuri, respektivisht me nofkën *Beha'ullah* (1817-1892), i cili sipas tyre është trashëgimtar direkt i Muhammedit a.s.

Shihet se Behaizmi është degë e lëvizjes babiste me ndikim nga imamizmi shi'it, i cili është lideri i zgjedhur nga Zoti, mëson se ai është zëvendësim për Muhammedin dhe shpall fenë e re.

Behaizmi nuk është asgjë tjetër pos vetëm pikëpamje me synim të shkatërrimit të islamit, Behaullahu ka ardhur t'i eliminojë gabimet dhe mosmarrëveshjet e religjioneve të hershme dhe të konstituojë “mbretërinë e Zotit” që është synim i të gjitha religjioneve, personalisht ky paraqet realizimin e premtimit të *Bab*-it, ai nëpërmjet të të cilit do të manifestohet Zoti.

Sipas Behaizmit pasues të Babit janë edhe Musa, Krishna, Buda, Isa dhe Muhamedi. I fundit dhe më i rëndësishmi është vetë ai, Behaullahu i cili e konsideron veten përmbushje të premtimit nga të gjitha religjionet.

Behaizmi është i ndikuar nga imamizmi dhe i kushton më tepër rëndësi doktrinës etike dhe sociale se sa spekulimeve teologjike dhe metafizike.

Duke parë rrezikun nga lëvizjet e tyre, perandoria osmane në vitin 1868 i ndau në dy grupe dhe njërin e dërgoi në Akra në Palestinë kurse tjetrin në Famagusta në Qipro.

Behaullahu që u vendos në Akra, vdiq në vitin 1892 Pas vdekjes së tij, e zëvendësoi djali i tij i vjetër Abbas efendi, i cili më 1908, filloi të zhvillojë aktivitet të ngjeshur më shumë në Evropë dhe Amerikë e më pak në vendet islame. Në vitin 1920 qeveria angleze e emëroi për kalorës të perandorisë angleze.

Përhapja e behaizmit jashtë Lindjes së mesme ishte meritë kryesore e Abdulbehaut, trashëgimtarit të Behaullahut i cili bëri disa udhëtime në Egjipt, Evropë dhe Amerikë dhe pastaj çdo kund formonte degë të lëvizjes.

Dallojnë edhe krahu iranian i behaizmit, i cili ka ruajtur frymën zanafillore dhe krahu perëndimor, i cili është i preokupuar me aspektin etik dhe social.

Behaistët janë aktiv në tërë botën, sidomos në projekte sociale dhe ekonomike. Ata kanë status këshillues në United Nations Economic and Social Council (ECOSOC) dhe në United Nations Children's Fund UNICEF, kurse bashkëpunojnë me U.N. Office of Public Information etj.

Behaijt pohojnë se janë religjion i pavarur. Kështu që opinioni musliman i mendon si lëvizje joislame. Behaizmi shkëputjen e vet nga gjiri islam, e krahasojnë me shkëputjen e kristianizmit nga judaizmi apo me shkëputjen e budizmit nga hinduizmi.

Liga Islame në Meke qortoi para dy dekadash se behaistët nëpër tërë botën po tubojnë mjete materiale dhe ia dërgojnë hebraikëve. Si kundërvlerë, Lëvizja Botërore e hebraikëve ka ndihmuar por edhe sot ndihmon behaistët, kurse Lëvizja Botërore Cioniste në behaistët shihte aleatët e vet. Dhe qendra e behaizmit sot është në qytetin Haifa të Izraelit.

Në fund të shekullit XX mendohet se lëvizja behaiste kishte më tepër se 70 mijë qendra nëpër vende të ndryshme të botës.

3. Kadijanizmi

Gulam Ahmadi 1839-1908 në qytetin Kadijan në Pengjab pasi punësohet te Anglezët në qytetin e shejlekut të vicegurnatorit të Indisë, aty lidhet me anglezët, i simpatizon dhe bëri çmos t'i ndihmonte pasi që Anglia Indinë e konsideronte si një pronë të veten në lindje pra si pronë e fituar prej kolonializmit e shfrytëzoi këtë për realizimin e qëllimeve të saja. Kështu që pasi që mëson Islamin dhe fetë tjera, në vitin 1905 themelon shkollën fetare arabe, për përgatitjen e misionarëve për vendet arabe.

Ne vitin 1889 Mirza Gulam Ahmedi shpall publikisht se ka marrë leje prej Zotit të kërkoj nga nxënësit e tij t'i japin zotim për besnikëri.

Me 1901 solemnisht e shpall se duhet të konsiderohet si mehdi i muslimanëve dhe mesijh i krishterëve.

Pas vdekjes së tij, pasuesit ia ndërtuan varrin dhe shkruan tek varri i tij: “Mirza Gulam Ahmed mewud që do të thotë: Mehdi i pritur për të ringjall sheriatin”.

Ky sekt botonte libra ne indi Pakistan e pastaj edhe në Evropë.

Ixhmai është aprovuar se çdo musliman që thotë dhe deklaron se pas Muhamedit a.s. mund të vij ndonjë pejgamber ai konsiderohet pabesimtarë. Nga kjo mund të themi se kjo lëvizje nuk ka të bëjë me Islamin, po është prodhim për ta shkatërruar Islamin.

4. Vehabizmi

Dihet se ndarja e parë në mesin e muslimanëve ka ndodhë për shkak të qeverisjes, pra të hilafetit. Pastaj ka kalua në rrafshin fetar, ndërsa Vehabijtë janë ata të cilët e kanë ndarë qeverisjen politike nga ajo fetare, sepse Saudët dhe Vehabijtë kanë bërë marrëveshje që vehabijtë të merren me çështjet fetare dhe nuk do të përzihen në çështje shtetërore dhe saudët të merren me çështjet shtetërore dhe të mos përzihen në çështjet fetare. Kjo i ndihmoi Saudëve që të themelojnë shtetin saudit ndërsa Vehabijtë me pretekstin se Shiitët e konsiderojnë Imamatin (Hilafetin) pjesë të besimit këta e refuzojnë institucionin e Hilafetit duke pohuar se Hilafet Univerzal nuk duhet të ketë. Ibn Abdulvehhabi mendon se në territorin e caktuar duhet shpallur sundimin e të drejtës së Zotit, dhe aty të ketë imam, e jo edhe të ketë halif universal për tërë botën. Anglia u ka premtuar liderëve të fiseve arabe pavarësi dhe sovranitet të plotë, nëse ata do të luftojnë kundër osmanlinjve. Në arritjen e këtij qëllimi Saudët kanë lidhë marrëveshje me Britanezët dhe Francezët.

Vehabijtë duke e quajtur veten ehl'ut-tevhid, të gjithë të tjerët jashtë tyre i quajtën ehl'ul-shirk (idhujtar). Po ashtu, të gjithë muslimanët që nuk mendonin si ata, ishin të pamëshirë ndaj tyre.

Vehabijtë i thonë vetes se janë selefij ndërsa është e kundërta sepse selefus salih janë të pastër nga ata dhe nga mendimet qëllimkëqija që tyre sepse nuk janë asgjë tjetër pos si një ripërtëritje e havarixhëve. Ata shkatërrojnë islamijetin përbrenda e sidomos në vendet siç është Arabia Saudite, ku alimët e ehli sunnetit nuk guxojnë të flasin haptazi.

Vehabijtë nuk i pranuan edhe medhhebet në Islam dhe i quajnë shirk (idhujtari).

Vehabijtë nuk e pranojnë drejtimin Esharit dhe Maturidij në Akaid, dhe janë pengues të ilmul kelamit dhe filozofisë Islame. I thonë vetes se janë ehlu sunneti vel xhemaati ndërsa është e kundërt sepse ata nuk janë ehlu sunneti vel xhemaati sepse ato janë pakicë, madje edhe në vendet arabe. Vetëm në Saudi ata janë shumicë ndërsa pjesa tjetër e umetit janë Esharit dhe Maturidij. P.sh.: 200 mil. në Indonezi, 400 mil. në Pakistan, Indonezi, Bangladesh dhe Indi, 150 mil. në Kinë dhe Malajzi. Pastaj qindra mil. në Afrikë, pastaj qindra mil. në Egjipt, Siri, Irak, Palestinë etj. të gjithë këta janë Esharij dhe Maturidij të cilët përbëjnë ehlu sunneti vel xhematin.

SEKTET DHE MEDHHEBET NË ISLAM

Dëgjojmë shpesh për sektet dhe medhhebet në islam. Ka prej atyre që sektin e barazojnë me medhhebin dhe anasjelltas. Dëgjojmë shpesh edhe për grupin e shpëtuar. Ka prej atyre të cilët dëshirojnë ta kuptojnë se cila është grupa e shpëtuar dhe duke u munduar ta kuptojnë cila është grupi e shpëtuar krijojnë urrejtje ndaj medhhebeve, duke menduar se edhe medhhebet janë grupe dhe nuk janë pjesë e xhematit të umetit, kështu i refuzojnë dhe nuk i pranojnë edhe medhhebet. Për të bërë dallimin në mes tyre shkurtazi do t'i sqarojmë si vijon:

Në përgjithësi çështjet ndahen në:

- çështje primare, dhe
- çështje sekondare.

Çështjet primare janë çështje të ndërlidhura me besimin (imanin).

Çështjet sekondare janë çështje të ndërlidhura me iradet (adhurim) dhe muamelat (veprimi reciprok ndër njerëzor).

Me çështjet primare merret shkenca ilmul-kelamit (besimit), ndërsa me çështjet sekondare merret shkenca e fikhut.

Pasi që feja është e përcaktuar në njohje të Krijuesit dhe dëgjueshmërinë ndaj tij, atëherë mund të vijmë në përfundim se:

- njohja e Krijuesit është primare, ndërsa
- dëgjueshmëria ndaj tij është sekondare.

Mospajtimi në çështje primare është i urryer ndërsa mospajtimi në çështje sekondare nuk është i urryer.

Grupet dhe drejtimit ndahen në:

1. Sektet të ndara në bazë të besimit;
2. Drejtimit e ndara në bazë të ibadetit (adhurimit) dhe raporteve ndërnjerëzore;
3. Sektet të cilat janë të ndara në bazë të çështjeve parësore por edhe sekondare.

1. Sektet të ndara në bazë të besimit

Në bazë të besimit sektet ndahen në:

1. Muëtezil;
2. Havarixh;
3. Ehlu sunet;
4. Eshari dhe Maturidi.

Përpos këtyre kemi edhe sektet tjera si: Murgijet, Xheberijt, Kaderijt, etj.

Murgijet ndahet në sekte tjera siç janë: Pasuesit e Junus Bin Aunit; el-Gasaniyet; el-Jevmijet; eth-Thevbanijet dhe el-Halidijet.

Muëtezilët janë sekt i ndarë nga ehlu suneti për shkaqe të bazës së besimit. Përndryshe muëtezilët mund t'i quajmë si *filozofi e veshur me petkun Islam*.

Sektet e Muetezilëve janë: el-Gejlanijet, el-Vasilijet, el-Umerijet, el-Hudhelijet, en-Nidhamijet, eth-Thumamijet, el-Besherijet, el-Muzdarijet, el-Hishamijet, el-Xhahidhijet, el-Keabijet, el-Xhebaijet, el-Behsheijet, el-Ahshedijet, el-Hajtijet dhe el-Hasenijet.

Havarixhët janë sekt i ndarë nga ehli suneti. Havarixhët thonë se njeriu bëhet jobesimtar për shkak të mëkatimit të madh dhe ndahen në 21

sekte: el-Mahkemijet, el-Ezarkatu, en-Nexhdat, el-Bejheijetu, el-Axharidetu, es-Salijetu, el-Mejunetu, el-Hamzijetu, el-Halfijetu; el-Etrafijetu; esh-Sheabijetu; el-Hazimijetu; et-Thealebijetu; el-Ahisijetu; err-Rrushdijetu, el-Meabedijetu, el-Mekremijetu, el-Mealumijetu, el-Mexhhulijetu, el-Abadijetu, el-Esgarijetu dhe el-Hafsiijetu.

Ehlu suneti është **baza** (nga e cila janë ndarë sektet tjera) i cili i përmbahet vetëm tekstit (Kur'anit dhe hadithit), përndryshe gjenerata e parë e cila ende nuk ishte përzier me filozofi greko-romake çështjet e fesë i bazonin në tekste duke mos kundërshtuar aspektin racional por të ndrojtur nga filozofitë e huaja në islam.

Esharijtë dhe Maturidijtë janë vazhdimësi e ehlu sunetit dhe nuk janë të ndarë prej bazës, sepse pasi që ka fillua përzjerja me kultura të popujve të ndryshëm si ato persiane dhe greko-romake, këta as nuk lejonin depërtimin e filozofive të huaja në islam posaçërisht filozofinë greko-romake as nuk i kanë lënë çështjet të padebatuara por as nuk kanë rënë pre e filozofive të huaja kështu që Esharijtë dhe Maturidijtë mund t'i quajmë mes i ehlu sunetit dhe muëtezilëve sepse e bëjnë ndërlidhjen e teksteve me logjikën dhe assesi nuk janë sekt në vete i ndarë nga ehlu suneti.

2. Drejtimit në bazë të ibadetit (adhurimit) dhe raporteve ndërnjerëzore

Drejtimit për çështje të adhurimit dhe raportet ndërnjerëzore ndryshe i quajmë Medhhebe (hartim programi për mënyrën e kuptimit të çështjeve të adhurimit dhe të raporteve ndërnjerëzore). Nga kjo mund të themi se nuk do të ishte e drejtë që medhhebet të quhen shkolla juridike sepse shkollat juridike merren me çështjen e raporteve ndërnjerëzore ndërsa medhhebet përpos çështjeve të raporteve ndërnjerëzore merren edhe me çështjet e adhurimit ndaj Krijuesit.

Medhhebet nuk janë drejtime të cilat e kundërshtojnë njëra tjetrën në çështje primare të adhurimit dhe të raporteve ndërnjerëzore por në çështje sekondare të çështjes së adhurimit dhe të raporteve ndërnjerëzore.

Medhhebet nuk janë të ndara nga njëra-tjera por janë drejtime të cilat brenda bazës debatojnë për të ardhur deri te Kur'anit dhe suneti. Me një fjalë drejtimit janë drejtime të cilat shpijnë te pikëbashkimi dhe assesi te ndarja apo shkëputja.

Shkaqet të cilat kanë ndikuar në këto drejtime janë të shumta por kryesore janë se: Islami thërret në logjikë, islami është për gjithë popujt, për të gjitha vendet dhe gjeneratat dhe islami është edhe për këtë botë edhe për botën tjetër.

Drejtimet e formuara në çështje të adhurimit dhe të raporteve ndërnjerëzore janë:

1. Medhhebi (drejtimi) Hanefij;
2. Medhhebi (drejtimi) Shafii;
3. Medhhebi (drejtimi) Malikij; dhe
4. Medhhebi (drejtimi) Hanbelij.

Ekzistojnë edhe medhhebet (drejtime) tjera por ato janë shumë pak të njohura.

Medhhebin Malikij dhe Hanbelij më shumë mund t'i quajmë drejtime të cilat u përmbahen teksteve (Kur'anit dhe sunetit) dhe të cilat shumë pak e përdorin Kijasin (analogjinë), me fjalë tjera shumë pak e përdorin logjikën në zbulimin dhe shpalosjen e ligjeve të sheriatit.

Medhhebi Shafii dhe Hanefij bazohet në tekste dhe në logjikë. Shafiijtë përdorin Kijasin më shumë se Hanbelijtë dhe Malikijtë, ndërsa Hanefijtë edhe më shumë se Shafiijtë.

Shihet se Hanefijtë janë mes i Hanbelijve dhe Malikijve në njërin anë dhe të Shafiiëve në anën tjetër. Themelues i shkencës së usuli fikhut është Shafiiu ndërsa Hanefijtë e kanë zhvilluar edhe më shumë këtë shkencë.

Nuk mund t'i quajmë Hanefijtë racionalistë përballë tekstit (Kur'anit dhe sunetit) por racionalistë të kuptimit të tekstit (Kur'anit dhe sunetit).

3. Sektet të cilat janë të ndara në bazë të çështjeve parësore por edhe sekondare

Sektet të cilat janë të ndara në bazë të çështjeve parësore por edhe sekondare janë: Shiitët dhe Sunitët.

Shiitët janë grupi i vogël i cili është ndarë prej grupit të madh (sunit) kështu që nuk do të ishte e drejtë që sunitët të quhen sekt edhe pse quhen përballë shiitëve dhe sekteve tjera por vetëm se për të bërë dallimin ndaj sekteve tjera, sepse sekti është grup i vogël fetar i ndarë prej grupit të madh (bazë) dhe se origjina e fjalës sekt rrjedh nga latinishtja “secte” që do të thotë “ndjekës” ose prej fjalës “sectare” që do të thotë “pres (prerje)” dhe shiitët janë ndarë nga sunijet.

Në mes të shiitëve dhe sunitëve qëndron dallimi primar dhe sekondar në të njëjtën kohë.

Dallimi primar është dallimi i besimit të çështjes së Imamit se a është shtyllë e fesë apo interes i përgjithshëm i muslimanëve.

- Shiitët thonë se Imamati është shtyllë e besimit.
- Sunitët thonë se Imamati nuk është pjesë thelbësore e besimit por është interes i përgjithshëm i muslimanëve.

Pas kësaj edhe sunitët por edhe te shiitët ekzistojnë drejtime të ndara sa i përket çështjes së ibadetit dhe muamelat.

Shiitët në përgjithësi ndahen në:

1. Imamij;
2. Zejdij dhe
3. Ismailij.

1. Imamijtë janë shiitët që pretendojnë në 12 Imamët dhe se imami i 12 edhe sot është gjallë dhe e presim paraqitjen e tij, përndryshe quhen pritësit e imamit.

2. Zejdijtë janë shiitët të cilët konsiderojnë Imam Zejd bin Ali bin Husein r.a.

3. Ismalijjtë janë shiitët të cilët e konsiderojnë imam pas Xhafer bin Sadikut djalin e tij Ismailin dhe nuk i konsiderojnë Imam bijtë e tjerë të cilët vijnë nga djali tjetër i tij Kjadhimi.

Ekzistojnë edhe të ashtuquajturat sekte por e vërteta është se nuk janë sekte siç janë: Gulatu-shia të cilët ndahen në pesëmbëdhjetë sekte:

- El-Kejsanijet të cilët janë të ndarë në katër sekte;
- El-Mushebehunët të cilët janë të ndarë në pesë sekte;
- El-Keramijet të cilët ndahen në shtatë sekte;
- El-Xheberijet në katër sekte.

Edhe sektet siç janë: Babij, Behaij, e të ngjashëm me ta nuk mund të quhen sekte islame se ato kundërshtojnë bazën e bazave të fesë siç është vula e pejgamberit (Muhamedi a.s është vula e Pejgamberëve).

Sa i përket haditheve të Muhamedit a.s:

“Vërtetë ata që ishin para jush nga njerëzit e Librit u ndanë dhe u përçanë në 72 grupe, edhe ky umet do ndahet në 73 grupe. Të gjithë do të jenë në zjarr dhe vetëm njëri do të jetë në Xhenet, e ky është xhemati.” dhe hadithi tjetër: ***“Do të ndahet umeti im në 73 grupe, të gjitha do jenë në zjarr pos njërit. Shokët e e pyetën: Kush është ai grup o i dërguar i Allahut. Muhamedi a.s. u përgjigj: Ata të cilët e pasojnë rrugën në të cilën jam unë dhe shokët e mi.”***

(Këto hadithe) Nuk kanë për qëllim numrin e sipërpërmendur por kanë për qëllim shumësinë sepse prej kohës se kaluar e deri në të sotmen nuk mund të determinohet numri shtatëdhjetë e tre, por edhe nëse determinohet atëherë ka mundësi që në të ardhmen të paraqiten edhe sekte të tjera kështu që numri do të ishte në kundërshtim me hadithin.

Grupi i shpëtuar është grupi i selefu salih nga të cilët burojnë Esharijtë dhe Maturdijtë dhe medhhebet pa përjashtim të cilat janë ehlu suneti dhe xhemaati sepse të gjithë angazhohen që të kapen për litarin e Allahut siç ka thënë Zoti i Lartmadhëruar:

“Dhe përmbahuni fort për litarin e Allahut të gjithë së bashku dhe mos u ndani. Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju sepse kur ishit në armiqësi Ai i pajtoi zemrat tuaja e në saje të dhuntisë së Tij u bëtë vëllezër dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Allahu ua shpjegon shpalljet e veta që ju të drejtoheni në rrugën e drejtë”. (Ali Imra : 103)

Zanafilla e Havarixhëve dhe mentaliteti i ngurtë i tyre

Havarixh është shumës i fjalës harixhij.

Harixhij quhet ai i cili ndahet dhe largohet, ai i cili del prej radhëve dhe shkëputet prej bazës, me fjalë tjera ai i cili rebelohet.

Kishin kaluar tri dekada prej vdekjes së Muhamedit a.s. dhe asnjëherë në mesin e muslimanëve deri atëherë nuk ka pasur ndarje mbi bazë fetare. Ka pasur mospajtime në çështje tjera si p.sh.: në çështjen se kush ka përparësi në pozitën e të parit të shtetit Islam. Ndoshta edhe kanë luftua në mes vete, por jo duke e konsiderua njëri- tjetrin jomusliman.

Havarixhët janë të parët të cilët morën guximin dhe u ndanë mbi bazë fetare, shkak dhe pretekst i ndarjes së tyre është arbitrazhi në mes Aliut r.a. dhe Muavijut për paqe. Konfliktit në mes Muavijut në njërën anë dhe Alijut r.a. në anën tjetër i erdh fundi kur u dakorduan për arbitrim në mes tyre, por në ato moment prej tyre doli logo se: *“nuk ka arbitrazh dhe se gjykimi i takon vetëm Zotit të Lartmadhëruar dhe askujt tjetër”* (Inil Hukmu i-laa Lil-Laah).

Harixhiju i parë është Abdullah Vehbe er-Rasibij i cili i thotë Alijut r.a: *“Ti je Kafir, sepse nuk gjykove me fjalën dhe ligjin e Allahut”*. Ky akuzim ekstrem ndaj Aliut r.a. është fanatizëm, sepse si është e mundur të akuzohet për pabesim Aliu r.a. kur dihet se ai ishte i cili e kishte vendos veten të sakrifikohej në shtratin e Muhamedit a.s., kur Muhamedi a.s e kishte bërë hixhretin?!. Po si të akuzohej për pabesim kur ishte njëri prej 10 të përgëzuarve me xhenet prej Muhamedit a.s.?!

Aliju r.a. nuk i shpalli pabesimtarë, ai e ruajti gjakftohtësinë dhe për të mos lejuar konflikt, u lejon atyre që të vendosen në një vend që quhet Harura (vend afër Kufes në Irak). Për këtë arsye edhe disa dijetarë i kanë quajtur Harurujun (Haruranas).

Havarixhët pasi që shkojnë në atë vend dhe pasi që vendosen aty vendosin postbllloqe, patrullonin dhe jetonin të ndarë nga shoqëria Islame.

Abdullah ibn Abasi, njëri prej interpretuesve më të njohur të Kur'anit (*për të cilin ishte lutur Muhamedi a.s. që t'i shtohet dituri në të kuptuarit dhe të interpretuarit të Kur'anit*) shkon te ata për të zhvilluar bisedime për bashkëjetesë mirëpo ata ishin kategorik në vendimin e tyre fanatik dhe ekstremizmi kishte kaluar në kulminacion. Ja si është zhvilluar debati ndërmjet tyre dhe Abdullah ibn Abasit:

Abdullah ibn Abasi : - Cili është problemi juaj me Aliun r.a.?

Ata i përgjigjen: Aliu është Kafir (pabesimtar).

- Pse është Kafir? - i pyet Abdullah ibn Abasi.

- Sepse nuk ka gjykua me ligjin e Allahut dhe ka pranua ndërmjetësim dhe arbitrimin me Muavijun - i përgjigjen ata.

Abdullah ibn Abasi i pyet: - A më e rëndësishme është çështja e pajtimit të një burri dhe të një gruaje apo çështja e pajtimit të Umetit ?.

Ata i përgjigjen: - Çështja e pajtimit të Umetit.

(*Pasi që ata thirreshin në Kur'an: Inil Hukmu il-la Lil-Laah*), Abdullah ibn Abasi u citoj atyre ajetin Kur'anor: "...dhe le të jetë një ndërmjetësues (arbitër) nga ana e saj (gruas) dhe një ndërmjetësues (arbitër) nga ana e tij burrit." (*en-Nisa*). Ky ajet Kur'anor ka zbritur për pajtimin e bashkëshortëve, e pse mos të bëhet pajtimi i umetit nëpërmjet ndërmjetësimit dhe arbitrimit në bazë të këtij ajeti Kur'anor.

Edhe ky argument nga Kur'ani prej Abdullah ibn Abasit nuk ndikoi sepse ishin të ngurtë në qasjen e tyre, vetëm se duhet cekur se nga 6000 Havarixh të cilin ishin aty 2000 u kthyen dhe iu bashkuan radhëve të Aliut r.a..

Pas një kohe, Abdullah ibn Hababi el Erefi së bashku me bashkëshorten e tij shtatzënë, duke menduar dhe duke qenë i bindur se jeton në shoqëri Islame, kalon pran vendbanimeve të tyre, ata e ndalin dhe e pyesin: - Çka mendon për Aliun?.

Ai u përgjigjet: - Ai është emirul muëminijnë (udhëheqës i muslimanëve).

Ata i thonë : - Ti je Kafir (pabesimtar).

Para syve të tij e therin gruan e tij e cila ishte shtatzënë në muajin e nëntë e më pastaj e mbysin edhe atë. Këtë vepër e bënë nga fanatizmi që kishin në gjokset e tyre.

Aliu r.a. nuk i kishte luftuar por i kishte lënë të lirë të jetojnë, por i kishte kushtëzuar se nëse e luftojnë Aliun r.a. dhe qytetarët, ai do t'iu kundërvihet. Por pas kësaj ndodhie, Aliu r.a. i dëbon prej atij vendi dhe ata shpërndahen në vende të ndryshme.

Edhe pse këto ngjarje kanë ndodhë pas jetës së Muhamedit a.s. disa dijetarë e ndërlidhin me një rast të Muhamedit a.s. me një arab pas betejës se Hunejnit kur Muhamedi a.s. ishte duke i ndarë pagat, kur i vjen një beduin dhe i thotë: - *O Muhamed, vepro drejtë sepse nuk je duke veprua me drejtësi!?*. Muhamedi a.s. i thotë: - Mjerë për ty, po nëse edhe unë nuk veproj me drejtësi kush do të vepronte me drejtësi!?

Disa prej sahabeve kërkuan nga Muhamedi a.s. që ta ndëshkojnë, por Muhamedi a.s. u thotë: - Jo, se edhe nëse vritet prapë pas tij do të vijë njerëz të llojit të tij.

Karakteristikat dhe tiparet e havarixhëve

Duhet të jemi të qartë se Muhamedi a.s. nuk i ka quajtur Havarixhët me emër, as nuk i ka përmend tiparet e tyre me emër, por ekzistojnë dhjetëra hadithe ku dijetarët prej atyre haditheve i përshkruajnë tiparet dhe karakteristikat e Havarixhëve dhe të ngjashmëve me ta. Muhamedi a.s. aq mirë i ka detajuar tiparet e tyre sa që nuk ka detajuar asnjë grup tjetër të muslimanëve në mënyrë të përpiktë sikurse grupimet në një grup të tillë.

Në bazë të atyre haditheve mund të vijmë në konkludim se tiparet e havarixhëve janë si vijon:

1. Të rinj në moshë, pa eksperiencë dhe me iluzione e ëndrra, i shikojnë gjërat bardhë e zi dhe jo më shumë.
2. Janë të ngurtë në mentalitetin e tyre.

3. Ata thërrasin në parimet Islame, por nuk kanë të bëjnë asgjë me parimet Islame.
4. Ata thërrasin në librin e Allahut, por nuk kanë të bëjnë asgjë me librin e Allahut.
5. Ata thërrasin në ligjin e Allahut, por nuk kanë të bëjnë asgjë me ligjin e Allahut.
6. Lexojnë Kur'anin sa që duket se janë të mrekullueshëm në leximin e tij, por ai lexim nuk kalon më larg se te fyti i tyre sepse nuk buron nga zemra dhe nga thellësia e shpirtit të tyre.
7. Falin namazin, namazi i tyre duket se është namazi më i miri në krahasim me namazin e të tjerëve, por asgjë nuk kanë të bëjnë me namazin (sepse namazin e bëjnë për ti nënçmuar tjerët).
8. Agjërojnë sa që agjërimi i tyre duket se është agjërimi më i miri por nuk kanë të bëjnë asgjë me agjërimin (sepse agjërimin e bëjnë për t'i nënçmuar tjerët).
10. Ata flasin fjalë të mira, janë oratorë, shprehin fjalë impresionuese ashtu që me fjalët e mira të tyre do të duken se janë fjalët më të mira nga të gjitha krijesat por veprat e tyre janë të këqija (nuk përkojnë me fjalë ëmbra e tyre).

Të gjitha cilësitë e tyre janë cilësi të muslimanit të devotshëm por kulminacion i atyre cilësive është se ato dalin nga feja Islame ashtu siç del shigjeta nga harku i saj.

Kur havarixhët e kanë thënë fjalën: “Inil hukmu il-la Lil_lah” (Gjykimi i takon vetëm Allahut), Aliu r.a. për ta ka thënë: “*Kaulul hak juradu bihil batil*” që do të thotë: “*Fjalë e drejtë, por me qëllim të keq*”. Dihet se ata mosfalësin e namazit nuk mundohen me e mësua me u falë por e shpallin kafir, mosagjëruetin nuk e udhëzojnë për agjërim por e quajnë kafir, hajnin nuk e ndalojnë nga vjedhja e mëtutjeshme por e quajnë kafir, ashtu siç e kanë quajtur kafir Aliun r.a. duke i thënë se nuk ka gjykuar me ligjin e Allahut por e ka pranuar arbitrimin edhe pse arbitrimi në Kur'an është i ligjësuar me ajete të tij.

Nuk duhet harruar faktin se Aliun r.a. e kanë vra Harixhinjët me pretekst se nuk është duke vepruar me fjalën e Allahut, ndërsa ata e kanë bërë këtë se janë duke thënë se janë duke vepruar me ligjin e Allahut. A nuk

është pra e vërtet se havarixhët nuk kanë të bëjnë asgjë me parimet Islame, sepse parimet Islame janë të qarta, ndërsa ata i deformojnë dhe veprojnë veprime që nuk kanë të bëjnë me Islamin ata me një fjalë janë fjalë ëmbël ndërsa me vepra janë helmues?.

ZANAFILLA E HAVARIXHËVE DHE MENTALITETI I NGURTË I TYRE

Havarixh është shumë i fjalës harixhij.

Harixhij quhet ai i cili ndahet dhe largohet, ai i cili del prej radhëve dhe shkëputet prej bazës, me fjalë tjera ai i cili rebelohet.

Kishin kaluar tri dekada prej vdekjes së Muhamedit a.s. dhe asnjëherë në mesin e muslimanëve deri atëherë nuk ka pasur ndarje mbi bazë fetare. Ka pasur mospajtime në çështje tjera si p.sh.: në çështjen se kush ka përparësi në pozitën e të parit të shtetit Islam. Ndoshta edhe kanë luftua në mes vete, por jo duke e konsiderua njëri-tjetrin jomusliman.

Havarixhët janë të parët të cilët morën guximin dhe u ndanë mbi bazë fetare, shkak dhe pretekst i ndarjes së tyre është arbitrazhi në mes Aliut r.a. dhe Muavijut për paqe. Konfliktit në mes Muavijut në njërën anë dhe Aliut r.a. në anën tjetër i erdh fundi kur u dakorduan për arbitrim në mes tyre, por në ato moment prej tyre doli logo se: *“nuk ka arbitrazh dhe se gjykimi i takon vetëm Zotit të Lartmadhëruar dhe askujt tjetër”* (Inil Hukmu i-laa Lil-Laah).

Harixhiju i parë është Abdullah Vehbe er-Rasibij i cili i thotë Alijut r.a: *“Ti je Kafir, sepse nuk gjykoje me fjalën dhe ligjin e Allahut”*. Ky akuzim ekstrem ndaj Aliut r.a. është fanatizëm, sepse si është e mundur të akuzohet për pabesim Aliu r.a. kur dihet se ai ishte i cili e kishte vendos veten të sakrifikohej në shtratin e Muhamedit a.s., kur Muhamedi a.s e kishte bërë hixhretin?!. Po si të akuzohej për pabesim kur ishte njëri prej 10 të përgëzuarve me xhenet prej Muhamedit a.s.?!.

Aliju r.a. nuk i shpalli pabesimtarë, ai e ruajti gjakftohtësinë dhe për të mos lejuar konflikt, u lejon atyre që të vendosen në një vend që quhet Harura (vend afër Kufes në Irak). Për këtë arsye edhe disa dijetarë i kanë quajtur Harurujun (Haruranas).

Havarixhët pasi që shkojnë në atë vend dhe pasi që vendosen aty vendosin postblloqe, patrullonin dhe jetonin të ndarë nga shoqëria Islame.

Abdullah ibn Abasi, njëri prej interpretuesve më të njohur të Kur'anit (për të cilin ishte lutur Muhamedi a.s. që t'i shtohet dituri në të kuptuarit dhe të interpretuarit të Kur'anit) shkon te ata për të zhvilluar bisedime për bashkëjetesë mirëpo ata ishin kategorik në vendimin e tyre fanatik dhe

ekstremizmi kishte kaluar në kulminacion. Ja si është zhvilluar debati ndërmjet tyre dhe Abdullah ibn Abasi:

Abdullah ibn Abasi : - Cili është problemi juaj me Aliun r.a.?

Ata i përgjigjen: Aliu është Kafir (pabesimtar).

- Pse është Kafir? - i pyet Abdullah ibn Abasi.

- Sepse nuk ka gjykua me ligjin e Allahut dhe ka pranua ndërmjetësim dhe arbitrimin me Muavijun - i përgjigjen ata.

Abdullah ibn Abasi i pyet: - A më e rëndësishme është çështja e pajtimit të një burri dhe të një gruaje apo çështja e pajtimit të Umetit ?.

Ata i përgjigjen: - Çështja e pajtimit të Umetit.

(Pasi që ata thirreshin në Kur'an: Inil Hukmu il-la Lil-Laah), Abdullah ibn Abasi u citoj atyre ajetin Kur'anor: "...dhe le të jetë një ndërmjetësues (arbitër) nga ana e saj (gruas) dhe një ndërmjetësues (arbitër) nga ana e tij burrit." *(en-Nisa)*. Ky ajet Kur'anor ka zbritur për pajtimin e bashkëshortëve, e pse mos të bëhet pajtimi i umetit nëpërmjet ndërmjetësimit dhe arbitrimin në bazë të këtij ajeti Kur'anor.

Edhe ky argument nga Kur'ani prej Abdullah ibn Abasi nuk ndikoi sepse ishin të ngurtë në qasjen e tyre, vetëm se duhet cekur se nga 6000 Havarixh të cilin ishin aty 2000 u kthyen dhe iu bashkuan radhëve të Aliut r.a..

Pas një kohe, Abdullah ibn Hababi el Erefi së bashku me bashkëshorten e tij shtatzënë, duke menduar dhe duke qenë i bindur se jeton në shoqëri Islame, kalon pran vendbanimeve të tyre, ata e ndalin dhe e pyesin: - Çka mendon për Aliun?.

Ai u përgjigjet: - Ai është emirul muëminijnë (udhëheqës i muslimanëve).

Ata i thonë : - Ti je Kafir (pabesimtar).

Para syve të tij e therin gruan e tij e cila ishte shtatzënë në muajin e nëntë e më pastaj e mbysin edhe atë. Këtë vepër e bënë nga fanatizmi që kishin në gjokset e tyre.

Aliu r.a. nuk i kishte luftuar por i kishte lënë të lirë të jetojnë, por i kishte kushtëzuar se nëse e luftojnë Aliun r.a. dhe qytetarët, ai do t'i kundërvijë. Por pas kësaj ndodhie, Aliu r.a. i dëbon prej atij vendi dhe ata shpërndahen në vende të ndryshme.

Edhe pse këto ngjarje kanë ndodhë pas jetës së Muhamedit a.s. disa dijetarë e ndërlidhin me një rast të Muhamedit a.s. me një arab pas betejës së Hunejnit kur Muhamedi a.s. ishte duke i ndarë pagat, kur i vjen një beduin dhe i thotë: - *O Muhamed, vepro drejtë sepse nuk je duke veprua me drejtësi!?*. Muhamedi a.s i thotë: - Mjerë për ty, po nëse edhe unë nuk veproj me drejtësi kush do të vepronte me drejtësi!?

Disa prej sehaveve kërkuan nga Muhamedi a.s. që ta ndëshkojnë, por Muhamedi a.s. u thotë: - Jo, se edhe nëse vritet prapë pas tij do të vijë njerëz të llojit të tij.

Karakteristikat dhe tiparet e havarixhëve

Duhet të jemi të qartë se Muhamedi a.s. nuk i ka quajtur Havarixhët me emër, as nuk i ka përmend tiparet e tyre me emër, por ekzistojnë dhjetëra hadithe ku dijetarët prej atyre haditheve i përshkruajnë tiparet dhe karakteristikat e Havarixhëve dhe të ngjashmëve me ta. Muhamedi a.s. aq mirë i ka detajuar tiparet e tyre sa që nuk ka detajuar asnjë grup tjetër të muslimanëve në mënyrë të përpiktë sikurse grupimet në një grup të tillë.

Në bazë të atyre haditheve mund të vijmë në konkludim se tiparet e havarixhëve janë si vijon:

1. Të rinj në moshë, pa eksperiencë dhe me iluzione e ëndrra, i shikojnë gjërat bardhë e zi dhe jo më shumë.
2. Janë të ngurtë në mentalitetin e tyre.
3. Ata thërrasin në parimet Islame, por nuk kanë të bëjnë asgjë me parimet Islame.
4. Ata thërrasin në librin e Allahut, por nuk kanë të bëjnë asgjë me librin e Allahut.
5. Ata thërrasin në ligjin e Allahut, por nuk kanë të bëjnë asgjë me ligjin e Allahut.
6. Lexojnë Kur'anin sa që duket se janë të mrekullueshëm në leximin e tij, por ai lexim nuk kalon më larg se te fyti i tyre sepse nuk buron nga zemra dhe nga thellësia e shpirtit të tyre.

7. Falin namazin, namazi i tyre duket se është namazi më i miri në krahasim me namazin e të tjerëve, por asgjë nuk kanë të bëjnë me namazin (sepse namazin e bëjnë për ti nënçmuar tjerët).

8. Agjërojnë sa që agjërimi i tyre duket se është agjërimi më i miri por nuk kanë të bëjnë asgjë me agjërimin (sepse agjërimin e bëjnë për t'i nënçmuar tjerët).

10. Ata flasin fjalë të mira, janë oratorë, shprehin fjalë impresionuese ashtu që me fjalët e mira të tyre do të duken se janë fjalët më të mira nga të gjitha krijesat por veprat e tyre janë të këqija (nuk përkojnë me fjalë ëmbela e tyre).

Të gjitha cilësitë e tyre janë cilësi të muslimanit të devotshëm por kulminacion i atyre cilësive është se ato dalin nga feja Islame ashtu siç del shigjeta nga harku i saj.

Kur havarixhët e kanë thënë fjalën: “Inil hukmu il-la Lil_lah” (Gjykimi i takon vetëm Allahut), Aliu r.a. për ta ka thënë: “*Kaulul hak juradu bihil batil*” që do të thotë: “*Fjalë e drejtë, por me qëllim të keq*”. Dihet se ata mosfalësin e namazit nuk mundohen me e mësua me u falë por e shpallin kafir, mosagjëruetin nuk e udhëzojnë për agjërim por e quajnë kafir, hajnin nuk e ndalojnë nga vjedhja e mëtutjeshme por e quajnë kafir, ashtu siç e kanë quajtur kafir Aliun r.a. duke i thënë se nuk ka gjykuar me ligjin e Allahut por e ka pranuar arbitrimin edhe pse arbitrimi në Kur'an është i ligjësuar me ajete të tij.

Nuk duhet harruar faktin se Aliun r.a. e kanë vra Harixhinjët me pretekst se nuk është duke vepruar me fjalën e Allahut, ndërsa ata e kanë bërë këtë se janë duke thënë se janë duke vepruar me ligjin e Allahut. A nuk është pra e vërtet se havarixhët nuk kanë të bëjnë asgjë me parimet Islame, sepse parimet Islame janë të qarta, ndërsa ata i deformojnë dhe veprojnë veprime që nuk kanë të bëjnë me Islamin ata me një fjalë janë fjalë ëmbël ndërsa me vepra janë helmues?.

VEHABIJTË, SHIRKU, TEKFIRI, BIDATI DHE TAGUTI

Në historinë e njerëzimit dihet se ka ekzistuar politeizmi dhe monoteizmi. Feja Islame është fe monoteiste dhe muslimanët janë monoteist. Shihet se e kundërta e monoteizmit është politeizmi, e nuk mund të quhet monoteizmi politeizëm. Fenë e politeistëve të Mekës para shpalljes së Kur'anit, Kur'ani e përshkruan kështu:

**“Nëse i pyet (politeistët) kush i krijoi qiejt dhe tokën,
do të thonë: - All-llahu.”**

E pastaj përgjigjen pse adhurohen idhujt, Kur'ani e tregon nëpërmjet përgjigjes së politeistëve: **“...që të afrohem i në afërsi të All-llahut”**.

Këtë ajet Kur'anor Muhamed Ibnul Abdul Vehabi e bartë tek Muslimanët e Mekës dhe të Medinës së kohës së tij (por edhe te muslimanët në përgjithësi), duke i cilësuar se janë idhujtarë me arsyetimin se : “Politeistët nuk kanë besuar se zotëruat (Idhujt) e tyre mund të krijojnë diç, bile ata kanë besuar se Krijuesi është All-llahu”. Abdul Vehabi i ka paralelizuar *ata që bëjnë tevessul (ndërmjetësim) dhe që vizitojnë varreza me politeistët që thonë: “Ne i adhurojmë vetëm që të afrohem i në afërsi të All-llahut”*. Pra i ka krahasuar idhujtarët paraislamik të Mekës me banorët e Mekës dhe të Medinës së kohës së tij për shkak të tevesulit dhe vizitës së varreve.

Pasi që i ka quajtur idhujtar muslimanët dhe i ka shpallur kafirë (mosbesimtarë), kanë filluar ta sulmojnë Mekën dhe Medinën, me fjalë tjera banorët e Mekës dhe Medinës.

Vehabijtë kur kanë shkuar në Medine kanë plaçkitë dhomën në të cilën gjendet varri i Muhamedit a.s. dhe kanë marrë me vete të gjitha gjësendet me vlerë, kanë dashur ta rrënojnë kubën e gjelbër mbi varrin e Muhamedit a.s. por nuk ja kanë arritur qëllimit, vetëm se duhet ditur se edhe sot nëse ju jepet mundësia dëshirojnë ta rrënojnë kubën mbi varrin e Muhamedit a. s. sepse sipas tyre haram është të falet ne xhaminë ku ka varre. Edhe sot Vehabijtë varrin e Muhamedit a.s. brenda xhamisë së Muhamedit a.s. e quajnë dukuri idhujtarie, me fjalë tjera idhujtari dhe insistojnë që të hiqet. Një dijetar i tyre nuk është falur ne xhaminë e Muhamedit a.s.. Kur e kanë pyetur se pse nuk falesh? Është përgjigjur: “Është i ndaluar (haram) namazi në ato xhami ku brenda tyre ka varre!?”.

Në Meke ashtu dhe në Medine Vehabijtë kanë shkaktuar krime që s'mbahen mend. I kanë rrënuar të gjitha shenjat mbi varret e as'habëve (shokëve të Muhamedit a.s).

Muhammed Ali Pasha (me prejardhje Shqiptare) nga Egjipti dërgoi birin tij Tusun Pashën që ti ndal Vehabistët por ishte i pasukseshëm pasi që asnjë prej ushtrisë së tij nuk kthehet në Egjipt. Pastaj e dërgon djalin tjetër të tij, Ibrahim Pashën i cili edhe pse arrin sukses vriten shumë vetë nga të dyja palët. Fitneja e tyre ishte fatkeqësi që e pësuan ithtarët e islamit dhe nga shkaku i tyre është derdhur shumë gjak, është grabitur shumë pasuri dhe me paraqitjen e tyre është shkaktuar dëm i madh.

Në ligjëratat e Vehabijve thuhet se Abdul Vehabi i ka luftua shirkijatet (idhujtarit në fe) dhe bidatet (risitë në fe), ndërsa nuk tregojnë se Vehabijtë i kanë luftua muslimanët pasi që ata i kanë llogaritur si idhujtarë, por e tregojnë vetëm luftimin ndaj objekteve dhe jo të muslimanëve.

Edhe pse shenjat e para të prishjeve të varrezave kanë qenë para lufte, menjëherë pas lufte ka filluar prishja e varrezave dhe e teqeve. Këto ishin shenjat e para të veprimit në praktik të Vehabizmit. Për dallim se përpos prishjes së varrezave dhe teqeve nuk ka ndodhë konflikt luftarak në mes të muslimanëve mirëpo kjo nuk do të thotë se nuk mund të ndodhë nëse u jepet rasti dhe të kenë mundësi.

Lufta Irako-Iraniane

Analitikët kanë thënë se faktor i luftës Irako-Iraniane është faktori naftë, mirëpo ndezës dhe shpërthyes i asaj lufte ka qenë pikërisht ideologjia Vehabiste, duke mos e anashkaluar edhe palën tjetër. Këtë çka po e them e dokumentoj me atë se emërues i përbashkët është po i njëjti:

Shiitët bëjnë tevessul (kërkojnë bekim) prej varrezave dhe tyrbeve.

Vehabijtë i luftojnë me ngulm.

Irani e konsideron veten se e ka rolin udhëheqës në gadishullin arabik.

Vehabijtë e konsiderojnë si betejë vendimtare për të shpëtuar Islamin nga bidati (risi në fe) që kanë bërë shiitët për të shkatërruar Islamin.

Edhe pse burim i shiizmit është Basra dhe Kufa e Irakut, qeveria e Irakut është përkrahur moralisht e financiarisht nga Vehabijtë, e cila në fund

të luftës nuk është ndarë e kënaqur me premtimet e premtuara të Vehabistëve e cila më pastaj kaloi në luftën midis tyre dhe erdhi prapë deri tek gjak-derdhja.

Edhe pse lufta përgjakshme zgjati 8 vite asnjëra nga palët ndërluftuese nuk e arriti fitoren e pakushtëzuar.

Sipas të dhënave jozyrtare lufta vehabo-shiite (Irako-Iraniane) mori jetët e një milion njerëzve përveç dëmit ekonomik ku u shkatërruan shumë qytete dhe fshatra, për rimëkëmbjen e të cilave u nevojitën më pas qindra miliarda dollarë.

Lufta në Siri (v. 2011) vazhdimësi e luftës Irako-Iraniane

Ajo çka po ndodhë në Siri dhe Irak, nuk është asgjë tjetër pos vazhdimësi e veprimeve Vehabiste të shekullit të XVIII kur Abdul Vehhabi e ka bërë kundër banorëve të Mekës dhe Medinës sepse prapë është emëruesi i përbashkët.

Edhe pse ushtria Siriane është sunitë, mirëpo Vehabistët e mbështetin luftën, kundër qeverisë Siriane, pasi që sipas tyre Siria është një shtet që udhëhiqet nga një alevit (fraksion Shiit), Bashar al-Asadin ata e cilësojnë si kafirë, apo idhujtarë e si pasojë Vehabijtë legjitimojnë vrasjen e tij.

Luftën në Siri e quajnë “luftë e drejtë” e sunizmit i cili tregohet si vehabizëm e për pasojë si feja e vërtetë Islame, kundër shiizmit dhe alevizmit e cila duhet të ç’rrënjoset me shpatë, pra luftën e tyre kundër Sirisë e justifikojnë si luftë të sunizmit kundër shiizmit dhe një luftë të shenjtë për mbrojtjen e sunetit, ashtu sikurse më herët e kanë justifikuar luftën e sadam Huseinit ndaj Iranit (Shiizmit) dhe luftën ndaj banorëve të Mekës dhe Medinës.

Ideologjia Vehabiste është e ndërtuar mbi parimin që grupet e “devijuara” brenda Islamit, t’i bëjnë tekfir, apo kafirë, dhe pastaj kërkohen që të vriten dhe këtë pastaj e quajnë “luftë e shenjtë”.

Maksim e Vehabistëve është: *“Nuk rregullohet gjendja e umetit deri sa nuk pastrohet Imani”* këtu e kanë për qëllim luftimin e muslimanëve në emër të legjitimitetit të luftimit të shirkijateve dhe bidateve (të cilat do t’i sqaroj më vonë).

Ndoshta në fillet e para të Vehabizmit kanë vdekur me mijëra njerëz, në luftën Irako Iraniane ka arrit shifra në një milion, mirëpo tani lufta në Siri dhe Irak veç ka marrë jetën e dhjetëra mijërave e ndoshta do të tejkalon shifrën në miliona dhe si rezultat përfundimtar asnjëra palë nuk do të dalë fituese por do të kthehen në pikën zero.

Vehabijtë dhe Tekfiri

Mushrik ka kuptimin e politeistit, kafir ka kuptimin e pabesimtarit. TEKFIKIR do të thotë: akuzim për mosbesim.

Ideja e parë e TEKFIKIRIT fillon prej Havarixhëve, ku sipas këtij fraksioni çdo musliman që kryen një mëkat të madh konsiderohet se ka dalë nga Feja Islame dhe duhet llogaritur për mosbesimtar edhe pse dijetarët janë unikë se mëkati i madh nuk e nxjerrë njeriun nga imani.

Vehabijtë e marrin të drejtën që ta quajnë mushrik atë të cilin dëshirojnë ta luftojnë, po ashtu edhe ta quajnë pabesimtarë atë të cilin dëshirojnë ta sulmojnë, me fjalë tjera e kanë ringjall idenë e TEKFIKIRIT të Havarixhëve.

Sintagma e “ tekfirit” është sintagmë e cila ka shkaktuar dhe shkaktonte kaos të brendshëm dhe i gjithë mundi do të orientohej për luftë ndaj ‘vetvetes’ me vetveten, pra në luftë vëllavrasëse.

Vehabijtë dhe Bidati

Maksimë tjetër e Vehabistëve është se: “Abdul Vehhabi i ka luftuar bidatet”.

E cekëm më lart se Vehabijtë nuk tregojnë se Vehabijtë i kanë luftua ata të cilët sipas pretendimit të tij (tyre) janë quajtur bidat e jo sipas konsensusit të dijetarëve Islam.

Ja disa prej veprimeve të konsideruara bidat nga ana e vehabijve:
- Këndimi i Mevludit është bidat;

- Tesbihi për të vdekurin është bidat;
- Tesbihi pas namazit është bidat;
- Dua e përbashkët pas namazit është bidat;
- Falja e drekës pas namazit të xhumasë është bidat;
- Zinxhiri i bidateve nuk merr fund sa që edhe thënie: “Sadakallahul adhijm” (Zoti e ka thënë të vërtetën) në fund të leximit të Kur’anit e quajnë bidat.

Ata bidatin e quajnë çështje e cila të nxjerr prej feje dhe që është urë e sigurt për në xhehenem sikurse kufri, dhe se vet bidati është më i keq se vet mëkati sepse tek mëkati mëkatari pajtohet me mëkatin e tij ndërsa te Bidatgjija vazhdon të insistoj ende në bidatin e tij dhe se ai duhet të luftohet.

Vehabijtë dhe Taguti

Sipas Vehabijve, në kohën e Ibn Tejmijes në vendet muslimane u paraqit çështja e Tagutit. Ibn Tejmije është ai cili i ka shpjeguar dhe i ka luftuar ata të cilët nuk e mohojnë Tagutin. Ai ka dhënë mund të madh në asgjësimin e këtij problem pra në çështjen e TAGUTIT.

Shekuj më pas, kur shirku(idhujtaria) dhe bidati(risia në fe) ishin me të madhe të përhapura në tokë, dhe kur dalaleti (humbja) dhe xhehli (padituria) ishin rritur, Allahu dërgoi Muhammed ibn AbdulVehabin,të “ripërtij” fenë dhe t’i luftoj ato.

Pas tij Allahu i dërgoi nxënësit e tij, të cilët i sqaruan llojet e ndryshme të tagutave me të cilët muslimanët në kohën e tyre ishin preokupuar.

Ai i cili nuk e mohon tagutin nuk mund të jetë musliman dhe pasuria e tij është haram, kështu që lejohet t’i merret pasuria të vritet dhe t’i merret nderi i tij.

Sikurse Tekfiri dhe bidati ashtu edhe Taguti shkakton kaos të brendshëm dhe i tërë mundi do të orientohej në luftë ndaj “vetvetes” pra me vetveten.

Nga Vehabijtë dëgjohen thëniet si në vazhdim:

- Të punuarit në polici është haram, sepse është Tagut;
- Të punuarit në ushtri është haram sepse është Tagut;

- Të punuarit në administratë është haram sepse është Tagut;
- Të punuarit në prokurori dhe gjykatë është haram sepse është Tagut;
- Të punuarit në sistemin Bankarë është haram sepse është Tagut;
- Të mësuarit në shkolla publike është haram sepse ato shkolla janë shkolla të Tagutit.
- Haramet nuk kanë të ndalur. Sa që edhe zërin e femrës e quajnë haram me fjalë tjera e quajnë është turp, por e vërteta është se zëri i tyre është turp, e jo zëri i femrës.

PIKAT DALLUESE TË VEHABIZMIT

Kishin kaluar pesë shekuj pas Isa a.s. ndërsa njerëzimi jetonte në errësirë, pastaj lindi drita e njerëzimit Muhamedi a.s. i cili zhduki errësirën dhe mbuloi njerëzinë me dritë, mëshirë dhe paqe, pajtoi arabët e përçarë, i unifikoi ata, rregulloi sistemin shoqërorë, largoi injorancën dhe idhujtarinë. Prej kohës së Muhamedit a.s. deri në shek. XVIII islami ishte superfuqi botërore. Çdo kund ku depërtonte islami sillte freski në zemra, qetësim në shpirtra, tolerancë ndërnjerëzore, lumturi, zhvillim kulturorë, ekonomik dhe teknologjik.

Mirëpo, në pjesë e Nexhdit të Arabisë Saudite u paraqit një njeri, i cili solli ide të reja ide të cilat krijojnë urrejtje, përçarje, mostolerancë, ide të cilat ndajnë fëmijët nga prindërit, farefisn nga farefisi dhe shoqërinë nga shoqëria.

Për t'i dalluar idetë e Vehabizmit kam sjell shtatë pika dalluese të ideologjisë së tyre, e ato janë:

Pika e parë:

Dallimi në çështje të akides (besimit).

Ideologjia Vehabiste: Zoti ka formë dhe trup, zë vend dhe hapësirë, dhe se cilësitë e Zotit janë cilësi që zënë vend, ka drejtim, ngrihet dhe zbret, po ashtu ulet. Ibni Tejmije duke qenë në minber ka thënë: Allahu zbret në qiellin e tokës siç zbres unë nga kjo shkallë e minberit në një shkallë më poshtë dhe ka zbrit një shkallë më poshtë.

Ibn Tejmije ka thënë: Zoti i Lartmadhëruar ulet, dhe me vete e ulë edhe Muhamedin, të dërguarin e Tij mbi arsh.

Përderisa:

Ehlu suneti dhe xhemaati: siç tregon Tahaviju se : Kush e cilëson Allahun me kuptim të cilësive të njeriut, ai është pabesimtarë.

Imam Ahmedi ka thënë: Kush beson dhe thotë se Allahu është trup ai është pabesimtarë, po ashtu ka thënë: “Çka do që të mendosh, Allahu është e kundërta e asaj çka mendon”.

Pika e dytë:

Dallimi për Muhamedin s.a.v.s.

Ideologjia Vehabiste është si vijon:

- Kush thotë “O Muhamed” ai është pabesimtarë, sepse thërret të vdekurin e Muhamedi është i vdekur.
- Salavatet me zë pas ezanit, janë bid’at dhe ndalohej.
- Salavatet në namaz janë të ndaluara, bid’at.
- Salavatet me zë pas namazit janë të ndaluara.

Ndërsa sa i përket ehli sunetit dhe xhemaatit:

- Salavatet lejohen pas ezanit edhe me zë edhe pa zë, por më e vlefshme është pa zë, duke mos sjell vendim të prerë për moslejimin me zë, ndërsa Abdul Vehabi e ka mbytur myzinin i cili ka thirrur me zë salavate pas ezanit.

Pika e tretë:

Dallimi rreth çështjes së vizitës së varrit të Muhamedit s.a.v.s

Vehabijtë mendojnë se:

Ndalohej vizita e varrit të pejgamberit s.a.v.s. dhe vizita e bashqes së xhenetit (Revdatu Nebij), po ashtu ndalohej edhe shkurtimi i namazit në atë udhëtim, se udhëtimi i tillë është udhëtim mëkati.

Ndërsa sa i përket ehli sunetit dhe xhemaatit:

Vizita e varrit të pejgamberit s.a.v.s nuk është pjesë përbërëse e Haxhit, por është prej veprave të vlefshme (fadail).

- **Vehabijtë** ndalojnë që të falet namazi në xhami ku ka varre të ndonjë pejgamberi, Evlijae apo shehidi. Kështu që, mendimi i tyre është që sa më shpejt të jetë e mundur të hiqet kupola mbi varrin e Muhamedit s.a.v.s. ose edhe të largohet varri i Muhamedit a.s. nga xhamia e tij.

- **Vehabijtë:** Duke u nisur në parimin se Muhamedi s.a.v.s. nuk e ka festuar ditëlindjen e tij thonë se festimi i ditëlindjes së tij është bid'at, i cili bid'at të shpie në humbje dhe në xhehenem.

Ideologjia Vehabiste është se mishi i cili shtrohet me rastin e manifestimit të ditëlindjes së Muhamedit s.a.v.s. apo të Mevludit është më i keq dhe më haram se mishi i derrit.

Ndërsa:

Në traditën tonë: manifestimi i ditëlindjes së Muhamedit s.a.v.s. është bë që të shtohet dashuria ndaj Muhamedit s.a.v.s. të mësohet jeta e tij, të praktikohet rruga e tij, të mësohen gjeneratat e reja për jetën dhe veprën e Muhamedit s.a.v.s.

Pika e katërt:

Dallimi në festimin e festava.

Vehabijtë ndalojnë manifestimin e ditës së hixhretit të pejgamberit s.a.v.s. të natës së Israsë dhe miraxhit, të natës së beratit, të fitores së Bedrit, bile ndalojnë edhe manifestimin e natës së njëmijë netëve, pra të natës së “Lejletul Kadrit”, sepse manifestimi i këtyre festave është bid'at dhe është në kundërshtim me besimin.

Ndërsa jovehabijtë mendojnë se:

Të gjitha këto manifestime nuk janë ibadete (adhurime) por që përkujtimi i tyre sjell freski dhe përkujtim për zemra, sepse përkujtimi u bënë mirë dhe u sjell dobi besimtarëve.

Tradita e festimit të festave nuk është bë që të bëhet bid'at, të futet diçka e re në fe, por që këto festa të jenë shkak për të mësuar vlerën e këtyre ditëve, të këtyre netëve dhe asnjëherë nuk janë konsideruar se janë pjesë ibadeti (adhurimi).

Pika e pestë:

Të gjithë muslimantë e dinë se shtyllat e islamit janë pesë :

- Të shqiptuarit e shehadetit
- Falja e namazit
- Dhënia e zekatit
- Agjërimi i Ramazanit
- dhe kryerja e haxhit për ata të cilët kanë mundësi.

Mirëpo vehabijtë kanë shtuar edhe shtylla tjera:

- Pantolonat e shkurtra
- Misvakin vazhdimisht në gojë e në duar që të luhet me të si lodër
- Të lëshuarit e mjekrës
- Shtetet Islame janë shtete të pabesimit.

Ndërsa:

Shtyllat e Islamit, janë shtylla të cilat i ka përmend Muhamedi s.a.v.s ndërsa sa i përket: pantallonave të shkurtra, misvakut, të lëshuarit të mjekrës, këto janë çështje për të cilat dijetarët islam e kanë dhënë vlerësimin e tyre, por jo duke i kategorizuar ashtu siç mendojnë vehabijtë.

Pika e gjashtë:

Dallimi në konceptin e të pranuarit të medhhebeve.

Vehabijtë jo vetëm se nuk i pranojnë katër medhhebet, por pasimin e medhhebeve e llogaritin “shirk” (idhujtari). Nga kjo pasimin e medh’hebit Hanefij tek ne e konsiderojnë idhujtari (shirk).

Ndërsa:

Ne i takojmë medhhebit Hanefij: dhe të parët tanë e kanë mësuar dhe e kanë praktikuar këtë medhheb, duke i pranuar edhe medhhebet tjera, por që medhhebet tjera zbatohen në vendet tjera pasi që edhe të parët e vendeve të tyre i kanë mësuar ato medhhebe në vendet e tyre.

Bazuar në këtë shumë veprime si në namaz, agjërim, dhe haxh jo vetëm që nuk i pranojnë por i konsiderojnë bid’ate, shprehjet e tyre janë: bid’at, kufr dhe shirk, nevojë e panevojë.

Krerët e BIK-ut kanë filluar në disa raste të thonë se ka filluar një qasje pak më ndryshe, por e vërteta është se është krejtësisht ndryshe në koncept, sepse pasimi i medh'hebit Hanefij, apo edhe të ndonjë medhhebi tjetër sipas vehabive është bid'at.

Pika e shtatë:

Prijësi i Vehabijve, Abdul Vehabi ka thënë:

“Kush pranon ftesën tonë, atij i takon çka është e jona, dhe çka është e jona është e tij, e kush nuk pranon ftesën tonë ai është pabesimtar dhe lejohet të vritet”.

Ndërsa:

Selefu Salih: është i pastër nga mendimet e ideologjisë së Abdul Vehabit, i cili është veçuar, është ndarë nga programi i Selefu Salih.

Të parët tanë kanë jetuar në paqe, të lumtur dhe në tolerancë me myslimanët dhe me jo myslimanët dhe këtë tolerancë na kanë trashëguar deri më sot.

Sa më shumë që do të paraqiten dhe do të përhapen idetë vehabiste, aq më i vogël do të jetë numri i tyre, sepse vehabijtë mbështillen nën termin e selefizmit ndërsa Selefu Salih është i pastër ndaj veprimeve të tyre.

DIALOG I IMAGJINUAR NË MES TË PROFESORIT VEHABIST DHE STUDENTIT VEHABIST

Babai tërë jetën e tij kishte ëndërruar që fëmija i tij të shkollohej në Medinen e ndriçuar. Në vendin ku kishte jetuar Muhamedi a.s., në vendin ku kishin jetuar sehabet. Erdhi momenti dhe djali e kreu medresenë, i erdh edhe lajmi se djali ishte regjistruar në Universitetin e Medines. Me mallëngjim e dërgoi djalin në Medinen e ndriçuar.

Pasi i përfundon djali studimet, i bënë gati rrobat për tu kthyer në vendlindje, por para se të përshëndetet e zhvillon një dialog me shejhun e tij Vehabist:

Shejhu Vehabist: Tani i ke përfunduar studimet. Kur të kthehesh në vendin tënd thuaj: “**Ne jemi ehlus suneti vel xhemati.**”, “**Ne thërrasim në TEVHID.**”, “**Ne jemi kundër shirkut dhe bidatit.**”, “**Ne jemi grupi i shpëtuar.**” dhe “**vetëm menhexhi (planprogrami) i ynë është i drejtë.**”

Studenti Vehabist: Gëzohet dhe e tund kokën në shenjë pohimi (i përulet) *(Edhe pse nuk është e argumentuar që Muhamedi a.s. e ka tundur kokën në shenjë miratimi apo pranimit gjatë një bisede me ndonjërin prej sehabeve. Por shejhu nuk e qortoi për një veprim të tillë. Edhe pse nuk ka argument që kështu të ketë vepruar Muhamedi a.s.).*

Shejhu Vehabist: Pasi që të kthehesh në vendlindje do ta fillosh punën si Dai (thirrës islam).

Studenti Vehabist: Jo, jo. Pasi që të kthehem në vendlindje do ta filloj punën si imam (hoxhë) dhemenjëherë pasi që ta pranoj detyrën mund të ndodh ndonjë rast vdekjeje dhe do të më duhet t’ia fali namazin e xhenazes edhe atij i cili nuk është falur gjatë jetës së tij.

Shejhu Vehabist: Namazin e xhenazes mos ja fal atij i cili nuk ka falur namaz gjatë tërë jetës së tij.

Studenti Vehabist: Por, nëse është babai ose nëna ime.

Shejhu Vehabist: Edhe nëse është babai ose nëna jote.

Studenti Vehabist: Po kështu kanë vepruar djemtë e komunistëve. Kur i tërë xhemati ia falte namazin e xhenazes babasë së tij, ata ndaleshin para derës së xhamisë dhe nuk hynin në xhami.

Shejhu Vehabist: Po, pasi që nuk është falur vet sa ka qenë gjallë, nuk ka se si ti falet namazi i xhenazes pasi që të ketë vdekur.

Studenti Vehabist: Pastaj pas shtatë ditëve do të thirrem të këndoj *mevlud*.

Shejhu Vehabist: Po, si të këndohet mevlud me rastin e vdekjes së familjarit. Kjo është *bidat*.

Studenti Vehabist: Por, ata këndojnë mevlud edhe me rastin e ditëlindjes së Muhamedit a.s..

Shejhu Vehabist: Jo, jo! Nuk lejohet të këndohet mevlud, sepse aty kërcejnë, pinë alkool dhe *këndojnë salavate me xhematë*.

Studenti Vehabist: Jo, jo shejh, alkool nuk pinë. Por, shërbehet ushqim dhe ëmbëlsira. Kurse në mes të Mevludit ngrihen në këmbë si shenjë respekti ndaj Muhamedit a.s..

Shejhu Vehabist: Po ata qenkan duke e adhuruar Muhamedin a.s., ndërsa Muhamedi a.s. ka vdekur dhe kjo është e ndaluar.

Studenti Vehabist: Ata gjatë këndimit të mevludit këndojnë salavate për Muhamedin a.s. me xhemat.

Shejhu Vehabist: Si është e mundur që këndojnë salavate me xhematë (në kor) për Muhamedin a.s..

Studenti Vehabist: Salavatet janë të përmendura në Kur'an: **“Vërtetë Allahu dhe melaqet dërgojnë salavate për pejgamberin. O ju të cilët keni besuar, dërgoni salavate për të...”** (El-Ahzab)

Shejhu Vehabist: Por nuk përmendet këndimi i salavateve në Mevlud.

Studenti Vehabist: Po edhe në mënyrë individuale muezini këndon salavate pas ezanit të çdo namazi dhe pas ezanit të namazit të xhumasë.

Shejhu Vehabist: Po edhe në mënyrë individuale pas ezanit është e ndaluar sepse ajeti nuk e përmend se salavatet këndohen pas çdo ezani dhe pas ezanit të namazit të xhumasë.

Studenti Vehabist: I nderuari shejh, po si të veprojmë unë sepse tek ne kur ta falin namazin e farzit ngrihen dhe e falin sunetin menjëherë.

Shejhu Vehabist: Kur ta vazhdojmë faljen e sunetit pas faljes së farzit, ti rri ulur, e kur të ulen ata, ti ngrihu dhe fale sunetin sepse **nëse e ngjall një**

sunet të Muhamedit a.s. ti do të hysh në xhenet. E sunet është që menjëherë pas farzit t'i bësh tesbihët dhe atë vetmas, e pastaj të ngrihesh dhe ta falësh sunetin.

Studenti Vehabist: Por kështu unë do të shkaktoja çrregullim në rendin dhe rregullat e xhamisë, sepse tek ne ka rregull dhe qetësi shpirtërore deri sa xhemati është në xhami.

Shejhu Vehabist: Të falësh sunetin menjëherë pas farzit është bidat dhe ti nuk je duke krijuar çrregullim, janë duke krijuar çrregullim ata të cilët e falin namazin sunet menjëherë pas namazit farz.

Studenti Vehabist: I nderuari Shejh. Pas namazit do të më duhet që të bëjë tesbihin me xhematë.

Shejhu Vehabist: Tesbihi së bashku me xhematë është bidat dhe **çdo bidat është humbje dhe çdo humbje të shpie në zjarr të xhehenemit** dhe tesbihi me xhemat është *haram*.

Studenti Vehabist: Po edhe duanë në fund të namazit e bëjnë së bashku.

Shejhu Vehabist: Kjo është bidat.

Studenti Vehabist: Gjatë muajit të Ramazanit, pas jacisë i falin edhe nga 20 rekate namaz të teravisë.

Shejhu Vehabist: Po kjo është e ndaluar dhe bidat, sepse duhet të falen vetëm 8 rekate.

Studenti Vehabist: Po namazi i natës prej 8 rekateve me xhemat a nuk është bidat, sikurse teravitë, dhikri dhe tesbihi me xhemat pas namazit?

Shejhu Vehabist: Namazi i natës e zëvendëson namazin e teravisë, se teravia me xhemat është bidat.

Studenti Vehabist: Por, në Qaben e madhëruar dhe këtu në Medinen e ndriçuar i falin nga 20 rekate të namazit të teravive, kjo a nuk është bidat?

Shejhu Vehabist: Ti mos fol për Mekën dhe Medinen, se në xhamitë tjera përpos Mekes dhe Medines i falin nga 8 rekate dhe ti mos fal teravi por vetëm 8 rekate namaz nate (jo teravi).

Studenti Vehabist: I nderuari shejh, tek ne ka teqe dhe njerëzit po i vizitojnë varret dhe teqet.

Shejhu Vehabist: Kjo është e ndaluar, kjo është *shirk* (idhujtari) dhe këto varre dhe teqe duhet rrënuar.

Studenti Vehabist: Por, këtu në Medine pas kryerjes së haxhit po vijnë dhe po e vizitojnë xhaminë e Muhamedit a.s. dhe gjatë vizitës po shkojnë edhe te varri i Muhamedit a.s., a nuk është edhe kjo teqe dhe a duhet të priset edhe kjo, pra kubeja e gjelbër mbi varrin e Muhamedit a.s.?

Shejhu Vehabist: Ne i kemi prishur mijëra kube mbi varre, i kemi prishur mijëra teqe dhe na ka mbetur vetëm kjo kube por edhe kjo duhet të priset, sepse kubeja e gjelbër mbi varre quhet teqe dhe duhet të hiqet.

Studenti Vehabist: Por prapë se prapë mbesin varret (varri i Muhamedit a.s., i Ebu Bekrit r.a., dhe i Omerit r.a., të cilat gjenden brenda xhamisë së Pejgamberit s.a.v.s.).

Shejhu Vehabist: Po edhe kjo duhet të bëhet, pra duhet të hiqet varri i Muhamedit a.s. nga xhamia e Muhamedit a.s., pasi është shirk sepse po e madhërojnë varrin dhe për të mos e lejuar shirkun duhet ta heqim edhe varrin e Muhamedit a.s. nga xhamia e Muhamedit a.s..

Studenti Vehabist: Ne jemi vend i varfër dhe shumë studentë janë të zgjuar dhe nuk kanë mjete financiare të shkollohen.

Shejhu Vehabist: Ti kur të shkosh në vendlindje do të japësh bursa, këto mjete do të sigurohen nga zekati për student.

Studenti Vehabist: Të japim bursa?! Por, për fakultetin ekonomik a mund të jepet bursa?

Shejhu Vehabist: Jepni bursa për dituri, se studentët kanë nevojë për bursa.

Studenti Vehabist: Pasi ta përfundoj fakultetin, ai i cili e ka kryer fakultetin ekonomik, duhet të punoj në Bankë komerciale apo depozitive.

Shejhu Vehabist: Ti thuaj atij (të cilin e ke financuar të kryej fakultetin ekonomik) e ke të ndaluar të punosh në Banka sepse është haram *sikurse të ketë bërë prostitucion me nënën e vet*.

Studenti Vehabist: Po nëse punon në ndonjë firmë apo punë tjetër.

Shejhu Vehabist: Po edhe kjo është haram sepse ato firma kanë marrë mjete financiare me kamatë në banka komerciale apo depozitive.

Studenti Vehabist: Po a të japim bursa për ata të cilët janë në fakultetin juridik?

Shejhu Vehabist: Jepni bursa se studentët kanë nevojë për bursa.

Studenti Vehabist: Kur ta përfundojnë duhet të punojnë në gjyqe laike.

Shejhu Vehabist: Pasi ta përfundojnë fakultetin juridik, ti thua ju se e kanë të ndaluar të punojnë në gjykatë dhe në prokurori sepse ai gjykon me ligj tjetër pos ligjit të Allahut.

Studenti Vehabist: Por, ne jetojmë në shtet laik.

Shejhu Vehabist: Po edhe shteti laik është haram dhe është bidat.

Studenti Vehabist: Po kjo po i bie se në çdo çështje duhet t'i kundërshtoj dhe se çdo gjë qenka bidat sepse ne jetojmë në shtet laik dhe kjo po i bie se ne po jetojmë në bidat (shtet laik).

Shejhu Vehabist: Bidati është më i keq se kufri sepse për kufrin shejtani i thotë se ***ti je pajtuar me pabesimin tënd*** dhe e lë të lirë, ndërsa shejtani i thotë bidatgjijt: ***vazhdo edhe më tutje se e ke me të drejtë, ti duhesh ta forcosh bidatin tënd.***

Studenti Vehabist: Po kjo po i bie se në çdo çështje duhet t'i kundërshtoj dhe që të mos jem prej tyre (popullit tim).

Shejhu Vehabist: Po, ti duhet ta lëshosh mjekrën dhe të dallohesh prej tyre, sepse ***kush i përngjet një populli, ai është prej tyre*** e kështu që ti nuk je prej tyre dhe ne duhet të dallohemi prej tyre sepse vetëm ne jemi grupi i shpëtuar dhe ky është qëllimi ynë, ky është menhexhi (planprogrami) ynë, në mënyrë që ta pastrojmë fenë, sepse kush e pastron fenë hyn në xhenet. Vetëm menhexhi (planprogrami) ynë është i drejtë. Ti vazhdo dhe bëj daëve. Kështu kemi vepruar në të gjitha vendet islame të cilat kanë qenë vende socialiste. Kështu kemi vepruar me Algjerinë dhe kemi vazhduar me Afganistanin dhe Çeçeninë. Kështu kemi vepruar me *pranverën Arabe* në Egjipt dhe e kemi vazhduar me Sirinë dhe Irakun. Në bazë të kësaj *ideologjie* ne bëjmë përçarje dhe vazhdimisht themi se ***“është e ndaluar dhe haram përçarja në mesin e muslimanëve”***. Për shkak të bidatit dhe shirkut të tyre ne vrasim bidatgjinj, ua shkatërrojmë shtëpitë, lagjet dhe qytetet sepse i kanë mbushur me bidate dhe janë bërë shtete laike dhe kështu neve na është lejuar ***gjaku i tyre, pasuria e tyre dhe nderi i tyre.***

KAPITULLI I KATËRT

NOCIONI I “FETVASË” DHE “MUFTISË”, DHE E DREJTA E GRUAS PËR TË DHËNË “FETVA” DHE PËR TË QENË “MUFTI”

Fetva është term i cili ka për qëllim gjykimin juridik, me fjalë tjera është term i cili ka për qëllim vendimin legjislativ të cilin e jep juristi i specializuar në Islam për një çështje të caktuar.

Fetvaja zë vend shumë të rëndësishëm në sheriatin Islam dhe ka vlerë të madhe në jetën e besimtarit.

Zakonisht fetvaja i jepet një personi i cili bënë pyetje për të zgjidhur një çështje të fikhut, sepse fikhu Islam përfshinë të gjitha çështjet për të cilat ka nevojë njeriu në këtë botë dhe në botën tjetër pra është çështje e të specializuarit për një çështje fetare duke argumentuar me argumente.

Çdo dijetarit që i parashtrohet një pyetje për çështje të legjislacionit Islam dhe ai e di, e ka për detyrë të përgjigjet, nëse ai pa kurrfarë arsye nuk jep përgjigje ai është mëkatar.

Fetvaja ka të bëjë vetëm me çështjet të cilat nuk janë të precizuara në Kur'an.

Personi i specializuar për të dhënë përgjigje quhet **Mufti**.

Muftiu nuk guxon të flas sipas tekeve të tija, por përgjigja e tij duhet të jetë në përputhshmëri të plotë me rregullat themelore, në të cilat rregulla bazë mbështetet dhënia e fetvasë sepse Muftiu i shpjegon rregullat e fesë. Nga kjo rezulton se Mufti nuk mund të bëhet çdokush. Për këtë arsye dijetarët Islam i kanë parapa kushtet për të pasur të drejt të jepet fetva dhe për të qenë Mufti, të cilat kushte i kanë nda në kushte të kuptimit shkencorë dhe në kushte të personit fizik .

Kushtet në kuptimin shkencorë janë:

- Të ketë njohuri për Kur'anin;
- Të ketë njohuri për sunetin e Muhamedit s.av.s.;
- Të ketë njohuri për Ixhmain;
- Të jetë njohës i mirë i analogjisë;
- Të jetë ekspert i lëmit të Usuli Fikhut;
- Të njohë gjuhën arabe;
- dhe t'i njeh qëllimet e përgjithshme të sheriatit.

Kushtet e personit fizik të muftisë janë:

- Të jetë besimtar;
- Të jetë i moshës madhore;
- Të jetë i drejtë;
- Të jetë i drejtë dhe të jetë i mençur; që do të thotë t'i kuptoj gjërat drejt.

Nga të gjitha kushtet të cilat janë të parapara nuk është e paraparë që mufti të jetë vetëm mashkulli, por ka të drejt edhe femra.

Gjatë tërë historisë Islame femra ka qenë aktive në lëmenjtë shkencore, e po ashtu edhe në shkencën e fikhut, ajo ka punuar në të gjitha veprimtaritë e jetës, ka qenë juriste me fjalë tjera ka qenë mufti sepse ka dhënë fetva sepse duhet ditur se nocioni mufti nuk ka të bëjë me pozitën udhëheqëse por ka të bëjë me legalitetin për të dhënë mendim të specializuar në sheriatin Islam. Gjithashtu nuk ka argument të qartë në sheriatin Islam për të mos qenë femra prokurore.

Në Suretu Tevbe Zoti i Lartmadhëruar edhe besimtarët por edhe besimtaret i ka barazua në çështjen e urdhërimit në të mirë dhe në të larguarit nga e keqja, ku bënë pjesë edhe çështja e fetvasë. Në këtë sure thuhet:

“Besimtarët dhe besimtaret janë dashamirë të njëri-tjetrit, urdhërojnë për të mirë, e ndalojnë nga e keqja, e falin namazin dhe e japin zekatin, respektojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij. Të tillët do ti mëshirojë Allahu. Allahu është ngadhënjyes, i Urtë.” (Et Tevbe, 71)

Kur'ani famëlartë ka regjistruar raste ku femra ka pasur mendime të përkryera, ku ka pasur mendime të drejta, sa për ilustrim po përmendim Suretul Muxhadele ku fillon ajeti i parë i kësaj sure në këtë mënyrë:

“Vërtet, Allahu dëgjoi fjalët e saj e cila bisedoi me ty lidhur me burrin e vet, që u ankua te Allahu, prandaj Allahu ka dëgjuar bisedën tuaj. Allahu dëgjon çdo bisedë dhe sheh çdo punë.” (El Muxhadele, 1)

Ky ajet dhe ajetet në vazhdim kanë anulua zakonet e kohës së injorancës dhe këshillojnë për sjellje njerëzore ndaj bashkëshorteve e shkak ka qenë femra.

Ka raste ku edhe Muhamedi s.av.s është pajtuar, apo e ka marrë mendimin e drejtë të femrës. Gjatë marrëveshjes së Hudejbijës Ummi Seleme ka dhënë mendim të cilin e ka pranuar Muhamedi a.s., kështu që ai mendim (fetva) i ka shpëtuar edhe sehabet që të mos vepronin në kundërshtim me sheriatin. Pasi që Pejgamberi a.s e kishte nënshkruar marrëveshjen, ka dalë para sehabeve dhe u ka thënë: “Ngrihuni, preni Kurbanet dhe rruani kokat e juaja”. Nuk është ngritur asnjëri prej vendit deri sa u ka thënë tri herë. Pastaj ka hyrë në tendën e Ummi Selemes dhe i ka tregua se nuk e ka dëgjuar asnjëri.

Ummi Seleme e jep mendimin e saj dhe i thotë: “Dil ti i pari mos i fol askujt asnjë fjalë shko dhe preje deven tënde kurban dhe rruaje kokën.”

Muhamedi a.s. veproi ashtu, (e pranoi mendimin e saj) kur a kanë pa tjerët pastaj edhe ata kanë vepruar ashtu.

Urvete bin Zubejri tregon për Aishen r.a.: Nuk kam parë grua më të ditur në mjekësi, as në fikh, as në poezi se Aishja r.a., shkonim te ajo dhe ajo me diturinë e saj na i vërtetonte.

Edhe Muhamedi a.s. i ka udhëzuar shokët që të merrnin dituri nga Aishja r.a. sepse shumë çështje të fikhut sidomos çështjet të cilat kanë të bëjnë me fikhun e grave janë marrë pikërisht nga ajo.

Në historinë Islame është i njohur rasti kur gruaja e ka kundërshtuar në mendim Omerin r.a. derisa ai ishte Halife i myslimanëve, ndërsa Omeri para masës së gjerë ka thënë: “Mendim të drejt ka dhënë gruaja, ndërsa Omeri ka gabuar”.

Duke u nisur nga fakti se iftaja (Fetva) dhe institucioni mufti nuk është pozitë udhëheqëse, por institucion që jep përgjigje për çështje të fesë, vijmë në përfundim se femra mund të jetë mufti, përderisa sa i përket hadithit të cilin e transmeton Buhariu nga Ebu Bekri Merfuë: **“Nuk shpëton populli të cilin e udhëheq femra”** ka të bëjë me pozitën e udhëheqësit kryesor për të gjitha çështjet e umetit, pra për udhëheqjen dhe të drejtuarit

absolut për të gjitha çështjet e umetit si: ato ekonomike, politike, ushtarake etj., e assesi nuk ka të bëjë me atë se nuk ka të drejt të jetë mufti dhe të jep fetva. Ndërsa, sa përket disa çështjeve tjera nuk ka pengesë të jetë udhëheqëse si p.sh. të jetë drejtore e arsimit, ministre e një ministrie, edukatore, thirrëse në rrugë të Allahut, juriste (Mufti) etj. Për këto ka të drejt udhëheqjeje me ixhmaë (Mendim unanim i të gjithë ekspertëve Islam). Këto të drejta i ka pasur brez pas brezi deri në ditët e sodit.

SISTEMI ISLAM SISTEM I MESATARES

Njeriu është qenie shoqërore nga natyrshmëria e tij, ai duhet të jetojë në bashkësi, nga kjo fillojnë raportet ndërs shoqërore, këto raporte fillojnë prej raporteve në familje duke vazhduar në ato sociale, ekonomike dhe politike.

Historia njih sistemën skllavo-pronar prej sistemeve të para, e pastaj atë feudal për të vazhduar sistemi kapitalist e në fund edhe sistemi socialist.

Me një fjalë, kemi kapitalizmin në një anë dhe socializmin në anën tjetër që ndryshe quhen të djathtët dhe të majtët, mirëpo në mes tyre qëndron mesi, e mesi i tyre në aspekt ekonomik, për të mos thënë në aspekt ideologjik, është islami. Kjo nga shkak se si sistemi socialist ashtu edhe ai kapitalist kanë për qëllim materien dhe kanë qasje të njëjtë në këtë çështje për dallim të islamit i cili e njih edhe anën materiale po ashtu edhe atë shpirtërore, ndërsa edhe socializmi edhe kapitalizmi e njohin vetëm anën materiale.

Kapitalizmi është i ndërtuar mbi bazën e materializmit që do të thotë se i kushton vëmendje të veçantë faktorëve ekonomik të cilat sjellin kapitalin.

Në kapitalizëm njeriu konsiderohet si një shtazë ekonomike.

Kapitalizmi ka për qëllim realizimin e fitimit të skajshëm, pa marrë parasysh mënyrën e fitimit.

Sistemi Kapitalist qëllim kryesor ka ruajtjen e interesit kapitalist pra të individit, kështu që i jep përparësi individit ndaj shoqërisë, për këtë arsye i jep liri absolute në pronësi dhe në aktivitet ekonomik.

Sistemit kapitalist i kushtonte rëndësi të posaçme individit dhe shikon interesin individual, e që pastaj në mënyrë indirekte të realizohet interesi shoqërorë, pasi që shoqëria nuk është asgjë tjetër përpos që përbëhet prej individëve të cilët formojnë shoqërinë.

Prej faktorëve në të cilët është ngritur ky sistem është kamata e cila me kalimin e kohës jo vetëm që ka shkatërruar individin por edhe shoqërinë, ndërsa për të shpëtuar nga vetshkatërrimi edhe shoqëria edhe individit duhet të largohet kamata nga skena ekonomike edhe pse ky element ishte mjet i zhvillimit të tij.

E kundërta e kapitalizmit është socializmi, siç e cekëm më lartë sikurse e para ashtu edhe dyta qëndron në baza materiale.

Si baba i socializmit është i njohur Marks, ai së bashku me Engelsin nxorën programin e komunizmit në vitin 1848.

Sipas tyre socializmi është rezultat i luftës në mes të pushtuesit dhe të pushtuarit, me fjalë tjera luftë në mes klasës kapitaliste dhe klasës punëtore, mirëpo kjo luftë duhet të përfundoj me fitimin e klasës punëtore e cila do ta eliminonte klasën kapitaliste dhe do të formonte shtetin e proletariatit i cili do të ishte shtet totalitar pa klasa mirëpo ai shtet bëhet i fuqishëm dhe vendos regjim të plotë. Sipas këtij sistemi pas një kohe edhe shteti do të zhduket.

Specifikë e socializmit është pronësia shtetërore dhe ndalimi i pronësisë private.

Sistemi socialist qëllimin kryesor e sheh interesin shoqëror, në rend të parë i jep përparësi shoqërisë e pastaj individit. Duke u nisur nga ky parim shteti ndërhyr në çdo aktivitet ekonomik dhe e ndalon pronësinë individuale në mjete të prodhimit.

Ky sistem arsyetohet me atë se duke u përkujdesur vetëm në interesin shoqërorë, në mënyrë indirekte realizohet edhe interesi individual sepse individi është pjesë e tërësisë së shoqërisë. Individi ka vlerë atëherë kur shoqëria ka vlerë. Me kalimin e kohës, pronësia shtetërore ekonomike ndikoi që ky sistem të kaloj në sistem burokracie.

Sistemi ekonomik islam është sistem i bashkdyzimit socialist dhe kapitalist

Feja Islame si sistem ekonomik të cilin e ka parapa Krijuesi (Allahu), është i përshtatshëm për të gjitha vendet, për të gjitha kohët dhe për çdo çështje, sepse parasheh baraspeshimin në çdo aspekt.

Feja islame parasheh:

baraspeshimin material me atë shpirtëror;

baraspeshimin individual me atë shoqëror;

baraspeshimin ekonomik, ku shihet liria relative në realizimin e interesit edhe të individit por edhe të shoqërisë në të njëjtën kohë paralelisht dhe reciprokisht.

Islami nuk lejon themelimin e ndonjë diktature të ndonjë klase si në kapitalizëm, por gjithashtu nuk lejon themelimin e ndonjë shteti totalitar si

në socializëm. Ekonomia Islame qëndron në mes të interesit individual dhe atij të përgjithshëm.

Ekonomia islame është ekonomi e anës ekonomike dhe morale, synon ngritjen materiale dhe shpirtërore.

Islami e ruan natyrshmërinë e njeriut, ai e pranon të drejtën për të pasur pasuri siç e thekson Zoti i Lartmadhëruar: **“Dhe ai është që shumë e do pasurinë.”** (el Adijat, 7).

Mesatarja e Islamit në krahasim me Socializmin dhe kapitalizmin qëndron edhe në atë se socializmi dhe kapitalizmi qëndron mbi bazën materiale ndërsa Islami mbi bazën morale dhe materiale.

Feja Islame nuk është vetëm fe e besimit por është sistem i organizimit shoqëror politik dhe ekonomik. Politika ekonomike islame angazhohet me ruajtjen e interesit shoqëror dhe individual, me ruajtjen e plotësisht të nevojave materiale dhe shpirtërore.

Njeriu ka nevoja materiale pa të cilat nuk mund ta zhvillojë normalisht jetën si nevoja për ushqim, veshmbathje dhe vendstrehim. Zoti i Lartmadhëruar kur e ka zbritur njeriun e parë Ademin a.s. i ka siguruar ushqimin, veshmbathjen dhe vendstrehimin ku thotë: **“Ti (O Adem dhe pasardhësit tu) nuk do të kesh uri dhe nuk do të mbetesh pa vendstrehim dhe pa veshmbathje.”** (TaHa).

Si socializmi ashtu edhe kapitalizmi shikojnë vetëm anën e kësaj bote ndërsa bazat e ekonomisë islame janë që njeriu të fitoj lumturi edhe në këtë botë edhe në botën tjetër.

Sistemi ekonomik islam nuk parasheh as individin si çështje të organizimit ekonomik, e as shoqërinë si çështje të organizimit ekonomik, por në të njëjtën kohë, sistemi ekonomik islam bënë bashkimin e të dy sistemeve ekonomike, sistemin ekonomik kapitalist dhe sistemin ekonomik socialist. Nëse bie ndesh interesi individual me interesin shoqëror i jepet përparësi interesit shoqëror. Është rregull e fikhut islam se ***dëmi individual realizohet për të mënjeluar dëmin e përgjithshëm.***

Në Islam vlera e njeriut është në bazë të besimit dhe devotshmërisë së tij dhe nuk ulet vlera e njeriut nga asnjë punë përderisa ajo punë është e lejuar.

Përderisa Sistemi social bashkëkohor është produkt i konfliktit të interesave të dy klasave, klasës kapitaliste dhe klasës punëtore, dhe krizave të cilat shkurtuan revolucionin e punëtorëve në realizimin e të drejtave të tyre, Feja Islame këto çështje i ka determinua para 1400 vitesh.

Në pronësi Islami parasheh mesataren sepse nuk ndalohet pronësia private e pasurisë dhe ajo nuk vendos të gjitha mjetet e prodhimit, shpërndarjes dhe këmbimit në duart e shtetit. Islami mbështet pronësinë publike për të mirën e përgjithshme të popullsisë por përkrah edhe të drejtën e pronësisë private. Në islam pasuria i takon vetëm Allahut, ndërsa njeriu konsiderohet si përgjegjës apo si përkujdesje e dhënë nga Allahu e cila është e ndërlidhur ngushtë me urdhëresat dhe ndalesat e Allahut. Thotë Zoti i Lartëmadhëruar: **“...dhe jepuni nga pasuria që ua ka dhënë Allahu juve.” (en-Nur 33).**

Në islam pasuria është mjet dhe nuk është qëllim, pasuria është mjet për përfitim dhe ndërtim të tokës ngase ajo është e destinuar nga Allahu për këtë qëllim por nuk është qëllim i jetës dhe kurrësi nuk bënë të pengoj njeriun nga adhurimi për Zotin nga shkakun se jeta ka vlera më të mëdha se pasuria. Njeriu ha për të jetuar dhe nuk jeton për të ngrënë. Punëtori krahas përfitimit material duhet të kërkojë edhe shpërblimin e botës tjetër. Zoti i Lartëmadhëruar thotë: **“E kush punon ndonjë të mirë që peshon sa grimca e atomit do ta gjej dhe kush punon ndonjë të keqe sa grimca e atomit do ta gjejë.” (Zelzele, 7, 8).**

Puna në islam konsiderohet një prej kushteve për të arritur kënaqësinë e Allahut.

Edhe pse Allahu është Pronar i vërtetë i pasurisë, Allahu ua ka përshkruar robërve të tij si nder dhe begati për ta por në të njëjtën kohë sprovë dhe përgjegjësi. Islami të drejtën individuale të pronësisë e konsideron të shenjtë siç thotë Muhamedi a.s.: **“Vërtetë gjaqet tuaja, pasuritë tuaja janë të shenjta ashtu siç është e shenjtë kjo ditë në këtë majë dhe në këtë vend.”.**

Pronësia në Islam është e kushtëzuar dhe e lidhur ngushtë me urdhrat e Allahut. Thotë Zoti i Lartëmadhëruar: **“O ju të cilët keni besuar jepini nga më e mira e asaj që fituat dhe nga ajo që u dhamë prej tokës.” (el-Bekare, 267).**

Sa i përket shtetit ai duhet të kontrollohet nga një qeveri demokratike ashtu siç është urdhëruar Muhamedi a.s.: **“Dhe konsultohu për çdo çështje.”.**

Barazia ekonomike nuk është parim në Islam sepse njerëzit ndryshojnë në aftësi të përfitimit dhe shpërndarjes së pasurisë. Dallimi në

mes njerëzve është rregull hyjnor dhe nuk mund të eliminohet në mënyrë artificiale. Ajo çka duhet të jetë e barabartë është sigurimi i të drejtave themelore dhe liria e barabartë në realizimin e fitimit e jo të posedimit. Shihet se në këtë çështje feja islame qëndron në mesin e artë.

Islami nuk pranon ndarjen e pasurisë në mënyrë të barabartë të të gjithë njerëzit, por parasheh që njerëzit të shpërblehen në bazë të punës dhe të angazhimit sepse në këtë mënyrë realizohet barazia dhe drejtësia në shoqëri e jo në bazë të ndonjë forme tjetër, sepse dallimet ekonomike në mes njerëzve nuk janë asgjë tjetër pos sprovë me të cilën Zoti i sprovon njerëzit se si duhet vepruar në gjendje të mirë ekonomike dhe në gjendje të vështirë ekonomike.

Specifikë tjetër e islamit është se është e themeluar mbi baza të moralit, mbi bazat e dhembshurisë, dashurisë dhe bashkëpunimit të ndërsjellë. Thotë Zoti i Lartmadhëruar: **“Ndihmohuni në mes vete në të mira dhe në të mbara e jo në mëkate dhe armiqësi.”** (el-Maide, 2).

Specifikë tjetër e ekonomisë islame është maturia apo mesatarja edhe në shpenzimin e pasurisë. Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Hani dhe pini e mos e teproni, pse Ai (Allahu) nuk i do ata që e teprojnë.”** (el-Earaf, 31). Kjo sa i përket gjërave të lejuara, ndërsa sa i përket gjërave të ndaluara qoftë pak apo shumë është e ndaluar.

Parimi më i rëndësishëm i ekonomisë Islame është sigurimi shoqëror. Kjo e drejtë është e drejt ndaj Allahut, sepse në Sheriatin Islam të drejtat ndahen në të drejtat ndaj Allahut, të drejtat ndaj të tjerëve dhe në të drejtat të përbashkëta e duhet ditur se sigurimi shoqëror i takon të drejtave që kanë të bëjnë me të drejtat ndaj Allahut.

Sigurimin ndaj të tjerëve Islami e ka paraparë pjesë përbërëse të vetën. Thotë Zoti i Lartmadhëruar: **“A nuk e sheh se ai i cili përgënjeshtroi fenë, është ai i cili largon jetimin dhe nuk angazhohet për të ushqyer të varfrin.”** (El. Maide, 1,3).

Nxitjen në ndihmën ndaj të varfërve Islami e parasheh nëpërmjet shpërblimit të cilin e ka njeriu në dhënien e Zekatit. Zekati është i destinuar për kategori të ndryshme e ato janë: kategoria e të varfërve: kategoria e të ngratëve; kategoria e punonjëseve për mbledhjen dhe për shpërndarjen e zekatit; kategoria për përfitimin e zemrave; kategoria për lirimin nga robëria; kategoria për të falimentuarit nga borxhet e tepërta dhe kategoria në rrugë të Allahut (këto kategori janë të përmendura në Suretu Tevbe, 60).

Nëse nuk mjafton zekati atëherë kërkesat e tij përmbushen nga burimet tjera të arkës shtetërore. Nëse arka shtetërore nuk posedon mjete të mjaftueshme atëherë qeverisë i mbetet të caktoj masa (tatime) shtesë ndaj të pasurve në mënyrë që të përmbushen kërkesat.

Në Islam qytetarët kanë të drejtën për pasuri private, të drejtën e mbrojtjes së nderit dhe të drejtën e barazisë para drejtësisë.

Kamata në Islam është e ndaluar rreptësisht sepse është fitim i padrejtë e cila e përqendron pasurinë te disa individë.

Ndalimi i kamatës edhe pse nuk e forcon individin në anën tjetër nuk e dobëson as shoqërinë, bile ndalimi i kamatës bënë balancimin dhe baraspeshimin në mes të individit dhe të shoqërisë. Në kohët e fundit ka zëra që thonë se sistemi financiar i Bankave bashkëkohore nuk është i përshtatshëm në zbatim, në anën tjetër vazhdimisht dëgjojmë zëra se zbatimi i sistemit financiar Islam është më praktik dhe më i zbatueshëm dhe se islami është zgjidhje e krizës globale financiare e cila në çdo moment mund të eksplodoj sepse sistemi bashkëkohor financiar është ndërtuar në baza financiare artificiale ndërsa sistemi financiar Islam është i ndërtuar në baza të shëndosha dhe natyrale.

LIMITI I PROFITIT NË TREGTI I PAPËRCAKTUAR

Tregtia është një lloj aktiviteti ekonomik që merret me shitblerjen dhe shpërndarjen e prodhimeve të ndryshme me qëllim të furnizimit të popullsisë. Shitblerja e mallrave bëhet me qëllim të profitit. Edhe qëllimi i tregtarit është profiti.

Profiti është: dallimi pozitiv ndërmjet çmimit të shitjes së mallit dhe çmimit të blerjes së tij, duke i llogaritur edhe harxhimet tregtare.

Kur'ani e ka përmendur tregtinë në shumë raste ndërsa ne do t'i përmendim disa prej tyre:

Thotë Zoti i Lartmadhëruar:

“O ju që besuat, mos hani mallin e njëri-tjetrit në mënyrë të palejuar, përpos tregtisë në të cilën keni pajtueshmëri mes vete...” (en-Nisa, 29).

“E All-llahu e ka lejuar shitblerjen, por e ka ndaluar kamatën.” (El-Bekare: 275).

Kur'ani tregon se edhe njëri prej Pejgamberve, pra Jusufi a.s. është shitblerë:

“Dhe ata e shitën atë (Jusufin) për një çmim të ulët, thjesht për disa dirhemë, sepse nuk kishin interesim (për çmim të lartë) dhe nuk lakmuan.” (Jusuf: 20).

Kur'ani po ashtu tregon edhe për sigurinë e fisit Kurejsh, për furnizimin dhe sigurimin e jetesës së tyre, si dhe dy udhëtimet e njohura të kurejshëve ndërmjet Jemenit dhe Shamit, dhe thotë:

“Për të mbrojtur dhe siguruar kurejshët! Garantimin e udhëtimit të tyre të lirë dimrit dhe verës! Pra, le ta adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie i Cili i ushqen ata në kohëra të urisë dhe i siguron nga frika.” (Kurejsh: 1-4).

Tregtia bëhet nga të gjitha anët e botës si nga veriu ne jug po ashtu nga lindja në perëndim sepse natyrshmëri e mallrave është të këmbehen nga të gjitha anët e botës. Edhe Muhamedi a.s. është marrë me tregti para se të ishte pejgamber që do të thotë se njëri prej profesioneve të Muhamedit a.s. ka qenë tregtia.

Ekzistojnë hadithe të shumta të cilat flasin për fushën e tregtisë dhe rëndësinë e saj.

Muhamedi a.s. ka stimuluar tregtinë me qëllim të realizimit të profitit pas mbulimit të harxhimeve dhe nuk e ka përmendur diku në përcaktimin e përqindjes së caktuar të profitit.

Bëhet pyetja: pse nuk e ka përkufizuar limitin e profitit?.

Kjo nga shkak se ka dallim në mes të shitjes së mallrave me shumicë ndaj mallrave të cilat shiten me pakicë, ndaj shitblerjes së mallrave të artikujve elementarë dhe atyre jo elementarë, ndaj mallrave të cilave u skadon afati për një afat të shkurtër dhe mallrave të cilave u skadon afati pas një kohe të gjatë, ndaj mallit i cili sigurohet me lehtësi dhe mallit i cili sigurohet me vështirësi. Po ashtu nuk ekziston ndonjë tekst i cili do të obligonte ose më së paku do të preferonte përqindje të caktuar profiti ose të jetë profit i cili nuk duhet ta tejkalojë përqindjen e profitit në minimum të limitit si p.sh. në 5%, 10%, 20%, 30%, etj. Dhe do të ishte e padrejtë përcaktimi i përqindjes fikse për të gjitha mallrat, për të gjitha vendet, për të gjitha kohët.

Kur i është kërkuar Muhamedit a.s. të bënte përcaktimin e çmimeve të mallrave të tregut ai është përgjigjur:

“Vërtet Ai është Allahu i cili cakton furnizimin, cakton çmimin dhe ofron rrugëdalje ose ngushton furnizimin. Unë për shkak të ndonjë padrejtësie ndaj jush si në pasuri ashtu edhe për lirinë tuaj nuk dëshiroj të dal para Allahut dhe ju të kërkonit të drejtën e juaj para meje.”

Shkalla më e ulët që duhet ta realizojë tregtia e suksesshme është që profiti ta mbulojë sasinë obligative të zekatit në pasurinë përkatëse si dhe harxhimet e bëra nga pronari për ato mallra.

Muhamedi a.s. ka aprovua profitin 100%. Transmetohet se Muhamedi a.s. i kishte dhënë Urves (njërit prej sahabeve) një dinarë që t'i blejë një dele, ndërsa Urve me një dinar i kishte blerë dy dele dhe pastaj njëren dele e kishte shitur për një dinarë, kështu që ia kishte kthyer Pejgamberit a.s. një dinar dhe ia kishte dërgua një dele. Në atë rast Pejgamberi a.s. i është lutur All-llahut që t'ia bëjë të bereqetshme tregtinë e tij. Kështu, Urveja sikur të blinte madje edhe baltë do të përfitonte nga ajo (baltë). (Transmeton Buhariu)

Mund të përfundojmë në atë se: mashtrimi në tregti është i ndaluar ndërsa limiti i profitit është i papërcaktuar dhe se profitin e cakton ekonomia e tregut.

FESTAT DHE MANIFESTIMI I TYRE

Manifestimi, ngërthen në vete tubimin dhe përkujdesjen për diçka. Thuhet, *filani nuk ka manifestuar*, që do të thotë, nuk është përkujdesur dhe nuk është interesuar për atë çështje.

Është natyrshmëri njerëzore që njeriu të përkujdeset për diçka.

Manifestimet mund të jenë:

- **Manifestimi i një çështjeje të kësaj bote;**
- **Manifestimi i një çështjeje fetare.**

1. Manifestimi i një çështjeje të kësaj bote: nuk është i ndaluar përderisa qëllimi të jetë i pastër, brenda kufijve të sheriatit islam dhe që nuk ndikon negativisht në moral dhe nuk sjell veprime të këqija.

2. Manifestimi fetar, i cili mund të jetë:

- a.** Manifestim për të cilin ekziston ndonjë tekst i sheriatit;
- b.** Manifestim për të cilin nuk ekziston ndonjë tekst i sheriatit.

Sa i përket manifestimit të ndonjë feste për të cilin ekziston teksti, ajo festë festohet, që do të thotë se lejohet festimi.

Sa i përket manifestimit të ndonjë feste fetare për të cilën nuk ka tekst, dijetarët kanë dhënë dy mendime:

- **Mendimi i parë:** ai lloj manifestimi nuk lejohet, sepse konsiderohet bid'at.

- **Mendimi i dytë:** ai lloj manifestimi lejohet, sepse nuk ekziston ndonjë tekst i cili e ndalon atë manifestim, pra çështja ka mbetur neutrale.

Që në fillim duhet të potencojmë se manifestimi i ndonjë feste dhe manifestimi i festës së Bajrameve nuk kanë diçka të përbashkët, por ndryshojnë njëra me tjetrën.

Nuk mund të thuhet se ne muslimanët i kemi vetëm dy festa (festa e kurban bajramit dhe fitër bajramit), sepse numri i festave nuk përkufizohet vetëm me këto dy festa. Muhamedi s.a.v.s. edhe ditën e premte (e xhuma) e ka quajtur festë. Sa i përket hadithit se kur pejgamberi s.a.v.s. ka shkuar në Medine dhe atje i sheh duke u argëtuar në dy ditë të festave të tyre dhe Muhamedi s.a.v.s. u ka thënë *“Zoti ua ka zëvendësuar me dy ditë (tjera) më*

të mira se ato dy ditë, e ato janë: Dita e fitër Bajramit dhe e Kurban Bajramit.” tregon se Muhamedi s.a.v.s. ka sinjalizuar se këto dy festa janë më të vlefshme se festat tjera.

Festa manifestohet me shprehjen e gëzimit dhe të lumturisë dhe nuk ka të bëjë me ligjësim adhurimi, siç është rasti i ligjësimit të namazit të agjërimit, etj.

Pra, manifestimi i festave është i lejuar, qoftë festë fetare apo jo fetare, por me kusht që të jetë brenda suazave të ligjit islam dhe të ketë qëllim të mirë.

Në fenë islame edhe pse shprehim ndjenjat e gëzimit dhe lumturisë, nuk i quajmë Bajrame – festë, siç është rasti i shprehjes së gëzimit dhe lumturisë me rastin e lindjes së fëmijës e cila manifestohet me “Akikë” (prerje kurbanit). Pastaj dasma e martesës, sepse manifestimi i tyre ka të bëjë me përkujdesjen për të ardhmen dhe të vepruarit për botën tjetër.

Zoti i Lartmadhëruar tregon se si i ka thënë Musait a.s.:

“Dhe përkujto për ditët e Allahut.” (El Ibrahim : 5)

Të kujtojmë hixhretin e Muhamedit a.s. prej Meke në Medine. Kjo ngjarje ka rëndësi të posaçme në historinë islame. Për këtë arsye Umeri r.a. e ka caktuar si fillim të kalendarit islam dhe viti i hixhretit është viti i parë i kalendarit islam, dhe, pse të mos festohet “viti i ri i hixhretit” kur kjo do të bënte lidhjen dhe forcimin e zemrave të muslimanëve me fenë e tyre dhe do të bënte që të mos harrohej kjo festë duke i festuar festat tjera të kësaj bote.

Mendimi i atyre të cilët thonë se festat përpos festave të Bajramit janë bid’at, duhet t’u sqarohet se bid’ati nuk ka të bëjë me këto festa, sepse nuk është ligjësuar ligjësim fetar për manifestimin e këtyre festave, është shprehje gëzimi dhe interesimi dhe nuk janë terminologji të cilat i konsiderojmë mjet adhurimi. Edhe pse emërtimi i festës së bajrameve është i njëjtë me emërtimin e festave të tjera, festa e bajrameve festohet me adhurim, pra me falje të namazit të përbashkët të Bajramit, pastaj me prerje të kurbanit, ndërsa festat tjera nuk ngërthejnë në vete adhurim apo ritual të veçantë, qoftë falje të namazit, qoftë ndonjë adhurim tjetër, por paraqesin vetëm përkujtim të datave historike, net me vlerë të madhe dhe vite të cilat kanë lënë gjurmë në civilizimin islam.

PAJTIMI

Pajtimi është një marrëveshje në mes të dy palëve të konfrontuara me qëllim të përfundimit të armiqësisë së tyre në bazë të kushteve të ligjësuara.

Pajtimi është ligjësuar me Kur'an, me sunet dhe me ixhmaë. Po ashtu edhe logjika është argument i pajtimit.

Argument nga Kur'ani

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Nuk ka dobi nga bisedat e juaja përpos nëse urdhëroni për dhënie të lëmoshës ose për punë të mira ose pajtim në mes njerëzve.” (En-Nisa, 114)

Në ajet tjetër Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Vërtet besimtarët janë vëllezër dhe pajtoni mes vëllezërve tuaj.” (El-Huxhurat, 10)

Argument nga suneti

Përpos Kur'anit e cila është mrekullia kryesore e Muhamedit a.s., njëra prej mrekullive më madhështore është pajtimi në mes fiseve të arabëve të cilët ishin të përçarë në mes vete.

Argument nga ixhmai

Të gjithë sehabet janë dakorduar në atë se pajtimi është i lejuar edhe pse për disa pika të pajtimit kanë dhënë mendime të ndryshme.

Argumenti logjik

Logjika e pranon pajtimin sepse parandalon ngatërresat të cilat me kalimin e kohës shpijnë në shkatërrimin e shoqërisë.

Në pajtim rolin kryesor e ka falësi i cili falë. Falja është virtyt i të fortëve të cilën nuk e zotëron kushdo.

Pajtimi është shumëllojtësh:

1. Pajtimi i lejuar (Mubah),
2. Pajtimi i pëlqyer (Mustehab),
3. Pajtimi i urryer (Mekruh),
4. Pajtimi i ndaluar me fjalë tjera i papranuar (Haram).

Pajtimi është i lejuar atëherë kur për atë pajtim në rend të parë është kënaqësia e Allahut, pastaj janë të kënaqur të dy palët e pajtuara. Bazë e këtij pajtimi është dituria dhe drejtësia, thotë Zoti i Lartmadhëruar:

“Dhe pajtoni në mes tyre me drejtësi”.

Pajtimi mustehab (i pëlqyer) është atëherë kur pajtimi sjell interes të individëve por edhe të shoqërisë.

Është rregull e fikhut: “Pajtimi në mes palëve është i lejuar por jo me ndalim të së lejuarës apo lejimi i të së ndaluarës”. Nga ky rregull i fikhut mund të konkludojmë se ndodh pajtimi i cili është i ndaluar atëherë kur për ardhjen e atij pajtimi lëshohet ndonjë vaxhib ose lejohet e ndaluara, ose ndalohet e lejuara.

Pasi që familja është qeliza e parë e shoqërisë atëherë edhe pajtimi duhet të fillojë nga familja pastaj pajtimi në shoqëri dhe në fund edhe pajtimi ndërkombëtar kështu pajtimin mund ta ndajmë si vijon:

Pajtimi në mes të bashkëshortëve;

Pajtimi në mes të personave të padrejtë me të drejtë;

Pajtimi në çështje pronësore dhe materiale;

Pajtimi i gjaqeve;

Pajtimi në mes të besimtarëve dhe jobesimtarëve.

Për pajtimin e bashkëshortëve thotë Zoti i Lartmadhëruar:

“...dhe dërgoni një arbitër (ndërmjetësues) nga ana e tij dhe një arbitër (ndërmjetësues) nga ana e saj.” (En-Nisa).

Ekzistojnë ndërmjetësues të cilët jo vetëm që nuk shkojnë në pajtimin e bashkëshortëve por shkojnë për ndarjen e tyre.

Pas kurorëzimit, kur burri e lëshon gruan pala e gruas kërkon të paguhet dënimi prej 3000 deri në 7000 euro.

Ndërmjetësuesit (ku në të shumtën e rasteve në krye të tyre është ndonjë hoxhë) këtë dënim e justifikojnë me shpenzimet e një dasmeje të cilat sillen prej 3000 deri në 7000 euro.

Disa tjerë këtë dënim e arsyetojnë me çështjen e HUL'IT, por HUL'I nuk është dënim por është e kundërta e kësaj sepse HUL'I është e drejtë e bashkëshortes që të heq dorë nga mehri nëse i lejohet shkurorëzimi ndërsa në dënim familja e dhëndrit duhet t'i paguaj familjes së bashkëshortes dënimin e emëruar si dënim për shkak të shkurorëzimit.

Të tjerët dënimin e shpenzimeve të dasmës e arsyetojnë me mehrin (Mehrul mithlin) përderisa mehri është çështje e cila është ekskluzivisht për bashkëshorten pa marrë parasysh a shkurorëzohet apo nuk shkurorëzohet. Kjo formë e arsyetimit është e papranueshme se është shtrembërim i së vërtetës dhe lejim i së ndaluarës.

Dënimi i cili bëhet ndaj shkurorëzuesit pse e ka shkurorëzuar është heqja e shpenzimeve të një dasmeje edhe pse dihet se dasma në esencë nuk është prej riteve të obliguara të kurorëzimit por është një publikim dhe një aheng i cili nuk mund të parashihet si çështje e dënimit në rast të shkurorëzimit. Kjo bie ndesh me rregullin e Fikhut: “Pajtimi në mes palëve është i lejuar por jo ndalimi i të lejuarës apo lejimi i të ndaluarës”.

Pajtimi në mes të personave të padrejtë me të drejtët

Pajtimi në mes palëve është çështje e çmuar dhe me vlerë për këtë arsye në pajtim duhet të ekzistoj dituria dhe drejtësia për këtë arsye nuk është e drejtë kur ndërmjetësuesit bëjnë pajtimin e të fortëve dhe të dobëtëve në bazë të thënies së njohur: “Ore i dobët mos bënë zë, ore i fortë mos bënë më”. Sepse duke u nisur nga kjo formë e pajtimit, të fortët krekosen edhe më shumë ndërsa të dobëtit ndihen të thyer në zemër edhe më shumë. Një prej çështjeve të pajtimit mekruh dhe haram është lëshimi i ndonjë vaxhibi gjatë pajtimit.

Pajtimi i gjaqeve

Përpos konflikteve që ndodhin për çështje materiale pajtimi më i vështirë është pajtimi i gjaqeve, për këtë arsye **pajtimi ndahet në:**

- Pajtim për çështje pronësore ose materiale dhe;
- pajtim për shkak të ndonjë vrasjeje.

Jeta është vlere më e çmueshme e njeriut dhe e drejtë e pacenueshme. Pajtimi i rasteve të tilla është prej rasteve më të ndërlikuara por e cila kërkon përkushtueshmëri të madhe. **Vrasja është tri llojesh:**

1. Vrasja pa qëllim (gabimisht);
2. Vrasja e dyshimtë dhe;
3. Vrasja me qëllim.

Në vrasjen paqëllimtë ekzistojnë vetëm dy opsione për t'u pajtuar:

1. Falja pa kurrfarë kompensimi dhe;
2. Falja me kompensim.

Zakonisht te vrasja e paqëllimtë bën pjesë vdekja gjatë aksidenteve të komunikacionit. Është mirë që ndërmjetësuesit të sqarojnë se pranimi i

shpagimit të gjakut nuk është i ndaluar edhe pse ka të drejtë të falin pa kompensim.

Thotë Zoti i Lartmadhëruar:

“Nuk bën që besimtari të vret besimtarin përpos paqëllim. Kush vret një besimtar gabimisht, duhet të liroj një besimtar të robëruar dhe t'u paguaj gjakun familjes (trashëgimtarëve) të të vrarit, përpos rastit kur familja e të vrarit ia falë gjakun.” (En-Nisa, 92)

Në vrasjen e paqëllimtë

Në vrasjen e dyshimtë prapë ekzistojnë dy opsione:

1. Falja pa kurrfarë kompensimi;
2. Falja me kompensim.

Vrasje e dyshimtë quhet ajo vrasje ku i vrari nuk është vrarë me armë të nxehta apo me armë të ftohta (si p.sh. shpata, thika, sëpata, e të ngjashme, pra ka ndodhur me ndonjë mjet të lehtë e cila nuk shkakton vdekjen por që në atë rast prej atij mjeti ka ndodhur vdekja si p.sh. shuplaka, thupra e të ngjashme).

Në vrasjen e qëllimtë ekzistojnë tri opsione:

1. Kërkim ekzekutimi nga trupi gjykues, Gjakmarrja (kurse hakmarrja nuk lejohet);
2. Falja pa kompensim dhe;
3. Falja me kompensim.

Në Islam dënimet ndahen në:

1. Dënim me të drejt faljeje (Kisas) dhe në;
2. Dënim me pa të drejt faljeje (Hudud).

Dënimi me vrasje të qëllimshme bën pjesë në dënim me të drejt faljeje e që quhet Kisas. Kisas quhet dënimi proporcional që do të thotë kërkim të dënimit me vdekje për vrasësin por që e drejt e familjes është që të falin qoftë me kompensim, qoftë pa kompensim.

Në të tri raste është e paraparë se lejohet shpagimi dhe po ashtu edhe e drejta e faljes pa shpagim.

Në të dy rastet e para, pra në vrasjen gabimisht dhe vrasjen e dyshimtë janë të parapara vetëm dy opsione. Faljen pa kompensim dhe faljen me kompensim ndërsa te vrasja e qëllimshme është e paraparë dënimi me vdekje.

Kompensimi që quhet DIJE është një akt ligjor i cili u bën të mundur shoqërisë të vazhdoj të jetojnë jetën sepse pas miratimit të pajtimit mos të vazhdoj marrje jete të njerëzve por të jetojnë në paqe. Kjo dhuratë e Zotit duhet të mirëpritet dhe duhet të gjejë zbatim dhe të mos refuzohet. Sepse pranimi i kompensimit është i lejuar. Thotë Zoti i Lartmadhëruar: **“Atij që i falet diçka nga vëllai i vet, atëherë ajo le të përcillet kuptueshëm dhe shpagimi i atij le të bëhet me të mirë. Kjo është një lehtësim dhe mëshirë prej Zotit tuaj.”** (El-Bekare, 178).

Hakmarrja (vrasja e ndonjërit prej anëtarëve tjerë të familjes së vrasësit) është e ndaluar, ndërsa sa i përket gjakmarrjes (ekzekutimi i vrasësit me qëllim-dënimi me vdekje-Kisasi) nga organet e drejtësisë është e lejuar. Por që siç e cekëm më parë ekzistojnë tri opsione:

1. Kërkim ekzekutimi për vrasësin;
2. Falje me kompensim (DIJE) dhe;
3. Falje pa kompensim.

Prej këtyre tri opsioneve vepra më e pëlqyeshme dhe më e lavdëruar është falja, qoftë ajo me kompensim qoftë ajo pa kompensim. Thotë Zoti i Lartmadhëruar:

“...dhe kujt i falet diçka prej vëllait të tij” (El-Bekare, 178).

Por Islami e lejon kërkimin nga drejtësia për ekzekutimin e vrasësit për shkak se drejtësia kërkon reciprocitet për mbrojtjen e vlerave të pacenueshme edhe pse nuk kërkohet me çdo kusht gjakmarrja pra për të vepruar në të njëjtën mënyrë për një të keqe që i është bërë dikujt. Në shumë ajete të Kur'anit bëhet thirrje për falje për keqbërësit sepse kjo është virtyt i çmuar dhe i lartë dhe jo virtyt i nënçmuar. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Nuk është e barabartë e mira dhe e keqja. Ktheje të keqen me të mirë sepse atëherë ai me të cilin kishe armiqësi do të bëhet dashamir dhe mik i afërt.” (El-Furkan, 34).

Ai i cili falë i krijon vetes mundësi për të jetuar i qetë dhe në harmoni me veten dhe me të tjerët. Vet jeta është mësuesi më i mirë i faljes sepse për të falë nevojitet durim, vendosmëri, urtësi dhe zemërgjerësi.

Dhe në fund angazhimi i pajtimit të çështjeve për të cilat nuk ka lejuar Zoti i Lartmadhëruar falje është ajo që në Islam quhet (HUDUD) e cila është e drejt ekskluzive e Allahut, me fjalë tjera e drejta e shoqërisë është haram, sepse siç e cekëm më parë në islam dënimet ndahen në:

1. Dënim me të drejt faljeje (KISAS) dhe,
2. Dënim me pa të drejt faljeje (HUDUD).

Dënimet me pa të drejt faljeje (HUDUD) janë dënimet të cilat i ka paraparë Allahu dhe askush nuk ka të drejt në to, pra askush nuk ka të drejt faljeje. Ky autoritet nuk i jepet askujt (nga cila do palë qoftë, e dëmtuesit, apo e të dëmtuarit e trupit gjykues apo ekipit ndërmjetësues) sepse janë dhunimet e bëra ndaj shoqërisë. Sikurse individi nuk ka të drejt të falë diçka të shoqërisë ashtu edhe shoqëria nuk ka të drejt të falë dëmin e shkaktuar mbi individin. Pra shoqëria nuk ka të drejt të ushtroj të drejtën e faljes për një krim të kryer prej ndonjë individi ndaj shoqërisë.

MARTESA, DASMA DHE DËNIMI I SHPENZIMEVE TË DASMËS

Për shkak të rëndësisë që ka familja në islam, ashtu siç janë paraparë kushtet e namazit, haxhit, agjërimit, zekatit, po ashtu janë të parapara edhe kushtet e martesës (aktit të kurorëzimit). Ato kushte janë:

1. **Oferta dhe pranimi;**
2. **Dy dëshmitarë.**

Mehri është vaxhib dhe nuk bën pjesë në kushtet e Nikahit.

Oferta dhe pranimi

Martesës i paraprinë fejesa. Fejesa është akt i cili nuk është i domosdoshëm që dy palët t'i përmbahen. Koha në mes të fejesës dhe aktit të kurorëzimit nuk është e përcaktuar, ajo mund të zgjasë një kohë të shkurtë (në të kaluarën ka zgjatur me vite). Pas kësaj kohe caktohet dita e dasmës në të cilën ditë bëhet edhe kontrata e martesës.

- Në ditën e fejesës (myzhdes – lajmit përgëzues) në momentin e kërkimit të dorës së vajzës ngrihet familjari i vajzës dhe thotë: **Në bazë të librit të Allahut dhe traditës së të dërguarit të Allahut e keni kërkuar dorën e filanes (x vajzës).**

- Familjari i dhëndrit ngrihet dhe thotë: **Po, është e vërtetë, e kemi kërkuar.**

- I autorizuari i vajzës thotë: **dhe tani e jap dorën e filanes (x vajzës), në bazë të librit të Zotit dhe traditës së të dërguarit të Allahut.**

Më së shumti me rastin e fejesës e kanë përdorur tekstin si në vijim: **Zoti e ka urdhëruar, ndërsa pejgamberi e ka praktikuar** (Këtë tekst e kanë thënë si në vijim: **Allah nemrile, pejgamber kaullile**).

Kjo është bërë me rastin e fejesës, ndërsa në rastin e martesës, pasi që nusja të hipë në automjetin e paraparë, familjari i vajzës i thotë familjarit të dhëndrit: **Gjaku i imi, robi i yti dhe rruga e mbarë.** Kësaj i

thuhet e ka bërë “Teslimin” (dorëzimin). Edhe pse ky Teslim (dorëzim) bëhet kur të gjithë krushqit janë në automjet dhe askush nuk i dëgjon përpos atyre dyve në mes vete, kur dihet se kanë pasur kohë të mjaftueshme deri sa kanë qëndruar në vendin e pritjes së krushqve.

Akti i kurorëzimit mund të bëhet gjatë ceremonisë së dasmës ku janë dasmorët dhe atë në këtë mënyrë [Kjo mënyrë praktikohet gjatë fejesës (myzhdes) dhe nuk bëhet gjatë martesës].

- NGRIHET I AUTORIZUARI I DHËNDRIT PARA TË PRANISHMËVE E THOTË: **A e pranon për bashkëshort filanin (x personin) në bazë të librit të Allahut dhe traditës së të dërguarit të Allahut.**

- PASTAJ, I AUTORIZUARI I VAJZËS PARA TË PRANISHMËVE THOTË: **Po, e pranoj filanen (x vajzën) si bashkëshorte të filanit (x djalit), në bazë të librit të Zotit dhe traditës së të dërguarit të Allahut.**

Nëse gjatë aktit të kurorëzimit janë të pranishëm dhëndri dhe nusja, atëherë bëhet kështu:

- DJALI PARA TË PRANISHMËVE THOTË: **A pranon të martohesh me mua në bazë të librit të Allahut dhe traditës së të dërguarit të Allahut?**

- VAJZA PARA TË PRANISHMËVE THOTË: **Pranoj të martohem me ju në bazë të librit të Zotit dhe traditës së të dërguarit të Allahut.**

Shihet qartë se në tekst të ofertës dhe pranimi janë fjalët: “**në bazë të librit të Zotit**” që do me thënë që burri do ta trajton bashkëshorten sipas porosive të Zotit në Kur’an. Do të sillet mirë me bashkëshorten dhe do ta respekton dhe nderon atë sepse sjellja e mirë me bashkëshorten është urdhër kur’anor, thotë Zoti i Lartmadhëruar: “**Jetoni e silluni mirë me to (me gratë e juaja)!**” (En-Nisa : 19)

Pasi që oferta dhe pranimi bëhen para dëshmitarëve ndërsa Dëshmitari i parë dhe Mbikëqyrës është Zoti i Lartmadhëruar, kontrata bëhet me emrin e Tij, në dëgjueshmërinë e Tij, në pajtim me urdhëresat e Tij.

Martesa është një mjet i marrëdhënieve permanente, jo vetëm ndërmjet burrit dhe gruas, por edhe ndërmjet tyre dhe Zotit, që do të

thotë se besëlidhja e fortë e tyre të jetë edhe për kohëra të mira dhe aso të vështira. Mbi dhuratën e martesës Zoti i Lartmadhëruar thotë në Kur'an: **“...dhe kur ato kanë marrë nga ju besë të fortë?” (En-Nisa : 21)**

Fjalët **“sipas traditës së të dërguarit të Allahut”**. Kjo nga shkakun se Muhamedi a.s. ka thënë: **“Martesa është tradita ime dhe kush nuk e pason traditën time nuk është prej meje.”** Po ashtu Muhamedi a.s. ka thënë: **“Më i miri prej jush, është ai që sillet më mirë me familjen e tij.”**

Akti i kurorëzimit i bërë në prezencën e dëshmitarëve, qoftë në prezencën e dasmorëve, qoftë në prezencën e disa dëshmitarëve është valid. Pastaj mund të regjistrohet në gjendjen civile të cilën e bëjnë nëpunësit për çështjet martesore dhe këtë më parë e kanë bërë edhe në ndonjë letër jozyrtare, ndërsa sot bëhet edhe në libra të xhamisë ku jepet certifikata e martesës.

Regjistrimi bëhet për të siguruar të drejtën e të martuarve. Është urdhër kur'anor për të regjistruar borxhin sepse me regjistrimin e tyre ruhen të drejtat e njerëzve. Thotë Zoti i Lartmadhëruar: **“Nëse jepni borxh deri në një afat të caktuar, regjistrojeni.” (El-Bekare : 282)**, kështu që kur bëhet regjistrimi i borxhit atëherë më primare do të ishte që të bëhet regjistrimi i atyre çështjeve që kanë të bëjnë me nderin dhe pasardhësit.

Pas plotësimit të kushteve edhe ruknit të martesës (dy dëshmitarëve dhe pëlqimit bashkëshortor) bashkëshortët e kanë të lejuar kontaktin martesor.

Vendi i aktit të martesës

Akti i martesës është e pëlqyeshme të bëhet në xhami, por nëse nuk bëhet në xhami mund të bëhet në shtëpi por edhe në ndonjë objekt tjetër, por mund të bëhet edhe në ndonjë ambient të hapur. Kjo do të thotë se nuk ka shumë rëndësi se ku kryhet akti i martesës, në xhami apo shtëpi.

Dallimi në mes të dasmës dhe martesës

Dasma është aheng, ndërsa martesë është kontratë në mes të dy bashkëshortëve, këta dy terma kanë dallim me njëra me tjetrën. Nikahi është farz ndërsa dasma është sunet. Mund të ketë martesë pa dasmë, ndërsa nuk mund të ketë dasmë pa martesë.

Sikurse në shumë çështje tjera edhe në dasmë më shumë rëndësi i jepet çështjeve sekondare se sa atyre primare. Primare është martesë, ndërsa sekondare është dasma. Nikahi është kurorëzimi, ndërsa dasma është ahengu apo ceremonia e kurorëzimit.

Dasma është ceremonia e martesës dhe jo kusht i saj, nuk është traditë shoqërore por është e bazuar në islam. Vetë pejgamberi a.s., shokët e tij dhe muslimanët e parë, organizonin ceremoni dasme. Qëllimi i dasmës është në dy gjëra:

1. Grumbullimi i gjithë familjarëve dhe njerëzve të dashur; dhe

2. Ushqimi.

Dasma është gëzim për çiftin, për njerëzit dhe të afërmit e tyre, ato shërbejnë për afrimin mes familjarëve, farefisit, miqësisë dhe shoqërisë.

Dita e dasmës është një ditë e veçantë, pasi atë ditë fillon të themelohet një familje e re muslimane. Islami kërkon familje të lumtura, të gëzuara dhe të konsoliduara.

Dita e dasmës duhet të jetë një ditë e shënuar, ditë në të cilën arrihet dhe realizohet kënaqësia e Zotit të Madhëruar. Ajo është një ditë ku themelohet një familje e re, një shtëpi e re, shtëpi e cila duhet të jetë vend i qetësisë, harmonisë, i adhurimit dhe faltore e Zotit të Lartmadhëruar. Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an e tregon rastin e Musait a.s. kur ka thënë: **“Ndërtoni shtëpi për popullin tuaj në Egjipt dhe shndërrojini ato në faltore.” (Junus : 87).** Realizimi i fjalëve të Musait a.s. për ne: **“Shndërroni shtëpitë në faltore.”** Nënkupton që ato shtëpi të bëhen qendra në të cilat:

- Forcohet besimi;
- Gjendet qetësia dhe lumturia shpirtërore;
- Lexohet dhe studiohet Kur'ani;
- Lexohen libra fetarë, arsimor, shkencor;
- Përkujtohet, lavdërohet dhe madhërohet Zoti i Lartmadhëruar.

Dhurata martesore (mehri)

Mehri nuk është kusht i martesës, që do të thotë është vaxhib, por nuk është kusht i martesës. Kjo argumentohet me ajetin kur'anor: **“Grave jepni dhuratën e kurorës së tyre (mehrini) më të mirë.” (En-Nisa : 4)**

Gjatë martesës shumica e neglizhojnë mehrin, e konsiderojnë diçka simbolike edhe pse kjo nuk është simbolike. Edhe pse shuma e saj nuk është e përcaktuar dhe nuk ka as minimum dhe as maksimum të saj. Mehri është dhuratë ekskluzivisht për bashkëshorten dhe jo për familjen e saj. Është e ditur se dhurata shpirtërore është më e madhe dhe më e rëndësishme se dhurata materiale, por prapë se prapë pas dhuratës shpirtërore vjen edhe ajo materiale. Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“...dhe u keni dhënë ndonjëres prej tyre thesare pasuri.” (En-Nisa)**

Ligjërata dhe lutja

Pas ofertës dhe pranimit, dhe pas deklarimit para dëshmitarëve është mirë të mbahet një ligjëratë (fjalim) dhe në fund të bëhet një lutje dhe të përfundon procedura e martesës, ndërsa ahengu mund të vazhdoj.

Dënimi në bazë të shumës së shpenzimeve të dasmës

Shpenzimet e dasmës nuk janë çështje kontraktuale, nuk janë pjesë e aktit të kurorëzimit. Ato as që llogariten si shpenzime të aktit të kurorëzimit por thjesht janë dëshirë e dasmorit për të treguar bujarinë, gëzimin dhe lumturinë e vet.

Shpenzimet e dasmës asnjëherë nuk duhet të merren si bazë për tu dënuar në rast të shkurorëzimit.

Shpenzimet e dasmës asnjëherë nuk duhet të merren si bazë që ajo shumë në të ardhmen të llogaritet gjatë trashëgimisë së anëtarëve të familjes.

Në dasma ftohet edhe hoxha. Në të shumtën e rasteve hoxha më shumë merret si prijës simbolik se sa si një kryerës i procedurave (rregullave) të martesës (nikahit) të cilat i përmendëm si më lartë.

Tek ne shpesh po ndodh që për një dasmë të shpenzohen mesatarisht 7000-8000 euro. Në atë dasmë në vend të përkujtimit të Zotit bëhet vallëzimi dhe këndimi. As nuk bëhet regjistrimi, as akti i kurorëzimit. Bëhen shpenzime të nevojshme dhe të panevojshme, të përcaktuara dhe të papërcaktuara. Prijësi fetar (hoxha) ndoshta nuk e ka kryer asnjë procedurë të paraparë në islam të cilat i cekëm si më parë por thjesht ka hipë në automjet, ka shkuar krushq, është kthyer në shtëpi sa që edhe në rastin e dorëzimit (testimit) të gruas nuk prezanton dhe pas një kohe të shkurtë për çështje të imta, duke e pasuar epshin dhe për shkak se ndarja është bërë si një çështje e zakonshme dhe si një rrobë e cila lehtë mund të hiqet dhe të ndërrohet, vjen deri te shkurorëzimi, pasi që shkurorëzimi bëhet me shkas dhe pa shkas, ftohet familja e vajzës dhe ftohet hoxha së bashku me këshillin ndërmjetësues dhe familjari i vajzës kërkon nga ata që të dënohet familja e dhëndrit me një shumë dasme. Kur pyeten: Pse? Përgjigja është: Shpenzimet e dasmës kanë kushtua 7000-8000 euro dhe dënimi duhet të jetë aq sa kanë qenë shpenzimet e një dasme.

Në vend se të merren alternativat dhe shkaqet që të pengohen shkurorëzimet, hapen dyer të cilat e stimulojnë shkurorëzimin, kurse dënimi për raste të tilla është rrugë e së keqes dhe jo rrugë e ndërtimit të ardhmërisë së brezave të rinj.

KOHA E OBLIGUESHMËRISË SË DHËNIES SË ZEKATIT TË TRUPIT DHE ZEKATIT TË PASURISË

Zekati ndahet në :

1. Zekat të trupit (zekatul fitri) dhe
2. Zekat të pasurisë (zekatul male).

1. **Zekati i trupit** (zekatul fitri) i cili në të shumtën e rasteve populli i quan “Vitrat” apo vitrat e Ramazanit. E që është gabim të quhet ashtu, pra nuk lejohet zëvendësimi i shkronjës “f” me shkronjën “v” sepse merr kuptim krejtësisht tjetër.

2. **Zekati material** (zekatul male) e ndryshe mund të quhet edhe zekati i pasurisë. Pra e kundërta e të parës, pra e kundërta e zekatit të trupit.

Sikurse namazi i cili e ka farz kohën e kryerjes së obligueshmërisë së tij ashtu edhe zekati i trupit por edhe zekati i pasurisë e ka kohën e caktuar për dhënien apo në kryerjen e obligueshmërisë së tij. Që ne do t'i shpjegojmë veç e veç.

Sa i përket zekatit të trupit (zekatul fitri), koha e kryerjes së tij nuk është në Ramazan, as koha e kryerjes së obligueshmërisë së tij nuk është muaji i ramazanit dhe as dhjetë ditët e fundit të ramazanit, por koha e kryerjes së tij është me përfundimin e ramazanit dhe para faljes së namazit të bajramit. Sepse Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Ka shpëtuar ai i cili e ka dhënë zekatin (e fitrit) dhe e përkujton Allahun dhe e falë namazin (e fitër Bajramit).”

Siç shihet ajeti qartë e tregon se zekatul fitri apo zekati i trupit është i ndërlidhur me faljen e fitër Bajramit (e kundërta është me rastin e therjes së kurbanit ku Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe fale namazin (e Kurban Bajramit) dhe there Kurbanin.” (El-Kevther, 2).

Zekati material është zekati i cili jepet gjatë tërë vitit, pra në Ramazan, por edhe në muajt tjerë kalendarik përpos muajit të ramazanit. Duhet

përmendur se viti kalendarik llogaritet sipas kalendarit hënor i cili është më i shkurtë për 11 ditë prej atij diellor. Pra viti duhet të llogaritet 354 ditë dhe jo 365 ditë.

Dallimi në mes të zekatit të trupit dhe zekatit të pasurisë apo material është sikurse dallimi në mes të Haxhit dhe umres sepse haxhi është obligim vetëm në muajt e caktuar të vitit ndërsa Umreja mund të kryhet në 12 muajt e vitit kalendarik pra në çdo ditë prej ditëve të kalendarit.

Parashtrohet pyetja: A lejohet kryerja e zekatit të trupit dhe zekatit material para kohës së obligueshmërisë së tij?

Para se të përgjigjemi në këtë pyetje duhet të sqarojmë se në sheriatin islam të drejtat dhe detyrimet ndahen në:

1. Të drejta dhe obligime ndaj Krijuesit (Allahut),
2. Të drejta dhe obligime ndaj krijesës (njerëzve) dhe
3. Të drejta dhe obligime edhe ndaj Krijuesit edhe ndaj krijesës në të njëjtën kohë.

Sa i përket të drejtave dhe obligimeve ndaj Krijuesit (Allahut), kryerja e obligimit të tyre nuk pranohet nëse kryhet para kohe, me fjalë tjera konsiderohet i pavlefshëm nëse kryhet para kohe. Shembull: Ramazani është obligim ndaj Krijuesit dhe ne nëse e agjërojmë para kohe për një muaj apo për dy muaj ai agjërim nuk pranohet sepse është e drejtë dhe obligim ndaj Allahut e jo ndaj njerëzve. Shembull tjetër nëse namazi i xhumasë falet ditën e enjte ai namaz nuk pranohet sepse është e drejtë dhe obligim ndaj Allahut ngjashëm është edhe nëse e falim namazin e drekës para kohës së namazit të drekës ai namaz nuk pranohet.

Kjo ishte sa i përket të drejtave dhe obligimeve ndaj Allahut ndërsa sa i përket llojit të dytë të drejtave dhe obligimeve ndaj njerëzve, kryerja e obligimit duhet të kryhet në kohën e saj të caktuar mirëpo bëhet përjashtim kur njerëzit kanë nevojë për atë ndihmë materiale dhe kanë nevojë për atë përsheptim në të kundërtën obligueshmëria duhet të kryhet në kohën në të cilën është obligim e jo më herët pra sikurse te namazi dhe agjërimi. Në këtë rast jemi duke e sqaruar pyetjen se a lejohet zekati i trupit të jepet para përfundimit të Ramazanit apo gjatë Ramazanit, dhe a lejohet zekati i pasurisë para kohe, pra një vit apo dy vite para kohe. Përgjigja është se për shkak të nevojës së të varfërve lejohet zekati i trupit 29 ditë eventualisht 30

ditë më herët që do të thotë prej ditës së parë të Ramazanit dhe deri në ditën e fundit të ramazanit dhe nuk lejohet më herët pra nuk lejohet zekati i fitrit para ditës së parë të ramazanit. Koha e cila jepet prej ditës së parë të ramazanit nuk është kohë e rregullt e zekatit të trupit por është kohë e çrregullt dhe kjo vetëm nga shkak se është e drejt dhe obligim ndaj njerëzve dhe për shkak të nevojës së tyre që kanë për atë zekat sepse koha e rregullt e tij është vetëm pas përfundimit të ramazanit dhe para faljes së namazit të fitër bajramit.

Sa i përket zekatit material apo zekatit të pasurisë, kohë e rregullt e dhënies së tij është i tërë viti kalendarik sepse është e drejt dhe obligim ndaj njerëzve. Shembull nëse një person e arrin Nisabin (85gr. ari apo kundërvlera e 85gr. arit) me 1 Janar kohë e rregullt e dhënies së tij është deri më 20 dhjetor (me kalendar hënor prej 1 Rexhep deri në ditën e fundit të Xhumadel Uhra) dhe nëse nuk kryhet deri në këtë datë konsiderohet vonim i kryerjes së obligueshmërisë. Brenda këtyre 12 muajve zekatdhënësi ka të drejt të jep zekatin me këste p.sh. nëse e ka për obligim me dhënë 1200 euro ai mund t'i jep për çdo muaj nga 100 euro. Ndërsa kohë e çrregullt e dhënies së zekatit të pasurisë sikurse të zekati i trupit është dhënia e zekatit dy vite para kohe nëse ekziston ndonjë krizë apo kanë nevojë njerëzit për atë zekat.

Përfundim:

- Koha e rregullt e zekatit të trupit është prej faljes së namazit të sabahut të ditës së fitër bajramit dhe deri në faljen e namazit të fitër bajramit.
- Koha e çrregullt e zekatit të trupit është prej ditës së parë të ramazanit dhe deri në faljen e sabahut të ditës së fitër bajramit (më herët nuk lejohet).
- Koha e rregullt e zekatit të pasurisë është çdo ditë e vitit kalendarik.
- Koha e çrregullt e zekatit të pasurisë është një vit apo dy vite para obligueshmërisë ashtu sikurse tolerohet dhënia e zekatit të trupit gjatë ramazanit për shkak të nevojës së njerëzve që kanë nevojë për atë zekat.
- Zekati i pasurisë lejohet me këste përderisa është brenda periodës kalendarike.

EZANI, ZHURMËN E SHNDËRRON NË QETËSI SHPIRTËRORE

Organi kryesor i shqisës së të dëgjuarit është veshi. Funkzioni i tij është: mbledhja, përcjellja dhe përpunimi i sinjaleve akustike, tingujve, zërave, zhurmave, drejt organeve të tjera të aparatit dëgjimor.

Pjesët e veshit janë: pjesa e veshit të jashtëm, të mesëm e të brendshëm.

Pjesa e jashtme e cila përbëhet nga llapa e veshit, kanali i dëgjimit dhe daullja e veshit.

Pjesa e mesme e cila përbëhet nga tre kockëzat e veshit, çekiçi, yzengjia, kudhra (stapes, incus dhe malleus).

Pjesa e brendshme e cila përbëhet nga Kërmilli (Cochlea), që shërben për transformimin e lëkundjeve mekanike në impulse nervore, dhe labirinti, ose i quajtur organi vestibular, që nuk i shërben dëgjimit por ndjenjës së ekuilibrit.

Duhet ditur se dëgjimi është një proces ndijor dhe rezultat i një aktiviteti të sinkronizuar të një sërë organesh dhe qelizash.

Njeriu është në gjendje të shquaj një repertor të gjerë tingujsh dhe të prodhojë imazhe sonore, e kjo realizohet në sajë të pranisë së një kategorie qelizash të specializuara, të pozicionuara në zonën e veshit të brendshëm.

Gjatë procesit të dëgjimit valët e zërit kapen së pari nga llapa e veshit të jashtëm i cili i “mbledh” ato dhe i drejton për në kanalin dëgjimor. Pastaj valët godasin daullen e veshit ose membranën timpanike që shtrihet gjatë fundit të brendshëm të kanalit dëgjimor dhe e bëjnë atë të dridhet. Tre kockat e veshit të brendshëm (të quajtur **çekiçi, kudhra** dhe **yzengjia**) i dërgojnë këto dridhje te kërmilli i veshit, një organ në formë spiraleje në veshin e brendshëm. Dridhjet e zërit që futen në kërmillin e veshit krijojnë valë në lëngun që ai përmban. Këto valë bëjnë që një ndarje delikate, membrana bazilare të ndryshojë formën e saj.

Çka thotë Kur'an për dëgjimin?

Dëgjimi është i përmendur në Kur'an. Zoti i Lartmadhëruar tregon për dëgjimin, shikimet, që nga embrioni ku thotë:

“Allahu ju nxori nga barqet e nënave tuaja kur nuk dinit asgjë dhe ju bëri me shqisa të të dëgjuarit, të parit dhe me zemër e mendje...”(15 :78).

Shihet se sipas Kur'anit renditja fillon me dëgjimin e pastaj shikimet. Kur'an i dëgjimin e ka përmend në njëjës ndërsa shikimin në shumës. Rënditjen e këtyre shqisave e vërteton edhe embriologjia. Të shikojmë si e shpjegon embriologjia krijimin e fetusit dhe organet dëgjimore dhe shikimet:

Sipas embriologjisë ndjenja e dëgjimit formohet para funksioneve tjera vitale.

- Që nga java e 8 e shtatzënisë fillon të zhvillohet Shqisa e dëgjimit.

- Prej javës së 18 deri në javën 22 të shtatzënisë formohet veshi i brendshëm dhe nervat e trurit janë të zhvilluara mjaftueshëm ashtu që foshnja dëgjon të rrahurat e zemrës së nënës.

- Rreth javës së 25 të shtatzënisë foshnja dëgjon edhe zërat e jashtëm, ndërsa gjer në javën e 27 fillon njohjen e zërave.

Për dallim nga shqisa e të dëgjuarit, shqisa e të parit zhvillohet tek në javën e 26 të shtatzënisë, pas kësaj periudhe embrioni fillon t'i hapë dhe t'i mbyllë sytë.

Duhet pasur parasysh që fëmijët në rend të parë duhet aktivizuar në dëgjim e pastaj në shikimin e lojërave, pra në argëtimin e tyre në lojëra kompjuterike, pra në rend të parë duhet ta aftësojnë shqisën e të dëgjuarit e pastaj shqisën e të parit, e jo siç po ndodh në shekullin njëzetë e një ku në rend të parë po zhvillohet shqisa e të parit e pastaj shqisa e dëgjimit, gjë që do të ndikojë që njeriu të jetojë më i izoluar dhe më i mbyllur në vetvete. Shkaktar i kësaj është zhvillimi i teknologjisë informative-kompjuterike.

Dëgjimi dhe dëmtimi i dëgjimit

Dëgjimi është dhunti e Zotit dhe këtë dhunti duhet shfrytëzuar për atë për çka e ka krijuar Zoti i Lartmadhëruar. Dëgjimi është mjete i pranimit të shpalljes. Pa të dëgjuar nuk do të kishte qenë e mundur të pranohej shpallja prej pejgamberëve. Mirëpo, sikurse dëmtohen pjesët e tjera të trupit ashtu edhe dëgjimi dëmtohet. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Thuaj: Nëse Allahu ua merr të dëgjuarit, të parit dhe ua mbyll zemrat dhe mendjet, cili zot tjetër pos Allahut do t’ua sjell ato”.

Si dëmtohet shqisa e dëgjimit

Dëgjimi dëmtohet kur membrana bazilare deformohet nga një valë zëri që vjen në të, gjithashtu zhvendoset edhe organi i Kortit. Ky organ përmban receptorët dëgjues, një koleksion qelizash me zgjatime në formë qimesh. Sipër tij është membrana tektoriale. Lëngu tek kërmilli i veshit e shtyn lart membranën bazilare kështu që qelizat me zgjatime në formë qimesh fërkohen me membranën tektoriale. Ky veprim shkakton menjëherë impulse nervore në nervin dëgjimor, i cili i përcjell mesazhet deri në lobet temporale të trurit.

Dëmtimi i dëgjimit bëhet nga:

- 1. Ndotja akustike;**
- 2. Përdorimi i barnave (ilaceve); dhe**
- 3. Emocionet dhe ndjenjat negative.**

1. Nivelet e dëgjimit dhe ndotja akustike.

Veshi, si aparat i dëgjimit nuk mund të dëgjoj zërin prej 0-10 dB. Këtë ultësi të zërit e ka buburreci.

Njeriu nuk mund ta dëgjoj zërin e buburrecit sepse ai ka ultësinë prej 0-10 dB dhe Zoti i Lartmadhëruar këtë e ka treguar para 14 shekujve kur ka thënë:

“Dhe atëherë kur arritën në luginën e buburrecave, një buburrec tha: - O ju buburreca hyni në vendet tuaja që të mos u copëtojë Sulejmani dhe ushtria e tij duke mos ju vërejtur.” (en-Neml :18)

Fazën e parë të dëgjimit ku veshi mund ta dëgjojë zërin është prej 10-20dB. Ky është zëri më i ulët që Kur’ani e ka quajtur **“Rikza”**, me fjalë tjera fillimi i dëgjimit fillon nga kjo masë e zërit. Thotë Zoti i Lartmadhëruar:

“...ose a po e dëgjon zërin tepër të ulët të tyre (Rikza).” (Merjem : 98)

Faza e dytë e dëgjimit të veshit është prej 20-40dB. Ky është zëri i ulët që Kur’ani e quan **“hemsä”**. Thotë Zoti i Lartmadhëruar:

“E, para të Gjithmëshirëshmit ulen zërat e nuk dëgjohej tjetër pos një zë i ulët (hemsä).” (TaHa : 108)

Niveli kur fillon të çrregullohet gjumi është 42-45 dB.

Dëmtimi i mundshëm i të dëgjuarit bëhet prej 120-140 dB.

Kur’ani ka përmend se një dënim prej dënimeve para ditës së Kijametit është **“ushtima” (Sajha)** e cila do të jetë prej 160 deri në 200 dB.

Niveli më i larti i ushtimës është në ditën e Kijametit të cilën Zoti i Lartmadhëruar e ka cilësuar është **“Saaaahatun”** e cila do të jetë prej 200 deri në 240 dB.

Shurdhimin e nervit të veshit e shkakton ndotja akustike ndërsa ndotjen akustike e shkaktojnë: zhurmat e prodhimit në industrinë tekstile, në prodhimin e mineraleve, po ashtu ndotjen akustike e shkaktojnë burimet e ndryshme të veprimtarive njerëzore siç janë mjetet e transportit, pra që nga mjetet motorike automobilistike, hekurudhore (trenat) dhe ajrore (aeroplanët), etj.

Makina në ecje (50 km/orë) shkakton zhurmën në 60-80 dB; Trenat e shpejtë, me shpejtësi maksimale (300 km/orë) shkaktojnë zhurmën në 110

dB; Kamioni në ecje (50 km/orë) shkakton zhurmën në 78-92 dB; Aeroplani në ngritje shkakton zhurmën në 110 dB;

Përpos industrisë dhe mjeteve motorike dhe automobilistike, ndotja akustike shkaktohet edhe nga aktivitetet private, qofshin nga lokalet natës muzika e lartë, apo sallonet e bastoreve.

Dihet se në Evropë rreth 65% e popullsisë janë të ekspozuar ndaj niveleve të larta të zhurmës (për 24 orë në 55 dB) e cila shkakton acarime dhe shqetësime të ndryshme.

Rreth 113 milionë njerëz (17%) janë të ekspozuar ndaj niveleve të zhurmës deri në 65 dB. Rreth 10 milionë njerëz janë të ekspozuar ndaj niveleve të papranueshme të zhurmës (për 24 orë në 75 dB).

Ka një konsensus se niveli i zhurmës në mjediset e hapura nuk duhet të kalojë 65 dB gjatë ditës, ndërsa në vendbanimet e reja ai nuk duhet të jetë më shumë se 55 dB.

Përpos zhurmave të jashtme janë edhe zhurmat e brendshme të veshit të cilat vijnë nga dëmtimi mikroskopik në mbaresën e nervit të dëgjimit në veshin e brendshëm. Lëndimet në këto mbaresa shkaktojnë edhe humbjen e dëgjimit.

2. Përdorimi i barnave (ilacheve)

Dëmtimi i dëgjimit nuk bëhet vetëm prej ndotjes akustike, por edhe prej faktorëve tjerë siç janë: marrja e tepërt e ilacheve (*barnat anti-inflamatore, antibiotike, sedativët, barnat kundër depresionit si dhe aspirina*). Po ashtu nga procesi i plakjes. Pastaj ndikon faktori social-psikologjik dhe ekonomik, demografik si dhe statusi social.

3. Emocionet dhe ndjenjat negative

Faktorë tjerë të dëmtimit të dëgjimit janë edhe varietet emocionale negative, sikurse: zemërimi, depresioni, ankthi, shqetësimet e ndryshme, lodhja si dhe dëshpërimi.

Ezani dhe dëgjimi

Ezan, (ar: Edhan) është folje nga emri “**udhun**”, që do të thotë *vesh*. Edhe pse në gjuhën shqipe quhet ezan, duhet të quhet edhan.

Veshi është mjeti i pranimi të shpalljes nga Zoti i Lartmadhëruar. Kur është dhënë propozimi që thirrja për namaz të bëhet nëpërmjet kambanave ose borisë, nuk ka kalua ai propozim, por i është dhënë përparësi propozimit që të bëhet thirrja me anë të zërit të njeriut dhe për këtë është caktua sehabiu Bilalli r.a., i cili ka pasur zërin e bukur.

Ezani është sunet i fortë dhe po ashtu sunet kifaje, që do të thotë se nëse në një lagje thërritet ezani në shtëpi ai cili falet nuk e thërret ezanin, kjo nënkupton se mjafton ezani i njërit për të tjerët, por nëse në një lagje nuk ka ezan atëherë ai i cili falet në shtëpi e thërret ezanin aq sa e dëgjojnë veshët e tij, sepse ezan do të thotë dëgjim. Pra, do të thotë thirrje publike e cila duhet të arrijë deri te veshi i njeriut e jo që i tejkalon normat e veshit sepse ezan do të thotë aq sa arrin te veshi e jo çka e dëmton veshin. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Dhe ku ka fjalë më të bukur se sa fjala e ati j i cili thërret për Allah dhe vepron punë të mira dhe thotë: Me të vërtetë unë jam prej muslimanëve.” (Fusilet : 33).

Komentatorët mendojnë se këtu është fjala për atë i cili e thërret ezanin.

Ezani thirret në një gjuhë të përbashkët: gjuhën Arabe. Në Ezan përmendet emri i Allahut, i të dërguarit të tij, bëhet thirrja për lutje dhe për shpëtim. Siç e përmendëm më lartë, se dëmtimi i dëgjimit shkaktohet prej tre faktorëve, e ato janë: ndotja akustike, përdorimi i barnave dhe emocionet negative. Duke pasur parasysh se 70% e trupit të njeriut përbëhet nga uji, përderisa profesori japonez Emoto (*ka punuar me mikroskop mbi kristalet e*

ujit për 12 vite me radhë) ka konstatuar se kristalet e ujit reagojnë ndaj faktorëve të jashtëm, si: fjala dhe muzika. Ai ka konstatuar se kur njeriu dëgjon fjalë të bukura ose kur i thuhet lutje, pastërtia dhe përbërja gjashtëkëndëshe e kristaleve të ujit shfaqet më dukshëm, përderisa kur artikullohet fjala “djall” pranë ujit, kristalet marrin forma kaotike, deformohen. Po ashtu kur pranë ujit lëshohet muzikë Heavy-metal, kristalet e ujit shpërbëhen, përpos kësaj, kur pranë ujit përdoren fjalë fyese, banale, kristalet e tij deformohen.

Ai ka konstatuar se kristalet e ujit reagojnë dhe deformohen edhe kur mendohen gjëra negative, apo kur njeriu është i shqetësuar. Uji reagon edhe sipas gradëve të ndryshme të vetëdijes, sikur i di të gjitha dhe merr formë sipas përbërjes së tyre.

Në një rast kur është pyetur prof. Emoto: Si reagojnë kristalet e ujit kur u jepet të dëgjohet Kur'an? Apo ndaj 99 emrave të Allahut?.

Përgjigja e tij ka qenë: Kristalet shfaqeshin në një mënyrë aq të bukur, sa që fillova të mendoja nëse unë kam gjë lidhje me Islamin?

A nuk ka thënë Zoti i Lartmadhëruar:

“Pra, me të përmendurit e Allahut qetësohen zemrat.” (Err-Rrad : 28)

Ezani thirret pesë herë në ditë. Në ezan bëhet përmendja e Allahut dhe në kohën kur si ushqim ditor përpos ushqimit janë bërë edhe barnat edhe ndotja akustike e shkaktuar nga fabrikat, automjetet dhe nga faktorët e ndryshëm dhe në kohën kur krijohen zhurma të ndryshme të cilat shkaktojnë shqetësime, është ezani mu ai që këtë shqetësim e shndërron në qetësim të zemrës dhe në qetësi shpirtërore.

Gjithsesi se kjo do të mbetet temë diskutimi edhe në të ardhmen, sepse njeriu ka nevojë të qetësohet e qetësimi i zemrës së njeriut bëhet duke e përkujtuar Zotin, sepse Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Ata të cilët besojnë dhe i qetësojnë zemrat e tyre duke e përkujtuar Allahun, pra duke e përkujtuar Allahun qetësohen zemrat dhe shpirtrat.” (err-Rra`d : 28)

DETYRAT NDAJ TË VDEKURIT

Çka duhet të veprohet nëse vdes ndonjë familjar?

Ndaj të vdekurit kemi farze, sunete dhe mustehabe.

Në të shumtën e rasteve dhe në jetën e përditshme është bërë traditë që më shumë i jepet përparësi suneteve dhe mustehabeve se sa farzeve të së njëjtës çështje, ndërsa do të duhej që në rend të parë të kryheshin farzet, pastaj sunetet dhe pastaj mustehabet.

Në rast se vdes ndonjë familjar, atëherë rezultojnë këto farze (obligime):

- Larja e xhenazes, falja e namazit të xhenazes dhe varrimi;
- Kryerja (larja) e borxheve;
- Zbatimi i testamentit;
- Trashëgimia (ndarja e trashëgimisë/pasurisë).

E para:

Larja e xhenazes dhe varrimi.

Prej pasurisë së të vdekurit kryhen shpenzimet e larjes së xhenazes (gusuli), i cili është farz, si dhe bëhet varrimi.

Të gjitha shpenzimet të cilat kanë të bëjnë rreth përgatitjes si gusuli (pastrimi), kefini (qefini) dhe varrimi, duhet të jenë drejtpërsëdrejti nga pasuria e të vdekurit (e jo nga shpenzimet e familjarëve të tij). Nëse nuk ka pasuri, atëherë vjen në pyetje pasuria e familjarëve ose e shoqërisë.

E dyta:

Kryerja (larja) e borxheve.

Nëse i vdekuri ka borxhe, e tërë pasuria e tij shpenzohet në kryerjen e borxheve dhe pas kryerjes së borxheve zbatohet testamenti dhe në fund ndahet pasuria e tij, me fjalë tjera trashëgohet nga të afërmit.

Borxhet ndahen në dy lloje:

- **Borxhet ndaj Allahut;**
- **Borxhet ndaj njerëzve.**

Borxhet ndaj Allahut janë: si p.sh.: zekati, haxhi, përbetimi, etj.

Nëse atë vit i vdekuri nuk e ka dhënë zekatin, në rend të parë jepet zekati prej pasurisë së tij.

Nëse atë vit e ka pasur obligim haxhin, ndahen mjete prej pasurisë së tij dhe dërgohet zëvendësim (bedel) për haxh.

Nëse është përbetuar se: “do të presë një kurban nëse Zoti i mundëson diçka”, e atë vit Zoti ia ka mundësuar atë, mirëpo ky nuk e ka prerë kurbanin e përbetimit, atëherë prej pasurisë së tij pritët një kurban (i përbetimit).

I përmenda këto borxhe sa për ilustrim, por të gjitha borxhet të cilat kanë të bëjnë ndaj Allahut duhet t'i kryhen të vdekurit.

Borxhet ndaj njerëzve.

Para se të varroset i vdekuri, familjarët duhet të angazhohen që çdo kujt të cilit i ka pasur borxh i vdekuri të për t'ia kryer (ose së paku të kërkojnë një afatizim). Kuptohet, borxhi kryhet prej pasurisë së të vdekurit dhe atë para se të kryhet trashëgimia dhe të zbatohet testamenti. Zoti i Lartmadhëruar në ajetin e trashëgimisë thotë: “...(Kjo e drejtë në trashëgim bëhet) pasi të kryhet testamenti (vasieti) që ka lënë dhe pasi të kryhet borxhi...” (En Nisa : 11)

Kur Muhamedi a.s. ka prezantuar në faljen e namazit të xhenazes së një të vdekuri ka parashtruar pyetjen se a i ka pasur borxh dhe a i është kryer borxhi, e nëse i vdekuri kishte ndonjë borxh, Muhamedi a.s. ka thënë **“Faljani ju namazin e xhenazes vëllait tuaj.”** (Buhariu). Muhamedi a.s. u ka thënë tjerëve që t'ia falin namazin e xhenazes, por vetë nuk ka prezantuar në atë namaz, e kjo për t'i treguar muslimanëve rëndësinë e larjes së borxhit edhe për së gjalli, por edhe pas vdekjes, sa që në një hadith ka thënë:

“Shpirti i besimtarit është i varur (në mes qiellit dhe tokës) deri sa t’i lahet borxhi.”

E treta:

Zbatimi i testamentit.

Në kushtetutat njerëzore, fjala testament ka zënë vendin e fjalës trashëgimi edhe pse ka dallim të madh në mes të së drejtës trashëgimore dhe asaj testamentare. Në kohë të fundit thuhet trashëgimia testamentare, por trashëgimia është farz dhe në të nuk ka të drejt as i vdekuri, ndërsa testamenti është dhuratë e të vdekurit, i cili e ka lënë sa ka qenë gjallë, në mënyrë që ai testament (dhuratë) të zbatohet pas vdekjes së tij.

Me fjalë tjera, një e treta e pasurisë (*mundet edhe më pak*) është e drejtë testamentare, ndërsa dy të tretat janë e drejtë trashëguese dhe kjo zbatohet pasi që të kryhen borxhet e të vdekurit. Kështu pra, nëse i vdekuri ka lënë testament më shumë se një e treta, atëherë zbatohet si testament vetëm një e treta, më shumë jo. Zoti i Lartmadhëruar në ajetin e trashëgimisë thotë: **“... pas testamentit të porositur ose borxhit, duke mos dëmtuar (trashëguesit)...”** (En Nisa : 12)

E katërta:

Trashëgimia.

Trashëgimia prej të vdekurit është farz dhe mënyra e trashëgimisë sipas islamit quhet feraid (farz).

Pasi t’i kryhet borxhi dhe pasi t’i zbatohet testamenti, atëherë çka mbetet pas prej pasurisë së tij trashëgohet, me fjalë tjera, duhet të fillojë menjëherë procedura e trashëgimisë ashtu siç e ka paraparë Allahu i Lartmadhëruar në librin e Tij dhe të cilat i ka shpjeguar i dërguari i Allahut – Muhamedi s.a.v.s..

Mustehab është që nga pasuria e të vdekurit, para trashëgimisë me u dhënë dhurata apo sadaka të varfërve (jo trashëgimtarëve), të gjorëve dhe jetimëve.

Pasi të kryhen këto detyra dhe obligime ndaj të vdekurit, atëherë vazhdohet me sunetet dhe me mustehabet që kanë të bëjnë me të vdekurin.

RRETH NGUSHËLLIMIT PËR TË VDEKURIT DHE MËNYRAT E SHPREHJES SË NGUSHËLLIMIT

Vdekja është pikënisje e jetës së vërtetë dhe të përgjithmonshme. Besimtari nuk i frikësohet vdekjes, ai vepron në jetë aq për sa ka për të jetuar, po ashtu vepron edhe pas vdekjes aq për sa ka për të jetuar. Thotë Zoti i Lartmadhëruar:

“Ai ka krijuar vdekjen dhe jetën për të ju sprovuar se cili vepron punët më të mira.”

Vdekja nuk është zhdukje, por është ndërprerje e lëvizjes së trupit, e njeriu/shpirti ekziston, por ka ndryshuar vetëm gjendja e syrit, e veshit, e gjuhës, e dorës, e këmbës, sepse ai pas vdekjes shih çka nuk ka parë më par, ndien dhimbje ose gëzim, përjeton dëmin ose shpërblim, pikëllim ose lumturi, hidhërim ose kënaqësi.

Besimtarin as nuk e befason e as nuk e tmerron vdekja, por e pret gjithmonë me vepra të mira dhe i përgatitur, sepse e di se vdekja vjen ditën dhe natën, para dite dhe në mesnatë, në punë dhe në shtëpi, në rrugë dhe në shkollë, në luftë dhe në shëtitore, në restorant dhe në shtrat dhe çdokund.

Kanë vdekur mbretërit, kryetarët, ministrat e kryeministrat, ambasadorët, të varfrit e të pasurit, të fortit e të dobëtit, pleqtë e të rinjtë, gratë dhe fëmijët.

Zoti i Lartmadhëruar Muhamedit a.s. i ka thënë:

“Me të vërtetë (ti o Muhamed) je i vdekur (do të vdesësh) dhe me të vërtetë ata janë të vdekur (do të vdesin).”

Kur të dëgjohet se dikush ka ndërruar jetë thuhet:

“Ne vërtetë jemi të Allahut dhe padyshim se te Ai (të gjithë) do të kthehemi.”

Përpos lajmërimit nëpër shtëpi veç e veç, sot kemi forma të ndryshme të lajmërimit siç janë mjetet elektronike të shkruara dhe rrjetet sociale, e kjo bëhet me qëllim që sa më shumë njerëz të marrin pjesë në faljen e namazit të të vdekurit dhe përcjelljes së kufomës, si dhe njoftohen njerëzit për ditët dhe afatin e ngushëllimit dhe ky ngushëllim bëhet me qëllim që të arrihen shpërblime (sevape).

Ebu Hurejre r.a. ka treguar se:

“Atë ditë kur kishte vdekur Nexhashiu, Pejgamberi s.a.v.s. i kishte lajmëruar njerëzit për vdekjen e Nexhashiut, e pastaj së bashku me ta kishte shkuar në një vendfalje (Musal-la), aty ishte rreshtuar me shokët e tij (dhe e ka falur namazin e xhenazes jo prezent – Gaib) duke thirrur Allahu Ekber katër herë.”

Më e rëndësishme për të vdekurin, por edhe obligim i të gjallëve ndaj të vdekurit është falja e namazit të xhenazes dhe larja e xhenazes (këto janë farze), pastaj ndarja e trashëgimisë, larja e borxhit, zbatimi i testamentit, e pastaj çështjet tjera dhe ngushëllimi i familjarëve, ndërsa ajo që po ndodhë është se më shumë po i jepet rëndësi ngushëllimit se sa çështjeve të cilat i përmendëm.

Edhe pse vdekjet janë përditshmëri, edhe pse për çdo ditë jemi në ceremoni të varrimit dhe të ngushëllimit, prapëseprapë është heshtur dhe heshtet për të rregulluar një formë më të mirë të mënyrës së ngushëllimit për të vdekurin, duke filluar prej momentit të vdekjes e deri te mbyllja e odës apo siç quhet mbyllja e të pames.

Pra, pas varrimit dhe pas ditës së varrimit hapet e pamja, është e sigurt se kjo fjalë buron nga populli dhe është zëvendësuar në vend të fjalës “teazije” e cila ka për qëllim ngushëllimin.

Ngushëllim do të thotë nxitje për durim apo përpjekje për durim.

Ngushëllimi është mustehab, sepse me ngushëllim manifestohet ndihma reciproke, përkrahja e ndërsjellët, mëshira mes vete përmes të cilit fitohet shpërblimi.

Ibni Maxhe dhe Bejhekiu transmetojnë me senedin Hasen nga Amër bin Hazmi se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

“Çdo musliman kur ta ngushëllojë (e nxitë për durim) vëllanë e tij për ndonjë fatkeqësi, Allahu e zbukuron atë me rroba të ndershmërisë në Ditën e Kijametit.

Ngushëllimi mund të bëhet edhe para varrimit, por edhe pas varrimit.

Kur shkohet “për të pame” apo për ngushëllim, ngushëlluesi i thotë të ngushëlluarit:

-A je mërziur (për babën, nënën, motrën, vëllanë, etj.).

I ngushëlluari përgjigjet: - Jam mërzi.

-Mos u mërzi, krejt jemi të asaj rruge (udhe), s’kemi çka me bë – i thotë ngushëlluesi.

Pas kësaj mënyrat e shprehjes së ngushëllimit të cilat përdoren janë si në vijim:

-Zoti e mëshiroftë, Zoti e past mëshirue, etj.

-Zoti e shpërbleftë me Xhenet.

-Zoti ia past fal gabimet (mëkatet), Allahu magfired.

Transmeton Uthmani r.a. se pasi varrosej i vdekuri, Muhamedi a.s. qëndronte edhe pak dhe thoshte:

“Kërkoni falje për të vdekurin (vëllanë tuaj) dhe kërkoni që t’ia forcojë fjalët e tij në botën tjetër, sepse ai tani është duke dhënë përgjigje.”

Ndonjëherë dëgjojmë: “Zoti ju dhasht sabrin, apo, Zoti u dhasht durimin.

Kjo mund të jetë prej rastit të Jakupit a.s. kur djemtë e tij i vinë në shtëpi dhe i thonë se ujku e ka ngrënë djalin e tij Jusufin a.s. dhe ai ka thënë: **“Më së miri është që të durohet me durim të mirë.” (Fe sabrun xhemile – durimi është çështja më e bukur).**

Ndonjëherë dëgjohet “të gjithë të asaj rruge jemi”, kjo buron nga ajeti kur’anor:

“Secili njeri do ta përjetojë vdekjen, pastaj te Ne do të kthehen.”

“Zoti ja past fal imanin (besimin).” Kjo ng dëshira që i vdekuri të ketë vdekur me besim, etj.

Ekzistojnë edhe forma të tjera të ngushëllimit, siç janë:

-Kofsh shëndosh;

-E paq kryet shëndosh.

Por për këtë formë të ngushëllimit nuk dihet se nga buron, me fjalë tjera këto ka mundësi që burojnë nga vet populli të cilët luten që i gjalli të mos e teproj me mërzi për shkak të të vdekurit dhe kështu të kalojë në fazë depressive dhe të lodhet për së tepërmi dhe ta dëmtoj veten e tij nga mërzia.

Mënyra më e mirë e ngushëllimit është kjo:
Zoti i Madhëruar e mëshiroftë të vdekurin tuaj.
Me mëshirën e Tij e kurseftë nga vuajtjet.
Juve ju ndihmoftë me durim për këtë rast.
Dhe ju shpërbleftë.

Ekziston edhe një formë tjetër e ngushëllimit:
Vërtetë Allahu e ka marrë në mëshirën e Tij.
Ai e ka në kompetencë
dhe çdo gjë e ka afatin e caktuar,
dhe kthehet tek Ai.
Bëhu e durueshme se Zoti të shpërblen.

Edhe pse në të kaluarën nuk kanë qenë mjetet e komunikacionit (udhëtimit modern) dhe numri i vizitorëve (ngushëlluesve) ka qenë më i vogël e pamja apo ceremonia e ngushëllimit ka zgjatur dy muaj, e pastaj një muaj, e më vonë dhjetë ditë, pastaj shtatë ditë, pastaj pesë ditë, ndërsa në ditët e sodit tri ditë, kurse pas tri ditëve, në shtëpi (në familje) mund të zgjat edhe më shumë.

Në kohë të fundit “e pamja” me fjalë tjera për ngushëllime pritet në shatore dhe në shtëpi apo dhoma të pritjes për ngushëllime. Përpos ngushëllimit është mirë që para të pranishmëve të përkujtohen të mirat e të vdekurit sepse Muhamedi a.s. ka thënë: ***“Përkujtoni të mirat e të vdekurve tuaj.”***

Kjo sepse i vdekuri nuk ka mundësi të kthehet, ndërsa të gjallët duke i dëgjuar të mirat e tij (nga i vdekuri) motivohen dhe edukohen që edhe ata të vazhdojnë me të mira.

Në fund duhet ditur që kur të vdes ndonjë njeri vjen në pyetje njëra prej dy çështjeve **“Ose është i liruar nga njerëzit ose njerëzit janë liruar prej tij.”** sepse nëse ka qenë i mirë, ai është liruar nga krijesat, ndërsa nëse ka qenë njeri jo i mirë, atëherë krijesat janë liruar prej tij.

TRADITA (EL-URFU)

Te fukahatë, tradita është një prej argumenteve të Sheriatit. Në shumë prej çështjeve sekondare të fikhut gjykohet sipas parimit të traditës, posaçërisht në përbetime, betime dhe shkurorëzime. Ibn Abidin, në librin e tij “Erkhuz”, thotë: “Tradita në sheriat merret në konsideratë, nga shkakku se dispozitat sillen rreth saj. Traditë quhet ajo që njerëzit e bëjnë zakon, përhapet në masë, e veprohet në mes tyre në çdo rast të tillë. Me fjalë të tjera, është shprehje që është e njohur kur të thuhet në kuptim të veçantë, të cilin gjuha nuk e ka thënë në rend të parë, dhe nuk i ka shkuar në mend dikujt, derisa është dëgjuar, me një falë, është zakon në shoqëri.” Ky përkufizim përfshin definicionin teorik dhe praktik. Dijetari i njohur Nesefiju (Abdullah bin Ahmed), në librin e tij “El-Mustesfa”, thotë: “Tradita dhe zakoni janë çështje të cilat kanë zënë vend në shpirtin nëpërmjet mendjeve (logjikës), ndërsa natyrshmëria e shëndoshë i pranon si të tilla.” Në shpjegimin dhe sqarimin e tij thuhet: “Zakoni është çështje e përsëritur, e cila nuk është e ndërlidhur me logjikën”. Ibn Abidini në librin “Risaletu” rreth traditës (urfit) thotë: “Të përsëriturit dhe shprehia e njëpasnjëshme, e cila bëhet çështje e njohur dhe zë vend në shpirtin dhe mendje, e pastaj pranohet pa kurrfarë kushti dhe argumenti, saqë bëhet e vërtetë zakonore.”

Për sa i përket gjendjes dhe praktikimit të tyre, tradita dhe zakoni kanë një kuptim.

Shembull i traditës praktike: Shprehia e njerëzve në shitblerje (marrje, pagesë) pa e shprehur me gojë; shprehia e ndarjes së mehrit të martesës në meher të menjëhershëm dhe të afatizuar; shprehia e njerëzve në ngrënien e bukës dhe mishit të deles.

Shembull i traditës së bërë shprehi: Tradita e njerëzve që, kur të shprehin fjalën fëmijë, kanë për qëllim mashkullin e jo femrën; po ashtu peshkun nuk e konsiderojnë mish, ose kur me fjalën “Dabetun” (kafshë), kanë për qëllim kalin.

Dallimi në mes traditës dhe ixhmait

Ixhmai ndërtohet mbi pajtueshmërinë e muxhtehidëve të umetit, ndërsa *tradita* nuk kushtëzohet që të ketë pajtueshmëri të muxhtehidëve të umetit, veçse mjafton që një çështje ta pranojnë shumica, e në atë shumicë bëjnë pjesë edhe dijetarët edhe njerëzit e rëndomtë. Nga ky aspekt, tradita i përngjan sjelljes dhe edukatës së njerëzve.

Llojet e traditës

Tradita, pa marrë parasysh a është traditë që ka kaluar në shprehje apo traditë praktike, është dy llojesh:

- traditë e përgjithshme dhe
- traditë e veçantë.

Traditë e përgjithshme : Është ajo që e kanë bërë traditë qytetarët në një prej kohëve. *Shembull:* Tradita në punë të prodhimeve; përdorimi i falës haram në kuptim të shkurorëzimit, për të bërë të pavlefshëm aktin e kurorëzimit; hyrja në banjë publike dhe pastrimi në të, pa u caktuar koha.

Traditë e posaçme: Është ajo që e kanë bërë traditë banorët e një qyteti, ose e një pakice a një grupi të caktuar njerëzish, si f.v.: Banorët e Irakut e kanë bërë traditë që kalin ta quajnë “Dabetun” (kafshë), konsiderimi si argument për borxh i regjistrave të tregtarëve.

Përveç kësaj, tradita ndahet në:

- traditë të shëndoshë dhe
- jo të shëndoshë.

Traditë e shëndoshë është tradita e njerëzve sipas së cilës nuk e bëjnë të lejuarën të ndaluar dhe as të ndaluarën të lejuar. Si f.v.: Dhënia e kaparit për mallra para prodhimit; tradita që gruaja të mos kalojë në shtëpinë e burrit të saj, derisa të mos marrë një sasi të mehrit, dhe se mehri është dy

llojesh: mehri i menjëhershëm dhe mehri i mëvonshëm, dhe ajo që i jep i fejuari së fejuarës gjatë fejesës, konsiderohet dhuratë, e jo pjesë e mehrit.

Traditë jo e shëndoshë është tradita e njerëzve sipas së cilës lejojnë të ndaluarën ose ndalojnë të lejuarën, si f.v.: Tradita e të vepruarit me kamatë dhe praktika e të vepruarit me fajde; përzierja e femrave me burra në manifestime dhe tribuna të ndryshme, në vende publike.

Zbatimi i traditës

Janë të panumërt shembujt për veprime sipas traditës, nga shkak se baza e traditës është ndryshimi i kohës dhe i gjeneratave. Për këtë arsye unë do të tregoj vetëm disa pjesë prej shembujve, të cilët kanë lidhje me jetën praktike:

- Gjykimi tradicionalisht për orenditë e shtëpisë, të cilat blihen para martesës e tradita ia jep të drejtën bashkëshortes, prandaj nuk merret parasysh deklarimi i burrit se para martesës kanë qenë të tijat;

- Hyrja e pjesës së epërme në shitblerje të banesave, edhe pse akti nuk përfshin të drejtën e banesës dhe pjesën e epërme të saj. Kjo kuptohet vetëm në aspektin e traditës;

- Parapagimi i prodhimit industrial. Tradicionalisht është e lejuar, pasi që njerëzit kanë nevojë, edhe pse është shit-blerje inekzistente në momentin e kontratës;

- Malikijët dhe dijetari i umetit, prej dijetarëve hanefijë, Hulvani, kanë lejuar blerjen e frutave në pemë nëse një pjesë e tyre ishin të pjekura e një pjesë jo, si f.v.: shalqiri, domatja, rrushi, e të ngjashme, pasi që është bërë traditë shitblerja e tyre dhe për shkak të domosdoshmërisë, edhe pse një pjesë e tyre konsiderohet shitblerje inekzistente. Këtë dispozitë e kanë kundërshtuar shafijjtë, hanbelijët dhe, sipas një mendimi, edhe hanefijët, edhe pse Ibn Abasi kishte lejuar shitblerjen e tillë, e jo në kundërshtim me të. Edhe tradita gjykon të njëjtën gjë;

- Blerja e mallrave të nevojshme si: orë, zmadhues të zërit, rrobalarëse, frigoriferë me garanci, dhe kushtëzimi për riparimin e tyre nëse prishen brenda një afati të caktuar. Kjo është e lejuar sipas parimit të traditës së përgjithshme, përballë tekstit të hadithit: ***“Pejgamberi a.s. ka ndaluar shitblerjen me kusht.”*** Ndërsa hanefijët në “Kapitullin e kushteve” e kanë lejuar këtë. E vërteta është se tradita e përgjithshme nuk është në

kundërshtim me hadithin, por është në bazë të kijasit. Sikurse thotë Ibni Abidini: “Nga shkaku se hadithi tregon arsyen që të mos lindë konflikti në kontratë, dhe sepse qëllimi është *të mos ketë konflikt*. Ndërsa këtu (shitblerja me garanci) ndërpret mosmarrëveshjet. E traditë e kësaj është ndërprerja e mosmarrëveshjeve. Kjo është në përputhshmëri me hadithin, e edhe tradita gjykon të njëjtën gjë.”;

- Fjala *vakëflënës* ndërtohet në bazë të traditës, e cila ka dominuar në kohën e tyre. Muhamed bin Hasani ka lejuar vakëfin e pasurisë së luajtshme nga pasuria e paluajtshme, nëse njerëzit kanë lënë vakëf në atë mënyrë, mendim që është në kundërshtim me mendimin e Ebu Hanifes se vakëfi duhet të jetë i përgjithshëm.;

- Detyrimi i *dijes* (pagimi i gjakut) për vrasjen gabimisht të farefisit (rrethit të dytë të trashëgimisë), që ka qenë traditë arabe, edhe pse ishte paraparë detyrimisht që të ekzekutohej, sepse vrasja është e drejtpërdrejtë;

- Përshtatshmëria në martesë. Gjithashtu kjo është një traditë arabe, edhe pse të gjithë njerëzit janë të njëjtë. E kjo traditë është për perspektivën e bashkëshortes nga shkaku se zakonisht njerëzit e klasës së lartë i nënçmojnë ata të klasës së ulët.

Ndryshimi i ligjeve në bazë të ndryshimit të traditës

Duke pasur parasysh se traditat ndryshojnë, edhe ligjet ndryshojnë gjithashtu. Ligjet e përpiluara në bazë të traditës, ndryshojnë gjithashtu. Kështu thotë Ibni Abidini. Për këtë arsye, për kushtet e ixhtihadit kanë thënë: *Patjetër duhet të dihen traditat e njerëzve*. Shumë ligje ndryshojnë me ndryshimin e kohëve ose për shkak të traditës, ose për shkak të paraqitjes së domosdoshmërisë, ose çrregullimit dhe degjenerimit të qytetarëve të një kohe, sepse, po të mbetej ligji siç ka qenë i mëhershmi, do të ishte i vështirë dhe i dëmshëm për njerëzit. E rregullat e Sheriatit ndërtohen mbi parimin e zbutjes e lehtësimit dhe largimit të dëmit e të çrregullimit. Kështu që njerëzit jetojnë në sistemin më të mirë dhe në situatë më të volitshme. Mund të përfundojmë se, ndryshimi ndodh për shkak të çrregullimit ose zhvillimit, siç do të shihet në **shembujt në vijim**:

Prej dijetarëve të mëvonshëm është dhënë fetvaja për lejimin e marrjes së pagës për mësimin e Kur'anit, për detyrën e Imamit, muedhinit (muezininit) dhe për obligimet e tjera, si për namaz, agjërim e haxh. Kjo është një

dispozitë, e cila është kundërshtuar nga deklarimi i dijetarëve, e prej tyre i hanefijve, të cilët kanë paraparë ndryshimin e kohëve. Dhe caktimi i pagave prej arkës qendrore islame, për ruajtësit e simboleve fetare. Po të angazhoheshin këta për të fituar dhe siguruar për jetën e tyre nga bujqësia, tregtia ose industria, do të humbte Kur'ani dhe njerëzit do të neglizhonin çështjet parimore të fesë;

Garancia për punën e kryer. Esenciale është besnikëria e tij, e ai nuk dënohet, përpos nëse në punë e tepron ose lë mangë diçka. Mirëpo, fukahatë kanë paraparë garantimin duke pasur parasysh ankesat e shumta se ata nuk e kryejnë detyrën si duhet, dhe për të siguruar pasurinë e njerëzve;

- Mosmjaftimi vetëm i pamjes së jashtme të drejtësisë tek dëshmia. Ebu Jusuf dhe Muhamedi kanë dhënë fetva se është e domosdoshme pastërtia e dëshmitarëve, se kështu sigurohet dhe mbrohet e drejta e njerëzve dhe nuk keqpërdoret pasuria e tyre. Duke ditur se është në kundërshtim me atë që ka deklaruar Ebu Hanife - se mjafton pamja e jashtme e drejtësisë në të gjitha dëshmitë, përpos në hududë dhe kisas. Pastërtinë e dëshmisë nuk e ka kushtëzuar duke u bazuar si në kohën e tij. E në atë kohë zotëronte drejtësia, për shkak se jeta në kohën kur ka qenë Pejgamberi a.s. ka qenë më e mira kohë. Por, duke vlerësuar se ka ndryshuar koha dhe është përhapur gënjeshtria, dy nxënësit e tij kanë dhënë fetva në kundërshtim me mendimin e Ebu Hanifes dhe duke zbritur në rangun e traditës;

- Përdorimi i forcës për të pandehurin nga ana e joqeveritarit. Ebu Hanife ka dhënë fetva se nuk lejohet përdorimi i forcës, përpos prej qeveritarit (institucionit). Duke vërejtur se në kohën e tij pengimin dhe ndalimin e atyre që e thyejnë ligjin, e bënte vetëm udhëheqësi (institucioni). Mirëpo, dy nxënësit e tij, duke parë se në kohën e tyre kishin ndryshuar rrethanat, ishte përhapur padrejtësia dhe kishte filluar çrregullimi, dhanë fetvanë që të ndaloheshin edhe prej joqeveritarit. Këta të dy qenë bazuar në rrethanat që kishin qenë në kohën e tyre;

- Ndalimi i vajzave të reja për të marrë pjesë në mesxhide, ku falej namazi me xhemat, edhe pse nuk ishte ndaluar në kohën e Pejgamberit a.s.. E kjo duke pasur parasysh prishjen e moralit dhe përhapjen e imoralitetit;

- Hanefijtë kanë dhënë fetva që burri e ka të ndaluar të udhëtojë me gruan e tij, edhe nëse ka përmbushur obligimin e mehrit të menjëhershëm, e kjo për shkak të prishjes së kohës.

- Gjithashtu kanë dhënë edhe fetvanë se nuk i pranohet deklarimi gruas se nuk e ka marrë pjesën e caktuar të mehrit të mëhershëm, edhe pse ka pasur

kontakt me bashkëshortin, e kjo është se ajo refuzon se ka marrë mehrin, ndërsa rregulli është: *Refuzuesi përbetohet*. Ky rregull nuk zbatohet në këtë rast, për shkak se zakonisht gruaja nuk e lejon veten të kontaktojë me burrin pa e pas marrë pjesën e menjëhershme të mehrit;

- Kërkimi i zekatit prej qiramarrësit të punimit të tokës, e jo prej qiradhënësit. Kështu kanë dhënë fetva dy nxënësit e Ebu Hanifes, sepse kjo ishte më e mirë dhe më e leverdishme për kohën, dhe më e lehtë për fukahatë, për shkak se zekati merret prej frytit. Këtë mendim e kishte edhe Maliku duke dhënë fetva se, zekati i takon qiramarrësit. Edhe pse Ebu Hanife mendon se një e dhjeta e zekatit i takon qiradhënësit, për shkak se zekati është pasuri e pronësuesit, kurse toka është pronë e qiradhënësit.

Këto shembuj e të tjerë, si f.v., shitblerja e plotësuar, shfrytëzimi i banjës publike pa sqaruar kohën e qëndrimit dhe pa sqaruar sasinë e shpenzimit të ujit, dhe falja e namazit duke qenë i papastër, për shkak të domosdoshmërisë, kanë ndryshuar ligjet për shkak të zakoneve të qytetarëve të kohëve dhe rrethanave të ndryshme të tyre.

TRASHËGIMIA E FEMRËS NË SHERIATIN ISLAM

Përpos shpifjeve të shumta që i bëhen islamit, sidomos ndaj shkeljes së të drejtës së femrës, shpifet edhe në atë se islami nuk i jep të drejtë të barabartë femrës në trashëgimi me mashkullin, por një hise femrës, dy mashkullit.

Duhet pasur parasysh se në përcaktimin e trashëgimisë ndikojnë tri peshoja.

E para: shkalla e afërsisë

- Sa më i afërt të jetë trashëgimtari, pjesa e trashëgimisë është më e madhe, pa marrë parasysh a është mashkull apo femër.
- sa më i largët të jetë trashëgimtari pjesa e trashëgimisë është më e vogël pa marr parasysh a është mashkull apo femër.

E dyta: Gjenerata e paraardhësve dhe pasardhësve.

Kur i vdekuri e ka gjeneratën para jetës së tij (paraardhësit) dhe gjeneratën pas jetës së tij (pasardhësit), atëherë gjenerata pas jetës së tij merr pjesë më të madhe (se ai ka nevojë më shumë për mjete materiale) se sa gjenerata para jetës së tij (sepse paraardhësit kanë nevojë më pak për mjete materiale se sa pasardhësit) pa marrë parasysh a janë meshkuj apo janë femra.

- Vajza si pasardhëse trashëgon më shumë se nëna paraardhëse ndërsa që të dyja janë femra dhe që të dyja janë të lidhura drejtpërsëdrejti me trashëgimlënësin, bile vajza trashëgon edhe më shumë se baba (i cili është mashkull) edhe pse lidhja e të dyve është e drejtpërdrejtë.
- Djali si pasardhës trashëgon më shumë se baba i cili është paraardhës edhe pse që të dy janë meshkuj.

Sipas L.T.K pasardhësit i përjashtojnë nga trashëgimia paraardhësit në tërësi.

E treta: Përkujdesjen të cilin e parasheh sheriatu islam si obligim

Sheriatu islam e obligon mashkullin(burrin) që të përkujdeset për ushqimin,veshmbathjen dhe vendstrehimin e femrës(gruas). Për këtë arsye për të mos e dëmtuar, është parapa që mashkulli të merr pjesën e dy femrave.

Në përgjithësi femra trashëgon në katër mënyra:

- 1. Mënyra e parë: femra trashëgon sa gjysma e mashkullit.**
- 2. Mënyra e dytë: femra trashëgon barazi me mashkullin.**
- 3. Mënyra e tretë: femra trashëgon me shumë se mashkulli.**
- 4. Mënyra e katërt: femra trashëgon, mashkulli nuk trashëgon.**

1. Trashëgimia e femrës sa gjysma e mashkullit

Femra trashëgon sa gjysma e mashkullit në këto raste:

E para: vajza me djalin.

Nëse i vdekuri lë pas vete vetëm një vajzë dhe një djalë:

1/3 i takon vajzës;

2/3 i takojnë djalit.

Kështu femra ka marrë një hise mashkulli dy hise.

E dyta: baba me nënën vetëm me një rast.

Nëse i vdekuri lë pas vetëm nënën dhe babën:

1/3 i takon nënës,

2/3 i takojnë babës.

Kjo ndarje, pra nëna të merr një hise më pak se baba vetëm në rast se i vdekuri nuk lë pas vete fëmijë, e nëse lë fëmijë atëherë nëna merr hise të barabartë me babën.

Në një hadith Muhamedi a.s. thotë:

“Farzmarrësëve jepuni pjesën farz (të përcaktuar, e çka të mbetet jepjani mashkullit burrë.)”

E treta: motrat me vëllezërit dhe motrat prej babe me vëllezërit prej babe.

Nëse i vdekuri nuk lë pas vete prindër, gjyshër dhe as fëmijë, nip e mbesa, por vetëm motër e vëlla, atëherë ndarja bëhet kështu: një hise motra, dy hise vëllai. Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an ka thënë:

“Po nëse ata janë vëllezër-burra dhe gra, atëherë mashkullit i takon aq sa dy femrave së bashku.” (En Nisa, 176).

Shembull:

I vdekuri lë pas vete një vëlla dhe një motër:

1/3 i takon motrës;

2/3 i takon vëllait.

Por, në qoftë se i vdekuri nuk lë pas vete prindër, gjyshër, as fëmijë, nipa e mbesa, as vëllezër e motra, por vetëm një motër prej babe dhe një vëlla prej babe, atëherë ndarja bëhet kështu:

1/3 e merr motra prej babe;

2/3 i merr vëllai prej babe.

Një hise i merr motra prej babe dhe dy hise i merr vëllai prej babe. Kjo është argumentuar me ajet kur'anor:

“Po nëse ata janë vëllezër - burra dhe gra (motra) atëherë mashkullit i takon aq sa dy femrave.” (Nisa : 176)

E katërta: burri dhe gruaja.

Duhet ditur se kurrë nuk ndodh që burri me gruan të trashëgojnë të njëjtën kohe si burrë e grua. Por gjithmonë me vdekjen e njërit trashëgon tjetri dhe anasjelltas. Sipas rregullit të sheriatit islam: Pas vdekjes së gruas, burri trashëgon dyfishin që do ta kishte trashëguar gruaja po të vdiste ai, pra burri trashëgon një hise më shumë. Këtë e argumentojmë me ajetin kur'anor:

“Juve (burrave), ju takon gjysma e asaj që kanë lënë gratë tuaja, nëse nuk kanë fëmijë, e nëse kanë fëmijë, atëherë për ju është një e katërta

nga ajo që kanë lënë, pasi të zbatohet testamenti që kanë lënë ose t'i paguhet borxhi,

Dhe grave ju takon një e katërta nga ajo që lini ju, nëse nuk keni fëmijë, e në qoftë se keni fëmijë atyre ju takon një e teta...” (Nisa, 12)

2. Trashëgimia e femrës barazi me mashkullin

Femra trashëgon barazi me mashkullin në këto raste:

E para: Baba dhe nëna trashëgojnë hise të barabarta kur i vdekuri lë pas vete fëmijë, qoftë mashkull, qoftë femër.

Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë:

“Kurse prindërve, çdonjërit prej tyre i takon një e gjashta që ka lënë, nëse ka fëmijë.” (Nisa, 12)

Shembull:

Nëse i vdekuri lë pas vetes vetëm nënën, babën dhe një djalë, atëherë ndarja bëhet kështu:

1/6 i takon babës;

1/6 i takon nënës;

4/6 i merr djali pjesën shtesë (teasibë).

Pra, gjinia femërore trashëgon barazi me gjininë mashkullore kur janë të një kategorie.

E dyta: Vëllezërit prej nëne me motrat prej nëne.

Nëse e vdekura lë pas vetes burrin, nënën, një vëlla prej babe dhe një motër prej nëne atëherë ndarja bëhet kështu:

½ i takon burrit;

1/6 i takon nënës.

Motra prej babe dhe vëllai prej babe, marrin pjesë të barabarta prej sasisë së 1/3, pra secili nga 1/6, që do të thotë pjesë të barabarta mashkulli me femrën.

3. Femra trashëgon më shumë se mashkulli

Në shariat islam sistemi i trashëgimisë bazohet në dy çështje thelbësore e ato janë:

E para: trashëgimia obligative e përcaktuar me Kur'an dhe hadithe, që do të thotë trashëgimtarit i takon pjesa aq sa është përcaktuar tekstualisht dhe në mënyrë decitive duke filluar prej $2/3, 1/3, 1/6, 1/2, 1/4$ deri në $1/8$.

E dyta: trashëgimia obligative e papërcaktuar dhe e pa definuar, e cila trashëgohet pas trashëgimisë obligative. Këtu bëjnë pjesë trashëgimtarët të cilët në shariat islam quhen trashëgimtarë “asaba” e që pastaj kemi 3 lloje të këtyre trashëgimtarëve.

1. ASABA BI NEFSIHI (Bashkëtrashëgimtari me gjininë e tij): ku bëjnë pjesë:

- djali me djalë dhe djalit,
- baba me gjyshin,
- vëllai me vëllanë e babës dhe fëmijët e tyre,
- axha me djemtë e tij.

2. ASABA BIL GAJRI (Bashkëtrashëgimtari me gjininë tjetër): ku bëjnë pjesë:

- vëllai me motrën,
- djali me vajzën,
- djali i djalit me vajzën e djalit e kështu me radhë.

3. ASABA MEAL GAJRI (Bashkëtrashëgimtari me rangun tjetër): ku bëjnë pjesë:

- Motra me vajzën ose me vajzën e djalit
- Motra e nënës me vajzën ose me vajzën e djalit
- Motra e babës me vajzën ose vajzën e djalit.

Rregull është që në rend të parë pjesën e trashëgimisë e marrin personat obligativ çka u takon në formë të prerë, e pastaj e trashëgojnë

trashëgimtarët e quajtur “asaba” të cilët e marrin pjesën tjetër të mbetur pas farzit.

Është e vërtetë se femrat më shumë trashëgojnë pjesë obligative, që do të thotë se në të shumtën e rasteve trashëgimia obligative është më fatlume për ta se sa trashëgimia “asaba”. Këtë do ta dëshmojmë në vijim:

Trashëgimtarët obligativ (As’habul furud)

2/3 Trashëgojnë:

1. dy vajza e më shumë 2. dy vajza të djalit e më shumë 3. dy motra e më shumë 4. dy motra të babës e më shumë.

1/2Trashëgojnë:

1. një vajzë , 2. një vajzë djali, 3. një motër, 4. baba, 5. burri

1/3Trashëgojnë:

1. nëna, 2. motra prej nëne, 3. vëllai prej nëne.

1/6 Trashëgojnë:

1. nëna, 2. gjyshi, 3. vajzat e djalit, 4. motrat, babës, motrat, nënës, vëllai prej nëne, 5. baba, 6. Gjyshi 7. Gjyshja.

1/4 Trashëgojnë:

1. burri, 2. Gruaja.

1/8 Trashëgon:

Gruaja.

Shumë qartë shihet se trashëgimtar obligativ (farz) në Kur’an janë më shumë femra se meshkuj.

1/3 e trashëgimisë vetëm në një rast meshkuj ndërsa në tri raste tjerat raste femra.

1/2 e trashëgon vetëm një rast mashkulli në tri raste të tjera femrat.

1/3 e trashëgon vetëm një rast mashkulli ndërsa në dy raste femra.

1/6 në tre raste trashëgon mashkulli pesë raste femra.

1/4 në një rast femra në një rast mashkulli.

1/8 trashëgon femra.

Proporcioni i trashëgimisë farz meshkuj me femra është 17 me 6 në favor të femrës.

4. Femra trashëgon, ndërsa mashkulli paralel nuk trashëgon

Ka raste ku femra trashëgon, ndërsa në rast tjetër të ngjashëm mashkulli nuk trashëgon.

Shembull:

I vdekuri lë pas vete Burrin, babën, nënën, vajzën dhe vajzën e djalit.

Burri	Baba	Nëna	Vajza	Vajza e djalit
1/4	1/6 +pjesën shtesë	1/6	1/2	1/6

I vdekuri lë pas vete Burrin, babën, nënën, vajzën dhe djalin e djalit.

Burri	Baba	Nëna	Vajza	Djali i djalit
1/4	1/6+ Pjesën shtesë	1/6	1/2	0

Në rastin identik vajza e djalit ka trashëguar, ndërsa po i njëjti rast kur është djali i djalit ai nuk ka trashëguar.

Pra në rast identik ku vajza e djalit ka trashëguar një të gjashtën pjesë farz, ndërsa mashkulli, pra djali i djalit nuk ka trashëguar sepse është

trashëgimtar asaba e në këtë rast nuk ka mbetur asgjë. Nëse thuhet po në këtë rast mashkulli ka të drejt në testamentin obligativ (vasijetin vaxhib). Përgjigja është se, për testamentin obligativ nuk janë pajtuar të gjithë dijetarët. (Nuk është aprovua ixhmai).

HISTORIKU I TË DREJTËS TRASHËGIMORE NË ISLAM

Institucioni i trashëgimisë konsiderohet si një ndër institucionet më të vjetra të së drejtës civile dhe paraqitet edhe si një fakt social në çdo shoqëri. Pasuria trashëgimore e trashëgimlënësit, brez pas brezi, ka kaluar tek trashëgimtarët sipas brezave juridikisht valide për thirrje në trashëgimi.

E drejta trashëgimore ka filluar të paraqitet me shkatërrimin e gjensit/rregullimit farefisnor dhe atij fisnor.

Në gjensin romak, pasuria e personit që do të vdiste trashëgohej në kuadër të gjensit, kurse veglat dhe mjetet personale varroseshin bashkë me të vdekurin.

Në komunitetin shoqëror skllavopronar, skllavopronarët kanë pasur të drejtë me ligj të trashëgojnë trashëgim me burrin me të cilin kanë qenë të lidhur në bashkësi të jetës dhe punës.

Në komunitetin shoqëror feudal, në bazë të ligjit trashëgohej vetëm prona feudale dhe si feudal. Karakteristikë e periudhës feudale është pandashmëria e pronës feudale dhesi trashëgimtar i vetëm ligjor paraqitet i biri madhor i trashëgimlënësit.

Përveç ligjit, si bazë për t'u thirrur në trashëgimi, në feudalizëm ekzistonte edhe kontrata mes personave, me anë të së cilës subjektet e marrëveshjes në fjalë akordonin vullnetin e tyre, ashtu që, në rast vdekjeje të njëjës nga palët, pasuria i kalonte palës që jetonte më shumë.

Në sistemin komunist, në shtetet ish-socialiste janë zhvilluar debate të gjera për heqjen e së drejtës trashëgimore, duke e quajtur trashëgiminë si produkt të shoqërisë borgjeze dhe të lidhur ngushtë me ekzistimin e pronës private dhe të eksploatimit të njeriut nga njeriu.

Me dekretin mbi heqjen e trashëgimisë të komitetit qendror ekzekutiv gjithrues të kongresit të punëtorëve, ushtarakëve dhe të deputetëve fshatarë, të cilin e kishte përgatitur Lenini, në kuadër të tezave të prillit, parashikohej që pasuria trashëgimore e trashëgimlënësit, qoftë e luajtshme, qoftë e paluajtshme, të shndërrohet në pronë shtetërore.

Pra abrogoheshin normat tradicionale mbi trashëgiminë dhe kështu shteti shndërrohet në trashëgimtar të vetëm të saj. Megjithatë, me dekret nuk abrogohen të gjitha dispozitat mbi trashëgiminë në republikën e asaj kohe. Në qoftë se personat në gjini të vijës së drejtë, vëllezërit e motrat dhe

bashkëshorti, janë të paaftë për punë, mbajtja e tyre edhe më tutje do të sigurohej nga prona trashëgimore, derisa të mos realizohej e drejta e sigurimit social për të gjithë ata që janë në nevojë.

Gjatë zhvillimit të historisë të së drejtës trashëgimore janë formuar sisteme të ndryshme trashëgimore, por më të njohurat janë tri:

1. Sistemi i gjakut të përbashkët;
2. Sistemi i shkallëve të gjinisë;dhe
3. Sistemi parenteral.

1. Sistemi i gjakut të përbashkët.

Ky sistem nisët nga supozimi filozofik se fëmijët trashëgojnë 50 për qind të gjakut të secilit prind e 25 për qind nga gjyshërit e 12,5 për qind nga stërgjyshërit. Sipas këtij sistemi personat më të afërt janë vëllezërit dhe motrat, sepse ata kanë 100 për qind të gjakut të përbashkët, 50 për qind nga nëna dhe 50 për qind nga babai. Prindërit dhe fëmijë kanë nga 50 për qind të gjakut të përbashkët. Dobësi e këtij sistemi është se vëllezërit dhe motrat i përjashtojnë fëmijët dhe prindërit nga trashëgimia. Për këtë arsye, ky sistem nuk praktikohet sot askund në botë, përpos te popujt e pazhvilluar dhe primitiv.

2. Sistemi i shkallëve të gjinisë.

Ky sistem e ka prejardhjen nga e drejta romake dhe gjeti zbatim në vendet ish-socialiste, e posaçërisht në Rusi. Sipas këtij sistemi trashëgimia bëhet si vijon:

- Në radhën e parë bëjnë pjesë fëmijët (djem e vajza) dhe prindërit e trashëgimlënësit, sepse janë persona në gjini të shkallës së parë;
- Në radhën e dytë bëjnë pjesë nipërit dhe mbesat, gjyshërit dhe gjyshet, sepse janë persona në gjini të shkallës së dytë me trashëgimlënësin;
- Në radhën e tretë bëjnë pjesë stërnipërit dhe stërmbesat, kushërinjtë, dajallarët, tezet, etj..

Sipas këtij sistemi, të afërmit në gjini përjashtojnë nga trashëgimia më të largët, sepse janë të shkallës më të largët.

3. Sistemi parenteral.

Sipas këtij sistemi personat grupohen në parentela (breza). Në këtë sistem parentelat (brezat) formohen si vijon:

- Parentela e parë, në të cilën bëjnë pjesë fëmijët dhe pasardhësit e tij (nipërit dhe stërnipërit);
- Parentela e dytë, në të cilën bëjnë pjesë prindërit dhe pasardhësit e tyre, pra vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit, si dhe pasardhësit e tyre (djali i vëllait, djali i motrës).
- Parentela e tretë, në të cilën bëjnë pjesë gjyshërit dhe gjyshet dhe pasardhësit e tyre (kushërinjtë dajallarët dhe tezet);
- Parentela e katërt, në të cilën bëjnë pjesë stërgjyshërit dhe stërgjyshet dhe pasardhësit e tyre.

Sistemi i trashëgimisë te jehudët

Te jehudët, sistemi i trashëgimisëka kaluar në disa etapa. Para se të përmendim etapat, duhet të theksojmë se sa i përket ligjeve të trashëgimisë tek jehudët, ato kanë ndryshuar në kohëra të ndryshme.

Dhiata e Vjetër ndryshon prej ligjevetë Talmudit, dhe që të dyja, pra si Dhiata e Vjetër, ashtu edhe Talmudi, ndryshojnë nga ligjet tek jehudët bashkëkohorë. Për këtë arsye ne do të shpjegojmë sistemin e trashëgimisë tek jehudët si vijon:

1. Trashëgimia në Dhiatën e Vjetër;
2. Trashëgimia në Talmud;
3. Trashëgimia në kohën e sotme.

1. Trashëgimia e Jehudëve sipas Dhiatës së Vjetër

Sipas Dhiatës së Vjetër, Jehudët kanë shkuar në atë drejtim, duke i dhënë të drejtë trashëgimie djalit, e jo vajzës, ose thënë me fjalë të tjera, djali e mbulon (e përjashton) vajzën dhe vajza nuk ka të drejtë të trashëgojë asgjë nga prindërit e saj. Po ashtu edhe gruaja, e cila nuk ka fëmijë, nuk trashëgon asgjë nga burri i saj, por burrin e saj e trashëgon vëllai i tij, ose të afërmit e tij.

Mirëpo me kalimin e kohës kanë filluar të trashëgojnë vajzat, nëse babai i tyre nuk ka djem, ose thënë me fjalë tjera vajza trashëgon kur nuk ka vëllezër fare, e jo së bashku me vëllezërit. Kjo ka ndodhur me vajzat e Sulfahadit, mirëpo edhe kjo me kusht që ata të martohen me të njëjtin fis, pra me qëllim që trashëgimia të mos kalojë jashtë fisit apo familjes. Vajzat e Sulfahadit e kanë pasur emrin Muhtetun, Neuhatun dhe Haxhetun. Këto vajza shkojnë te Musa a.s. dhe i thanë:

“Babai ynë ka vdekur dhe nuk ka fëmijë djem. Na jep pasurinë në vend të djemve të tij, pasi që ai nuk ka fëmijë djem”.

Musa e bën një lutje te Zoti që vajzat e Sulfahadit të trashëgojnë pjesën në vend të djemve dhe pasuria e babait të kalojë tek ata. Prej asaj kohe beniisrailët kanë thënë: “Çdo njeri i cili vdes dhe nuk ka djem atëherë pasuria e tij trashëgohet te vajzat e tij. Nga aty është ligjësuar te beni israilët ashtu siç i ka urdhëruar Musa a.s.. Në Dhiatën e Vjetër, ligji i trashëgimisë ka qenë si vijon:

1. Fëmijët

Pa marrë parasysh se a janë djem apo vajza, fëmijët trashëgojnë. Nëse fëmijët janë djem e vajza, vetëm djemtë trashëgojnë, ndërsa vajzat përjashtohen. Po, nëse i vdekuri nuk ka fëmijë djem, atëherë trashëgimia kalon tek vajzat. Kjo në Dhiatën e Vjetër është e përcaktuar kështu: “Çdo njeri i cili vdes dhe nuk ka djalë, atëherë pronësia e tij kalon tek vajza e tij.” (Sufur Ejub sah 42 fq. 12)

Nga kjo shihet se fëmijët djem mbulojnë (i përjashtojnë) baballarët, gjyshërit, gjyshet, vëllezërit dhe të afërmit.

2. Vëllezërit

Nëse i vdekuri nuk ka fëmijë, as meshkuj, as femra, atëherë trashëgojnë vëllezërit. Në Dhiatën e Vjetër, në sufur aded sah, 27 thuhet:

“... dhe nëse nuk ka i vdekuri vajzë, pronësinë jepjani vëllezërve të tij”.

3. Xhaxhallarët

Nëse i vdekuri nuk ka fëmijë, as vëllezër, atëherë atë e trashëgojnë xhaxhallarët. Në Dhiatën e Vjetër, sufur aded sah, 27 fq. 10 thuhet:

“Dhe nëse i vdekuri nuk ka vëllezër pronësinë jepjani axhallarëve të tij.”

4. Farefisi.

Nëse i vdekuri nuk ka axhallarë atëherë trashëgimia kalon te farefisi më i afërt pas tyre. Në sufur ded sah 27 fq. 11 thuhet: “Dhe nëse i vdekuri nuk ka vëllezër atëherë pronësinë jepjani më të afërmeve të tij.”

2. Trashëgimia në Talmud

Sipas Talmudit, mashkulli trashëgon, ndërsa femra nuk trashëgon. Femra është qenie që trashëgohet, ndërsa ajo nuk trashëgon. Apostujt jehudë e kanë praktikuar kështu:

- Trashëgimtarët, të cilët trashëgojnë prej të tjerëve, ndërsa të tjerët, të cilët nuk trashëgojnë prej tyre, janë:
- Fëmija mashkull prej nënës së tij;
- burri prej gruas së tij;
- fëmijët e motrës prej dajallarëve.
- Trashëgimtarët, të cilët nuk trashëgojnë janë: femra (nëna) prej fëmijës së saj, gruaja prej burrit të saj.
- Trashëgimtarët, të cilët e trashëgojnë njëri-tjetrin janë: djali prej nënës, burri prej gruas, vetëm se këtu duhet pasur parasysh se kjo ka qenë në fillim sipas librit Talmud. Mirëpo, këtë formë të trashëgimisë më vonë e kanë ndryshuar apostujt, duke vendosur ligjet si vijon:
- Sistemi i trashëgimisë së babait kur vdes.

Në rend të parë e trashëgon djali.

Nëse nuk ka djem, shikohet nëse ka nipër ose vajza.

Nëse nuk ka vajza, atëherë shikohet nëse vajza ka djem (djem të vajzës) ose vajza të vajzës.

Nëse ata nuk janë, atëherë trashëgimia kalon te babai.

Nëse nuk ka baba, trashëgimia kalon te vëllezërit.

Nëse nuk ka vëllezër apo djem të vëllezërve, trashëgimia kalon te motra.

Nëse nuk ka motër apo djem të motrës, trashëgimia kalon te babai i babait.

Nëse nuk është babai i babait, atëherë trashëgimia kalon te vëllai i babait.

Nëse nuk ka vëllezër të babait, atëherë trashëgimia kalon te babai i babait të babait.

Nëse edhe ai nuk është, atëherë trashëgimia kalon te vëllezërit e babait të babait.

Sipas librit Talmud, djemtë e të vdekurit, të cilët trashëgojnë babin e tyre dhe kanë motër të pa martuar, e kanë obligim që prej një të dhjetës së pasurisë së trashëguar ta martojnë motrën e tyre. Nëse janë shumë motra, të gjitha martohen, por me vlerë jo më shumë se 10 për qind të pasurisë së trashëguar,.

Shihet se Talmudi i jep të drejtë vajzës 10 për qind, për shkak se ajo ka nevojë të martohet. Mirëpo duhet cekur se nëse baba i vajzës vdes, e më vonë edhe gjyshi, atëherë mbesa, pra vajza e djalit, nuk ka të drejtë të trashëgojë prej pasurisë së babait të saj.

3. Trashëgimia e jehudëve në kohën e sotme

Dijetarët jehudë shkojnë në atë drejtim që djemtë të kenë të drejtë trashëgimie, ndërsa vajzat jo. Për të pasur më të qartë këtë, sqarojmë si vijon:

1. Nëse vdes njeriu, i pari i cili trashëgon është djali. Nëse janë shumë djem, atëherë të pamartuarit marrin nga dy hise, të martuarit nga një hise .

2. Nëse nuk ka fëmijë djem, por vetëm vajza, atëherë të gjitha vajzat, të martuarat e të pamartuarat, trashëgojnë njësoj. Nëse është vetëm një vajzë ajo e trashëgon tërë pasurinë.

Për të trashëguar vajza është kusht qëi vdekuri të mos ketë djem ose djem të djemve. Pra, nëse i vdekuri lë pas vetes djem e vajza, atëherë trashëgojnë vetëm djemtë, ndërsa vajzat nuk trashëgojnë asgjë; mirëpo nëse vajzat nuk janë të martuara, atëherë djemtë e kanë për obligim që të përkujdesen për motrat e tyre derisa të martohen, në vlerë të 10% të pasurisë së trashëguar.

Vajza nuk ka të drejtë në 10% të pasurisë së babait në tri raste:

1. Kur i vdekuri ka lënë djem e vajza, atëherë e tëra u takon djemve.
2. Kur i vdekuri ka martuar vajzën deri sa ai ka qenë gjallë.

3. Nëse janë martuar pas vdekjes së babait të tyre dhe nuk kanë kërkuar asgjë.

3. Nëse i vdekuri nuk ka lënë pas vetes fëmijë, atëherë atë e trashëgon babai, ndërsa nëna jo. Pra, as nëna nuk trashëgon prej birit të saj.

4. Nëse i vdekuri nuk lë pas vetes as fëmijë, as prindër, atëherë atë e trashëgon vëllai. Vëllezërit trashëgojnë pjesë të barabarta.

5. Nëse i vdekuri nuk lë as fëmijë, as prindër, e as vëllezër, atëherë atë e trashëgon gjyshi. Edhe në këtë rast nuk i jepet të drejtë gjyshes, çka do të thotë se kjo është një diskriminim i të drejtës së trashëgimisë së femrës.

6. Nëse i vdekuri nuk lë pas vetes as fëmijë, as prindër, as fëmijë, as gjysh, atëherë në radhë vjen axha, ndërsa halla jo. Gruaja nuk ka të drejtë të trashëgojë nga burri i saj, ndërsa burri e trashëgon gruan e tij.

Sistemi i trashëgimisë në krishterizëm

Në krishterizëm, trashëgimtarët ndahen në:

1. Trashëgimtarë obligativ; dhe
2. Trashëgimtarë të brezave.

1. Trashëgimtarë obligativ në krishterizëm janë: burri dhe gruaja.
2. Trashëgimtarë të brezave janë të gjithë trashëgimtarët e tjerë, përpos burrit ose gruas, të cilët trashëgojnë pasi që burri ose gruaja ta trashëgojë pjesën e saj.

Burri trashëgon në tri mënyra:

Mënyra e parë:

Burri trashëgon një të dytën, nëse gruaja s'ka lënë pas vetes fëmijë.

Mënyra e dytë:

Burri trashëgon një të katërtën, nëse gruaja ka lënë pas vetes së paku tre fëmijë, pa marrë parasysh a janë meshkuj apo femra. Mirëpo, nëse janë

më shumë se tre fëmijë, atëherë ai merr pjesë të barabartë me çdonjërin fëmijë; pra, ai konsiderohet si njëri prej djemve.

Mënyra e tretë:

Burri trashëgon tërë pasurinë, nëse e vdekura nuk ka lënë as fëmijë, as prindër e as vëllezër.

Ashtu siç trashëgon bashkëshorti prej bashkëshortes, njësoj trashëgon bashkëshortja prej bashkëshortit.

Te krishterët ekzistojnë dy sisteme të trashëgimisë:

- a) Sistemi ibnul Kalakut; dhe
- b) Sistemi i Asalit.

a) Sistemi ibnu Kalakut

Ibnu Kalaku, patriark i krishterë, trashëgiminë e parasheh në këtë mënyrë:

1. fëmijët, djem dhe vajza, pa marrë parasysh se a janë të martuar apo të pamartuar, që të gjithë trashëgojnë në mënyrë të barabartë. Dhe, nëse ndonjë djalë ka vdekur dhe ka lënë fëmijë, atëherë djemtë e djalit trashëgojnë me xhaxhallarët e tyre prej gjyshit të tyre hisen sikurse të kishte qenë gjallë prindi i tyre.

Pas gjeneratës së djemve trashëgon gjenerata e fëmijëve të djemve, e kështu me radhë.

2. Nëse i vdekuri nuk ka fëmijë apo fëmijë të fëmijëve, atëherë pasi që gruaja e merr pjesën e saj obligative, pjesën tjetër e trashëgon:

Baba $\frac{2}{3}$, ndërsa nëna trashëgon $\frac{1}{3}$. Nëse ndonjëri prej tyre është i vdekur, atëherë hisen e njërit prej tyre e marrin vëllezërit dhe motrat e të vdekurit, në pjesë të barabarta. Nëse ndonjëri prej vëllezërve ose motrave është i vdekur, atëherë hisen e marrin fëmijët e vëllezërve ose fëmijët e motrave të të vdekurit.

3. Nëse i vdekuri nuk ka as fëmijë, as baba e as nënë, atëherë trashëgojnë vëllezërit dhe motrat.

4. Nëse i vdekuri nuk ka as fëmijë, as nënë, as baba, as gjysh e as gjyshe, atëherë në radhë trashëgojnë xhaxhallarët dhe dajallarët.

5. Nëse i vdekuri nuk ka as fëmijë, as nënë e as baba, as vëllezër, as motra, as gjysh, as gjyshe, as axhallarë, as dajallarë, atëherë atë e trashëgojnë fëmijët e gjyshit dhe të gjyshes.

6. Nëse i vdekuri nuk e ka asnjërin prej këtyre, atëherë trashëgojnë dy të tretën së bashku xhaxhallarët dhe hallat e babait, ndërsa dajallarët e babait e trashëgojnë së bashku një të tretën.

7. Nëse i vdekuri nuk ka as asnjërin prej këtyre, atëherë trashëgimia kalon te gjyshërit dhe gjyshet, ashtu që loza e atësisë trashëgon dy të tretat, ndërsa ata tëmëmësisë një të tretën, e nëse ndonjëri prej tyre ka vdekur, atë e trashëgojnë fëmijët e tyre.

8. Nëse nuk është asnjë nga gjeneratat e përmendura, atëherë trashëgojnë xhaxhallarët dhe hallat e gjysheve.

Nëse nuk ka asnjë prej tyre, atëherë pasuria kalon në shtëpinë e patriarkut.

Ky sistemi trashëgimisë është sistemi i Ibni Kalakut. Këtë sistem të trashëgimisë e praktikojnë priftërinjtë e kohës bashkëkohore.

b. Sistemi i Ibni Asalit

Ky është sistemi i dytë i trashëgimisë të të krishterët. Sipas këtij sistemi trashëgimia bëhet në këtë mënyrë:

1. Të vdekurin, në rend të parë, e trashëgojnë fëmijët, meshkuj e femra, në pjesë të barabarta.
2. Pastaj, djemtë e djemve dhe vajzat e djemve.
3. Pastaj, baba.
4. Pastaj, vëllezërit, motrat dhe nëna në hise të barabarta.
5. Pastaj, vëllezërit dhe motrat prej babait.
6. Pastaj vëllezërit dhe motrat prej nënës.
7. Pastaj fëmijët e vëllezërve dhe të motrave.
8. Pastaj baba i babait.
9. Pastaj nëna e babait.
10. Pastaj xhaxhallarët.
11. Pastaj djemtë e axhallarëve.
12. Pastaj fëmijët e vajzës.

13. Pastaj fëmijët e motrës.
14. Pastaj hallat.
15. Pastaj djemtë dhe vajzat e hallës.
16. Pastaj babai i nënës.
17. Pastaj nëna e nënës.
18. Pastaj dajallarët.
19. Pastaj fëmijët e dajallarëve.
20. Pastaj tezet.
21. Pastaj fëmijët e tezeve.
22. Pastaj baballarët e gjyshërve, e kështu me radhë, më i afërm e më i afërm.

Sistemi i trashëgimisë tek arabët para islamit

Para Islamit, në kohën e injorancës, tek arabët sistemi i trashëgimisë ka qenë i rregulluar mbi dy baza:

- a. në bazë të gjinisë,
- b. në bazë të kontratave.

a. Trashëgimia në bazë të gjinisë

Ky sistem i trashëgimisë nuk u ka dhënë të drejtë trashëgimie femrave dhe fëmijëve, pa marrë parasysh a janë meshkuj apo femra, kjo nga shkakun se femra dhe fëmijët nuk kanë qenë të aftë të marrin pjesë në luftë. Pra, paaftësia për luftë me armikun ka qenë arsye tek arabët që këto dy kategori t'i përjashtojnë nga trashëgimia.

b. Trashëgimia në bazë të kontratave

Sipas sistemit të trashëgimisë në bazë të kontratave, po qe se dy persona kanë lidhur kontratë se nëse ndonjëri prej tyre bën krim, vret ndonjë njeri, atëherë tjetri ia paguan gjakun, por edhe për çfarëdo të keqe, përgjegjësitë i kanë të barabarta; nëse ndonjëri prej tyre vdes, e trashëgon tjetri.

Përpos kësaj forme të trashëgimisë, ka ekzistuar edhe forma e birësimit (adoptimit), ashtu që fëmija e ka marrë emrin e babait, te i cili është adoptuar (birësuar), e jo emrin e babait të vërtetë, e pastaj në bazë të kësaj ka pasur të drejtë të trashëgojë.

Me ardhjen e Islamit, sistemi i trashëgimisë tek arabët ka kaluar nëpër tri faza, sepse në mënyrë graduale është vendosur ligji i trashëgimisë dhe atë:

Faza e parë

Në fazën e parë ka zbritur ajeti kur'anor:

“Kur ndonjërit prej jush i është afruar vdekja, nëse lë pasuri pas vete, testamenti (vasijeti) për prindërit dhe për të afërmit ju është bërë juve obligim, por ashtu siç është drejt. Për ata që janë të devotshëm kjo është detyrë që lypset kryer.” (El Bekare, 180)

Ajeti qartë ka treguar trashëgiminë testamentare: që në bazë të asaj trashëgimie të trashëgojë edhe nëna, edhe pse i takon gjinisë femërore, e po ashtu të kenë të drejtë të trashëgojnë dhe fëmijët, pa marrë parasysh a janë meshkuj apo femra.

Faza e dytë

Në këtë fazë zbret ajeti kur'anor:

“Meshkujve u takon një pjesë nga ajo që lënë prindërit dhe të afërmit, por edhe grave u takon një pjesë nga ajo që lënë prindërit dhe të afërmit, pavarësisht a është pak ajo pjesë e caktuar apo shumë, është pjesë obligative.” (En-Nisa, 7)

Në këtë fazë, ajeti tregon për trashëgiminë e femrës, sikurse tregon për trashëgiminë e mashkullit, por pa e definuar dhe pa e përcaktuar masën e trashëgimisë së mashkullit.

Faza e tretë

Në këtë fazë zbret ajeti kur'anor:

“Allahu ju ka bërë obligim që për fëmijët tuaj (trashëgimia) mashkullit t'i takojë dy herë më shumë se femrës.” (En-Nisa, 11)

Shkak i zbritjes së këtij ajeti kur'anor ka qenë se kur gruas së Sead bin Rebas i është vrarë burri në luftën e Uhudit. Ajo i ka pasur dy vajza, ndërsa vëllai i Rebias, pra axha i vajzave, e ka marrë tërë pasurinë, kurse fëmijëve nuk u ka lënë asgjë. Gruaja shkon te pejgamberi s.a.v.s. dhe i thotë: “Axha i vajzave e ka marrë tërë pasurinë, e ata as që kanë mundësi të martohen, sepse nuk kanë pasuri. Muhamedi s.a.v.s i thotë: ***“Prit se Allahu do të gjykojë për këtë.”*** Pastaj ka zbritur ajeti i trashëgimisë dhe pejgamberi s.a.v.s. dërgon një të dërguar te axha i vajzave që t’i thotë: ***“Dy vajzave të Seadit jepja dy të tretat e pasurisë të babait të tyre, një të tretën jepja gruas, dhe çka të mbetet merre për vete.”***

Kështu Islami pastaj në mënyrë të detajuar ka sqaruar hiset e trashëgimisë që quhen farz, të cilat janë të përmbledhura në tre ajetet e sures Nisa.

Sistemi i trashëgimisë tek shqiptarët dhe në Kosovë

Te Iliro-Shqiptarët familja patriarkale ka ekzistuar me shekuj, që nga epoka e bronzit, kur ka lindur familja monogamie e deri në shek. XX, pas luftës së dytë botërore. Kur vdiste një anëtar i familjes së madhe patriarkale, nuk hapej çështja e trashëgimisë dhe nuk ndahej, sepse si trashëgimlënësi, edhe trashëgimtari ishin brenda së njëjtës familje. Gratë ishin të përjashtuara nga shoqëria. Trashëgimia bëhej sipas kanunit.

Koncepti i kanunit ishte si vijon:

Babai kishte për detyrë t’u jepte pasuri, kur ndaheshin nga familja e madhe.

Kanuni e njeh si trashëgimtar djalin, e jo vajzën.

Trashëgimia të jetë në mënyrë të tërthortë, brenda një brezi, në mënyrë të barabartë, në mes të kushërinjve të brezit.

Kur mungon brezi i parë, kalon te brezi tjetër.

Kur mungon fisi, kalon te fisi tjetër.

Kanunet e njohura te shqiptarët janë:

Kanuni i Skënderbeut.

Kanuni i Lumës.

Kanuni i Lekë Dukagjinit.

1. Kanuni i Skënderbeut dhe Kanuni i Lumës.

Kanuni i Skënderbeut e njeh barazinë midis djemve, por nuk e njeh barazinë e djemve me vajza në trashëgimi. Në nenin 88 përcaktohet se: Vajzat, kur ndahet shtëpia shkojnë me prindër, kjo shihet si gjallë të dy apo njeni. Po nuk patën prindër, por vllazën zakonisht shkojnë me të madhin, por për arsye të ndryshme ato shkojnë me cilin vëlla të duen.

Në Kanunin e Skënderbeut dhe të Lumës ekzistojnë dy institucione që krijojnë marrëdhënie pasurore ndërmjet familjes patriarkale. Këto dy institucione ishin “Selemi” dhe “Mirazi”.

Selemi është institut i Kanunit të Skënderbeut. Selemi është pasuri e veçantë e anëtarit të familjes ku një anëtar i familjes në mënyrë të veçantë lidhte ndonjë kontratë me ndonjë anëtar të ndonjë familje tjetër dhe së bashku fitonin e krijojnë pasuri. Mendohet se selemi është shenjë e parë e shpërbërjes së familjes patriarkale. Po ashtu, Selemi ishte edhe pasuria që sillte grujat me rastin e martesës, e me kalimin e kohës ajo pasuri rritej.

Mirazi është institut i kanunit të Lumës. Sipas këtij kanuni, nëse i vdekuri nuk lë fëmijë meshkuj, atëherë vajza e martuar konkurren me kushërinjtë e saj në një të dytën, në një të tretën dhe në një të pestën e tokës për të trashëguar. Pra, trashëgimia e vajzës së martuar, e cila bëhet pronare e tokës të babai i saj, quhet miraz.

Mendohet se në këtë institut ka pasur ndikim perandoria Osmane.

Kanuni i Lekë Dukagjinit përmban dispozita për rregullimin e trashëgimisë prej nenit 88 deri në 131.

Ky kanun sanksionon pabarazinë në trashëgimi jo vetëm të fëmijëve të gjinive të ndryshme, por edhe midis burrit dhe gruas.

Sipas këtij kanuni vajzat nuk kishin të drejtë trashëgimie. Kjo shihet si në vijim:

88. Kanunja një për trashëgimtar djalin, e jo vajzën.

89. djalin e pakunor kanunja nuk e një për trashëgues.

90. nipit të trangut të gjakut i përket trashëgimia, e jo nipit të tamblit a nipit bijash.

91.

- a) as te prindja as te burri gruaja s'hin në pjesë të trashëgimit;
- b) të mos ngrihen prindja e gruas me ngulë në plangët e dhëndrit të dal fare;
- c) të mos përzihen fiset e një flamuri me fise të tjetrit flamur.

Përpos kanuneve të sipërsënuara ekziston edhe instituti Statutet e Shkodrës.

Instituti Statutet e Shkodrës ka fare pak dispozita për trashëgiminë ligjore.

Sipas këtij instituti, në radhë të parë, trashëgojnë bijtë.

Nëse nuk janë bijtë, trashëgon i ati ose nëna.

Nëse nuk janë prindërit, trashëgojnë vëllezërit ose bijtë e tyre.

Nëse nuk janë vëllezërit, trashëgojnë djemtë e motrave.

Nëse nuk janë vëllezërit dhe as bijtë e motrave, trashëgojnë xhaxhallarët dhe bijtë e tyre. Nëse nuk janë xhaxhallarët, atëherë trashëgojnë kushërinjtë deri në shkallën e katërt.

Sipas këtij Instituti pasuria e burrit kalon te gruaja, dhe anasjelltas.

Nëse i vdekuri nuk ka trashëgimtarë, atëherë pasuria kalon në Komunë.

E drejta e trashëgimisë në Kosovë

Prej pas luftës së dytë botërore e deri në përfundimin e Luftës Çlirimtare të Kosovës më 1999, Ligji Trashëgimor i Kosovës ka kaluar në katër faza:

Faza e parë: Prej vitit 1945 deri në vitin 1955;

Faza e dytë: Prej vitit 1955 deri në vitin 1963;

Faza e tretë: Prej vitit 1963, por ligji i miratuarnë vitin 1974;

Faza e katërt: Fillon më 28 Korrik 2004, kur Kuvendi i Kosovës, në Kosovën e çliruar nga okupatori serb, miraton Ligjin e parë për trashëgiminë, i cili Ligj është në fuqi edhe sot.

Edhe në të kaluarën, por edhe sot në Kosovë, ligji i trashëgimisë nuk zbatohet, posaçërisht kur janë në pyetje femrat.

Ndarja bëhet sipas zakoneve, të cilat nuk janë në përputhshmëri me Islamin, edhe pse sipas ligjit u takon hise. Mirëpo kjo e drejtë, atyre u mohohet. Dhe çka është më interesante, mostrashëgimia e tyre i mvishet Islamit, ndërsa trashëgiminëe tyre Islami e ka bërë farz, ashtu siç e ka bërë farz namazin, zekatin, haxhin, agjërimin etj.

Kështu që pasuria trashëgohet brez pas brezi pa dokumente. Mënyrat e trashëgimisë në Kosovë janë si vijon:

1. Ndarja e pasurisë sipas burrave.
2. Ndarja e trashëgimisë pa ndërmjetësues.
3. Trashëgimia si emanet.
4. Trashëgimia e mirazit.

1. Ndarja e trashëgimisë përmes burrave. Janë dy kategori të ndarjes, me pjesëmarrjen apo ndërmjetësimin e burrave:

- a. pjesëmarrja formale e burrave.
- b. pjesëmarrja e burrave për zgjidhjen e kontesteve.

a. Pjesëmarrja formale e burrave

Kryesisht në këtë kategori të ndarjes marrin pjesë burrat e farefisit, vetëm e vetëm për të bërë një akt solemn, për të zbatuar traditën, sepse trashëgimtarët paraprakisht janë deklaruar mes vete se kush çka të marrë. Vëllezërit e marrin çka kanë kërkuar, dhe prej motrave është kërkuar të heqin dorë nga trashëgimia.

b. Pjesëmarrja e burrave për zgjidhjen e kontesteve.

Rastet, kur vëllezërit kanë mosmarrëveshje për ndarjen e pasurisë, kanë qenë dhe janë të shumta, si:

- vdekja e hershme e trashëgimlënësit,
- prishja e marrëdhënieve të vëllezërve para ndarjes së pronës,
- si faktor mund të jetë jeta në bashkësi, ku gratë (kumatat) e nisin sherrin dhe jeta bëhet konfliktuoze dhe e padurueshme.

2. Ndarja e pasurisë pa ndërmjetësim.

Në disa raste vëllezërit merren vesh që të mos ketë ndërmjetësim. Ata pajtohen në mes vete se si ta ndajnë pronën e prindit të tyre, ndërsa motrave u thonë që të heqin dorë nga pjesa trashëgimore e tyre, madje kalon një kohë e gjatë dhe nuk e regjistrojnë pronën në organet kompetente.

3. Trashëgimia si emanet

Në disa raste trashëgimlënësi u thotë trashëgimtarëve që këtë apo atë pronë i lë amanet këtij apo atij personi dhe trashëgimtarët pajtohen me mendimin e tij.

4. Trashëgimia e mirazit

Sipas të drejtës zakonore shqiptare, gruaja nuk mund të ishte trashëgimtare as në shtëpinë e babait, as në shtëpinë e burrit. Në kanunin e Lumës ishte rregulli kështu: “Trashëgimtarë të radhës së parë janë djemtë, e jo vajzat. Nëse i vdekuri nuk kishte djem, por vajza të martuara, vajzat thirreshin si trashëgimtare të radhës së dytë dhe konkurronin së bashku me kushërinjtë e tyre. Pjesa e vajzave në pasurinë e të atit quhet miraz dhe përbëhej nga një e dyta, një e treta dhe një e pesta e tokës.”

Mendoj se fjala “miraz” ka prejardhjen prej gjuhës arabe, që do të thotë “trashëgimi”, pra është fjalë e cila ka kaluar në tri faza: Në fazën e parë është thënë “mirath”, pastaj shkronja “th” është shndërruar në “s” dhe është thënë “miras” e pastaj shkronja “s” është shndërruar në “z” dhe është thënë “miraz”. Mirëpo, me kalimin e kohës përdoret vetëm në formë nënçmuese për të drejtën trashëgimore, të cilën e kërkon vajza e martuar për t’ia bashkangjitur burrit të saj.

Pasi që një gjë e tillë ka filluar të zbatohet, dhe është bërë zakon, asaj i është mohuar edhe e drejta e vizitës së familjes së saj, të drejtë të cilën e kishte me kanun, sepse vëllezërit u thonë motrave: nëse kërkon hiqe, nuk keni të pame në shtëpitë tona.

Në kanunin e Lekë Dukagjinit thuhet: “Djemtë kanë hiqe, kurse vajzat nuk kanë marrë hiqe për shkak se ato martohen dhe krijojnë familje diku tjetër. Vëllezërit i marrin në pushime. Ato kanë të drejtë dy herë në vit (për pushime) nga dy javë apo nga një muaj.

Atëherë në katund i kanë dhënë larg dhe për këtë dy herë në mot ka shkuar vajza në shtëpinë e vet”.

Përfundojmë në atë së feja Islame i ka dhënë të drejtë trashëgimie gruas, vajzës, nënës, gjyshes, vajzës së djalit, motrës, motrës nga nëna, motrës nga babai dhe i ka radhitur në radhën e trashëgimtarëve të domosdoshëm (as’habul furud), me kushte dhe rrethana të caktuara, me pjesë të domosdoshme, nëse plotësohen ato kushte.

Sipas L.T.K trashëgimtarët radhiten në tri radhë:

Radha e parë

Në radhën e parë të vdekurin e trashëgojnë:

1. Fëmijët; dhe
2. bashkëshorti

Në nenin 12 të L.T.K-së thuhet “Trashëgimlënësin e trashëgojnë para të gjithëve fëmijët e tij dhe bashkëshorti i tij”.

Radha e dytë

Nëse i vdekuri nuk ka pasardhës, trashëgojnë:

1. Prindërit; dhe
2. Bashkëshorti

Në nenin 14.1 të L.T.K-së thuhet “Pasurinë e trashëgimlënësit, që nuk ka lënë pasardhës, e trashëgojnë prindërit e tij dhe bashkëshorti i tij”.

Radha e tretë

Nëse i vdekuri nuk ka lënë pasardhës, bashkëshort, prindër, dhe prindërit e tij nuk kanë lënë pasardhës të tjerë, atëherë e trashëgojnë gjyshërit dhe gjyshet e tij.

Në nenin 18.1 thuhet: “Pasurinë trashëgimore të trashëgimlënësit, që nuk ka lënë pasardhës, bashkëshort, prindër, dhe prindërit e tij nuk kanë lënë pasardhës të tjerë, e trashëgojnë gjyshërit dhe gjyshet e tij.”

Në fund trashëgon edhe Komuna

Në nenin 21.1 thuhet: “Nëse trashëgimlënësi nuk ka lënë as trashëgimtarë ligjor dhe as testament, konsiderohet se trashëgimia i takon komunës, ku trashëgimlënësi ka pasur vendbanimin e tij të fundit”.

ÇKA DUHET TË DIMË RRETH LARGIMIT TË DËMIT

Njeriu, i krijuar si qenie e lirë në natyrë, ballafaqohet në jetën e tij me shumë vështirësi. Vështirësitë e tij janë të natyrave të ndryshme. Për largimin e atyre vështirësive nevojitet urtësi. Ka dallim në mes të urtësisë dhe diturisë. Përderisa dituria të mëson të mirën dhe të keqën, atëherë urtësia të mëson ta dallosh një të mirë më të mirë prej dy të mirave apo një të keqe më të vogël prej dy të këqijave.

Është e domosdoshme që dëmi të largohet, mirëpo në rend të parë duhet të dimë se çka është domosdoshmëri. Domosdoshmëria është *çështja* apo *veprim* prej të cilës varet jeta e njeriut si për këtë botë ashtu edhe për botën tjetër, ashtu që nëse mungon kjo *domosdoshmëri*, vihet në rrezik jeta në këtë botë, zhduken të mirat dhe fitohet ndëshkimi në botën tjetër.

Sheriati parasheh lehtësim dhe përkujdeset për parimin *largimi i dëmit dhe i vështirësive* sepse rregulli i fikhut është *dëmi duhet të mënjanohet*. Dhe largimi i dëmit është obligim.

Ky rregull tregon se, nëse **dëmi veçse ka ndodhur, ai duhet të mënjanohet**, mirëpo nga ky rregull rezultojnë edhe rregullat e tjera e prej atyre është edhe ky: **Dëmi nuk mënjanohet me të njëjtin dëm, e mos të flasim që të mënjanohet me dëm edhe më të madh.**

Po ashtu, duhet ditur se dëmi individual duhet të përballohet për t'u mënjанuar dëmi i përgjithshëm apo kolektiv.

Po ashtu edhe **dëmi më i madh mënjanohet duke shkaktuar dëm më të vogël**. Kur dy të këqija ndodhen në të njëjtën kohë lejohet që të veprohet e keqja më e vogël për të larguar të keqen më të madhe, si p.sh.:

- Lejohet të pranohet shpërblimi për **thirrje të ezanit** sepse po të mos thirret ezani, atëherë dëmi do të ishte edhe më i madh.
- Lejohet të pranohet shpërblimi për **imam** (edhe pse është i ndaluar pranimi i pagës për imam) sepse po të mos kishte imam, atëherë e keqja do të ishte edhe më e madhe.
- Lejohet të jepet **mësim të fikhut me pagesë** edhe pse në përgjithësi është i ndaluar pranimi i pagesës për mësim të fikhut, por lejimi bëhet sepse po të mos kishte mësues të fikhut atëherë e keqja do të ishte edhe më e madhe.

Sa i përket largimit të dëmit, ai duhet të ketë prioritet nga sjellja e dobisë. Andaj rregulli i fikhut është: **Ka prioritet largimi i dëmit kundrejt sjelljes së dobisë.** Kjo nënkupton se, nëse në të njëjtën kohë paraqitet edhe dëmi edhe dobia, atëherë i jepet përparësi largimit të dëmit e jo sjelljes së dobisë së atij momenti.

Njeriu mund të ballafaqohet me vështirësi ku i kanoset rreziku i ekzistencës së tij, atëherë të lejuarit e të ndaluarës në rast nevojë është domosdoshmëri sepse **nuk ka obligim në rast pamundësie, ashtu siç nuk ka ndalesë (haram) në rast domosdoshmërie.** Ky rregull ndërtohet mbi bazat e përgjithshme të Kur'anit nga ajeti kur'anor: **“Allahu nuk e ngarkon (obligon) njeriun më shumë se sa ka aftësi ai.”**

Ndërsa pjesa tjetër e rregullit: **Nuk ka ndalesë në rast domosdoshmërie.** Rezulton nga pjesa e ajetit kur'anor: **“Dhe kush është i detyruar (dhe hanë mishin e derrit, cofëtinën, mishrat e ndaluar) pa dëshirën e tij dhe nuk tejkalon, nuk ka mëkat për të.”** Për këtë arsye dijetarët kanë thënë: **Absurde është të obligohet njeriu të bëjë të pamundurën.** Nëse njeriu ka uri vdekjeje dhe gjen dy dele dhe prej atyre deleve njëra është e prerë dhe tjetra e ngordhur, në atë rast ai i jep përparësi njëres prej tyre edhe pse njëra dele është e lejuar, ndërsa tjetra është e ndaluar sepse të larguarit nga e ndaluara (harami) ka përparësi nga të afruarit e së lejuarës (hallallit).

Në fund e kemi rregullin: **domosdoshmëria i lejon të ndaluarat deri sa të zgjat ajo domosdoshmëri,** kjo do të thotë se kur të tejkalohet ajo domosdoshmëri kthehet rregulli në bazën e saj, shembull, nëse një mësuese në kohën e menstruacionit e ka ndaluar ta prek mus'hafin, mirëpo në orën kur ajo i mëson fëmijët ajo gjatë asaj ore e ka të lejuar prekjen e mus'hafit deri sa të përfundoj ora e mësimi dhe që nga momenti kur të përfundon ora e mësimi ajo prapë e ka të ndaluar prekjen e mus'hafit sepse ajo domosdoshmëri e mësimi të Kur'anit vetëm se ka kaluar. Kësisoj krahaso edhe çështjet tjera sepse feja islame është për lehtësim dhe jo për vështirësim. Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“... dhe nuk ju obligoi në fe me ndonjë vështirësi.” (El Haxh : 78)**

DUNJAJA

Dunja do të thotë ajo çka është e poshtme, e ulët.

Ahiret do të thotë ajo çka është e lartë, çka vjen pas.

Njeriu nga poshtë do të shkoj lartë, nga kjo botë do të shkoj në botën tjetër. Për njeriun kjo botë është vetëm një stacion ku pret momentin për të hipur në autobusin (arkivolin) për të shkuar në botën tjetër dhe asgjë tjetër.

1. Dunjaja sprovë

Dunjaja është vend prove për njerëzit dhe për t'i sprovuar ata, Zoti i Lartëmadhëruar thotë:

“Dhe, dijeni se pasuria e juaj dhe fëmijët tuaj janë vetëm një sprovë, dhe se te Allahu është shpërblimi i madh.” (El Enfal, 28).

Në një ajet tjetër Zoti i Lartëmadhëruar thotë:

“Dhe mos i hedh sytë me lakmi për gjëra të cilat Ne ia kemi dhënë disave prej tyre për kënaqësi të shkëlqimit (të përkohshëm) të jetës së kësaj bote me qëllim që Ne të mund t'i provojmë me ta” (Taha: 131)

2. Dunjaja zbukurim

Dunjaja përpos që është sprovë është edhe zbukurim, mirëpo ai zbukurim duhet shfrytëzuar pozitivisht e jo negativisht, jo për shfrenim dhe vetëm dëfrim. Allahu i Lartësuar thotë:

“Burrave u është hijeshuar dashuria për gjërat e dëshiruara; për gratë, fëmijët, arin dhe argjendin e grumbulluar, kuajt e bukur, bagëtitë dhe arat e lëruara. Këto janë kënaqësitë e kësaj jete, por kthimi tek Allahu është shumë më i mirë” (Ali Imran, 14).

Edhe pse pasuria dhe fëmijët janë stoli, duhet ditur se qëllimi kryesor i njeriut duhet të jenë veprat e mira dhe të përgjithmonshme, siç thotë Zoti i Lartëmadhëruar:

“Pasuria dhe djemtë janë stoli e jetës së kësaj bote. Por veprat e mira që mbeten përherë, janë më të mira te Zoti yt sa i përket shpërblimit dhe, janë më të mira sa i përket shpresës për shpëtim”.

Po kështu Allahu i drejtohet Muhamedit s.a.v.s. duke i thënë: **“Dhe mos i heq sytë mënjanë prej tyre duke dëshiruar vetëm bukurinë e kësaj bote”** (El-Kehf : 28).

Në të vërtetë jeta e kësaj botë është zbukuruar, dhe është bërë qëllimi kryesor i njeriut.

Kjo dunja në vend se të bëhet bahçe e ahiretit, mund të jetë edhe shkatërrimtare për njeriun.

3. Dunjaja kalimtare

Jeta e kësaj bote do të largohet dhe do ta pason bota tjetër (Ahireti) ajo që ishte e largët do të bëhet e afërt Zoti i Lartëmadhëruar thotë: **“Çka është me ju që tuboni pasuri derisa t’i vizitoni varret”**(et-Tekathur,1).

Njeriu në këtë dunja është vetëm kalimtarë dhe kalimtari nuk është i qëndrueshëm as natën dhe as ditën. Udhëtari në të vërtetë ndoshta mund të zbresë në një vend dhe të pushojë e të qetësohet, ndërsa udhëtari i kësaj jetë nuk pushon asnjëherë: ai gjithnjë është në udhëtim, çdo moment që kalon ai pret një pengesë nga kjo jetë për t’iu afruar jetës tjetër, Ahiretit. Ashtu siç për udhëtarin patjetër do të vijë dita që të mbarojë udhëtimi i tij ashtu edhe për ne patjetër do të vijë dita që do të vdesim. Thotë Allahu i Lartësuar: **“Gjithsecili do ta shijojë vdekjen”** (Ali Imran, 185).

4. Dunjaja kënaqësi e përkohshme

Allahu i Lartësuar në Kuran thotë: **“... Por në të vërtetë e vogël është kënaqësia e jetës së kësaj bote e krahasuar me Jetën e Ahiretit”** [Et-Teube:38].

Dhe thotë Allahu duke treguar për njeriun që besoi nga populli i Firaunit: **“Nuk ka dyshim se kjo jetë e kësaj bote (dunjaja) nuk është veçse një kënaqësi (e përkohshme) dhe sigurisht se Jeta e Fundit (Ahireti) ajo është banesa që do të mbetet përgjithmonë”** (El-Gafir: 39).

Pasi që dunjaja është e përkohshme nuk duhet lakmuar në ata të cilët kanë shumë pasuri, sepse pasuria e tyre për ta është sprovë e ku e di ti a mos vallë do të kishe mundur ta kalosh atë provim.

“Dhe mos i hedh sytë me lakmi për gjëra të cilat Ne ia kemi dhënë disave prej tyre për kënaqësi të shkëlqimit (të përkohshëm) të jetës së kësaj bote me qëllim që Ne të mund t’i provojmë me ta” (Taha: 131).

5. Dunjaja të largon nga përkujtimi ndaj Zotit

Dunjaja e largon vëmendjen në përkujtimin e Zotit, për këtë arsye Allahu i Lartëmadhëruar na ka tërhequr vërejtjen kur ka thënë: **“O ju që keni besuar mos t’jua largojnë vëmendjen nga kujtimi i Allahut as**

pasuritë tuaja dhe as fëmijët tuaj. Dhe kushdo që e bën këtë, atëherë ata janë të humburit” (El-Munifukunë: 9).

Dashuria e kësaj dunjaje sjell shpresën e gjatë që hedh tek njeriu harresën, kështu që harron Krijuesin e tij ,e harron Zotin e tij duke mos e llogaritur që ai do te vdesë dhe do të dalë para Tij.

6. Dunjaja është rivalitet në mes njerëzve

Rivaliteti i njerëzve në këtë botë është i pandalshëm dhe në të gjitha fushat e jetës por të gjitha rivalitetet përmbledhen në tubim të pasurisë

Këtë fakt e ka përmendur edhe Allahu i Lartësuar në Kur'anin Famëlartë: **“Ju ka hutuar rivaliteti për të shtuar derisa të shkoni në varre”** që do të thotë se: Ju ka hutuar rivaliteti për të pasur sa më shumë pasuri, fëmijë, duke e harruar bindjen ndaj Allahut. Pastaj vazhduat të ishit në këtë gjendje, derisa ju erdhi vdekja dhe u varrosët nëpër varre.

Ndalimi i rivalitetit për të mbledhur sa më shumë pasuri nuk do të thotë urrejtje ndaj pasurisë. Por qëllimi i vërtetë i ndalimit është, se njeriu duhet ta kërkojë pasurinë në rrugë të ligjshme dhe duhet ta shpenzojë atë po në rrugë të ligjshme, dhe ta ketë në shërbim të tij e jo të bëhet shërbyes i saj.

Po ashtu, pasuria nuk duhet të zotërojë zemrën e njeriut, por njeriu duhet ta zotërojë atë në dorën e tij, sepse edhe pasuria në momentet ë caktuara nuk e kryen detyrën e saj sepse e humb vlerën.Thotë Zoti i Lartëmadhëruar:

“Dijeni se jeta e kësaj bote është vetëm lojë, dhe qejf, dhe mburrje e ndërsjellë mes jush dhe rivalitet për pasuri e fëmijë tamam si bimësia pas shiut ku rritja e saj e kënaq bujkun; më pas ajo thahet dhe e sheh të zverdhet, pastaj ajo bëhet kashtë. (El-Hadidë,20).

7. Dunjaja është mashtruese

Dunjaja, edhe pse është bahçe me të cilën fitohet bota tjetër, ajo është mashtruese.

Dashuria e kësaj dynjaje sjell shpresën e gjatë që hedh tek njeriu harresën, kështu që harron Jetën tjetër dhe nuk përpiqet për të duke mos e llogaritur që ai do te vdesë.

Sado që njeriu angazhohet të mbledhë sa më shumë pasuri nga kjo dynja, vazhdon të ndjejë nevojë dhe varfëri.

Sado që mbledh nga pasuria e dynjasë gjendja shpirtërore i shqetësohet saqë arrin në sëmundje nervore: tensioni apo stresi apo sëmundje të depresionit, thotë Zoti i Lartëmadhëruar:

“E jeta e kësaj bote është vetëm kënaqësi mashtruese.” (El-Hadid: 20)

8. Dunjaja dhe tubimi i pasurisë

Pasuria nuk duhet të zotërojë zemrën e njeriut, por njeriu duhet ta zotërojë atë në dorën e tij.

Njeriu është gatuar që ta dojë pasurinë, ai ka dëshirë të zjarhtë për të pasur pasuri dhe për këtë arsye ai përpiqet që ta mbledhë atë, Ibnu Abasi dhe Enes ibnu Malik transmetojnë, se Muhamedi a.s. ka thënë:

“Në qoftë se i biri i Ademit do të kishte një luginë me flori, do të dëshironte të kishte dy lugina (flori). Mirëpo barkun e tij nuk e mbush asgjë tjetër përveç dheut. Allahu ia pranon pendesën atij njeriu që pendohet”.

Biri i Ademit asnjëherë nuk ngopet me pasuri, nëse ai ka një luginë me flori do të kërkojë dy lugina. Po nëse i jepen dy lugina flori i dëshiron tri lugina. Ndërkaq barkun e tij nuk e mbush asgjë tjetër përveç dheut. Kjo do të ndodhë atëherë kur ai të vdesë, të varroset dhe do ta lërë këtë botë e gjithçka që ka në të”.

Tregohet se njëherë një mbret që zotëronte shumë toka, i thotë një plaku të vjetër: Ti do të nisesh nga pallati im nga ky drejtim. Do të vazhdosh të ecësh sa të duash. Në momentin që do të ndalosh, do të masim distancën nga pallati im deri tek vendi ku ke ndaluar dhe unë do të të jap aq pronë nga tokat që unë zotëroj. Plaku i kënaqur nga oferta bujare e mbretit, filloi të vraponte që të kishte sa më shumë pronë. Vrapoi e vrapoi derisa u lodh, më pas filloi të ecte, ec e ec derisa u lodh. Më në fund ndaloi, por nga lodhja e tepërt u shtri barkas dhe duke qenë se ishte lakmitar i madh i shtriu edhe duart që të përfitonte sa më shumë. Mirëpo ngaqë ishte lodhur shumë zemra i pushoi në vend dhe vdiq. Mbreti që po e ndiqte nga mbrapa me kalë, i tha shoqëruesve: “Matni gjatësinë e tij, përgatitini një arkivol dhe pastaj varroseni, sepse njeriu nuk merr nga kjo botë më tepër se masa e gjatësisë së tij”.

Po të ishte përfundimi me vdekjen do të ishte lehtë por pas vdekjes vazhdon vështirësia edhe më e madhe këtë e tregon Kur’ani kur tregon për ata të cilët depozitojnë pasuri:

“Atë ditë kur ajo (pasuri e deponuar) fërgohet në prushin e xhehenemit, e me të (ashtu zharavë) lyhen ballët, anët dhe shpinat e tyre (do t’u thuhet): “Kjo është ajo që e depozituar për veten tuaj, pra shijoni atë që e depozitonit!” (et-Tevbe, 35).

Tregimi i Karunit, njeri nga njerëzit e profetit Musa, rrëfëhet në Kur’an si shembull tipik i një karakteri me pasuri të kësaj bote. Së bashku Karuni dhe ata që vrapojnë pas pasurisë dhe që largohen nga feja për shkak të pasurive dhe në këtë mënyrë e humbin edhe dunjanë edhe ahiretin

Karuni ishte nga populli i Musait dhe ai shtypte atë popull ngase Ne i patëm dhënë aq shumë pasuri sa që një grup i fuqishëm mezi bartin çelësat e (pasurisë së) tij, e kur populli i vet i tha: **"Mos u kreno aq fortë sepse All-llahu nuk i do të shfrenuarit!"**

Kur’ani e nxit njeriun, që të kërkojë riskun e tij e të mbledhë pasuri, por me kusht që pasuria të mos e shmangë nga adhurimi i Allahut. Allahu i Lartësuar thotë: **“Përpiqu me atë që të ka dhënë Allahu të fitosh jetën e botës së ardhshme, duke mos harruar pjesën tënde në këtë botë. Bëju mirë të tjerëve, ashtu si të ka bërë mirë Allahu ty. Mos kërko ngatërresa në Tokë, sepse Allahu nuk i do ngatërrestarët.”**

Po Ne atë dhe pallatin e tij i shafuam në tokë dhe, veç All-llahut nuk pati që ta mbrojë e as vetë nuk pati mundësi të mbrohet.

Karuni dhe ata që kanë aspirata që të bëhen sikur ai, e kuptojnë se veprat e liga që ata i bëjnë i kujtojnë vetëm kur ndeshen me fatkeqësi. Pas të gjitha të këqijave që bie mbi ta, nëse ende vazhdojnë me të njëjtin avaz që ngre neveri ndaj Allahut, ata janë plotësisht të shkatërruar. Fundi i tyre do të jetë i pashmangshëm: ferri (xhehenemi), një vend i lig në të cilin do të mbesin përgjithmonë!

Tregohet një tregim se si dunjaja është vrasëse e vet njeriut nëse nuk është i kujdesshëm dhe i vëmendshëm të cilin po e tregojmë në përfundim të kësaj teme:

Një ditë prej ditëve Isa a.s. del të shëtisë nëpër tokë. Gjatë udhëtimit atë e shoqëron një jehudi i cili me vete i kishte dy bukë, ndërsa Isa a.s. vetëm një.

Isa a.s. i thotë: **“T’i bashkojmë ushqimet tona?”**

Po - ia kthen jehudija.

Mirëpo, më vonë, kur e kupton se Isa a.s. e kishte vetëm një bukë, u pendua.

Isa a.s. u ngrit dhe filloi të falej. Deri sa Isa a.s. falej, jehudia, i cili ishte bashkudhëtar, e ha një rën bukë.

Pasi që e përfundon Isa a.s. të falurit, fillojnë ta shtrojnë ushqimin në tryezë.

Isa a.s. i thotë: “Ku është buka tjetër?”

- Jo, ka qenë (e kam pasur) vetëm një bukë. - i përgjigjet.

Isa a.s. e ha një rën bukë, shoku i tij bukën tjetër dhe e vazhdojnë rrugën.

Gjatë rrugës ndalen nën hijen e një lisi.

Isa a.s. i thotë: “Ta kalojmë natën dhe të flemë sonte nën këtë lis”.

Jehudia pranon. Dhe ranë në gjumë që ta kalonin natën aty.

Në mëngjes jehudia, kur u zgjua, ishte verbëruar.

Isa a.s. i tha: “Çka mendon sikur të ta kthejë shikimin, a do të më falënderojë?”

Po - i tha jehudia.

Isa a.s. ia lëmoi sytë e tij dhe atij i vjen shikimi.

Pastaj Isa a.s. i thotë: “Pashë Atë që ta ktheu shikimin! A e ke pasur edhe një bukë?”

Jahudia i përgjigjet: - Betohem në Zotin se e kam pasur vetëm një bukë.

Isa a.s. hesht.

Duke udhëtuar e sheh një kaproll duke kullotur. Isa a.s. e thërret, e ai vjen. E prenë, e përgatisin dhe e hanë.

Pastaj Isa a.s. i thotë kaprollit: “Me emrin e Allahut ngjallu!”. Kaprolli ngjallet dhe merr rrugën e tij.

Ai thotë: “SubhanAllah!” (Qoftë i Lartësuar Zoti).

Isa a.s. i thotë: Pashë këtë argument që po e sheh! Kush e hëngri bukën e tretë.

Ai u përgjigj se nuk ka pasur më shumë se një bukë!

Vazhdojnë rrugën, gjatë rrugës nevojitej të kalohet një lumë i madh, i cili nuk e kishte urën.

Isa a.s. e merr për dore jehudinë dhe e kalojnë lumin pa u lagur.

Ai thotë: “SubëhanAllah!” (Qoftë i Lartësuar Zoti)

Isa a.s. i thotë: “Pashë këtë argument që po e sheh, kush e hëngri bukën e tretë?”

Ai thotë: “Për Zotin nuk ka qenë, pos një bukë”.

Vazhdojnë rrugën, derisa arrijnë në një fshat të madh, ku në periferi të atij fshati i gjejnë tre thasë të mëdhenj të mbushur me flori.

Isa a.s. tha: “Një thes flori më takon mua, një thes flori ty dhe një thes flori i takon atij, i cili e ka ngrënë bukën e tretë.”

Jehudia thotë: “Po unë e kam ngrënë bukën e tretë derisa ti flije”.

Isa a.s. i thotë: “Po t’i jap që të tre thasët me flori”, dhe largohet e ndahet prej tij.

Pasi që thasët me flori ishin të rëndë, ai nuk mundi t’i barte. Aty pranë kalojnë tre njerëz të cilët e mbytin atë, dhe ia marrin thasët me flori.

Dy prej tyre i thonë të tretit: “Shko në qytet dhe na sill ushqim”.

Ai shkon në qytet për të sjell ushqim

Ata dy që mbetën merren vesh, që kur ai të kthehet, ta mbysin dhe t’ia marrin hisen e tij të floririt.

Ai, i cili kishte shkuar të merrte ushqim në qytet mendon në vetvete: “Ushqimin do ta helmoj dhe do t’i mbys që të dy, kështu do t’i marr që të tre thasët me flori”. Dhe ashtu vepron, siç e kishte mësuar shejtani.

Kur u kthye me ushqim të helmuar, ata e hanë pasi që e mbysin, ndërsa, pastaj, edhe vetë vdesin pranë thasëve të floririt.

Isa a.s. shkon aty dhe kur i sheh që të katërt të mbytur pranë arit. Sinjalizoi me gisht te ata katër persona dhe havarijunëve, të cilët ishin me të u thotë: **“Kështu, lakmia e kësaj bote ju bën juve, andaj kini kujdes dhe ruajuni!”**.

Librat autoriale dhe të përkthyer (nga autori)

- |1. Besimi në Zotin|
- |2. Melaqet e Zotit|
- |3. Besimi në Librat e Zotit|
- |4. Pejgamberët e Zotit|
- |5. Besimi në Ditën e Kijametit|
- |6. Besimi në Kaderin e Zotit|
- |7. Tregime nga jeta e Muhamedit a.s|
- |8. Fikhu i Namazit|
- |9. Fikhu i Zekatit|
- |10. Fikhu i Agjërimit|
- |11. Fikhu i Haxhit|
- |12. Dashuria|
- |13. Singeriteti|
- |14. Drejtësia|
- |15. Amaneti|
- |16. Turpi|
- |17. Durimi|
- |18. Morali|
- |19. Falënderimi|
- |20. Bamirësia|
- |21. Mëshira|
- |22. Bujaria|
- |23. Vërtetësia|

- |24. Emërtoni fëmijët tuaj me emra të bukur|
- |25. Nata e dhëndërisë|
- |26. Dita e vdekjes dhe e varrimit|

- |27. Texhvidi i muslimanit të vogël|
- |28. Shkruaj lexo dhe mëso shkronjat e Kur'anit|
- |29. Planprogrami i muslimanit të vogël|
- |30. Drita e jetës|
- |31. Lutjet e jetës nga Kur'ani fisnik|
- |32. Këshilltari fisnik për djem dhe vajza (*nga autori Muhamed Sajim*)|

- |33. Trashëgimia|
- |34. Vasijeti|
- |35. Vakëfi|
- |36. Ixhtihadi|
- |37. Usuli fikhu për fillestarë|
- |38. Kurhani|
- |39. Statuti i familjes|

- |40. Dëshiroj të jem ai që nuk duhet të jem|

- |41. Dëshmorët e Prillit në Rakoc dhe Lagje të Re|
- |42. Fadil Çaka – Komandant Sharri||

- |43. Texhvidi – Shkenca e të lexuarit (kënduarit) të përpiktë të Kur'anit|
- |44. Mrekullitë numerike në Kur'anin Fisnik (*nga autori Abdurrezak Nufel*)|

- |45. (Pa)Mundësia e përkthimit të Kur'anit|
- |46. Tema të zgjedhura dhe të nevojshme|
- |47. Kryesore në terminologjinë e Hadithit (*Abduhu Abas El-Velidi*)|
- |48. Fjalë të arta të më të mirit të njerëzimit Muhamedit s.a.v.s. (*Abdul Fetah Xhemilë Berri*)|
- |49. Tregime për ta arritur kulminacionin e mirësisë dhe përsosmërinë e devotshmërisë (*nga autori Muhamed Eminë Xhundi*)|
- |50. Usuli fikhu islam - I - Ligjet e sheriatit - (*Vehbetu Zuhejli*)|**
- |51. Usuli fikhu islam - II - Përpilimi i ligjeve prej teksteve të sheriatit - (*Vehbetu Zuhejli*)|**
- |52. Usuli fikhu islam - III - Kur'ani dhe Suneti – (*Vehbetu Zuhejli*)|**
- |53. Usuli fikhu islam - IV - Ixhmai - (*Vehbetu Zuhejli*)|**
- |54. Usuli fikhu islam - V - Kijasi - (*Vehbetu Zuhejli*)|**
- |55. Istihسانی (*Vehbetu Zuhejli*)|**
- |56. Parimi i interesit (*Vehbetu Zuhejli*)|**
- |57. Fetavatë (*Muhamed Muteveli Esh-Shaëravi*)|**
- |58. Fundi i botës (*Muhamed Muteveli Esh-Shaëravi*)|**
- |59. Madhështia e islamit (*Muhamed Muteveli Esh-Shaëravi*)|**
- |60. Këto llogariten furnizime (*Muhamed Muteveli Esh-Shaëravi*)|**
- |61. Për Kushtetutën Islame (*Dr. Muhamed Sejid Ahmed El- Musejer*)|**
- |62. Shkurtimi i thonjve në dritën e sunetit dhe mjekësisë (*Ebul Vefa Abdul Ahar dhe Jahja Nasir*)|**
- |63. Islami dhe Politika (*Dr. Jusuf Kardavi*)|**

- |64. *Toka e Israsë (Pikat kritike palestinezo-izraelite)*|
- |65. *Për hulumtuesit e fesë së vërtetë (Muhamed Hisham Tilbete)*|
- |66. *Vëllazëria në islam dhe zemra e shëndoshë (Amër Halid)*|
- |67. *Superfuqia në Allahun (Amër Halid)*|
- |68. *Shpresa duhet të jetë besim dhe veprim (Amër Halid)*|
- |69. *Bindja e thellë në Allahun (Amër Halid)*|
- |70. *Shpresa në Allahun (Amër Halid)*|
- |71. *Shpresa në Allahun duhet të jetë besim dhe veprim (Amër Halid)*|
- |72. *Vendosmëria në fenë e Allahut (Amër Halid)*|
- |73. *Pasojat e mëkateve (Amër Halid)*|
- |74. *Vëllazëria muslimane (Amër Halid)*|
- |75. *Mjetet e vendosmërisë në fenë e Allahut (Amër Halid)*|
- |76. *Vlera e kohës (Amër Halid)*|
- |77. *Serioziteti (Amër Halid)*|
- |78. *Pozitiviteti (Amër Halid)*|
- |79. *Pendimi (Amër Halid)*|
- |80. *Trashëgimia në islam (për fillestarë)*|
- |81. *...apo...|*
- |82. *Shkurorëzimi dhe IDDETI*|
- |83. *Tradita (Dr. Vehbetu Zuhejli)*|
- |84. *Ligji para nesh dhe medhhebi i sehabiut (Dr. Vehbetu Zuhejli)*|
- |85. *Kujtime lufte*|
- |86. *Tema të zgjedhura dhe të nevojshme*|

Përmbajtja:

Kapitulli i parë	5
Qëndrimi i Islamit ndaj diturisë, arsimit dhe shkencës	5
Rreth ditës së mësuesit	13
Në barnatoren e lutjeve	15
Rukja – Pështymfryerja	20
Mrekullia logaritmike në Kur'an	25
Hapat e shejtanit	31
“E mira” dhe “e keqja”	38
Devotshmëria, arma më e fortë e besimtarit	50
Israja dhe Miëraxhi	52
Ettehiyatu dhe Miraxhi	58
 Kapitulli i dytë	60
Për të qenë thirrësi islam i suksesshëm	60
Islami është paqe	63
Politika në islam	65
Personaliteti islam	69
“Politika në islam”, “islami politik” dhe “politika islame”	72
Laicizmi dhe feja islame	79
Politika në bazë të Kur'anit	82
Të drejtat e fëmijëve në islam	85
Sheriati islam dhe ligjet njerëzore	94
Medhhebi dhe Medhhebet	97

Kapitulli i tretë	100
Shekullarizmi, Laicizmi dhe Vehabizmi	100
Sektet e filluara brenda islamit dhe të nxitura nga jashtë apo të nxitura nga jashtë e pastaj të filluara nga brenda	110
Sektet dhe medhhebet në islam	125
Zanafilla e Havarixhëve dhe mentaliteti i ngurtë i tyre	136
Vehabijtë, Shirku, Tekfiri, Bidati dhe Taguti	140
Pikat dalluese të vehabizmit	146
Dialog i imagjinuar në mes të profesorit vehabist dhe studentit vehabist	151
 Kapitulli i katërt	 156
Nocioni i “Fetvasë” dhe “Muftisë”, dhe e drejta e gruas për të dhënë “Fetva” dhe për të qenë “Mufti”	156
Sistemi islam sistem i mesatares	160
Limiti i profitit në tregti i papërcaktuar	166
Festat dhe manifestimi i tyre	169
Pajtimi	171
Martesa, dasma dhe dënimi i shpenzimeve të dasmës	178
Koha e obligueshmërisë së dhënies së zekatit të trupit dhe zekatit të pasurisë	184
Ezani, zhurmën e shndërron në qetësi shpirtërore	187
Detyrat ndaj të vdekurit	194
Rreth ngushëllimit për të vdekurit dhe mënyrat e shprehjes së ngushëllimit	197
Tradita (el-urfu)	201
Trashëgimia e femrës në shariatën islam	207

Historiku i të drejtës trashëgimore në islam	215
Çka duhet të dimë rreth largimit të dëmit	233
Dunjaja	235